

**VENDIMET E  
KOMISIONIT TË  
KONKURRENCËS  
2017**

**BULETINI ZYRTAR**

|                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>VENDIME ME OBJEKT – PËRQENDRIME</b>                                                                                                                                                                                                                                                       | <b>1</b>  |
| <b>Nr. 452, datë 07.03.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>1</b>  |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të JT International Tirana SHPK nga Marketing & Distribution SHPK nëpërmjet JT International Holding B.V.                                                                                                     | 1         |
| <b>Nr. 456, datë 28.03.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>4</b>  |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Tobacco Press d.o.o. Mostar dhe Aseteve të Duhanit të Fabrika Duhana Sarajevo d.d. nga British American Tobacco Investments Limited.                                                                       | 4         |
| <b>Nr. 457, datë 11.04.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>7</b>  |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Reynolds American Inc. nga Batus Holding Inc.                                                                                                                                                              | 7         |
| <b>Nr. 459, datë 25.04.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>10</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Fannie May Confections Brands Inc. nga Ferrero International S.A..                                                                                                                                         | 10        |
| <b>Nr. 463, datë 06.06.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>13</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrjeje të re të pavarur me funksione të plota ndërmjet “BMW AG / Daimler AG / Ford Motor Company / Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft.                                                                  | 13        |
| <b>Nr. 464, datë 06.06.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>17</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të rrjetit të shpërndarjes së shoqërisë Fabrika Duhana AD Banja Luka si dhe përfutimi i 100% të aksioneve të Express Logistic and Distribution EOOD nga British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited. | 17        |
| <b>Nr. 465, datë 20.06.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>20</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 49% të ndërmarrjes ITD SHPK, nga INVESTMENT JOTI-INFOSOFT GROUP SHPK tek Balfin SHPK.                                                                              | 20        |
| <b>Nr. 468, datë 04.07.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>24</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 100 % të ndërmarrjes Compal Electronics Europe sp z.o.o, nga Compalead Electronics B.V tek Vestel Ticaret A.S..                                                    | 24        |
| <b>Nr. 473, datë 14.09.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>28</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aseteve të ndërmarrjes Izi Mobil Telekomunikacije d.d. nga Telekom Slovenije d.d..                                                                                                                                          | 28        |
| <b>Nr. 474 , datë 14.09.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                             | <b>32</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A nga Intesa Sanpaolo S.p.A ”                                                                                                            | 32        |
| <b>Nr. 478, datë 26.10.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>36</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 90% të ndërmarrjes Insig Jete SHA, nga Eurosig SHA tek Z. Shefqet Kastrati dhe Z. Samir Mane.                                                                      | 36        |
| <b>Nr. 480, datë 09. 11. 2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                            | <b>42</b> |

|                                                                                                                                                                                                     |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të ndërmarrjes Jordan d.o.o. tek Telekom Slovenije d.d..                                                | 42        |
| <b>Nr. 484, datë 23.11.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>45</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek VODAFONE ALBANIA SHA.                                                 | 45        |
| <b>Nr. 485, datë 23.11.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>57</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek TELEKOM ALBANIA SHA.                                                  | 57        |
| <b>Nr. 486, datë 05.12.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>69</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të ndërmarrjes Fitzroy Merger CO, tërësisht e kontrolluar nga CTH Invest S.A. me Ferrara Candy Company Holdings Inc.                | 69        |
| <b>Nr. 487, datë 05.12.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>73</b> |
| Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi Portofolin e Kredisë së Procredit Bank AD Beograd nga Banca Intesa AD Beograd.                                   | 73        |
| <b>VENDIME ME OBJEKT – ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE</b>                                                                                                                                              | <b>77</b> |
| <b>Nr. 447, datë 16.01.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>77</b> |
| Për Dhënien e disa Rekomandimeve Bashkisë Berat për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit funeral                                                                                            | 77        |
| <b>Nr. 450, datë 28.02.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>79</b> |
| Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.                            | 79        |
| <b>Nr. 451, datë 28.02.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>81</b> |
| Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.                            | 81        |
| <b>Nr. 455, datë 28.03.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>85</b> |
| Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhetareve dhe automjeteve në Portin e Vlores.                                                            | 85        |
| <b>Nr. 462, datë 23/ 05 /2017</b>                                                                                                                                                                   | <b>87</b> |
| Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK. | 87        |
| <b>Nr. 466, datë 20.06.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>89</b> |
| Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e distribucionit dhe shfaqjes së filmave në rrjetet e kinemave në Tiranë.                                                                     | 89        |
| <b>Nr. 467, datë 04.07.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>91</b> |
| Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak. | 91        |
| <b>Nr. 469, datë 11.07.2017</b>                                                                                                                                                                     | <b>95</b> |
| Për rekomandime në lidhje me çertifikimin paraprak të shoqërisë “Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror, Albgaz SHA.                                                                              | 95        |

|                                                                                                                                                                                                                                                 |            |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>Nr. 470, datë 11.07.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>97</b>  |
| Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport”.                                                                             | 97         |
| <b>Nr. 472, datë 14.09.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>102</b> |
| Për mbylljen e Hetimit Paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK.                                                         | 102        |
| <b>Nr. 477, datë 12.10.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>105</b> |
| Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit. | 105        |
| <b>Nr. 479, datë 26.10.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>110</b> |
| Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës.                                                                                                                                                 | 110        |
| <b>Nr. 481, datë 16.11.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>115</b> |
| Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror.                                                                                                | 115        |
| <b>Nr. 482, datë 16.11.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>117</b> |
| Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të furnizimit të gazit natyror.                                                                                                  | 117        |
| <b>Nr. 483, datë 16.11.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>119</b> |
| Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të tregtimit të gazit natyror.                                                                                                   | 119        |
| <b>Nr. 488 datë 05.12.2017</b>                                                                                                                                                                                                                  | <b>121</b> |
| Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.                                                                                                                           | 121        |
| <b>Nr. 490 datë 20.12.2017</b>                                                                                                                                                                                                                  | <b>123</b> |
| Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines.                                                                                                                                   | 123        |
| <b>Nr. 491, datë 28.12.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>125</b> |
| Për hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve                                                                                                                                    | 125        |
| <b>Nr. 492, datë 28.12.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>127</b> |
| Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura.                                                         | 127        |
| <b>VENDIME ME OBJEKT - MARRËVESHJE TË NDALUARA</b>                                                                                                                                                                                              | <b>131</b> |
| <b>Nr. 446, datë 16.01.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>131</b> |
| Për hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes.                        | 131        |
| <b>Nr. 453, datë 07.03.2017</b>                                                                                                                                                                                                                 | <b>133</b> |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                  |            |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| Për dhënien e disa Rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe bankat e nivelit të dytë.                                                                                                                                                            | 133        |
| <b>Nr. 454, datë 21.03.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                  | <b>143</b> |
| Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes                                                           | 143        |
| <b>Nr. 461, datë 23.05.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                  | <b>147</b> |
| Për hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare.                                                                                                                                                                                          | 147        |
| <b>Nr. 476, datë 05.10.2017</b>                                                                                                                                                                                                                                                  | <b>149</b> |
| Për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 390, datë 22.12.2015 dhe mbylljen e hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes | 149        |

## VENDIME ME OBJEKT – PËRQENDRIME

### VENDIM

Nr. 452, datë 07.03.2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të JT International Tirana SHPK nga Marketing & Distribution SHPK nëpërmjet JT International Holding B.V.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 07.03.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit nëpërmjet përftimit të kontrollit të JT International Tirana SHPK nga Marketing & Distribution SHPK nëpërmjet JT International Holding B.V..

**Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet, 2, 10-12, dhe neni 16 dhe në veçanti Kreu III "Përqendrimet e ndërmarrjeve" nenet 53-64, Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve", Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit" dhe formulari i thjeshtuar "Për njoftimin e përqendrimit".

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Marketing & Distribution SHPK / JT International Tirana SHPK / JT International B.V dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të "Marrëveshjes lidhur me shitjen dhe blerjen e të gjithë kapitalit aksionar të JT International Tirana SHPK" e lidhur ndërmjet palëve, JT International Holding B.V (në cilësinë e Shitësit) dhe Marketing & Distribution SHPK (në cilësinë e Blerësit), e cila ka si objekt përftimin e të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë JT International Tirana SHPK (Target) nga Blerësi.

Transaksioni i transferimit të 100% të kapitalit themeltar nga Shitësi tek Blerësi në formën e zëvendësimit të pronësisë sjell përftimin e kontrollit të plotë dhe të vetëm të shoqërisë Target (JTI Tirana) nga Blerësi. Ky transaksion, i cili shkakton ndryshim në cilësinë e kontrollit në shoqërinë JT International Tirana SHPK, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës, i ndryshuar ("Ligji").

#### PALËT NË TRANSAKSION

**Marketing & Distribution SHPK,** në cilësinë e Blerësit është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të së drejtës shqiptare, me seli në adresën: Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 10, Tiranë. Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë: (i) të blejë apo të zotërojë në ndonjë mënyrë tjetër, të importojë, magazinojë, ruajë, eksportojë apo tregtojë me shumicë dhe pakicë mallra të ndryshme, përfshirë ato ushqimore,

bujqësore, blegtorale, industriale, lënde të parë minerare, si dhe çdo lloj malli tjetër; (ii) të ushtrojë veprimtari të Duty Free Shop, në përputhje me dispozitat në fuqi, etj.

**JT International Tirana SHPK**, në cilësinë e ndërmarrjes **Target**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të së drejtës shqiptare, me seli në adresën: Rr. "Milto Tutulani" Ndërtesa nr. 6. Hyrja 2, zyra 4, Tiranë. Shoqëria ka si objekt: kryesisht (a) shërbime këshillimi në lidhje me strategjinë e biznesit në sektorin e duhanit; (b) shërbime mbështetëse të administrimit në lidhje me shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të duhanit në Shqipëri, etj..

### **Xhiro për vitin 2015**

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është X.XX Lekë:

– Japan Tobacco International Holding B.V<sup>1</sup> : X.XX Yen<sup>2</sup> = X.XX Lekë.

Xhiro totale në tregun e brendshëm: është X.XX Lekë:

– Marketing & Distribution SHPK<sup>3</sup> : X.XX Lekë;

– JT International Tirana SHPK<sup>4</sup> : X.XX Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 " Për Mbrojtjen e Konkurrencës ", i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## **ANALIZA E KONKURRENCËS**

### **Tregu përkatës**

**Tregu përkatës i produktit** do konsiderohet tregu i importit dhe tregtimit të duhanit.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

### **Struktura e tregut**

Tregu i cigareve në Shqipëri dominohet nga cigare të importuara nga Italia dhe Greqia. Në tregun shqiptar ka një shumëllojshmëri të markave të cigareve të importuara. Në tregun e importit të cigareve operojnë 11 operatorë, dy prej të cilëve kanë pjesë tregu të konsiderueshme.

Ndër kompanitë kryesore: Philip Morris Albania operon në treg me markat e cigareve Marlboro, Merit, Philip Morris, L&M dhe Assos; Agna operon në treg me markat Kamelia, American Legend dhe OME; Marketing & Distribution operon me markat Winston, Camel, Imperial dhe Maxim; dhe British American Tobacco me markat Rothmans, Kent, Lucky Strike.

Philip Morris dhe Agna janë dy konkurrentet kryesore në treg për vitet 2015, 2016. Marketing & Distribution paraqitet si konkurrenti i tretë me i rëndësishëm në treg me 12% të tij për vitin 2015 dhe 9% në vitin 2016. Nga të dhënat rezulton se JT International Tirana nuk ka realizuar importe për vitet 2015, 2016 dhe si pasojë paraqitet me një pjese tregu prej 0%.

### **Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit**

Tregu i cigareve në Shqipëri dominohet nga cigare të importuara nga Italia dhe Greqia me një shumëllojshmëri markash.

Para realizimit të transaksionit, tregu paraqitet me nivele të larta përqendrimi gjatë dy viteve të fundit,

<sup>1</sup> Burimi: Raporti vjetor i shoqërisë JT International.

<sup>2</sup> Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2015, 1¥ = 104.12 Leke.

<sup>3</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2015 për shoqërinë Marketing & Distribution SHPK.

<sup>4</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2015 për shoqërinë JT International Tirana SHPK.

pasi indeksi i përqendrimit për vitin 2015 ishte 3019 dhe ka rënë në vlerën 2655 në vitin 2016.

Menjëherë pas realizimit të transaksionit nuk priten ndryshime të rëndësishme në strukturën e tregut pasi JT International Tirana SHPK nuk ka qenë aktive në tregun e importit dhe shitjes së cigareve të fabrikua gjatë dy viteve të fundit dhe pjesa e tregut e Marketing & Distribution SHPK nuk ndryshon.

**Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56 pika, 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.**

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar:

#### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të JT International Tirana ShPK nga Marketing & Distribution ShPK nëpërmjet JT International Holding B.V.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**



## VENDIM

Nr. 456, datë 28.03.2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Tobacco Press d.o.o. Mostar dhe Aseteve të Duhanit të Fabrika Duhana Sarajevo d.d. nga British American Tobacco Investments Limited.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 28.03.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Tobacco Press d.o.o. Mostar dhe Aseteve të Duhanit të Fabrika Duhana Sarajevo d.d. nga British American Tobacco Investments Limited.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe në veçanti Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit British American Tobacco Investmens Limited / Fabrika Duhana Sarajevo d.d. / Tobacco Press d.o.o. Mostar dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Transaksioni i përqendrimit është realizuar me anë të “Marrëveshjes për shitjen pjesore të asetëve lidhur me shitjen dhe blerjen e pakicës së asetëve të Tobacco-s të Fabrika Duhana Sarajevo d.d.” (“ACA”), e nënshkruar ndërmjet palëve, Fabrika Duhana Sarajevo d.d. (“Shitësi”) dhe British American Tobacco Investments Limited (“Blerësi”), më datë 27 Janar 2017.

Përqendrimi ka formën e një transaksioni asetesh dhe aksionesh, i kombinuar në një transaksion të vetëm që konsiston në përfutimin nga ana e Blerësit mbi baza të qëndrueshme, të kontrollit mbi Asetet e Shitura në përputhje me ACA.

Sipas pjesës së transferimit të asetëve të transaksionit (Asetet e Shitura) dhe në përputhje me ACA, Blerësi do të blejë nga Shitësi: (i) Asetet e Duhanit të Shitësit; (ii) markat e FDS në mënyrë të përkohshme; dhe (iii) Aksionet e Tobacco Press d.o.o. Mostar.

Këto Asete të Shitura blihen në mënyrë simultane dhe blerjet e këtyre dy llojeve të ndryshme asetesh janë të ndërvarrura, në kuptimin që Shitësi nuk angazhohet të shesë dhe Blerësi nuk angazhohet të blejë ndonjë nga këto lloje asetesh, nëse nuk mund t’i shesë apo t’i blejë ato të gjitha.

Si rrjedhojë, në këtë transaksion kontrolli i qëndrueshëm mbi Asetet e Shitura përftohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Blerësi.

Ky transaksion, i cili shkakton ndryshim të kontrollit në shoqërinë Tobacco Press d.o.o. Mostar dhe në asetet e duhanit të Fabrika Duhana Sarajevo d.d., përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10, pika 1, germa c të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës, i ndryshuar (“Ligji”).

### Palët në transaksion

**British American Tobacco Investments Limited**, në cilësinë e **Blerësit** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar dhe që funksionon në bazë të ligjeve të Anglisë dhe Uellsit, me seli në adresën: Globe House, 1 Water Street, London, WC2R 3LA, Mbretëria e Bashkuar. British American Tobacco Investments Limited është një shoqëri investimesh dhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj operon si shitëse me pakicë cigaresh dhe gazetash në Evropën Qendrore dhe Lindore. Shoqëria kontrollohet nga British American Tobacco p.l.c.

Ajo operon në Shqipëri me anë të degës së saj British American Tobacco – Albania ShPK.

**Tobacco Press d.o.o. Mostar (TPM)**: në cilësinë e ndërmarrjes **Target**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjet e Bosnjës dhe Hercegovinës, me seli në Blajburskih Znava br. 62, Mostar. Aktiviteti kryesor i TPM-së është të kryejë shitje me pakicë të librave, gazetave, revistave, produkteve të letrës, cigare dhe artikuj kancelarie. TPM operon me një rrjet prej 256 dyqanesh shitjeje me pakicë të tipit kioska gazetash të ndodhura në 56 degë lokale në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës.

**Asetet e Duhanit** përbëhen nga të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI) mbi asetet e duhanit të zotëruara nga Shitësi (Fabrika Duhana Sarajevo d.d.) në formën e: (i) DPI mbi Asetet e Duhanit dhe (ii) Marrëveshjet DPI mbi Asetet e Duhanit.

### Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **X.XX Lekë**:

- British American Tobacco p.l.c.<sup>1</sup> :  $X.XX \text{ £}^2 = X.XX \text{ Lekë}$
- Fabrika Duhana Sarajevo d.d..<sup>3</sup> :  $X.XX \text{ BAM}^4 = X.XX \text{ Lekë}$
- Tobacco Press d.o.o.. Mostar<sup>5</sup> :  $X.XX \text{ BAM} = X.XX \text{ Lekë}$

Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është **X.XX Lekë**:

- British American Tobacco – Albania ShPK<sup>6</sup> :  $X.XX \text{ Lekë}$

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b të Ligjit.

## ANALIZA E KONKURRENCËS

### Tregu përkatës

**Tregu përkatës i produktit**: Sa më sipër, tregu përkatës i produktit do konsiderohet tregu i importit dhe tregtimt të duhanit të prodhuar nëpërmjet makinerive (FMC).

**Tregu përkatës gjeografik**: Për analizimin e këtij rasti tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni ndodh jashtë tregut gjeografik të Republikës së Shqipërisë, por në kushtet kur pala përfituese e kontrollit ka degë në Shqipëri dhe plotëson kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, Komisioni i Konkurrencës autorizon përqëndrimin.

<sup>1</sup>Burimi: Raporti vjetor për vitin 2015 për shoqërinë British American Tobacco p.l.c.

<sup>2</sup>Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2015, 1£ = 193 lekë.

<sup>3</sup>Burimi: Pasqyrat financiare për 6 mujorin e vitit 2016 për shoqërinë Fabrika Duhana Sarajevo D.D., (të dhënat për vitin FY15)

<sup>4</sup>Burimi: [www.xe.com](http://www.xe.com), 1BAM=69 ALL (BAM – Bosnian Convertible Marka)

<sup>5</sup>Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2015 për shoqërinë Tobacco Press d.o.o. Mostar.

<sup>6</sup>Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2015 për shoqërinë British American Tobacco – Albania ShPK

## **Struktura e Tregut**

Në Shqipëri tregu i duhanit të prodhuar nëpërmjet makinerive (FMC) përbëhet vetëm nga importi i tyre. Në tregun shqiptar ka një shumëllojshmëri të markave të cigareve të importuara. Në këtë treg, për vitin 2016 kanë kryer aktivitetin e importit të produkteve të duhanit rreth 20 kompani, 15 prej të cilave janë kompani importuese të produktit FMC (cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive).

Ndër kompanitë kryesore: Philip Morris Albania operon në treg me markat e cigareve Marlboro, Merit, Philip Morris, L&M dhe Assos; Agna operon në treg me markat Kamelia, American Legend dhe OME; Marketing & Distribution operon me markat Winston, Camel, Imperial dhe Maxim; dhe British American Tobacco me markat Rothmans, Kent dhe Lucky Strike.

## **Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit**

Tregu i duhanit të prodhuar nëpërmjet makinerive në Shqipëri përbëhet vetëm nga duhani i importuar me një shumëllojshmëri markash.

Philip Morris dhe Agna janë dy konkurrentët kryesorë në treg me pjesë tregu për vitin 2016 respektivisht tregu X.XX dhe X.XX. Marketing & Distribution paraqitet si konkurrenti i tretë më i rëndësishëm në treg me X.XX të tij për vitin 2015 dhe X.XX në vitin 2016.

Nga të dhënat rezulton se British American Tobacco – Albania ShPK ka realizuar importe për vitet 2015, 2016 përkatësisht në masën X.XX dhe X.XX të tregut.

Bazuar në karakteristikat e tregut përkatës për duhanin e prodhuar nga makineritë, si dhe nisur nga numri i kufizuar i volumeve të shitjes dhe pjesës së tregut të markave të ndërmarrjes Fabrika Duhana Sarajevo d.d. (FDS) në Shqipëri, përqendrimi nuk do të shkaktojë pasoja negative për konkurrencën në këtë treg. Gjithashtu edhe pjesa e tregut e ndërmarrjes BAT Albania ShPK nuk do të ndryshojë si rezultat i realizimit të këtij transaksioni.

**Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.**

## **PËR KËTO ARSYE:**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar:

## **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Tobacco Press d.o.o. Mostar dhe Aseteve të Duhanit të Fabrika Duhana Sarajevo d.d. nga British American Tobacco Investments Limited.
  - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

**Nr. 457, datë 11.04.2017**

### **Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Reynolds American Inc. nga Batus Holding Inc.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Ne mbledhjen e tij të datës 11.04.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Reynolds American Inc. nga Batus Holding Inc..

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe në veçanti Kreu IV "Procedurat për kontrollin e përqendrimeve" nenet 53 - 64, Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve", Udhezimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit" dhe formulari i thjeshtuar "Për njoftimin e përqendrimit".

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Batus Holding Inc. i Reynolds American Inc. dhe relacionit të Sekretarit të Pergjithshëm,

### **VËREN SE:**

#### **TRANSAKSIONI DHE PERQENDRIMI**

Transaksioni i përqendrimit është realizuar me anë të "Marreveshje dhe plani i bashkimit", e nënshkruar ndërmjet paleve British American Tobacco p.l.c., Batus Holding Inc. ("Bleresi"), Flight Acquisition Corporation (Shoqëria e Perthithur) dhe Reynolds American Inc. ("Target"), me datë 16 Janar 2017.

Përqendrimi ka formën e një përfutimi të drejtperdrejte kontrolli mbi shoqërinë Target, kundrejt një shperblimi në para dhe në aksione për shumicën e aksioneve të shoqërisë Target (X.XX) që zotërohen nga aksionarë publikë, i kombinuar me një bashkim dhe perthithje të Flight Acquisition Corporation ("FAC") nga shoqëria Target, ku shoqëria Target është shoqëria mbijetuese pas bashkimit (shoqëria perthithese).

Si rrjedhojë, Bleresi përfiton në mënyrë të qëndrueshme kontroll të drejtperdrejte (X.XX) mbi shoqërinë Target. Grupi i Bleresit, edhe përpara nënshkrimit të Marreveshjes zotëron X.XX të shoqërisë Target. Në fund të këtij transaksioni Bleresi do të zotërojë X.XX të shoqërisë Target.

Ky transaksion, i cili shkakton ndryshim të kontrollit në shoqërinë Reynolds American Inc., përben një përqendrim në kuptim të nenit 10, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar ("Ligji").

#### **Palet në transaksion**

**Batus Holding Inc.:** në cilësinë e Bleresit është një shoqëri e organizuar në formën e grupit (holding) e themeluar dhe që funksionon në baze të legjislacionit të SH.B.A, me seli në adresën: 2711 Centerville Rd. Suite 400, Wilmington, Delaware, SHBA, 19808. Aktiviteti kryesor i shoqërisë është prodhimi dhe shitja me shumicë e produkteve të duhanit. Shoqëria është pjesë e grupit British American Tobacco p.l.c.

**Reynolds American Inc.:** ne cilesine e ndermarrjes **Target**, eshte nje shoqeri e themeluar ne perputhje me ligjet e SH.B .A-se, me seli ne 327 Hillsborough Street, Raleigh, North Carolina, SHBA, 27603-1725. Aktiviteti kryesor i Reynolds American Inc. eshte prodhimi dhe tregtimi i prodhimeve te duhanit me shumice . Shoqeria Target eshte nje shoqeri holding dhe nder shoqerite e kontrolluara teresisht nga ajo renditet edhe shoqeria e dyte me e madhe e duhanit ne Shtetet e Bashkuara, R. J . Reynolds Tobacco Company.

### **Xhiro per vitin 2015**

Xhiro totale ne tregun nderkombetar eshte X.XX Leke:

- British American Tobacco p.l.c.<sup>7</sup> : X.XX Leke
- Reynolds American INC<sup>8</sup> : X.XX <sup>9</sup> = X.XX Leke

Xhiro totale ne tregun e brendshem : eshte X.XX Leke:

- British American Tobacco -Albania SHPK <sup>10</sup> : X.XX Leke

Palet ne transaksion plotesojne kriteret e xhiros se percaktuar ne nenin 12, pika 1, germa a te Ligjit.

### **ANALIZA E KONKURRENCES**

#### **Tregu perkates**

**Tregu perkates i produktit:** Sa me siper, treg perkates i produktit do konsiderohet tregu i importit dhe tregtimit te duhanit te prodhuar nepermjet makinerive (FMC).

**Tregu perkates gjeografik:** Per analizimin e ketij rasti treg perkates gjeografik do te konsiderohet tregu i brendshem, pra territori i Republikes se Shqiperise.

Transaksioni ndodh jashte tregut gjeografik te Republikes se Shqiperise , por ne kushtet kur grupi i pales perfituese te kontrollit ka dege ne Shqiperi dhe plotesohen kriteret e xhiros ne tregun e brendshem dhe ate nderkombetar , Komision i Konkurrences autorizon perqendrimin.

#### **Struktura e tregut**

Ne Shqiperi tregu i duhanit te prodhuar nepermjet makinerive (FMC) perbehet vetem nga importi i tyre . Ne tregun shqiptar ka nje shumellojshmeri te markave te cigareve t e importuara. Ne kete treg, per vitin 2016 kane kryer aktivitetin e importit te produkteve te duhanit rreth 20 kompani, 15 prej te cilave jane kompani importuese te produktit FMC (cigareve te prodhuara nepermjet makinerive).

Nder kompanite kryesore: Philip Morris Albania operon ne treg me markat e cigareve Marlboro, Merit, Philip Morris, L&M dhe Assos; Agna operon ne treg me markat Kamelia, American Legend dhe OME; Marketing & Distribution operon me markat Winston, Camel, Imperial dhe Maxim; dhe British American Tobacco me markat Rothmans, Kent dhe Lucky Strike .

#### **Vleresimi i konkurrences pas perqendrimit**

Tregu i duhanit te prodhuar nepermjet makinerive ne Shqiperi perbehet vetem nga duhani i importuar i markave te prodhuesve kryesore nderkombetare te duhanit si: Philip Morris International, British American Tobacco, Japan Tobacco International, etj.

---

<sup>7</sup>Raporti vjetor per vitin 2015 per shoqerine British American Tobacco p.l.c.

<sup>8</sup>Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin 2016, fq 28, te dhenat per vitin 2015.

<sup>9</sup> Sipas kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise per vitin 2015, 1\$ = 126 Leke.

<sup>10</sup> Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin 2015 per shoqerine British American Tobacco-Albania ShPK.

Shoqeria Target RAI nuk ushtron aktivitet ekonomik ne Shqiperi. Pozita ne treg e shoqerise British American Tobacco Albania SHPK nuk ndryshon edhe pas realizimit te ketij transaksioni dhe si pasoje nuk do te sjelle asnje ndryshim ne strukturen apo ne shkallen e perqendrimit te tregut.

**Sa me siper, ky perqendrim nuk shfaq shenja te kufizimit te konkurrences ne treg ose ne nje pjese te tij ne veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit te pozites dominuese sipas parashikimeve te nenit 56, pika 1 te Ligjit Nr. 9121, date 28.7.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences", i ndryshuar.**

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Ne baze te nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56, pika 1, te Ligjit nr. 9121, date 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences", i ndryshuar:

#### **VENDOSI:**

- I. Te autorizojë perqendrimin e realizuar nepermjet perftimit te kontrollit te Reynolds American Inc. nga Batus Holding Inc..
- II. Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem per njoftimin e paleve dhe dergimin e vendimit pasi te behen pagesat qe parashikon rregullorja "Per caktimin e shpenzimeve per ndjekjen e procedurave prane Autoritetit te Konkurrences".

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCES**

## VENDIM

Nr. 459, datë 25.04.2017

### Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nepermjet perftimit të kontrollit të Fannie May Confections Brands Inc. nga Ferrero International S.A..

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 25.04.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit nepermjet perftimit të kontrollit të Fannie May Confections Brands Inc. nga Ferrero International S.A.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, date 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences", i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe ne veçanti Kreu IV "Procedurat per kontrollin e përqendrimeve" nenet 53 - 64, Rregullorja "Per zbatimin e procedurave te përqendrimit te ndermarrjeve", Udhezimi "Per formen e njoftimit te përqendrimit" dhe formulari i thjeshtuar "Per njoftimin e përqendrimit".

**Komisioni i Konkurrences**, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Ferrero International S.A I Fannie May Confections Brands Inc. dhe relacionit të Sekretarit të Pergjithshem,

## VËREN SE:

### TRANSAKSIONI DHE PERQENDRIMI

Transaksioni i përqendrimit realizohet me ane të "Marreveshje e blerjes së aksioneve", e nënshkruar ndermjet paleve Ferrero International S.A ("Bleresi"), dhe 1-800-Flowers.com Inc. ("Shitesi") në lidhje me blerjen e 100% të aksioneve të Fannie May BrandsInc. ("Target"). Marreveshja është nënshkruar me datë 15 Mars 2017 dhe është njoftuar për autorizim nga ana e Komisionit të Konkurrences brenda afatit 30 ditor që parashikon neni 12 pika 2 e ligjit nr. 9121, date 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences", i ndryshuar (Ligji 9121/2003).

Transaksioni konsiston në përftimin e plote të kontrollit nga Bleresi të 100% të kapitalit aksionar dhe të drejtat e votes tek shoqëria Target dhe të kontrolluarat e saj, së bashku me markat Fannie May dhe Harry London dhe operacionet perkatese tregtare të tyre, asetet duke përfshirë dhe pa u limituar në pasuritë e marra me qira si vijon: një impiant prodhimi në North Canton (Ohio), një magazine dhe qender shpërndarje në Maple Heights (Illinois), një magazine qender shpërndarje në Chicago (Illinois), një fabrike në North Canton dhe 79 dyqane shitje me pakice Fannie May.

Ky transaksion, i cili shkakton ndryshim të kontrollit në shoqërinë Fannie May Confections Brands Inc. dhe të kontrolluarat e saj (Fannie May Confections Inc. dhe Harry London Candies Inc. të dyja të ndodhura në SHBA), përben një përqendrim në kuptim të nenit 10, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, date 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences, i ndryshuar ("Ligji").



## Palet ne transaksion

**Ferrero International S.A:** ne cilesine e Bleresit eshte nje shoqeri holding e grupit Ferrero, e themeluar dhe qe funksionon ne baze te legjislacionit te Luksenburgut, me seli ne adresen: Findel Business Center, Complex B, Rue de Treves, L-2632 Findel, Luksenburg. Shoqeria eshte nje prodhues produktesh ushqimore e cila ushtron aktivitet ne prodhimin dhe tregtim in e embelsirave dhe produkteve te tjera te embla. Qe prej vitit 2013, shoqeria eshte perfshire edhe ne blerjen dhe tregtimin e arroreve te ngrenshem ne vecanti te lajthive.

Ne Shqiperi, shoqeria Ferrero International S.A realizon xhiro me ane te dy shoqerive distributore te Ferrero d.o.o (Kroate) Inter Trade & Distribution SHPK dhe Kosmonte Foods Tirana SHPK.

**Fannie May Confections Brands Inc.:** ne cilesine e shoqerise **Target**, eshte nje shoqeri e themeluar dhe qe ekziston sipas ligjit tregtar te shtetit te Delaware, me seli ne adresen: One Old Country Road, Suite 500, Carle Place, NY 11514, USA. Shoqeria kontrollohet 100% nga shoqeria 1-800-Flowers.com Inc. e cila ka si veprimtari shitjen e luleve dhe ushqimeve me shumice dhe pakice

Shoqeria Fannie May Confections Brands Inc. dhe shoqerite e kontrolluara prej saj Fannie May Confections Inc. dhe Harry London Candies Inc. (te cilat jane objekt i ketij perqendrimi) jane aktive ne tregun e prodhimit dhe shitjes me pakice te çokollatave Premium dhe embelsirave ne SHBA. Ajo nuk ka prezence ne tregun Shqiptar.

## Xhiro per vitin 2015

Xhiro totale ne tregun nderkombetar eshte X.XX Leke :

- Ferrero International S.A<sup>1</sup> = 10.5 miliard €<sup>2</sup> = X.XX Leke;
- Fannie May Confections Brands Inc<sup>3</sup> = X.XX USD<sup>4</sup> = X.XX Leke;

Xhiro totale ne tregun e brendshem<sup>5</sup> eshte X.XX Leke:

- Ferrero International S.A<sup>6</sup> = X.XX milione € = X.XX Leke;

Palet ne transaksion plotesojne kriteret e xhiros se percaktuar ne nenin 12, pika 1, germa b te Ligjit.

## ANALIZA E KONKURRENCES

### Tregu perkates

**Tregu perkates i produktit:** tregu i prodhimit dhe shitjes se embelsirave prej okollate; tregu i prodhimit dhe shitjes se embelsirave ne forme kremi; tregu i prodhimit dhe shitjes se embelsirave me permbajtje qumeshti dhe snacks te embel dhe; tregu i prodhimit dhe shitjes se embelsirave prej sheqeri.

**Tregu perkates gjeografik:** Per analizimin e ketij rasti treg perkates gjeografik do te konsiderohet tregu i brendshem, pra territori i Republikes se Shqiperise.

<sup>1</sup> Burimi : Shkresa Nr . 13611 prot., date 10.04.2017 - Deklarate e Ferrero International S.A per xhiron e realizuar gjate vitit ka lend arik 20 16 ne tregun nderkombetar dhe tregun shqiptar.

<sup>2</sup> Kursi i kembimit per vitin 2016. 1€ = 137.36 Leke . Burimi: Banka e Shqiperise , Raporti Statistikor, Janar 20 17.

<sup>3</sup> Burimi : Bilancet e aud ituara te shoqerise per vitin financiar te perfunduar ne qershor 20 16.

<sup>4</sup> Kursi i kembimit per vitin 20 16. 1\$ = 124.14 Leke. Burimi : Banka e Shqiperise, Raporti Statistikor, Janar 2017 .

<sup>5</sup> Grupi Ferrero ushtron aktivitetin e tij ne tregun sbqiptar nepennjet Ferrero d.o.o., e cila ka marreveshje me distributoret Inter Trade & Distribution SHPK dhe Kosmonte e Foods Tirana SHPK.

<sup>6</sup> Referuar shkreses nr . 13611 prot ., date 10.04.20 17 - Deklarate e Ferrero International S.A per xhiron e realizuar gjate vitit kalendarik 20 16 ne tregun nd erkombetar dhe tregun shqiptar.



## **VLERESIMI I KONKURRENCES**

Ferrero është aktiv në tregun shqiptar në shitjen e embelsirave të çokollates, produkteve të embla në formë kremi si dhe embelsirave të fresketa prej qumeshti dhe snacks të embel me anë të dy distributoreve vendas. Ndërsa Fannie May Confections Brands Inc. (ndërmarrja Target) nuk është e pranishme në Shqipëri dhe nuk ka shitje.

Vetë grupi Ferrero nuk ka prezencë të drejtperdrejtë në vendin tone, por i realizon shitjet e tij nëpërmjet dy distributoreve vendas. Referuar të dhënave të paraqitura nga pala njoftuese, rezultojnë se në vendin tone, për vitin 2016 pjesën më të madhe të shitjeve ndër produktet e Ferrero-s e zënë embelsirat prej çokollate me X%, ndërsa embelsirat në formë kremi zënë X%, embelsirat me përmbajtje qumeshti X% dhe embelsirat prej sheqeri vetëm X%. Ndërsa për vitin 2015 pjesën më të madhe të shitjeve ndër produktet e Ferrero-s e zënë embelsirat prej çokollate me X%, ndërsa embelsirat në formë kremi zënë X% dhe embelsirat me përmbajtje qumeshti vetëm X%.

### **Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit**

Ferrero është aktiv në tregun shqiptar në shitjen e embelsirave të çokollates, produkteve të embla në formë kremi si dhe embelsirave të fresketa prej qumeshti dhe snacks të embel me anë të dy distributoreve vendas. Fannie May Confections Brands Inc. (ndërmarrja Target) nuk është e pranishme në Shqipëri dhe nuk ka shitje.

Ky transaksion nuk pritet të sjellë një mbivendosje horizontale të veprimtarive ekonomike të paleve pjesëmarrëse në transaksion dhe fuqizim të pozitës ekonomike të grupit Ferrero në vendin tone, duke qenë se ndërmarrja Target nuk ka shitje dhe as prezencë të drejtperdrejtë në Shqipëri.

**Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.**

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar :

### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të Fannie May Confections Brands Inc. nga Ferrero International S.A..
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e paleve dhe dërgimin e vendimit pasi të behen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCES**

## VENDIM

Nr. 463, datë 06.06.2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrjeje të re të pavarur me funksione të plota ndërmjet “BMW AG / Daimler AG / Ford Motor Company / Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 06.06.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit nëpërmjet krijimit të një ndërmarrjeje të re të pavarur me funksione të plota ndërmjet “BMW AG / Daimler AG / Ford Motor Company / Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft.

**Bazë ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe në veçanti Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit “BMW AG / Daimler AG / Ford Motor Company / Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Palët Njoftuese synojnë të krijojnë një sipërmarrje të përbashkët (“JVC”) aksionet e të cilave janë të zotëruara nga Palët Themeluese OEM<sup>1</sup> në pjesë të barabarta, 25% respektivisht. Pas realizimit të përqendrimit, BMW, Daimler, Ford dhe Porsche (për llogari të VW Group) do të mund të ushtrojnë kontrollin e përbashkët mbi JVC.

Shoqëritë mëma kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) dhe kanë rënë dakord për një Term Sheet<sup>2</sup>, të dyja me datë 27 nëntor 2016, i cili është një aneks i MoU. Ato presin nënshkrimin e Marrëveshjes për JV gjatë gjysmës së parë të vitit 2017.

JVC do të jetë një sipërmarrje e përbashkët me funksione të plota, të cilat kryejnë, bazuar në një qëndrueshmëri të gjatë, të gjitha funksionet e një entiteti ekonomik të pavarur në përputhje me nenin 10 pika 3 të Ligjit.

Transaksioni që synon krijimin e një shoqërie të re të pavarur me funksione të plota “JVC” nga shoqëritë mëma BMW AG, Daimler AG, Ford Motor Company dhe Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft, në kuptim të nenit 10, pika 3 dhe nenit 12 të Ligjit është përqendrim që duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës. Në këtë kuadër, ky transaksion i është nënshtruar procedurës së kontrollit të përqendrimeve, të

<sup>1</sup> OEM nënkupton prodhuesit origjinal të pajisjeve (Original Equipment Manufacturer)

<sup>2</sup> “Term Sheet” është një listë termash dhe kushtesh që i bashkëlidhen një marrëveshjeje.

parashikuara në Kreun e IV, nenet 53-64 të Ligjit si dhe në “Rregulloren për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Krijimi i këtij Joint Venture, nëpërmjet të cilit BMW AG, Daimler AG, Ford Motor Company dhe Dr. Ing. H.c.F. Porsche Aktiengesellschaft fitojnë kontrollin e përbashkët mbi një sipërmarrje të përbashkët (JVC) është njoftuar pranë Komisionit Evropian më 31.03.2017<sup>3</sup>. Komisioni Evropian, sipas Rregullores së Bashkimit më datë 28.04.2017 ka miratuar<sup>4</sup> krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët midis BMW AG, Daimler AG, Ford dhe Porsche.

### Palët në transaksion

**BMW AG**, në cilësinë e ndërmarrjes mëmë, është një shoqëri e themeluar rregullisht sipas ligjit gjerman me seli të regjistruar në Muni, Gjermani. BMW është kryesisht një prodhues ndërkombëtar i automjeteve dhe motoçikletave. Grupi përfshin tre marka: BMW, Rolls Royce dhe MINI. Përveç zhvillimit prodhimit dhe tregtimit të këtyre mjeteve, BMW dhe filialet e tij (së bashku **"BMW Group"**) ofrojnë gjithashtu shërbime financiare për klientët privatë dhe bizneset.

Shoqëria BMW është prezente në Shqipëri nëpërmjet distributorit të saj H.L. GROUP SHPK.

**Daimler AG**, në cilësinë e ndërmarrjes mëmë, me ndarjet e saj Mercedes-Benz Cars, Daimler Trucks, Mercedes-Benz Vans, Daimler Buses dhe Daimler Financial Services, është një kompani e listuar publikisht, e themeluar rregullisht sipas ligjit gjerman me seli të regjistruar në Shtutgart, Gjermani. Daimler është globalisht aktiv në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve automobilistike, kryesisht makinave për pasagjerë, kamion, kamionçina dhe autobusë. Divizioni i makinave Mercedes-Benz Car shet makina për pasagjerë nën markën Mercedes-Benz dhe 'smart'. Daimler Financial Services ("**DFS**") mbështet shitjen e automjeteve ndërkombëtarisht. Portofoli i produkteve dhe shërbimeve të Daimler përbëhet nga financimi i paketave financiare dhe me qera të përshtatura për tregtarë dhe klientë, si dhe shërbime financiare si broker sigurimi, produkte investimi, karta krediti, dhe shërbime menaxhimi të flotës dhe qiraje.

Shoqëria Daimler është prezente në Shqipëri nëpërmjet distributorit AUTO STAR ALBANIA SHA.

**Ford Motor Company "Ford"**, në cilësinë e ndërmarrjes mëmë është një shoqëri e themeluar rregullisht sipas ligjeve të Shtetit të Delaware me seli qendrore të aktivitetit në Dearborn, Michigan. Ford shet ndërkombëtarisht një gamë të gjerë auto veturash nën markën e Ford, dhe një gamë tjetër të autoveturave luksoze nën markën Lincoln në Shtetet e Bashkuara. Aktiviteti kryesor i Ford përfshin projektimin, prodhimin, shpërndarjen, shërbimin dhe financimin e një linje të plotë të makinave për pasagjerë (përfshirë automjete elektrike me bateri dhe hibride) dhe automjete tregtare. Ford ofron shërbime financiare nëpërmjet filialit Ford Credit.

Ford është prezent në Shqipëri nëpërmjet distributorit të huaj, shoqërisë Grand Dalewest Ltd. (Qipro) me numër AC111, me seli në adresën 77 Strovolos Ave., Strovolos Centre, Nikosia, Qipro.

**Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft "Porsche"**, në cilësinë e ndërmarrjes mëmë është një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve dhe rregulloreve gjermane. Porsche është një prodhues i automjeteve i specializuar në projektimin, prodhimin dhe shpërndarjen e makinave sportive me performancë të lartë, SUVs dhe Berlin. Porsche është pjesë e VW Group.

VW, një shoqëri e listuar publikisht me seli qendrore në Wolfsburg (Gjermani) është shoqëria mëmë e VW Group. Siç është thënë dhe më sipër, VW Group përfshin marka automjeteve si Volkswagen Passenger Cars, Volkswagen Light Commercial, Porsche, Audi, Škoda, Bentley, Bugatti, Lamborghini, Seat, MAN, Scania dhe Ducati është aktiv ndërkombëtarisht në zhvillimin, prodhimin, marketimin dhe shitjen e mjeteve motorike (makinave për pasagjerë, automjeteve të lehta tregtare, kamioneve, autobusëve, mini-autobusëve, shasisë për

<sup>3</sup> Çështja M. 8376 – BMW / Daimler / Ford / Porsche / JV [http://ec.europa.eu/competition/elojade/isef/case\\_details.cfm?proc\\_code=2\\_M\\_8376](http://ec.europa.eu/competition/elojade/isef/case_details.cfm?proc_code=2_M_8376)

<sup>4</sup> [http://europa.eu/rapid/press-release\\_MEX-17-1164\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_MEX-17-1164_en.htm)

autobuse) duke përfshirë pjesët e këmbimit dhe aksesoret përkatës, motoçikletave dhe motorë naftë. Së fundmi, VW ka ngritur filialin e saj të markës MOIA, e cila do të jetë aktive në zhvillimin dhe tregtimin e shërbimeve lëvizëse si shërbimi car sharing.

Për më tepër, VW Group ofron shërbime financiare dhe sigurimi në lidhje me shpërndarjen dhe financimin e makinave dhe automjeteve tregtare. Ky aktivitet kryhet kryesisht nëpërmjet Volkswagen Financial Services AG (“FSAG”) dhe filialeve të tij. FSAG ofron shërbime lëvizëse individuale financimi, qera, sigurimi dhe shërbime prokurimi të sigurimit në lidhje me makinat dhe automjetet tregtare. Së fundmi, nëpërmjet filialit të FSAG, Volkswagen Bank GmbH, VW Group ofron shërbime bankare direkte.

VW Group është prezent në Shqipëri nëpërmjet filialeve, PORSCHE ALBANIA SHPK, Porsche Mobility SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

## **Xhiro për vitin 2015**

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është \*\*\*\*\* milion Lekë:

- BMW GROUP<sup>5</sup> = \*\*\*\*\* milion Lekë;
- VOLKSWAGEN GROUP<sup>6</sup> = \*\*\*\*\* milion Lekë;
- FORD MOTOR COMPANY<sup>7</sup> = \*\*\*\*\* milion Lekë;
- DAIMLER GROUP<sup>8</sup> = \*\*\*\*\* milion Lekë.

Xhiro totale në **tregun e brendshëm** është \*\*\*\*\* Lekë:

- Porsche Albania SHPK<sup>9</sup> = \*\*\*\*\* Lekë;
- Porsche Mobility SHPK<sup>10</sup> = \*\*\*\*\* Lekë;
- Porsche Leasing SHPK<sup>11</sup> = \*\*\*\*\* Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa a) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

## **ANALIZA E KONKURENCËS**

**Tregu përkatës i produktit:** tregu për instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e një infrastrukture karikimi publikisht të aksesueshme për automjetet elektrike me bateri (BEV).

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

## **VLERËSIMI I KONKURENCËS**

Palët njoftuese synojnë të ndërtojnë një sipërmarrje të përbashkët (JVC) aksionet e së cilës zotërohen nga Palët Themeluese OEM në pjesë të barabarta. Pas përfundimit të transaksionit të përqendrimit BMW, Daimler, Ford dhe Porsche do të ushtrtojnë kontroll të përbashkët mbi JVC.

Tregu shqiptar nuk do të ndikohet nga realizimi i transaksionit duke qenë se JVC do të operojë vetëm në Zonën Ekonomike Evropiane dhe nuk do të kryejë ndonjë aktivitet në Shqipëri të paktën për tre vitet e ardhshme.

Gjithashtu, Shqipëria nuk ka as infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për të ofruar infrastrukturën e karikimit me fuqi të lartë për automjetet elektrike me bateri.

<sup>5</sup> Burimi: Raporti vjetor 2016 i BMW GROUP.

<sup>6</sup> Burimi: Raporti vjetor 2016 i VOLKSWAGEN GROUP.

<sup>7</sup> Burimi: Raporti vjetor 2016 i FORD MOTOR COMPANY.

<sup>8</sup> Burimi: Raporti vjetor 2016 i DAIMLER GROUP.

<sup>9</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të Porsche Albania SHPK për vitin 2015 që gjenden në dosjen e rastit.

<sup>10</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të Porsche Mobility SHPK për vitin 2015 që gjenden në dosjen e rastit.

<sup>11</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të Porsche Leasing SHPK për vitin 2015 që gjenden në dosjen e rastit.

**Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.**

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

**VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një Joint Venture ndërmjet “BMW AG / Daimler AG / Ford Motor Company / Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr.464, datë 06.06.2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nepermjet perftimit të rrjetit të shperndarjes se shoqerise Fabrika Duhana AD Banja Luka si dhe perftimi i 100% te aksioneve te Express Logistic and Distribution EOOD nga British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Ne mbledhjen e tij te dates 06.06.2017, shqyrtoi ç eshtjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit nepermjet perftimit të rrjetit të shperndarjes se shoqerise Fabrika Duhana AD Banja Luka si dhe perftimi i 100% te aksioneve te Express Logistic and Distribution EOOD nga British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited .

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, date 28 .07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences", i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe ne veçanti Kreu IV "Procedurat per kontrollin e perqendrimeve" nenet 53 - 64, Rregullorja "Per zbatimin e procedurave te perqendrimit te ndermarrjeve ", Udhezimi "Per formen e njoftimit te perqendrimit " dhe formulari i thjeshtuar "Per njoftimin e perqendrimit ".

**Komisioni i Konkurrences**, pas shqyrtimit te raportit mbi njoftimin e perqendrimit British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited / Fabrika Duhana AD Banja Luka I Express Logistic and Distribution EOOD dhe relacionit te Sekretarit te Pergjithshem,

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Transaksioni i njoftuar realizohet me ane te "Marreveshjes per shitjen dhe blerjen e disa aksioneve, bizneseve dhe asetete te shoqerise Bulgartabac Holding AD dhe shoqerive te kontrolluara prej saj", e nenshkruar ndermjet paleve me date 11 Prill 2017, me objekt perftimi i rrjetit të shperndarjes se shoqerise Fabrika Duhana AD Banja Luka ("FDBL") si dhe perftimi i 100% te aksioneve te Express Logistic and Distribution EOOD ("ELD") nga shoqeria British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited.

Ne perputhje me Nenin 2 te Marreveshjes, Bleresi dote bleje nga Shitesit Asetet e Duhanit, disa kontrata tregtimi dhe shperndarjeje dhe pajisje tregtimi. Sipas pjeses se transferimit te aksioneve te transaksionit, Bleresi dote bleje nga Shitesit FDBL-B-ne dhe ELD-ne . Ne lidhje me aktivitetin e shitjes me pakice te Shitesve qe kryhet nga ELD dhe nga FDBL-B, Bleresi blen 100% te kapitalit dhe rrjedhimisht perfton kontroll te drejtperdrejte mbi ELD-ne dhe mbi FDBL-B. ELD kryen aktivitet vetem ne territorin e Republikes se Bullgarise. FDBL-B do te kryeje aktivitet vetem ne territorin e Republikes se Bosnjes dhe Hercegovines.

Ky transaksion, i cili shkakton ndryshim të kontrollit të shoqërive FDBL-B dhe ELD, përben një përqendrim në kuptim të nenit 10, pika 1, germa b dhe c të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës, i ndryshuar ("Ligji").

### **Palet në transaksion**

British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited, ("BAT WECT"), në cilësinë e Blerësit, është një shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet e Anglisë dhe Uellsit, me seli ligjore në Globe House, 1 Water Street, London, WC2R 2PG, Mbretëria e Bashkuar, nr. regj. 05203113. BAT WECT është një shoqëri holding investimesh. WECT është një shoqëri e kontrolluar nga British American Tobacco p.l.c.

Shoqëria realizon xhiro në tregun e brendshëm nepermjet filialit të zotëruar në mënyrë të terthortë prej saj British American Tobacco Albania SHPK.

FDBL-B d.o.o. Banja Luka ("FDBL-B"), në cilësinë e Targetit është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Bosnjës dhe Hercegovinës, me seli në Kralja Petra I Karado rdevica 82, Banja Luka, Bosnje dhe Hercegovinë, dhe numer regjistrimi 4404123950001. Aktiviteti kryesor i FDBL-B do të jetë kryerja e aktivitetit të shitjes me pakicë të librave, gazetave, revistave, kancelarive dhe cigareve vetëm në territorin e Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës. FDBL-B dote zotëroje asetet e shpërndarjes së Shitesve në Bosnje dhe Hercegovinë, të cilat do të jenë ndare fillimisht nga shoqëritë që i zotërojnë aktualisht.

Express, logistics and distribution EOOD ("ELD"), në cilësinë e Targetit është një shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Bullgarisë, me seli në Sofje 1000, 425 Tsarigradsko shosse blvd, Warehouse 2, rajoni Pancharevo, Bullgari, me numer regjistrimi 202834148. ELD është një shoqëri shpërndarëse në Bullgari e cila mbulon pikat ku shiten cigare në Bullgari - kioska, markete, stacione benzine, dyqane të specializuara etj. Aja shpërndan gjithashtu edhe gazeta dhe botime.

Aktivitetet e ELD-së kufizohen vetëm në territorin e Republikës së Bullgarisë.

### **Asetet e Duhanit**

Markat e Duhanit konsistojnë në të drejtat e pronësive intelektuale të Shitesve (DPI-te) dhe në Marreveshjet DPI të Shitesve lidhur me produktet e duhanit. Markat tregtare përfshijnë të gjitha markat tregtare të duhanit të zotëruara (në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të terthortë) nga BTH në Bullgari, rajonin e detit Adriatik (Bosnje dhe Hercegovinë, Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni dhe Kroaci), Bashkësinë e Shteteve të Pavarura-BShP (Rusi, Kazakistan, Turkmenistan dhe Gjeorgji) dhe të drejta të tjera globale mbi keto marka, prate gjitha regjistrimet e tjera të Markave në vende të tjera. Bulgartabac Holding AD (BTH) do t'i transferojë gjithashtu BAT-it disa licenca lidhur me markat MM dhe Prestige për territoret e lartpërmendura.

### **Xhiro për vitin 2015**

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është X.XX Leke:

- British American Tobacco p.l.c.<sup>1</sup> :  $X.XX \text{ £}^2 = X.XX \text{ Leke}$
- Bulgartabac Holding AD<sup>3</sup> :  $X.XX \text{ BGN}^4 = X.XX \text{ Leke}$

Xhiro totale në tregun e brendshëm është X.XX Leke:

- British American Tobacco - Albania SHPK<sup>5</sup> : X.XX Leke

Palet në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b të Ligjit.

<sup>1</sup> Burimi: Ra porti vjetor për vitin 2016 i British American Tobacco p.l.c.

<sup>2</sup> Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2016, 1£ = 168 leke.

<sup>3</sup> Burimi: Deklarata e të ardhurave për vitin 2016 për Bulgartabac Holding AD (ft.com/MarketsData)

<sup>4</sup> Burimi: xe.com, IBGN = 68.63 ALL (BGN - Bulgarian Lev)

<sup>5</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të konso lidhura viti 2016 për shoqërinë British American Tobacco -Albania SHPK.



## **ANALIZA E KONKURRENCES**

### **Tregu perkates**

Tregu perkates i produktit: Sa me siper, treg perkates i produktit do konsiderohet tregu importit dhe tregtimit te duhanit te prodhuar nepermjet makinerive (FMC).

Tregu perkates gjeografik: Per analizimin e ketij rasti treg perkates gjeografik do te konsiderohet tregu i brendshem, pra territori i Republikes se Shqiperise .

### **VLERESIMI I KONKURRENCES**

Ne Shqiperi tregu i duhanit te prodhuar nepermjet makinerive (FMC) perbehet vetem nga importi i tyre. Ne tregun shqiptar ka nje shumellojshmeri te markave te cigareve te importuara.

Ne kete treg per vitin 2016 kane kryer aktivitetin e importit te produkteve te duhanit rreth 20 kompani, 15 prej te cilave jane kompani importuese te produktit FMC (cigareve te prodhuara nepermjet makinerive).

Nder kompanite kryesore: Philip Morris Albania operon ne treg me markat e cigareve Marlboro, Merit, Philip Morris, L&M dhe Assos; Agna operon ne treg me markat Kamelia, American Legend dhe OME; Marketing & Distribution operon me markat Winston, Camel, Imperial dhe Maxim; dhe British American Tobacco me markat Rothmans, Kent dhe Lucky Strike.

### **Vleresimi i konkurrences pas perqendrimit**

Tregu i duhanit te prodhuar nepermjet makinerive ne Shqiperi perbehet vetem nga duhani i importuar me nje shumellojshmeri markash. Philip Morris dhe Agna jane dy konkurrentet kryesore ne treg per vitin 2016 me pjese tregu 37% dhe 33%. Marketing & Distribution paraqitet si konkurrenti i trete me i rendesishem ne treg me 9 %. Nga te dhenat rezulton se British American Tobacco - Albania SHPK ka realizuar importe per vitin 2016 ne masen 9% te tregut.

**Bazuar ne karakteristikat e tregut perkates per duhanin e prodhuar nga makinerite, si dhe nisur nga numri i kufizuar i volumeve te shitjes dhe pjeses se tregut te markave te ndermarrjes BTH ne Shqiperi, perqendrimi nuk pritet te shkaktoje ndryshime ne konkurrencen ne kete treg. Sa me siper, ky perqendrim nuk shfaq shenja te kufizimit te konkurrences ne treg ose ne nje pjese te tij ne ve anti, si rezultat i krijimit ose forcimit te pozites dominuese sipas parashikimeve te nenit 56 pika 1 te Ligjit Nr. 9121, date 28.7.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences", i ndryshuar.**

### **PER KETO ARSYE:**

Ne baze te nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, te Ligjit nr. 9121, date 28 .07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences", i ndryshuar:

### **VENDOSI:**

- I. Te autorizojte perqendrimin e realizuar nepermjet perfthimit te rrjetit te shperndarjes se shoqerise Fabrika Duhanit AD Banja Luka si dhe perfthimi i 100% te aksioneve te Express Logistic and Distribution EOOD nga British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited.
- II. Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem per njoftimin e paleve dhe dergimin e vendimit pasi te behen pagesat qe parashikon rregullorja "Per caktimin e shpenzimeve per ndjekjen e procedurave prane Autoritetit te Konkurrences".

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere .

### **KOMISIONI I KONKURRENCES**



## VENDIM

Nr. 465, datë 20.06.2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 49% të ndërmarrjes ITD SHPK, nga INVESTMENT JOTI-INFOSOFT GROUP SHPK tek Balfin SHPK.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 20.06.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 49% të ndërmarrjes ITD SHPK, të zotëruar nga INVESTMENT JOTI-INFOSOFT GROUP SHPK tek BALFIN SHPK.

**Bazë ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”..

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 49% të ndërmarrjes ITD SHPK, të zotëruar nga INVESTMENT JOTI-INFOSOFT GROUP SHPK tek BALFIN SHPK,

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Transaksioni i përqendrimit është realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të blerësi BALFIN SHPK (Balfin) të 49% të kapitalit themeltar që shitësi INVESTMENT JOTI – INFOSOFT GROUP SHPK (Infosoft) zotëron tek ITD SHPK (ITD) (target),

Transaksioni synon ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të ndërmarrjes ITD nga ndërmarrja Infosoft tek Balfin dhe në kuptim të nenit 10, pika 1, germa b dhe nenit 12 të Ligjit ky transaksion i është nënshtruar procedurës së kontrollit të përqendrimeve, të parashikuara në Kreun e IV, nenet 53-64 të Ligjit si dhe në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Pas realizimit të transaksionit, ITD zotërohet nga ortakët: Infosoft në masën 39%; Balfin në masën 49% të kapitalit themeltar; Znj. Enkelejda Salillari në masën 6% dhe Z. Rudenc Sina në masën 6%.

Pronësia e Kuotës kalon së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me të. Balfin pranon që të drejtat dhe detyrimet e tij në lidhje me Kuotën në Shitje dhe në përgjithësi me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e ndërmarrjes ITD në çdo kohë, duke përfshirë por jo vetëm, të drejtat e disponimit mbi këtë pjesëmarrje, janë të kufizuara sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Kontratën e Opsionit për Shitjen e Kuotës e nënshkruar nga palët më datë 19 Dhjetor 2016.

Kontrata e Opsionit përcakton në mënyrë të qartë se administrimi i ndërmarrjes ITD është vendimmarrje ekskluzive e Infosoft dhe ortakut Balfin do të votojë në mbledhjet e ortakëve të ndërmarrjes ITD, për të marrë vendime dhe /ose të kryejë çdo veprim tjetër të nevojshëm, në përputhje të plotë me udhëzimet, propozimet, votën dhe vendimet e Infosoft.

### **Palët në transaksion**

**Blerësi: Balfin SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi K72223031K, me seli në adresën Qendra e Biznesit “ABA”, Rr.”Papa Gjon Pali II”, kati 12, Tiranë, Shqipëri. Objekti i veprimtarisë është investimi me pjesëmarrje në kuota, ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave, informatikës etj. Blerësi dëshiron të blejë një pjesë të kuotës së shitësit që përfaqëson 49% të kapitalit të regjistruar dhe të paguar të shoqërisë.

**Shitësi: INVESTMENT JOTI-INFOSOFT GROUP SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themeluar dhe që funksionon sipas ligjit shqiptar, me NUIS K91425022E dhe seli në Rrugë “Murat Toptani”, Gjergji Center, Tiranë. Objekti i veprimtarisë është pjesëmarrje në shoqëri si dhe në borde drejtuese të shoqërive, konsulencë në menaxhim dhe administrim biznesi etj. Shitësi zotëron 88% të kapitalit të regjistruar dhe të paguar të shoqërisë “ITD” SHP me vlerë nominale \*\*\*\*\* lekë. Shitësi shet 49 % të kësaj kuote.

**Shoqëria Target: ITD SHPK** regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 04.01.1996, me numër NIPT J61820049L dhe seli në Rrugë “Murat Toptani”, Gjergji Center, Tiranë. Objekti i veprimtarisë është tregtimi i pajisjeve kompjuterike, software dhe hardware dhe pajisje zyrash, administrim dhe menaxhim i pasurive të paluajtshme etj.

### **Xhiro për vitin 2015**

Xhiro totale në tregun e brendshëm: është XXXXXX Lekë:

— BALFIN SHPK<sup>1</sup> : XXXXXXXXX Lekë

— ITD SHPK<sup>2</sup> : XXXXXXXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b të Ligjit.

### **ANALIZA E KONKURRENCËS**

#### **Tregu përkatës**

Tregu përkatës i produktit: Sa më sipër, tregu përkatës i produktit do konsiderohet tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të pajisjeve kompjuterike, software dhe hardware.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

#### **Struktura e tregut**

Në Shqipëri tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të pajisjeve kompjuterike, software dhe hardware është një treg i larmishëm. Në tregun shqiptar ka një shumëllojshmëri të markave të importuara dhe një numër të konsiderueshëm konkurrentësh.

<sup>1</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara viti 2015 për shoqërinë Balfin SHPK.

<sup>2</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara viti 2015 për shoqërinë ITD SHPK

Numri i konkurrentëve në treg ka ardhur në rritje për vitin 2016 kur kanë kryer aktivitet 671 shoqëri, 656 prej të cilave janë shoqëri me pjesë tregu më të vogël se 1%. Konkurrenti kryesor mbetet shoqëria ITD SHPK me XX %, por me rënie të pjesëve të tregut ndërkohë që i dyti renditet XXX SHPK me XX % dhe konkurrenti i tretë XXXX SHPK me XX%. Për vitin 2016 XXX SHPK zë XX % të tregut.

Duke qenë se ITD SHPK dhe Infosoft System SHPK zotërohen nga shoqëria Investment Joti-Infosoft Group, atëherë mund të themi se për efekt të analizës së strukturës së tregut dhe sjelljes së ndërmarrjeve në treg se konkurrenti kryesor zë XX % të tregut. Në vitin 2016 treguesi HHI është në nivelin e 746, që do të thotë se tregu ka nivel të ulët përqendrimi.

Ndërmarrja ITD SHPK i shet produkte edhe ndërmarrjes Neptun SHPK e cila operon si pjesë e Balfin Group. Në rastin konkret shoqëria ITD SHPK dhe Neptun SHPK nuk janë në konkurrencë me njëra tjetrën. Ato operojnë në tregje të ndryshëm përkatësisht ITD në tregun e rrjedhjes së sipërme(importit dhe shitjes me shumicë) dhe Neptun SHPK në tregun e rrjedhjes së poshtme(shitjes me pakice) dhe për këtë arsye kemi një përqendrim vertikal.

Pas transaksionit shoqëria ITD SHPK do të mbetet në nivelin e XX % pjesë tregu, ndërsa Investment Joti-Infosoft Group do të pësojë rënie në pjesën e kombinuar të tij të tregut.

Si rrjedhojë e këtyre karakteristikave të tregut përkatës përqendrimi nuk pritet të shkaktojë kufizime të konkurrencës në këtë treg si pasojë e krijimit apo fuqizimit të pozitës dominuese në tregun përkatës.

### **Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit**

Në tregun shqiptar, importohen dhe tregtohen një numër i madh markash të pajisjeve kompjuterike, software dhe hardware, nga një numër i konsiderueshëm ndërmarrjesh aktive në treg duke mundësuar shumëllojshmërinë e zgjedhjeve për konsumatorët në secilin prej segmenteve të tregut apo në fashat e çmimeve.

Në këtë treg për vitin 2016 kanë kryer aktivitet 671 ndërmarrje. Konkurrenti kryesor është ndërmarrja target e këtij përqendrimi, ITD SHPK me XX %. Krahësuar me vitin paraardhës, në vitin 2016 treguesi i përqendrimit (HHI) ka ardhur në rënie për shkak të rritjes së numrit të operatorëve në treg dhe rritjes së pjesëve të tregut të konkurrentëve.

Nga të dhënat e doganës po të krahasojmë vitin 2015 dhe 2016 kemi një rritje të konkurrencës në vitin 2016. Pjesa e tregut e Targetit por dhe e grupit është ulur ndjeshëm.

Pas transaksionit ndërmarrja ITD SHPK do të mbetet në nivelin e 22,7% pjesë tregu, ndërsa Investment Joti-Infosoft Group do të pësojë rënie në pjesën e kombinuar të tij të tregut.

Si rrjedhojë e këtyre karakteristikave të tregut përkatës përqendrimi nuk pritet të shkaktojë kufizime të konkurrencës në këtë treg.

**Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.**

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 49% të ndërmarrjes ITD SHPK, të zotëruar nga INVESTMENT JOTI-INFOSOFT

GROUP SHPK tek BALFIN SHPK;

- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## V E N D I M

Nr. 468, datë 04.07.2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 100 % të ndërmarrjes Compal Electronics Europe sp z.o.o, nga Compalead Electronics B.V tek Vestel Ticaret A.S..**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|      |                |         |
|------|----------------|---------|
| Znj. | Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z.   | Koço BROKA     | Anëtar  |
| Znj. | Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z.   | Eduard YPI     | Anëtar  |
| Znj. | Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 100 % të ndërmarrjes Compal Electronics Europe sp z.o.o, nga Compalead Electronics B.V tek Vestel Ticaret A.S.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të raportit, të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 100 % të ndërmarrjes Compal Electronics Europe sp z.o.o, nga Compalead Electronics B.V tek Vestel Ticaret A.S., si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Në datë 01.09.2016 palët pjesëmarrëse në transaksion, Compalead Electronics B.V (Shitësi) Vestel Ticaret A.S (Blerësi) dhe Toshiba Visual Solutions Corporation (TVS) kanë nënshkruar një Marrëveshje paraprake të Blerjes së Aksioneve.

Transaksioni i përqendrimit është realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të kuotës së kapitalit themeltar prej 100 % të ndërmarrjes Compal Electronics Europe sp z.o.o, (Compal) prej Compalead Electronics B.V (Compalead) tek Vestel Ticaret A.S.(Vestel)

Shitësi, duke qenë ortak i vetëm i ndërmarrjes, i cili mban 100% të pjesëve të kapitalit themeltar, dëshiron t'ia shesë Blerësit këto pjesë kapitalesh, të konvertueshme në aksione, dhe Blerësi dëshiron të blejë nga shitësi 100% të tyre për ti dhënë atij në shkëmbim çmimin e caktuar.

Çmimi i blerjes përcaktohet paraprakisht në Marrëveshjen Paraprake të Blerjes së Aksioneve dhe do të jetë 7,000,000. USD plus vlera neto e bilancit në përmbushje.

Në Marrëveshjen Paraprake të Blerjes janë vendosur disa kushte që duhen plotësuar për të përmbushur këtë marrëveshje dhe një nga këto kushte është edhe marrja e një vendimi përfundimtar dhe të pakushtëzuar nga Autoriteti përkatës i Konkurrencës.

Në datë 30 Dhjetor 2016, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen Përfundimtare të Blerjes së Aksioneve.

Transaksioni synon ndryshimin e kontrollit nga ndërmarrja Compalead tek Vestel nëpërmjet përfitimit të 100 të kuotave të Compal dhe në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b dhe nenit 12 të Ligjit ky transaksion i është nënshtruar procedurës së kontrollit të përqendrimeve, të parashikuara në Kreun e IV, nenet 53-64 të Ligjit si dhe në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

### **Palët në transaksion**

**Blerësi: Vestel Ticaret A.S.**, një shoqëri aksionare themeluar sipas legjislacionit të Turqisë, me seli në adresën Levent 199, Buyukdere, 199, 34394, Sisli, Stamboll, Turqi, me nr. regjistrimi 237866, përfaqësuar nga Z.Ahmet Suha Erol.

**Shitësi: Compalead Electronics B.V.**, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Holandez, me seli në adresën Prins Bernhardeplein 200, 1097 JB Amsterdam, Holande, me nr. regjistrimi 60035846.

**Ndërmarrja Target: Compal Electronics Europe sp z.o.o**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Biskupice Podgorne, 55-040, Poloni.

Objekti i veprimtarisë është prodhimi i pajisjeve elektronike hardware për përdorim të gjithanshëm, prodhim i pajisjeve (telekomunikacioni) prodhim i kompjuterëve dhe pajisjeve dytësore, prodhim i pajisjeve, instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore duke përfshirë ato dentare, riparim dhe mirëmbajtje e pajisjeve elektrike, shitje me shumicë e pajisjeve elektrike shtëpiake, magazinim dhe ruajtje e mallrave të tjera, përpunim i të dhënave, menaxhim i faqeve të internetit dhe aktivitete të ngjashme, kërkim shkencor dhe zhvillim eksperimental në shkencat natyrore dhe inxhinieri, si dhe shërbime të tjera.

Partner i ndërmarrjes target është Complaead Electronics B.V e cila zotëron 100% të gjitha pjesëve të kapitalit të ndërmarrjes target.

### **Xhiro për vitin 2015**

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është 320 666 395 644 **Lekë**:

— Vestel Ticaret A.S.<sup>1</sup> : 8 995 945 759 TRY<sup>2</sup> = 310 270 169 228 Lekë

— Compal Electronics Europe SP. z.o.o.<sup>3</sup> : 326 925 359 PNL<sup>4</sup> = 10 396 226 416 Lekë

Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është 419 873 120 **Lekë**:

— Vestel Ticaret A.S. : = 419 873 120 <sup>5</sup> Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, geramat a) dhe b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **Përcaktimi i tregut përkatës**

**Vestel Ticaret A.S.** është një shoqëri me veprimtari kryesore import-eksporti, tregti kombëtare dhe ndërkombëtare, mirëmbajtje, shërbime riparimi të pajisjeve elektronike, aparaturave dhe pjesëve të tyre, kompjuter, pajisje shtëpiake elektrike dhe jo-elektrike, mallra të qëndrueshëm të konsumit, komponentë dhe lëndë të para, njësi të pjesëve të këmbimit për mallrat e mësipërm, etj.

<sup>1</sup>Burimi: Deklarimi i detajuar i të ardhurave të konsoliduara të shoqërisë Vestel Ticaret A.S. per vitin 2015

<sup>2</sup>Burimi: Kursit zyrtar i Bankës së Shqipërisë datë 14.04.2017, 1TRY = 34.49 lekë.

<sup>3</sup>Burimi: Deklarimi i detajuar i të ardhurave të konsoliduara të shoqërisë Compal Electronics Europe S.p z.o.o. per vitin 2015.

<sup>4</sup>Burimi: [www.xe.com](http://www.xe.com), kursi 1PNL = 31.8 lekë

<sup>5</sup>Burimi: Deklaratë e shoqërisë Vestel Ticaret A.S. për të ardhurat e realizuara nga shitjet ne Shqipëri për vitin 2015, me Nr 249 Prot., datë 12.06.2017

Vestel prodhon të gjitha llojet e pajisjeve elektronike dhe mjeteve duke përfshirë edhe aparate TV.

Shitjet e Vestel në Shqipëri për vitin 2015 ishin të bazuara vetëm në Original Equipment Manufacturer (OEM) dhe klientët OEM zhvilluan aktivitetin e tyre të shitjes nëpërmjet rrjeteve të dyqaneve dhe kanaleve tradicionale të tregtisë. Vestel nuk ka bërë ndonjë shitje direkte, marketing, ose aktivitet shitjesh të mëpasshme në Shqipëri. Aktiviteti i Vestel në Shqipëri do ndërpritet me shitjen e OEM-ve. Pasi shitjet të kenë përfunduar, Vestel nuk kryen asnjë aktivitet tregtar në këtë zonë gjeografike.

**Compal Electronics Europe SP. z.o.o.** prodhon dhe shet aparate televizori LCD. Kjo shoqëri zotëron një fabrikë prodhimi të televizorëve LCD. Compal Electronics Europe SP. z.o.o. është degë e Compal Group<sup>6</sup>.

Kjo shoqëri nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon shitje në Shqipëri.

Korporata Toshiba Visual Solution (TVS) do t'i japë Blerësit një të drejtë ekskluzive, të pa-tjetërsueshme, të pa-tranferueshme, të pa-licencueshme, si dhe licencën për ta përdorur, riprodhuar dhe për të shfaqur logon e "Toshiba" për përpunim, marketing, promovim, reklamim, shitje, shpërndarje e aparateve të TV në vendet e licencuara ndërmjet një Marrëveshje Licencimi për Markat Tregtare<sup>7</sup>.

Palët po planifikojnë që të zgjerojnë fushën e tregtimit në territoret të MLM dhe të përfshijnë Shqipërinë, Kosovën dhe Moldavinë.

Përqendrimi ka formën e një transaksioni të kombinuar veprimesh. Përfitimi i 100% të kontrollit mbi Targetin (të synuarin), nga Blerësi si dhe Marrëveshja e Licencimit ndërmjet TVS dhe Blerësit nuk do të kryhen nëse mungon njëra prej veprimtarive.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", përcaktimi "treg përkatës", përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit, dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.

**Tregu përkatës i produktit:** Sa më sipër, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i prodhimit dhe shitjes të aparateve të televizorit LCD. Me qenë se në territorin e Shqipërisë nuk ka ndërmarrje të cilat operojnë në tregun e prodhimit të aparateve të televizorëve LCD, treg përkatës produkti do të konsiderojmë vetëm tregun e shitjes të aparateve të televizorëve LCD.

**Zona përkatëse gjeografike:** Për analizimin e këtij rasti si zonë përkatëse gjeografike do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

## VLERËSIMI I KONKURENCËS

Në kuptim të ligjit nr. 9121, datë 28/07/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar), vlerësimi i konkurrencës në treg në rastet e përqendrimit konsiston në vlerësimin e konkurrencës aktuale dhe asaj potenciale para dhe pas përqendrimit.

Sikurse është deklaruar nga palët, ndërmarrja Vestel Ticaret A.S. nuk kryen aktivitet në mënyrë të drejtpërdrejtë në territorin e Republikës së Shqipërisë, por është furnizues i ndërmarrjeve shqiptare që operojnë në tregun përkatës. Sipas parashikimeve të nenit 2 pika 1, germa b e Ligjit, në fushën e zbatimit të ligjit përfshihen të gjitha ndërmarrjet që e ushtrojnë veprimtarinë jashtë territorit nëse pasojat e veprimtarisë së tyre ndihen në tregun e brendshëm.

Sipas shkresës me Nr. 249 Prot., datë 12.06.2017 mbi shitjet që realizon Vestel Ticaret A.S., në Shqipëri, rezultoi se ndërmarrja ka realizuar 419 873 120 Lekë duke furnizuar kompanitë Distribrands SH.P.K., Alb-

<sup>6</sup>[www.compal.com](http://www.compal.com)

<sup>7</sup>Burimi: Formulari I thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit, vendet e Licencuara janë: Mbretëria e Bashkuar, Irlanda, Islanda, Finlanda, Suedia, Norvegjia, Danimarka, Portugali, Spanja, Franca, Belgjika, Holanda, Luksemburgu, Gjermania, Zvicra, Italia, Austri, Hungari, Rumania, Ukraina, Greqia, Qipro, Mali i Zi, Bosnja, Polonia, Malta, Maqedoni, Letoni etj.



Zeus SH.P.K., Tring TV SH.A., Neptun SH.P.K., Ocean Overseas srl, Vestel Holand B V, Vestel Poland SP zoo. dhe Hitachi Europe ltd Digital Media GR8.

Aktualisht, Shqipëria nuk është pjesë e fushës së territorit të Marrëveshjes Licencimi për Markat Tregtare (vijim-MLM), që Koorporata Toshiba Visual Solution (TVS) do t'i japë Blerësit nëpërmjet këtij transaksioni. Prandaj asnjë shitje që mbulohet nga MLM nuk është kryer në Shqipëri dhe nuk do të bëhet derisa Transaksioni të jetë miratuar nga Autoriteti i Konkurrencës. Pas marrjes së miratimit, Blerësi do të fillojë shitjet në Shqipëri.

Tregu përkatës i importit dhe shitjes së televizorëve LCD është një treg i hapur për konkurrencë mes markave dhe në Shqipëri tregtohen një numër i konsiderueshëm markash nga një numër i konsiderueshëm njësisht tregtare, pa barriera hyrje në treg dhe i hapur për konkurrencë.

**Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstaton se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg, ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit, ose forcimit të pozitës dominuese.**

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës:

#### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 100 % të ndërmarrjes Compal Electronics Europe sp z.o.o, nga Compalead Electronics B.V tek Vestel Ticaret A.S.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

<sup>8</sup>Distribrandi SH.P.K. 19%, Alb-Zeus SH.P.K. 9%, Tring TV SH.A. 11%, Neptun SH.P.K. 48%, Ocean Overseas srl 11%, Vestel Holand B V 0.47%, Vestel Poland SP zoo 1% dhe Hitachi Europe ltd Digital Media GR 1%.



## VENDIM

Nr. 473, datë 14.09.2017

### Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aseteve të ndërmarrjes Izi Mobil Telekomunikacije d.d. nga Telekom Slovenije d.d..

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 14.09.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aseteve të ndërmarrjes Izi mobil Telekomunikacije d.d. nga Telekom Slovenija d.d.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet blerjes së aseteve të ndërmarrjes Izi Mobil Telekomunikacije d.d. nga Telekom Slovenije d.d.;

## VËREN SE:

### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Pranë Autoritetit të Konkurrencës (AK) në datën 04.07.2017, me shkresë Nr. 294 Prot., janë depozituar dokumente dhe informacione në lidhje me përfitim të kontrollit të aseteve të ndërmarrjes IZI tek TELEKOM.

Në datë 30 Qershor 2017, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Aseteve, të cilës i parapriu një letër Mirëkuptimi e datës 23.08.2016 në të cilën palët shprehin interesin për të hyrë në negociata për lidhjen e një kontrate, me të cilën synojnë rregullim të marrëdhënieve reciproke të përbashkëta.

### Palët në transaksion

**Blerësi: Telekom Slovenije d.d.**, është ofrues i shërbimeve të telekomunikacionit, i regjistruar në Regjistrin Zyrtar të Agjencisë për Rrjetet dhe Shërbimet e Komunikimit të Republikës së Sllovenisë si kontraktues ose operator i shërbimeve në vijim: vlerë e shtuar, rrjeti vendas dhe bashkë-vendas, TV mobile, shërbime telefonike ndërkombëtare të disponueshme publikisht, shërbimet e aksesit në internet me brez të gjerë, shërbime të shpërndarjes analoge dhe sinjale dixhitale të radios përmes rrjeteve kablllore dhe radio, shërbime telefonike në shërbim të publikut, informacione rreth numrave të telefonit dhe publikimit, shërbime zanore satelitore, shërbime të dhëna me qira të fibrave optike të ndriçuara, shërbimet për transmetimin ose drejtimin e trafikut kombëtar dhe aksesin kombëtar, transmetimi i të dhënave në rrjetet fikse, shërbimet analoge dhe dixhitale të shpërndarjes së sinjaleve televizive përmes rrjeteve kablllore dhe IP TV, akses në internet dhe tranzit interneti, shërbimet e të dhënave me satelit dhe akses në internet, lloje të tjera shërbimesh, shërbime

të telefonisë në një vend të caktuar përmes TDM dhe shërbimet e ndërlidhjes ndërkombëtare, shërbimet e zërit në rrjetin publik të telefonisë së lëvizshme, shërbimet e linjës, pajisjet e rrjetit dhe komunikimit, shërbimet e inteksonjeksionit të rrjetit fiks dhe celular, IP, akses në internet dhe brez të ngushtë, shërbime të dhënash në rrjetin publik të telefonisë së lëvizshme.

**Shitësi/Ndërmarrja Target: Izi Mobil Telekomunikacije d.d.** është ndërmarrje e regjistruar në Regjistrin Zyrtar të Agjencisë për Rrjetet dhe Shërbimet e Komunikimit të Republikës së Sllovenisë si kontraktues ose operator i shërbimeve të mëposhtme: shërbime zanore në rrjetin telefonik publik, shërbime në lidhje me të dhënat në rrjetin telefonik publik, shërbime me vlerë të shtuar dhe si rrjet i telefonave celularë me qira (të dhënë me qira) gjithashtu i regjistruar.

Biznesi Target është aktiv në ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit me parapagesë dhe nuk ka aktivitet në Shqipëri. Përqendrimi ka të bëjë me tregjet e (1) shërbimet e telekomunikacionit të lëvizshëm tek konsumatorët finalë dhe (2) akses me shumicë dhe krijim telefonate në rrjetet e lëvizshme publike, të dyja këto të kufizuara në Slloveni.

Shitësi duhet të transferojë tek Blerësi asetet e Shitësit:

- Të gjitha kontratat me parapagim të lidhura midis shitësit dhe konsumatorëve fundorë, për të cilat konsumatorët fundorë kanë dhënë pëlqimin e tyre;
- Të gjitha markat tregtare dhe markat e shërbimeve, të regjistruara në Zyrën e pronësisë Intelektuale dhe/ose regjistrat e tjerë shtetërorë, në pronësi të shitësit; çdo shenjë të përdorur nga shitësi për etiketimin e mallrave dhe shërbimeve të tij, në fushën e komunikimeve elektronike;
- Stokun e mallrave të IZI Mobil, kartat SIM, paketat me parapagim me kartën SIM të përfshirë.

Tek Blerësi do të transferohen vetëm asetet e përmendura, pa përfshirë asete, të drejta apo detyrime (referuar pasuria që i mbetet shitësit”) të tilla si:

- Nuk do të transferohen punonjësit e shitësit apo të drejtat që lindin nga marrëdhënia e tyre e punësimit;
- Transaksioni nuk përbën një transferim të subjektit ekonomik apo një transferim të aktivitetit. Të gjitha përgjegjësitë që nuk i takojnë shprehimisht aseteve dhe të drejtave të transferuara, mbeten pjesë e pasurisë që i mbetet shitësit dhe janë plotësisht në ngarkim të shitësit.

## Xhiro për vitin 2016

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXXXXXXXXX Lekë:

— Telekom Slovenije d.d.<sup>1</sup> : XXXXXXXXXX Euro<sup>2</sup> = XXXXXXXXXX Lekë

— Izi Mobil Telekomunikacije d.d.<sup>3</sup> : XXXXXXXXXX Euro = XXXXXXXXXX Lekë

Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është XXXXXXXXXX Lekë:

— Telekom Slovenije d.d. : XXXXXXXXXX Euro = XXXXXXXXXX Lekë<sup>4</sup> Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa a) dhe b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## Përcaktimi i tregut përkatës

**Telekom Slovenije d.d.** është një shoqëri aksionare dhe aksionari më i madh i saj është Shteti i Sllovenisë (62.54%). Telekom Slovenije d.d. është e angazhuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve të lidhura me rrjetet (telekomunikacion) në Slloveni dhe jashtë saj. Shërbimet e telekomunikacionit të ofruara nga kjo shoqëri,

<sup>1</sup>Burimi: Raporti Vjetor për vitin 2016 i Telekom Slovenije.

<sup>2</sup>Burimi: Kursit zyrtar i Bankës së Shqipërisë për vitin 2016, 1Euro = 137 lekë.

<sup>3</sup>Burimi: Pasqyrat financiare për vitin 2016 të Izi Mobil.

<sup>4</sup>Burimi: Deklaratë e Telekom Slovenije për të ardhurat e realizuara në Shqipëri për vitin 2016, shkresa me Nr 294/3 Prot., datë 25.07.2017

përfshijnë telefoni zanore fikse dhe të lëvizshme, transmetim fiks dhe të lëvizshëm të dhënash, akses interneti me brez të gjerë (broadband) dhe akses në rrjete televizioni.

Kjo ndërmarrje nuk ushtron aktivitet në Shqipëri.

Telekom Slovenie d.d. ka realizuar të ardhura në Shqipëri për vitin 2016 nga shërbimi roaming dhe shërbimet e telefonisë fikse me shumicë për inter-operatorët<sup>5</sup>.

**Izi Mobil Telekomunikacije d.d.** është një shoqëri e angazhuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit me parapagesë<sup>6</sup>. Izi Mobil është një operator virtual i telefonisë së lëvizshme - ofrues i shërbimit light MVNO, i cili ofron shërbime për konsumatorë final por nuk ka në pronësi një rrjet të vetin apo një strukturë tjetër të rëndësishme<sup>7</sup>.

Kjo ndërmarrje nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon shitje në Shqipëri.

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me marrjen e kontrollit të vetëm nga Telekom Slovenie mbi asetet e ndërmarrjes Izi Mobil konkretisht: (i)kontratat me parapagim të lidhura ndërmjet Izi Mobil dhe përdoruesve të saj përfundimtarë në Slloveni (për të cilën përdoruesit përfundimtarë kanë dhënë pëlqimin e tyre), (ii) markat tregtare dhe shenjat e shërbimit të regjistruara në Zyrën Sllovene të Pronësisë Intelektuale dhe/ose regjistrat e tjerë kompetent, me të gjitha shenjat e tjera të paregjistruara, si dhe (iii) stokun e mallrave të Izi Mobil, përfshirë kartat SIM dhe paketat me parapagim me karta SIM të integruara në Slloveni.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.

**Tregu përkatës i produktit:** Sa më sipër, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i shërbimeve të telekomunikacionit të lëvizshëm për klientët fundor dhe tregu i aksesit me shumicë dhe origjinën e thirrjeve në rrjetet publike të lëvizshme.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

## VLERËSIMI I KONKURENCËS

Në kuptim të ligjit Nr. 9121, datë 28/07/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, vlerësimi i konkurrencës në treg në rastet e përqendrimit konsiston në vlerësimin e konkurrencës aktuale dhe asaj potenciale para dhe pas përqendrimit.

Transaksioni i propozuar konsiston në marrjen e kontrollit të vetëm nga Telekom Slovenia mbi kontratat me parapagesë, markat tregtare, shenjat e shërbimit dhe stokun e mallrave të Izi Mobil.

Telekom Slovenie d.d. nuk ushtron aktivitet në Shqipëri. Kjo ndërmarrje ka realizuar të ardhura në Shqipëri për vitin 2016 nga shërbimi roaming dhe shërbimet e telefonisë fikse me shumicë për inter-operatorët.

Izi Mobil Telekomunikacije d.d. nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon shitje në Shqipëri. Përqendrimi i synuar nuk do të sjellë ndonjë efekt për konkurrencën në Shqipëri.

**Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstaton se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti si rezultat i krijimit, ose forcimit të pozitës dominuese.**

<sup>5</sup>Burimi: Deklaratë e Telekom Slovenije d.d. për të ardhurat e realizuara në Shqipëri për vitin 2016, shkresa me Nr 294/3 Prot., datë 25.07.2017.

<sup>6</sup>Burimi: Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimit dhe Ekstrakti i Regjistrat Tregtar i Izi Mobil.

<sup>7</sup>Një light MVNO (p.sh. IZI) lidh një marrëveshje biznesi me një operator të telefonisë së lëvizshme (p.sh. Telekom) për të marrë akses me shumicë në shërbimet e rrjetit me çmim shumice, pastaj përcakton çmimet e shitjes me pakicë në mënyrë të pavarur.

## **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës:

### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së aseteve të ndërmarrjes IZI MOBIL Telekomunikacija d.d nga Telekom Slovenija d.d.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 474 , datë 14.09.2017

### **Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A nga Intesa Sanpaolo S.p.A ”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 14.09.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A nga Intesa Sanpaolo S.p.A.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet blerjes së disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A nga Intesa Sanpaolo S.p.A

## VËREN SE:

### **TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës (AK) në datën 28 korrik 2017, me shkresë Nr. 330 Prot, është depozituar Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimit si dhe janë depozituar dokumente dhe informacione në lidhje me blerjen e disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A (Veneto) nga Intesa Sanpaolo Bank S.p.A. (Intesa).

#### **Palët në transaksion**

**Blerësi: Intesa Sanpaolo S.p.A** është një shoqëri e regjistruar në Itali, me adresë: Piazza San Carlo, Torino, Itali. Intesa Sanpaolo S.p.A është shoqëria mëmë e Intesa Sanpaolo Group ("ISP Group"), një nga grupet më të mëdhenj bankare italiane. ISP Group është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet filialit në pronësi të plotë të tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA

**Shitësi/Targeti: Veneto Banca S.p.A.** është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit italian, me seli në Piazza G.B. Dall'Armi 1, 31044 Montebelluna, Treviso Itali. Veneto Banca Group është i pranishëm në të gjithë Italinë dhe jo vetëm, ajo vepron gjithashtu edhe në disa vende të Evropës Lindore. Në Shqipëri ajo operon nëpërmjet filialit të saj Veneto Banka SHA.

Njoftimi ka të bëjë me blerjen nga Intesa Sanpaolo S.p.A. të disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të Banca Popolare di Vicenza S.p.A. ( BPVI), në likuidim administrativ të detyrueshëm, dhe Veneto Banca S.p.A., në likuidim administrativ të detyrueshëm.

Transaksioni në përgjithësi është mjaft kompleks dhe parashikon një sërë veprimesh që duhet të kryhen nga Qeveria Italiane, Ministria Italiane e Financave, Banka e Italisë dhe së fundmi nga Banka Qendrore Evropiane dhe Komisioni i BE-së.

Të gjitha këto autoritete punuan ngushtë për të përfunduar procesin në një kohë shumë të shkurtër dhe për të siguruar një tranzicion të qetë dhe vazhdimësinë e biznesit për asetet italiane dhe të huaja të BPVI dhe Veneto Banca. Shteti Italian ka zgjedhur Intesën si blerës përmes një procedure të hapur, të drejtë dhe transparente të shitjes. Shteti Italian do të japë injektim në para prej rreth 4.785 miliard euro dhe garanci shtetërore deri në përafërsisht 12 miliard euro, veçanërisht për financimin nga Intesa të masës së likuidimit.

Intesa Sanpaolo S.p.A. ka paguar një çmim simbolik prej 1 euro për Kombinimin e Aseteve Target.

### Xhiro për vitin 2016

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar**<sup>1</sup> është XXXXXXXXXX Lekë:

- Intesa Sanpaolo S.p.A: XXXXXXXX €<sup>2</sup> = XXXXXXXXXX Lekë
- Veneto Banca S.p.A.: XXXXXXXX €<sup>3</sup> = XXXXXXXXXX Lekë

Xhiro totale në **tregun e brendshëm** është XXXXXXXXXX Lekë:

- Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA<sup>4</sup>: XXXXXXXXXX Lekë
- Veneto Banka SHA<sup>5</sup>: XXXXXXXXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nënin12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “ Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### ANALIZA E KONKURRENCËS

**Intesa Sanpaolo S.p.A**<sup>6</sup> është mëma e Intesa Sanpaolo Group, një nga grupet më të mëdhenj bankar në Itali. Intesa Sanpaolo S.p.A është prezente dhe operon në Shqipëri me filialin e zotëruar tërësisht prej saj, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA** është një bankë kryesore në vend që u ofron kompanive, klientëve institucionalë e privatë me të ardhura të larta si dhe klientëve individë e biznese të vogla e të mesme zgjidhje të arsyeshme përmes shërbimeve e produkteve të saj. Banka i ofron shërbimet e saj përmes një rrjeti prej 32 degësh në qytete të ndryshme të vendit dhe vazhdon të zgjerohet në mënyrë strategjike duke ndjekur nga afër zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

**Veneto Banca S.p.A.** është banka që drejton Veneto Banca Group, një nga institucionet italiane të kredisë e konsideruar e rëndësishme nga Banka Qendrore Evropiane. Sot Veneto Banca Group është i pranishëm në të gjithë Italinë. Veneto Banca Group operon gjithashtu në katër vende të Evropës Lindore: a) në Rumani; b) në Moldavi; c) në Kroaci dhe d) në Shqipëri.

Veneto Banca S.p.A. është prezente dhe operon në Shqipëri me filialin e zotëruar tërësisht prej saj Veneto Banka SHA.

<sup>1</sup> Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2016, 1euro=137 lekë.

<sup>2</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara 2016 të Intesa Sanpaolo S.p.A.

<sup>3</sup> Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2016 të Veneto Banca S.p.A

<sup>4</sup> Burimi: Pasqyrat financiare 2016 të Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA s.p.a., fq 127.

<sup>5</sup> Burimi: Pasqyrat financiare 2016 të Veneto Banca SHA.

<sup>6</sup> Burimi: [www.intesaspaolobank.al](http://www.intesaspaolobank.al)

**Veneto Banka SHA** zotërohet tërësisht nga Veneto Banca S.p.A. Aktiviteti i Veneto Banka SHA është grumbullimi i kursimeve, dhënie kredie në forma të ndryshme, si dhe çdo aktivitet tjetër financiar. Me një rrjet prej 15 filialesh, të shtrira në qarqet më kryesore të vendit, Veneto Banka operon kryesisht me bizneset e vogla dhe të mesme, si një mbështetës i fuqishëm si për prodhuesit shqiptar ashtu dhe për bizneset e sipërmarrjet italiane.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: tregu përkatës i produktit, dhe tregu përkatës gjeografik.

**Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet **tregu i brendshëm** pra territori i Republikës së Shqipërisë.

## **VLERËSIMI I KONKURENCËS**

Sektori bankar vazhdon të luajë rolin kryesor në ndërmjetësimin financiar në Shqipëri, me një strukturë që ka mbetur e pandryshuar në vitet e fundit, e përbërë nga 16 banka me kapital të gjithin privat. Pjesa më e madhe e sektorit bankar kontrollohet nga filialet e grupeve të huaja bankare me origjinë të kapitalit nga Bashkimi Evropian, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës së Shqipërisë. Për të analizuar tregun e shërbimeve bankare do të analizojmë treguesit kryesorë të sistemit bankar që janë aktivet, depozitat dhe kreditë.

### **Tregu i Aktiveve**

Referuar të dhënave të Shoqatës Shqiptare të Bankave për vitin 2016, vërejmë se Banka Kombëtare Tregtare ka përqindjen më të lartë të aktiveve me 27.10%, e ndjekur nga Raiffeisen Bank me 18.92% dhe Credins Bank me 11.59%. Intesa Sanpaolo Bank renditet e 4-ta me 10.48%, ndërsa Veneto Banka SHA e 12-ta me 1.85% të totalit të aktiveve.

Pas përqendrimit pjesa e kombinuar e Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA dhe Veneto Bank SHA do të shkojë në 12.33% të totalit të aktiveve.

Tregu bankar shqiptar klasifikohet si mesatarisht i përqendruar në terma të aktiveve (HHI= 1463).

### **Tregu i Depozitave**

Në tregun e depozitave rezulton se Banka Kombëtare Tregtare ka përqindjen më të lartë me 25.86%, e ndjekur nga Raiffeisen Bank me 19.70% dhe Credins Bank me 12.36%. Intesa Sanpaolo Bank renditet e 4-ta me 10.82%, ndërsa Veneto Banka SHA e 12-ta me 1.94% të totalit të depozitave.

Pas përqendrimit pjesa e kombinuar e Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA dhe Veneto Bank SHA do të shkojë në 12.76% të totalit të depozitave.

Tregu bankar shqiptar klasifikohet si mesatarisht i përqendruar në terma të depozitave (HHI= 1447).

### **Tregu i Kredive**

Në tregun e kredisë Banka Kombëtare Tregtare ka përqindjen më të lartë me 22.90%, e ndjekur nga Credins Bank me 16.75% dhe Raiffeisen Bank me 16.08%. Intesa Sanpaolo Bank renditet e 5-ta me 8.03%, ndërsa Veneto Banka e 11-ta me 1.94% të totalit të kredive.

Pas përqendrimit pjesa e kombinuar e Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA dhe Veneto Bank SHA do të shkojë në 9.97% të totalit të kredive.

Tregu bankar shqiptar klasifikohet si mesatarisht i përqendruar në terma të kredive (HHI= 1304).



## **Vlerësimi i përqendrimit**

Transaksioni është një përftim kontrolli i drejtpërdrejtë i Veneto Banca S.p.A. nga Intesa Sanpaolo S.p.A. Të dyja këto shoqëri operojnë në Shqipëri nëpërmjet filialeve të zotëruar tërësisht prej tyre, përkatësisht Veneto Banka SHA dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Tregu bankar në Shqipëri është një treg mesatarisht i përqendruar me 16 banka që operojnë. Para përqendrimit, pjesët e tregut të Intesa Sanpaolo Bank sipas aseteve, depozitave dhe kredive luhaten nga 8-11% ndërsa të bankës Veneto nga 1.85-2%.

Pas përqendrimit, pjesa e kombinuar e tregut të Veneto Banka SHA dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA pritet të mos ketë ndryshime domethënëse, duke mbetur në nivelin rreth 13% dhe për pasojë transaksioni nuk do të sjellë ndryshime domethënëse në tregun bankar.

## **Konkluzione**

Përfitimi i kontrollit të Banca Popolare di Venecia S.p.A dhe Veneta Banca nga Intesa San Paolo Bank është një transaksion i detyrueshëm për të shmangur pasojat serioze sociale<sup>7</sup> që do të kishin rrjedhur nga procedurat e likuidimit të detyrueshëm administrativ për këto dy banka. Transaksioni i realizuar për çmimin simbolik prej 1 euro ka si qëllim të shmangë pasojat në rastin e likuidimit të këtyre dy bankave për rreth 2 milion depozitues si dhe aktivitetet e rreth 200,000 bizneseve të mbështetura financiarisht, vendet e punës së të punësuarve të të dy grupeve bankare dhe në përgjithësi krizën në ekonominë italiane dhe vendet ku këto banka janë prezente nëse do të ishte lejuar likuidimi i dy bankave.

Në tregun bankar shqiptar transaksioni prek vetëm Veneto Banka SHA, nëpërmjet blerjes nga ana e Intesa Sanpaolo Bank të disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të Veneto Banka SHA. Vetë Veneto Banka SHA ka pjesë tregu të vogla sa i përket treguesve kryesorë të sistemit bankar, aktiveve, depozitave dhe kredive dhe për këtë arsye struktura e tregut pas përqendrimit nuk pritet të ketë ndryshime të rëndësishme.

Pjesa e kombinuar e tregut të Veneto Banka SHA dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA mbetet në nivelin rreth 13% dhe në këtë mënyrë nuk ka ndryshime domethënëse të strukturës së tregut për sa i përket nivelit të përqendrimit.

**Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstaton se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg, ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit, ose forcimit të pozitës dominuese.**

## **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës:

## **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A nga Intesa Sanpaolo S.p.A
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

<sup>7</sup> Burimi: Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit,



## VENDIM

Nr. 478, datë 26.10.2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 90% të ndërmarrjes Insig Jete SHA, nga Eurosig SHA tek Z. Shefqet Kastrati dhe Z. Samir Mane.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 26. 10. 2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 90% të ndërmarrjes Insig Jete SHA, nga Eurosig SHA tek Z. Shefqet Kastrati dhe Z. Samir Mane

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 90% të ndërmarrjes Insig Jete SHA, nga Eurosig SHA tek z. Shefqet Kastrati dhe z. Samir Mane,

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Pranë Autoritetit të Konkurrencës (AK) në datën 28.04.2017, me shkresë Nr. 180 Prot. AK, jemi njoftuar në lidhje me një Kontratë për Shitje Aksionesh të lidhur në datë 27.04.2017 ndërmjet dy personave fizik në cilësinë e blerësit dhe konkretisht z. Samir Mane dhe z. Shefqet Kastrati, të cilët blejnë 90% të aksioneve të Insig, të cilat zotërohen nga Eurosig.

Në vitin 2016, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr.426, datë 20.07.2016 “Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurosig SHA të shoqërisë Insig SHA”, ka autorizuar përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurosig SHA të shoqërisë Insig SHA.

Në zbatim nenit 6, pika 2 të Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtaritë e shoqërisë së sigurimit/risigurimit”, ndërmarrja Eurosig SHA, zotëruese e 100% të kuotave të ndërmarrjes Insig SHA, me Vendimin e Aksionarëve nr. 15 datë 10.11.2016 ka vendosur përshtatjen e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit Insig SHA në dy shoqëri pritëse të themeluar rishtazi Insig SHA dhe Insig Jete SHA, duke miratuar në parim ndarjen e shoqërisë Insig SHA.

Pas vendimit të aksionerëve të sipërcituar, ndërmarrja Insig Jete SHA është krijuar dhe regjistruar më datë 23.12.2016 pranë QKB me 100% të kuotave aksionare nga ndërmarrja Eurosig SHA. Eurosig, në cilësinë e ortakut të vetëm synon 90% të kapitalit aksionar të Insig Jete, nga të cilat z.Manë blen 45% të aksioneve ose ½ e aksioneve target dhe z.Kastrati blen 45% të aksioneve ose ½ e aksioneve target.

Bazuar në nenin 10, pika 1, germa a) të Ligjit 9121/2003, rasti i paraqitur përbën një përqendrim, sepse kemi një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit, si pasojë e përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë nga dy persona fizikë, përkatësisht blerjes prej 90% të aksioneve, prej persona të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrjeje tjetër.

Forma e përqendrimit është ajo e përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë nga personat fizikë z. Samir Manë dhe z. Shefqet Kastrati mbi Insig jete sh.a.

Pas transaksionit, ndërmarrja Insig Jete SHA, ndryshon strukturën e kapitalit të ndërmarrjes respektivisht:

- Z. Samir Manë 45 % në kapital, me nr. aksione XXXX me vlerë XXXXX secila, vlera në lekë XXXXX;
- Z. Shefqet Kastrati 45 % në kapital, me nr. aksione XXXX me vlerë XXXXX secila, vlera në lekë XXXXX ;
- Shoqëria "Eurosig" SHA. 10 % në kapital, me nr. aksione XXXX me vlerë XXXX secila, vlera në lekë XXXX.

Vlera e transaksionit në total është XXXX lekë ekuivalente me XXXX Euro.

#### **Palët në transaksion**

**Blerësi 1: Z. Samir Manë**, shtetas shqiptar, është President i Grupit Balfin. Z. Manë zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë Balfin SHPK.

**Blerësi 2: Z. Shefqet Kastrati**, shtetas shqiptar, është president i Grupit Kastrati. Fusha e veprimtarisë së tij është e gjerë. Z. Kastrati aktualisht zotëron aksione në shoqëri të cilat kryejnë veprimtari në sektorë dhe industri të ndryshme përfshi dhe tregun e sigurimeve jo jete në Shqipëri. Aktualisht z. Kastrati zotëron kuotat prej 84% të shoqërisë Alb Siguracion SHA.

**Shitësi:** Eurosig SHA, shoqëria aksionare, e themeluar dhe e regjistruar konform legjislacionit shqiptar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Eurosig është një shoqëri sigurimi e krijuar në formën e shoqërisë aksionare pa ofertë publike, e cila funksionon në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare": të Ligjit Nr. 52 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit".

**Shoqëria Target:** "Insig jete" SHA është një shoqëri aksionare e themeluar dhe e regjistruar konform legjislacionit shqiptar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Data e krijimit të shoqërisë është 23.12.2016 dhe ushtron aktivitetin e saj tregtar në territorin e Republikës së Shqipërisë në sektorin e sigurimit dhe ri-sigurimit të jetës në bazë të Licencës me nr.4/2000 datë 22.6.2012 lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Insig).

#### **Xhiro për vitin 2016**

Llogaritja e xhiros së palëve në këtë transaksion, në zbatim të nenit 12, pika 1/b, dhe neni 17, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 " Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, përcakton se për shoqërisë e sigurimit përdoret vlera bruto e primeve të nënshkruara.

Sipas të dhënave të Pasqyrave Financiare të depozituar në dosjen e palëve njoftuese, konstatohet së vlera e primit bruto për vitin 2016 është si më poshtë:

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXX Lekë:

— Eurosia SHA<sup>1</sup> : XXXX Lekë

— Insia Jeta SHA<sup>2</sup> : XXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenet përkatëse dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## **ANALIZA E KONKURRENCËS**

Në zbatim të nenit 13 të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, vlerësimi i konkurrencës në rastet e vlerësimit të përqendrimeve mbështetet në analizën e efikasave ekonomike dhe përfitimet e konsumatorit e cila e shprehur në terma real ka të bëjë me uljen e çmimit dhe rritjen e cilësisë së shërbimit. Gjatë vlerësimit të përqendrimeve, elementët e analizës së konkurrencës fokusohet në përcaktimin e tregun përkatës i cili përfshin tregut specifik ku ndodh transaksioni.

Sipas të dhënave të deklaruara nga palët, transaksioni ndodh në tregun e sigurimit të Jetës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), si edhe Udhëzimit Nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit, dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.

**Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu i sigurimit të jetës.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë është një treg financiar i rregulluar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Sipas të dhënave të deklaruara nga palët, transaksioni i shitjes së kuotave ka marrë miratim nga Bordi i AMF. Sipas informacionit të ardhur nga ky institucion, AMF vlerësoi përshtatshmëria e aksionarëve të rinj për të mbajtur këtë pozicion, mospasja e detyrimeve fiskale të papaguara në afat si dhe mospasja e kredive të kualifikuara si “kredi të këqija” prej tyre. AMF vlerësoi se gjatë pesë viteve të fundit, dy aksionarët nuk ishin dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale në fushën ekonomike dhe atë financiare; nuk ishin ortakë të një shoqërie, për të cilën janë hapur procedurat e falimentimit apo të vendosur në likuidim për 5 vitet e fundit; nuk ju është hequr e drejta për të ushtruar një veprimtari të caktuar tregtare brenda apo jashtë vendit; nuk kishin dhënë kontribut apo ndihmë në themelimin e veprimtarive të paautorizuara tregtare të pranimit dhe grumbullimit të depozitave si dhe në lidhje me burimin e parave për blerjen e aksioneve, u vlerësua se dokumentacioni i paraqitur justifikonte burimin e kapitalit në shoqërinë e sigurimit.

Për arsyet e mësipërme, Bordi i AMF me Vendimin Nr 53, datë 22.05.2017 ka miratuar pjesëmarrjen influencuese në shoqërinë e sigurimit “Insia Jete” SHA në masën 45% të aksionarit Z.Samir Mane dhe në masën 45% të aksionarit Z.Shefqet Kastrati.

## **Struktura e tregut përkatës**

Sikurse u paraqit më sipër, tregu i sigurimeve është një treg i rregulluar nga aktet ligjore dhe nënligjore dhe i kontrolluar nga autoriteti përkatës mbikëqyrës, treg në të cilët ofrojnë shërbimin e tyre 8 ndërmarrje të sigurimit të jo-jetës dhe 3 ndërmarrje të sigurimit të jetës.

Sigurimi i Jetës zë 6.33 % të totalit të primeve të tregut të sigurimeve.

Sipas definicionit të tregut të produktit dhe të dhënave të AMF, në tregun e sigurimit të Jetës, volumi i primeve të shkruara bruto kapi shifrën 977 932 000 lekë duke shënuar një ulje në masën 4.82% krahasuar me vitin

<sup>1</sup>Burimi: Pasqyrat financiare për vitin 2016 i shoqërisë Eurosia sh.a.

<sup>2</sup>Burimi: Pasqyrat financiare për vitin 2016 i shoqërisë Insia sh.a.

2015. Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në shifrën 113 611 duke shënuar ulje në masën 0.06% krahasuar me vitin 2015.

Produkti kryesor i sigurimit të jetës është “Jeta e Debitorin”, i cili është sigurim i detyrueshëm për mbajtësin e kredive bankare. Ky produkt zotëron rreth 53% të primit bruto të sigurimit të jetës dhe 44% të kontratave të nënshkruara për vitin 2016, ndërkohë që ka një numër të konsiderueshëm produkte të tjera për të cilat nuk është lëshuar asnjë policë sigurimi.

Për vlerësimin e tregut të sigurimit të jetës, u morën në konsideratë indikatorë makroekonomik GIS (Global Insurance Statistics)<sup>3</sup> të cilët masin performancën dhe konkurrueshmërinë e tregut të sigurimeve në tregun e brendshëm si dhe krahasimin e indikatorëve me tregun e jashtëm. Analiza u realizua mbi indeksin e penetrimit, indeksin e densitetit, HHI, pjesët e tregut dhe nivelin e përqendrimit.

Dy treguesit e parë janë në nivele shumë të ulta krahasuar me vendet e OECD gjë e cila tregon se tregu i sigurimit të jetës është i ngurtë, me mungesë interesimi dhe kërkesë nga konsumatorët. Duke qenë se një pjesë e produkteve janë sigurime vullnetare, është shumë i rëndësishëm përdorimi i mekanizmeve të marketingut për nxitjen e interesit dhe rritjen e kulturës për përfitimet e skemës. Gjithsesi, vihen re se në vitet e fundit janë ofruar forma marketingu për shitje të produkteve të lidhura duke ndërthurur tregje jo të lidhura dhe duke rritur interesin e konsumatorit nëpërmjet mekanizmit të përfitimit (Spitali Amerikan/paketat Sicred; Credins invest/Fondi i pensionit etj).

Pas vlerësimit të pjesëve të tregut (Market Share) dhe llogaritjes së indeksit të Herschman Herfindal, rezultoi se tregu i sigurimit të jetës paraqet një strukturë oligopolistike me tregues të lartë të përqendrimit të tij (HHI=4536) për shkak të numrit të kufizuar të ndërmarrjeve në treg. Në këtë treg kryejnë aktivitetet ndërmarrjet Sigal Life Uniq Group Austria me 59.96% të tregut, Sicred me 28.35% dhe Insig Jeta me 11.69%.

**Primit e Shkruara Bruto nga Shoqëritë e Sigurimit të Jetës**

| Shoqëria e sigurimit<br>Insurance company      | Vlera (në mijë lekë)<br>Value (in thous. ALL) | Ndryshimi<br>(në %)<br>Change<br>(in %) | Pjesa ndaj Totalit<br>(në %)<br>Share in total value<br>(in %) |        |        |
|------------------------------------------------|-----------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------------------------------------------------|--------|--------|
| Viti / Year                                    | 2015                                          | 2016                                    | 16/15-1                                                        | 2015   | 2016   |
| Primi i Shkruar Bruto / Gross Written Premiums |                                               |                                         |                                                                |        |        |
| Sigal Life Uniq Group Austria                  | 675,482                                       | 586,355                                 | (13.19)                                                        | 65.74  | 59.96  |
| Sicred                                         | 265,575                                       | 277,208                                 | 4.38                                                           | 25.85  | 28.35  |
| Insig                                          | 86,384                                        | 114,369                                 | 32.40                                                          | 8.41   | 11.69  |
| TOTAL                                          | 1.027.442                                     | 977.932                                 | (4.82)                                                         | 100.00 | 100.00 |

Siç shihet nga të dhënat zyrtare, shoqëria objekt transaksioni ka pjesën më të ulët të tregut me vetëm 11.69 % por me performancë në rritje në vitin 2016.

Sipas të dhënave të AMF, ndërmarrjet Sicred SHA dhe Insig Jete Sha janë me kapital vendas (aksionar shqiptar) dhe pjesa e tregut që zotërojnë këto ndërmarrje për vitin 2016 është rreth 40%. Blerja aksioneve të ndërmarrjes Insig Jete nga z. Mane dhe z. Kastrati ruan strukturën e tregut me kapital vendas.

Nga gjithë sa u analizua më sipër, mendojmë se blerësit do të japin mundësi të reja vizioni dhe mbështetje ekonomike ndërmarrjes Insig Jete SHA pas transaksionit në fjalë. Duke qenë pjesë e suksesshme të tregjeve të tjera, do të kenë mundësi të ofrojnë strategjitë e marketingut për nxitjen e kërkesës konsumatorë sikurse i gjejmë në dy ndërmarrjet e tjera në treg Sigal Jeta dhe Sicred.

Ndryshimi i kontrollit të Insig Jetës ndodhi në muajin prill 2017 dhe për të vlerësuar ndikimin që ka patur ndryshimi i aksionareve në ndërmarrjen Insig Jetë, u realizua një analizë krahasimore e treguesve të vitit 2017 me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

<sup>3</sup> Kwon & Wolf from, OECD(2016): “Analytical tools for the insurance market and macro-prudential surveillance”

**Primet e Shkruara Bruto dhe Dëmet e Paguara nga Shoqëritë e Sigurimit të Jetës**  
*Gross Written Premiums and Paid Claims by Life Insurance Companies*

| Shoqëria e sigurimit<br><i>Insurance company</i> | Vlera (në mijë lekë)<br><i>Value (in thous. ALL)</i> | Ndryshimi<br>(në %)<br><i>Change<br/>(in %)</i> | Pjesa ndaj Totalit<br>(në %)<br><i>Share in total value<br/>(in %)</i> |        |        |
|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|--------|--------|
| Janar - Gusht / January - August                 | 2016                                                 | 2017                                            | 17/16-1                                                                | 2016   | 2017   |
| Primi i Shkruar Bruto / Gross Written Premiums   |                                                      |                                                 |                                                                        |        |        |
| Sigal Life Uniq Group Austria                    | 406.595                                              | 510.489                                         | 25,55                                                                  | 68,14  | 67,24  |
| Sicred                                           | 146.942                                              | 165.089                                         | 12,35                                                                  | 24,62  | 21,74  |
| Insig                                            | 43.193                                               | 83.670                                          | 93,71                                                                  | 7,24   | 11,02  |
| TOTAL                                            | 596.730                                              | 759.249                                         | 27.23                                                                  | 100,00 | 100,00 |

Treguesit e vlerës së primeve bruto të nënshkruara për periudhën janar-gusht 2017<sup>4</sup> janë në rritje me rreth 94% duke e vlerësuar ndërmarrjen një konkurrense potencial të tregut.

Sipas treguesve nga AMF në lidhje me pjesëve të tregut të ndërmarrjeve të sigurimit të Jetës për periudhën janar-gusht 2017 dhe krahasimit me të njëjtën periudhë të vitit 2016, vihet re qartë se pjesa e tregut të Insig Jete në vitin 2017 është rritur duke arritur nivelin 11.2% nga 7.24% të tregut për të njëjtën periudhë 2016. Ky fakt tregon se ndërmarrja ka tregues në rritje dhe mendohet se do të jetë një konkurrent i fuqishëm në treg duke rritur konkurrencën mes ndërmarrjeve në treg.

Në tregje me numër të kufizuar të konkurrentëve, (në të cilin gjatë viteve të fundit janë kryer vetëm ndryshime kontrolli dhe nuk ka hyrës të rinj), me produkte homogjene dhe transparencë informacioni, çdo transaksion përqendrimi brenda tregut do të ndikojë drejtpërdrejtë të dy produktet, sigurimin e jetës dhe jo jetës dhe do të ketë pasojë në konkurrencën në treg. E rëndësishme për të drejtën e konkurrencës është rritja e efikasitetit të tregut dhe e përfitimeve të konsumatorit<sup>5</sup>.

### Konkluzione

Transaksioni i njoftuar përbën një përfitim të drejtpërdrejtë kontrolli të 90% të kuotave të shoqërisë Insig Jeta SHA nga persona fizik z. S. Mane dhe z. Sh. Kastrati me nga 45% secili.

Tregu i sigurimeve në Shqipëri mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.13% të vëllimit të përgjithshëm të primeve. Tregu i sigurimeve të Jetës zë vetëm 6.33% dhe tregu i ri sigurimit me 0.54%.

Pjesët e tregut pas transaksionit nuk pritet të kenë ndryshime në strukturën e tregut të sigurimeve të jetës ku ushtron veprimtarinë shoqëria Insig Jeta SHA, pasi ky transaksion nuk do të shkaktojë mbivendosje horizontale të veprimtarive të palëve si dhe tregjeve të prekura.

Gjithsesi si para dhe pas transaksionit asnjëra nga ndërmarrjet objekt i përqendrimit të analizuar, nuk zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës të sigurimeve të jetës.

Nga analiza e treguesve të performancës së tregut të sigurimit të jetës rezulton se tregu performon dobët por me tregues në rritje gjatë vitin 2016 dhe 8 muji 2017 dhe transaksioni i njoftuar mendojmë se do të sjellë përfitime për tregun dhe konkurrencën në të.

Nga administrimi i dokumentacionit financiar të paraqitur nga personat fizik Z. Mane nëpërmjet Shoqërisë Balfin SHPK dhe z. Kastrati nëpërmjet shoqërisë Kastrati Group dhe AlbSiguracion SHA, vlerësojmë dy personat fizik kanë garanci financiare për të siguruar performancë më të mirë të shoqërisë Insig Jete.

**Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstaton se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg, ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit, ose forcimit të pozitës dominuese.**

<sup>4</sup><http://www.amf.gov.al/statistika.asp?id=1&s=1#>

<sup>5</sup>Neni 13/2 Ligji 9121/2003.

## **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës:

### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 90% të ndërmarrjes Insig Jete SHA, nga Eurosig SHA tek z. Shefqet Kastrati dhe z. Samir Mane.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 480, datë 09. 11. 2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të ndërmarrjes Jordan d.o.o. tek Telekom Slovenije d.d..**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 09.11.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të ndërmarrjes Jordan d.o.o tek Telekom Slovenija d.d.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të ndërmarrjes Jordan d.o.o tek Telekom Slovenije d.d;

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Pranë Autoritetit të Konkurrencës (AK) në datën 09.10.2017, me shkresë Nr. 406 Prot, janë depozituar dokumente dhe informacione në lidhje me përfitim të kontrollit të aksioneve të ndërmarrjes JORDAN nga TELEKOM.

Palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Shitjen në datë 21 Shtator 2017 dhe njoftimi është kryer pranë Autoritetit të Konkurrencës në datë 09.10.2017, duke respektuar afatin ligjor prej 30 ditësh siç përcakton neni 12, pika 2 e Ligjit Nr 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar.

#### Palët në transaksion

**Blerësi: Telekom Slovenije d.d.**, është ofrues i shërbimeve të telekomunikacionit, i regjistruar në Regjistrin Zyrtar të Agjencisë për Rrjetet dhe Shërbimet e Komunikimit të Republikës së Sllovenisë si kontraktues ose operator i shërbimeve në vijim: vlerë e shtuar, rrjeti vendas dhe bashkë-vendas, TV mobile, shërbime telefonike ndërkombëtare të disponueshme publikisht, shërbimet e aksesit në internet me brez të gjerë, shërbime të shpërndarjes analoge dhe sinjale dixhitale të radios përmes rrjeteve kablllore dhe radio, shërbime telefonike në shërbim të publikut, informacione rreth numrave të telefonit dhe publikimit, shërbime zanore satelitore, shërbime të dhëna me qira të fibrave optike të ndriçuara, shërbimet për transmetimin ose drejtimin e trafikut kombëtar dhe aksesin kombëtar, transmetimi i të dhënave në rrjetet fikse, shërbimet analoge dhe dixhitale të shpërndarjes së sinjaleve televizive përmes rrjeteve kablllore dhe IP TV, akses në internet dhe



tranzit interneti, shërbimet e të dhënave me satelit dhe akses në internet, lloje të tjera shërbimesh, shërbime të telefonisë në një vend të caktuar përmes TDM dhe shërbimet e ndërlidhjes ndërkombëtare, shërbimet e zërit në rrjetin publik të telefonisë së lëvizshme, shërbimet e linjës, pajisjet e rrjetit dhe komunikimit, shërbimet e inteksonjeksionit të rrjetit fiks dhe celular, IP, akses në internet dhe brez të ngushtë, shërbime të dhënash në rrjetin publik të telefonisë së lëvizshme.

**Shitësi/Ndërmarrja Target: Jordan podjete za zaposlovanje in usposabljanje invalidor Krsko d.o.o (Jordan d.o.o)** me adresë Spodnji Stari Grad 9, 8270 Krsko, e regjistruar më 24.01.1991, me nr. regjistrimi 5454433000, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me kapital aksionar 9.101,00 Euro. Ndërmarrja Jordan, është ndërmarrje sllovene me përgjegjësi të kufizuar, ndërmarrje për punësimin dhe trajnimin e njerëzve me aftësi të kufizuara.

Transaksioni ka të bëjë me shitjen dhe transferimin e aksioneve të Jordan d.o.o tek Telekom Slovenije. Jordan, me Vendimin e Këshillit Ekzekutiv të Asamblesë së Republikës së Sllovenisë, Nr 01 90-04/32-8 datë 17 tetor 1999 ka marrë statusin e një shoqërie për persona me aftësi të kufizuar. Transaksioni ka të bëjë me marrjen e kontrollit të vetëm nga ana e Telekom<sup>1</sup> mbi Jordan.

Shitësi Jordan zotëron 2 aksione biznesi në ndërmarrje :

- Aksion biznesi në vlerën nominale prej XXXXX Euro;
- Aksion biznesi në vlerën nominale prej XXXXX Euro,

ku të dyja së bashku përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë. Pas përqendrimit, Telekom do të zotërojë 100% aksionet e Jordan duke marrë kontrollin e vetëm mbi këtë ndërmarrje.

Telekom Slovenije është aktive në sektorin e telekomunikacionit ku në Shqipëri aktivitetet e saj janë të kufizuara kryesisht në shërbimin roaming të telefonisë celulare dhe me shumicë/fikse të ndër operatorëve.

Biznesi Target funksionon në Slloveni dhe merret me trajnimin dhe punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara, aktive në prodhimin e artikujve prej letre dhe kartoni. Nuk ka aktivitet në Shqipëri dhe ndërmarrja Jordan nuk ka degë në Shqipëri.

Në Marrëveshjen për shitjen dhe transferimin e aksioneve është parashikuar se transaksioni do të quhet i përfunduar me marrjen e të gjitha miratimeve përkatëse (nga rregullatorët dhe Autoritetet përkatëse të Konkurrencës), përfshirë edhe autorizimin nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës.

## **Xhiro për vitin 2016**

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXXXX Lekë:

- Telekom Slovenije d.d.<sup>2</sup> : XXXXX Euro<sup>3</sup> = XXXXX Lekë
- Jordan d.o.o.<sup>4</sup> : XXXXX Euro = XXXXX Lekë

Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është XXXXX Lekë:

- Telekom Slovenije d.d. : XXXXX Euro = XXXXX Lekë<sup>5</sup>

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa a) dhe b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “ Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

<sup>1</sup>Telekom Slovenia është shoqëria kontrolluese e Grupit Telekom Slovenia. Ky grup ka selinë në Lubjanë dhe është i angazhuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve të lidhura me rrjetet (telekomunikacionet) në Slloveni dhe jashtë saj.

<sup>2</sup>Burimi: Raporti Vjetor për vitin 2016 i Telekom Slovenije.

<sup>3</sup>Burimi: Kursit zyrtar i Bankës së Shqipërisë për vitin 2016, 1Euro = 137 lekë.

<sup>4</sup>Burimi: Pasqyrat financiare për vitin 2016 të Jordan d.o.o.

<sup>5</sup>Burimi: Deklaratë e Telekom Slovenije për të ardhurat e realizuara në Shqipëri për vitin 2016, shkresa me Nr 294/3 Prot., datë 25.07.2017



## **Përcaktimi i tregut përkatës**

**Telekom Slovenije d.d.** është një shoqëri aksionare dhe aksionari më i madh i saj është Shteti i Sllovenisë (62.54%). Telekom Slovenije d.d. është e angazhuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve të lidhura me rrjetet (telekomunikacion) në Slloveni dhe jashtë saj. Shërbimet e telekomunikacionit të ofruara nga kjo shoqëri, përfshijnë telefoni zanore fikse dhe të lëvizshme, transmetim fiks dhe të lëvizshëm të dhënash, akses interneti me brez të gjerë (broadband) dhe akses në rrjete televizioni.

Kjo ndërmarrje nuk ushtron aktivitet në Shqipëri por ka realizuar të ardhura në Shqipëri për vitin 2016 nga shërbimi roaming dhe shërbimet e telefonisë fikse me shumicë për inter-operatorët.

**Jordan Podjetje Za Zaposlovanje In Usposabljanje Invalidov Krsko d.o.o.** ndërmarrje sllovene, një shoqëri e cila merret me trajnimin dhe punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe është aktiv në prodhimin e artikujve prej letre dhe kartoni. Jordan nuk ka aktivitet në Shqipëri.

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me marrjen e kontrollit të vetëm nga Telekom Slovenie mbi të gjithë ndërmarrjen Jordan d.o.o.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit, dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.

**Tregu përkatës i produktit:** duke qenë se produkti që realizon të ardhura në Shqipëri është shërbimi i telefonisë celulare, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i shërbimit roaming dhe shërbimet e telefonisë fikse me shumicë për inter-operatorët.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

## **VLERËSIMI I KONKURRENCËS**

Në kuptim të Ligjit Nr. 9121, datë 28/07/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, vlerësimi i konkurrencës në treg në rastet e përqendrimit konsiston në vlerësimin e konkurrencës aktuale dhe asaj potenciale para dhe pas përqendrimit, në krijimin/forcimin ose jo të pozitës dominuese apo në mbi vendosje pjesësh tregu.

Dy palët në marrveshje ushtrojnë aktivitet në tregje të ndryshme dhe asnjë prej tyre nuk ushtron aktivitet në territorin e Shqipërisë. Telekom Slovenije d.d. realizon të ardhura vetëm nga shërbimi roaming dhe shërbimet e telefonisë fikse me shumicë për inter-operatorët ndërkohë që Jordan d.o.o. nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

## **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës:

## **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të Jordan d.o.o tek Telekom Slovenije d.d..
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 484, datë 23.11.2017

### **Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek VODAFONE ALBANIA SHA.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|      |                |         |
|------|----------------|---------|
| Znj. | Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z.   | Koço BROKA     | Anëtar  |
| Znj. | Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z.   | Eduard YPI     | Anëtar  |
| Znj. | Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 23.11.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek VODAFONE ALBANIA SH.A.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, neni 13, pika 3 dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi transferimin e ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SH.A tek VODAFONE ALBANIA SH.A

### **VËREN SE:**

#### **TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI**

Nëpërmjet shkresës Nr. 408 Prot, datë 11.10.2017 është depozituar njoftimi dhe dokumentacioni i plotë e i saktë në lidhje me Marrëveshjen për Transferimin e Spektrit nga Plus tek Vodafone.

Plus Communication, në datë 26 korrik 2017 me shkresën Nr. 326 Prot ka kërkuar konsultim paraprak lidhur me transaksionin e pritshëm që do të ndodhte në tregun e telefonisë celulare. Bashkëlidhur shkresës së Plus, gjendej edhe një korrespondencë (shkresa me Nr 744, Prot, datë 18.07.2017) ku Plus i ishte drejtuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me miratimin paraprak për transferimin e frekuencave dhënë në përdorim sipërmarrësit Plus tek dy operatorët e tjerë celularë dhe konkretisht Vodafone dhe Telekom.

Në përgjigje të kërkesës së Plus, është kërkuar plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin e përqendrimit.

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr 326/3, datë 05.10.2017 “Kërkesë për informacion “ i është drejtuar AKEP ku kërkon informacion nëse është marrë vendim lidhur me miratimin e procedurës së transferimit të spektrit. AKEP me shkresën Nr 326/4, Prot, datë 11.10.2017 informon Autoritetin e Konkurrencës se kishte filluar procedurat e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga Plus për miratimin e transferimit të frekuencave. Gjithashtu na informon se ka kërkuar dokumentacion shtesë, deri në dhënien e autorizimeve individuale për lejimin e përdorimit të frekuencave të transferuara nga Plus tek dy operatorët Telekom dhe Vodafone, duke

vendosur kushtet e përdorimit të tyre, kushte të veçanta në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në kuadrin e tyre ligjor në fuqi.

Në vijim të këtij komunikimi, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr 408/1, datë 16.10.2017 “Mbi vlerësimin e transaksionit të kalimit të frekuencave nga Plus Communication SHA tek Vodafone Albania SHA”, ka kërkuar informacion lidhur me vlerësimin që rregullatori ka bërë për procedurën e transferimit të spektrit si dhe vendimmarrjen e Këshillit Drejtues të AKEP.

Nëpërmjet shkresës Nr. 408/5, datë 13.11.2017, prot i AK, është depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, Vendimi Nr. 20, datë 13.11.2017 i AKEP “Për dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtës së përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication SHA tek sipërmarrësit Telekom Albania SHA dhe Vodafone Albania SHA”.

Me qëllim realizimin e një vlerësimi të plotë të transaksionit dhe pasojave në treg, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 326/6, datë 06.11.2017 “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar Plus Communication, ku kërkon informacion shtesë mbi arsyet ekonomike që çuan në vendimmarrjen e transferimit të spektrit të frekuencave. Në përgjigje të shkresës sonë, Plus, nëpërmjet shkresës Nr. 326/7 Prot., datë 07.11.2017 “Dërgohet informacion pranë Autoritetit të Konkurrencës” na informon se: Për shkak të vështirësive financiare ndërmarrja nuk mund të vijojë më tej me investime për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe konkurruese ndaj konsumatorëve dhe duke pasur parasysh kërkesat e AKEP ndaj operatorëve të tjerë për të siguruar vijimin e ofrimit të shërbimeve të kontraktuara, kërkon të transferojë frekuencat në përdorim të saj tek operatorët e tjerë celular sipas Marrëveshjeve me këta operatorë.

### **Palët në transaksion**

Ndërmarrja Vodafone Albania SHA (Vodafone), një shoqëri aksionare, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 15.5.2001, me Numër Unik Identifikimi K11715005L dhe me seli në adresën: Autostrada "Tiranë-Durrës", Rr. "Pavarësia", Nr. 61, Kashar, Tiranë. Kapitali i ndërmarrjes Vodafone është XXX lekë me numër aksionesh XXX me vlerë XXX lekë secila.

Ndërmarrja Target : Plus Communication SHA (Plus), një shoqëri aksionare e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 11.06.2009, me NIPT K91811014B, me seli qendrore në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova", Godina e Re, pranë Gardës së Republikës, Kati i 2, Tiranë, Shqipëri. Kapitali i ndërmarrjes është XXX lekë me numër aksionesh XXX me vlerë nominale XXX lekë secila.

### **Përqendrimi**

Transaksioni konsiston në përfitimin e të drejtave të përdorimit të ½ të spektrit të Plus nga Vodafone. Vodafone dhe Plus kanë rënë dakord<sup>1</sup> për transferimin e të drejtës së përdorimit të ½ të spektrit të frekuencave 900 MHz; ½ të spektrit të frekuencave 1800 MHz dhe ½ të spektrit të frekuencave 1970-1980 MHz çiftuar me 2160-2170 MHz, për kohëzgjatjen e mbetur respektivisht, dhënë në përdorim Plus nga AKEP.

Plus<sup>2</sup> ushtron veprimtarinë e vet në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 745, datë 26.06.2009, i ndryshuar, dhe është pajisur nga AKEP me Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 dhe Vendimin e AKEP Nr. 2677, datë 21.04.2016 “Dhënie e Autorizimit Individual sipërmarrësit Plus Communication...” për të drejtat e përdorimit të brezit të frekuencave 1970-1980 MHz çiftuar me 2160-2170MHz dhe 5 MHz spektër i pa-çiftuar 1915-1920 MHz, për një periudhë 15 vjeçare.

<sup>1</sup>Marrëveshja për Transferimin e Spektrit dhe Marrëveshja për Zgjidhjen me Pajtim

<sup>2</sup>Në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve të datës 22 qershor 2010, miratohet ndryshimi i emrit të shoqërisë MOBILE 4 AL SHA në PLUS COMMUNICATION SHA, reflektuar në QKB në datë 12.07.2010

Palët kanë nënshkruar **Marrëveshjen për Zgjidhjen me Pajtim** në datë 18 tetor 2017. Për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me njohjen e detyrimeve që 3 operatorët e tjerë i kishin Plus Communication për tarifat e terminimit, për shkak të tarifave asimetrike, palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje por edhe palë të treta<sup>3</sup> të përfshira në konflikte gjyqësore të papërfunduara, njihen me vlerën e detyrimit ndaj Plus dhe bien dakord mbi mënyrën e pagesës sipas kushteve të parashikuara në marrëveshje respektive me Vodafone, Albtelecom dhe Plus.

Në po të njëjtën datë, 18 tetor 2017, është lidhur midis Plus dhe Vodafone **Marrëveshja për Transferimin e Spektrit**. Plus zotëron spektrin e frekuencave 900, 1800 dhe 2100 MHz dhe këto frekuenca janë të transferueshme në përputhje me parashikimet e Ligjit Për Komunikimet Elektronike (Ligji Nr 9918/2008).

Në zbatim të nenin 74 të Ligjit Nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, Plus bën kërkesë për miratim paraprak të transferimit të spektrit të frekuencave, për të cilat AKEP nëpërmjet Vendimi Nr. 20, datë 13.11.2017 “Për dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtës së përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication SHA tek sipërmarrësit Telekom Albania SHA dhe Vodafone Albania SHA” vendosi të jap paraprakisht miratimin për transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus tek sipërmarrësit Vodafone dhe Telekom Albania SHA.

**Çmimi i transferimit**<sup>4</sup>: XXXXXX Euro pa TVSH.

Pjesë e paketës së transferimit është edhe **Marrëveshje për Zgjidhje me Pajtim** mes Albtelecom dhe Plus e lidhur në datë 18 tetor 2017 dhe bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje janë disa anekse shoqëruese dhe plotësuese të marrëveshjes. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, palët Albtelecom dhe Plus kanë rënë dakord të tërhiqen dhe të heqin dorë përfundimisht nga gjykimi i të gjitha mosmarrëveshjeve gjyqësore pavarësisht ekzekutueshmërisë së vendimeve gjyqësore.

Sipas kësaj marrëveshjeje, Albtelecom është shprehur se nuk ka më interes të përdorë, të gjithë apo një pjesë të frekuencave që ju janë akorduar Plus nga AKEP, dhe se për këtë arsye nuk ka asnjë pretendim në të tashmen apo në të ardhmen, kërkesa apo kërtime në rast se këto frekuenca do ti transferohen të tretëve (përfshirë operatorët e tjerë shqiptarë).

Sipas vlerësimit të AKEP, marrëveshjet për transferim frekuencat midis tre operatorëve (nga Plus Communication tek Vodafone Albania dhe Telekom Albania) si dhe midis katër operatorëve të rrjetit celular (për tarifat e terminimit të aplikueshme në Plus dhe proceset gjyqësore) nuk janë de-juro marrëveshje për bashkim apo për blerje kompanish (Merger apo Take-over), këto marrëveshje për transferim të plotë të radio frekuencave të Plus (asete të paprekshme të subjektit Plus) tek dy operatorët e tjerë celular de-fakto çojnë në ndryshim të strukturës së tregut dhe duhen trajtuar në bazë të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

## **Xhiro për vitin 2015**

Xhiro e palëve në këtë transaksion, në zbatim të nenit 12, pika 1/b, dhe neni 17, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, llogaritet sipas të dhënave të Pasqyrave Financiare të depozituar në dosjen e palëve njoftuese nga ku konstatohet se xhironja vjetore për vitin 2016 është si më poshtë:

Xhiro totale e palëve në **tregun e brendshëm**: është XXX **Lekë**:

— Vodafone Albania SHA<sup>5</sup>: XXX Lekë

— Plus Communication SHA<sup>6</sup>: XXX lekë

<sup>3</sup>Autoriteti i Konkurrencës; Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare; Albtelecom dhe Telekom Albania

<sup>4</sup>Burimi: Pika 3.1 e Marrëveshjes për Transferimin e Frekuencave

<sup>5</sup>Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara viti 2016 për shoqërinë Vodafone Albania SHA.

<sup>6</sup>Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara viti 2016 për shoqërinë Plus Communication SHA.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **Përcaktimi i tregut përkatës**

Vlerësimi i konkurrencës në rastet e përqendrimeve realizohet duke patur parasysh strukturën e tregut dhe konkurrencën aktuale dhe potenciale në treg. Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), si edhe Udhëzimit Nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit, dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.

**Tregu përkatës i produktit:** referuar analizave, treg përkatës i produktit do konsiderohet tregu i frekuencave dhënë në përdorim të operatorit Plus Communication SHA nga AKEP (frekuencat GSM 900MHz, 1800MHz dhe 2100MHz). Në këtë rast mund të themi se kemi edhe tregje të prekura dhe të lidhura me tregun përkatës i cili është tregu me pakicë i telefonisë celulare. Të gjithë operatorët që ushtrojnë veprimtari në tregun e telefonisë celulare në Shqipëri, janë të integruar vertikalisht në tregun e telefonisë celulare me pakicë.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

### **VLERËSIMI I KONKURRENCËS**

Transaksioni ndodh në tregun e spektrit të frekuencave të cilët mbikëqyren dhe rregullohet nga AKEP në zbatim të nenit 74 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH” dhe Rregullores Nr. 30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”.

Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga palët në shkresën Nr. 326 Prot. (prot AK), datë 26.07.2017 “Kërkohet konsultim paraprak nga AK”, struktura e tregut të frekuencave është si më poshtë:

(Të dhëna konfidenciale)

Nga analiza e treguesve, vihet re se asnjë nga operatorët në treg nuk ka pozitë dominuese në tregun e frekuencave të dhëna nga AKEP.

Sikurse është përshkruar më sipër, marrëveshja e transferimit të frekuencave ka parashikuar transferimin e ½ të frekuencave nga ndërmarrja Plus Communication drejt ndërmarrjes Vodafone Albania pas së cilës struktura e tregut dhe pjesa e kombinuar paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

(Të dhëna konfidenciale)

Në kushtet kur totali i frekuencave është i kufizuar, transaksioni i transferimit do të sjellë rritje të pjesës së tregut të brezit të frekuencave për ndërmarrjen Vodafone Albania, e cila pas përqendrimit arrin nivelin mbi XX % për bllokun e frekuencës 900MHz, XX % për frekuencën 2100MHz dhe me një nivel të konsiderueshëm (XX %) në frekuencën 1800 MHz.

Referuar informacionit të paraqitur nga Plus nëpërmjet shkresës Nr. 326, datë 26.07.2017 ndërmarrja Plus shprehet se ka renë dakort për transferimin e spektrit me qëllimin e vetëm që tregu i komunikimeve elektronike të gjenerojë zhvillime të mëtejshme. Plus shprehet se “Gjatë gjithë viteve të operimit në treg, që nga viti 2010, shoqëria ka rezultuar me humbje të konsiderueshme.... Humbja e akumuluar në vite kapin shifra të konsiderueshme rreth 6.1 milion lekë dhe për këtë arsye aksionaret e shoqërisë kanë ndërmarre dy herë masa ristrukturimi të kapitalit për të mbuluar humbjet.”

Referuar të dhënave mbi numrin e pajtimtarëve të katër ndërmarrjeve në treg, vihet re se ndërsa në tregun e frekuencës, PLUS zotëron gjysmën e tregut të spektrit që ka Telekom apo Altelekom, në tregun e shërbimeve,

konkretisht në kartat SIM përfshire broadband dhe datacard, PLUS zotëron vetëm 4.2% të tregut ndërkohe që Telekom zotëron 32.1% të tregut dhe Albtelekom 14.2%, gjë e cila tregon për nivel të ulët të shfrytëzimit të spektrit të frekuencave. Në kushtet kur ndërmarrja Plus paraqet tregues të ulët të performancës financiare dhe teknike dhe deklaron vështirësi në kryerjen e investimeve.

Në nenin 13, pika 3 të Ligjit Nr.9121, parashikohet se një përqendrim mund të mos ndalohet në rastet kur ndërmarrja palë në përqendrim rrezikon seriozisht të falimentojë dhe nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së saj ose ndërmarrja duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt, pavarësisht forcimit të pjesë së tregut të ndërmarrjeve palë në marrëveshje.

Konkurrenca ndikohet nga numri i konkurrentëve efektivë në treg. Sipas AKEP vlerësohet se tre konkurrentët mund të zhvillojnë një gamë të gjerë shërbimesh duke ofruar shërbime me cilësi të lartë, çmime konkurruese, zgjedhje dhe inovacione për konkurrencën e përgjithshme të tregut.

Lidhur me vlerësimin paraprak të transferimit të spektrit, Këshilli Drejtues i AKEP, në Vendimin e tij Nr 20, datë 13.11.2017 “Për dhënien paraprakisht të miratimit për transferim frekuencash...” arriti në konkluzionin se:

- Spektri që zotërojnë aktualisht 3 operatorët, mënyra e shfrytëzimit, shërbimet e ofruara, teknologjia e aplikuar, numri i pajtimtarëve etj, bën që transferimi i spektrit nga Plus Komunikation të mos ndikojë në konkurrencën në treg,
- Ky spektër shtesë mendojmë se do të shfrytëzohet nga dy operatorët për rritjen e kapacitetit të transmetimit për shkak të kërkesës për trafik më të madh të dhënash,

Nga transaksioni i kërkuar:

- Nuk krijohen deformime të konkurrencës,
- Nuk dëmtohet përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient i spektrit të frekuencave,
- Rritet eficaenca e përdorimit të spektrit të frekuencave,
- Mbrohet interesi publik,
- Realizohet transparenca e nevojshme e parashikuar ligjërisht.

Për sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi të jap paraprakisht miratimin për transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus tek Vodafone dhe Telekom Albania SHA.

Transferimi i propozuar i frekuencave 900/1800/20100 MHz të Plus Communication tek Telekom Albania dhe Vodafone Albania është një rast i veçantë i transferimit të frekuencave në kuptim të Ligjit 9918/2008 dhe kuadrit rregullator evropian për komunikimet elektronike pasi operatori Plus do të transferojë jo një pjesë të spektrit të frekuencave por të gjithë spektrin drejt dy operatorëve të tjerë dhe si rrjedhojë nuk do të jetë më operator i rrjetit celular duke çuar në një konsolidim të tregut celular nga katër operatorë në tre të tillë.

AKEP vlerëson se përveç vlerësimit apo opinionit të AKEP të impaktit të transaksioneve të propozuara në konkurrencën në tregun celular, këto transaksione duhet të trajtohen nga AK në përputhje me Ligjin 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”.

Referuar detyrimit të përcaktuar në Ligjin 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Sekretariati mori në shqyrtim ndikimin që sjell në tregun e shërbimeve ky transaksion. Duhet të theksojmë se struktura e tregut të frekuencave jo detyrimisht përcakton edhe strukturën e tregut të shërbimeve celularë, për faktin se brezi i frekuencave përfaqëson vetëm kapacitetin teknik për të siguruar ofrimin e shërbimeve. Vlerësimi i konkurrencës si dhe i strukturave të tregut u realizua në tregun e ofrimit të shërbimit, output-et, e cila përfshin tregun e shumicës dhe tregun e pakicës së shërbimeve celulare, e detajuar kjo sipas produkteve.



## VLERËSIMI I TREGUT TË SHËRBIMEVE

Industria e telekomunikimit është një industri që siguron mesatarisht 40 miliard lekë të ardhura, ose rreth 3% të GDP së të shtetit shqiptar<sup>7</sup>. Telefonia celulare zë 91% të industrisë së telefonisë (fiks dhe celulare). Tregu i komunikimeve celulare, ka qenë në vite objekt vlerësimi dhe analize e Autoritetit të Konkurrencës e cila në bashkëpunim me AKEP ka vlerësuar dhe ka dhënë rekomandime në lidhje me shqetësimet e tregut.

Tregu i telefonisë celulare është një treg i rregulluar, me barriera në hyrje për shkak të numrit të kufizuar të licencave dhe referuar Kapitullit VI “Rregullimi i Konkurrencës” të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i sjelljes së sipërmarrësve në treg është objekt i këtij ligji e përcaktuar në nenet 31 deri 41 të Ligjit.

Referuar përcaktimit të tregut të produktit si dhe Raportit Vjetor 2016 të AKEP-it, rezulton se gjatë vitit 2016 tregu i telefonisë celulare paraqitet sipas treguesve të mëposhtëm:

### Burimi: AKEP, Raporti vjetor 2016

Nga të dhënat e tabelës vihet re se numri i përdoruesve të shërbimeve tradicionale telefonike celulare dhe sasia e thirrjeve dhe SMS-ve të gjeneruara nga përdoruesit celularë ka pasur luhajtje gjatë periudhës 2013-2016 dhe

|                                                                          | 2013          | 2014                 | 2015          | 2016          | Ndryshimi<br>2016/2015 |
|--------------------------------------------------------------------------|---------------|----------------------|---------------|---------------|------------------------|
| <b>Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:</b>                       |               |                      |               |               |                        |
| - sipas kartave SIM                                                      | 5,282,350     | 4,928,784            | 4,777,885     | 5,160,060     | <b>8%</b>              |
| - përdorues aktivë Numri                                                 | 3,685,983     | 3,406,772            | 3,442,665     | 3,360,888     | <b>-2%</b>             |
| <b>përdoruesve me akses broadband 3G/4G:</b>                             |               |                      |               |               |                        |
| - Totali                                                                 | 1,231,259     | 1,576,877            | 2,049,072     | 2,739,550     | <b>34%</b>             |
| - Përdorues aktive Thirrje                                               | 1,231,259     | 907,975 <sup>6</sup> | 1,297,281     | 1,686,354     | <b>30%</b>             |
| <b>telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)</b>                | 6,769,300,966 | 7,301,024,035        | 7,381,147,348 | 6,793,769,155 | <b>-8%</b>             |
| <b>Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit</b>                   | 1,689,200,882 | 1,826,346,190        | 1,598,702,865 | 1,610,322,977 | <b>1%</b>              |
| <b>Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)</b> | 2,529,549     | 6,269,940            | 12,740,073    | 26,753,639    | <b>110%</b>            |

këta tregues janë kryesisht me tendencë në rënie. Ndërkohë përdorimi i shërbimeve të aksesit broadband nga rrjete celulare ka rritje të ndjeshme në vitin 2016 krahasuar me vitin 2013. Rritja e ndjeshme e përdorimit të shërbimit të aksesit broadband celular në terma përdoruesish dhe trafikut të të dhënave në vitin 2016, është shoqëruar me rënie të përdorimit të shërbimeve tradicionale celulare, thirrje dhe SMS, duke evidentuar përsëri efektin e zëvendësimit të mesazheve SMS dhe thirrjeve telefonike me mesazhe/thirrje nga aplikacionet OTT (Over The Top) nga Interneti i aparateve celularë.

Sipas raportit të AKEP, tregu i telefonisë celulare ofron shërbimin e Thirrjeve Celulare, SMS, aksesin broadband, transferimit të të dhënave, thirrjeve dalëse brenda dhe jashtë vendit të cilat të vlerësuara sipas strukturës së tregut mes 4 operatorëve celularë, paraqiten si më poshtë:

<sup>7</sup> Bazuar në të dhënat e GDP për vitin 2015-2016 të INSTAT dhe Raportit vjetor të AKEP



| Shërbimet                                                             | Telekom Albania | Vodafone | Albtelecom | Plus | HHI   |
|-----------------------------------------------------------------------|-----------------|----------|------------|------|-------|
| Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card) | 32.1%           | 49.4%    | 14.2%      | 4.3% | 3,689 |
| Përdorues Aktivë Telefoni                                             | 30.7%           | 50.8%    | 13.1%      | 5.4% | 3,725 |
| Përdorues aktivë broadband                                            | 27.3%           | 54.7%    | 13.7%      | 4.3% | 3,940 |
| Thirrje dalëse                                                        | 33.7%           | 51.7%    | 10.8%      | 3.8% | 3,946 |
| SMS dalëse                                                            | 21.2%           | 66.7%    | 8.9%       | 3.2% | 4,986 |
| Trafik Data                                                           | 21.0%           | 54.8%    | 22.1%      | 2.1% | 3,939 |

Referuar të dhënave të mësipërme vihet re se, tregu i telefonisë celulare është një treg me indeks të lartë përqendrimi Hershman Herfindal-it i cili vjen për shkak të numrit të kufizuar të operatoreve në treg si dhe pjesës së madhe të tregut që zotërojnë dy kompanitë më të mëdha në treg (Vodafone dhe Telekom Albania).

Dispozitat që parashikon Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, pavarësisht strukturës së përqendruar të tregut, kanë bërë të mundur mbajtjen nën monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të sjelljes së ndërmarrjeve në treg nëpërmjet mekanizmave të:

- Mos diskriminim të tarifave on-net/off-net, procedurë e cila u krye në dy faza dhe treguesit e përdorimit dhe përfitimit të këtyre tarifave tregojnë për një shtim të konsiderueshëm të volumit të thirrjeve apo sms mes operatoreve telefonik dhe thirrjeve ndërkombëtare<sup>8</sup>.
- Uljes së tarifave të përdoruesve celularë. Sipas vlerësimit të AKEP, treguesit e ARPU (Average Revenue Per User) dhe ARPM (Average Revenue Per Minute), të ardhurat që sigurojnë operatorët celular nga përdoruesit, kanë ardhur në rënie dhe janë në nivele më të ulta krahasuar me Rajonin dhe Bashkimin Evropian<sup>9</sup>.
- Transparencës së informacionit dhe detyrimit të operatoreve për publikimin e shërbimeve, tarifave, ofertave dhe lehtësimin e krahasimit të tarifave.

Pas analizave të tjera të AKEP në lidhje me tarifat për shërbimet e aksesit broadband celular, tarifat e shërbimeve të roaming ndërkombëtar, afatit të ofertave mujore, tarifave standarde për njësi komunikimi (pay as you go), tregojnë se tregu i telefonisë celulare po performon mirë pavarësisht strukturës së përqendruar të tij.

#### Pjesët e tregut të operatorëve celularë 2015-3M/I 2017

| Treguesit                                                             | Viti      | Telekom Albania | Vodafone | Albtelecom | Plus  | HHI  |
|-----------------------------------------------------------------------|-----------|-----------------|----------|------------|-------|------|
| Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card) | 3M I/2017 | 32.00%          | 48.92%   | 14.40%     | 4.68% | 3646 |
|                                                                       | 2016      | 32.10%          | 49.40%   | 14.20%     | 4.30% | 3691 |
|                                                                       | 2015      | 34.30%          | 41.50%   | 16.00%     | 8.20% | 3222 |
|                                                                       | 3M I/2017 | 33.95%          | 48.22%   | 12.60%     | 5.23% | 3664 |

<sup>8</sup>Burimi: Raporti Vjetor 2016 i AKEP, fq 45-46

<sup>9</sup>Burimi: Raporti vjetor 2016 i AKEP, fq 50-51

|                                          |             |               |               |               |              |             |
|------------------------------------------|-------------|---------------|---------------|---------------|--------------|-------------|
| <b>Përdorues Aktivë Telefoni</b>         | <b>2016</b> | <b>30.70%</b> | <b>50.80%</b> | <b>13.10%</b> | <b>5.40%</b> | <b>3724</b> |
|                                          | <b>2015</b> | <b>32.70%</b> | <b>46.80%</b> | <b>14.10%</b> | <b>6.40%</b> | <b>3499</b> |
| <b>Përdorues aktivë broadband</b>        | 3M I/2017   | 28.12%        | 52.72%        | 14.12%        | 5.05%        | 3794        |
|                                          | 2016        | 27.30%        | 54.70%        | 13.70%        | 4.30%        | 3944        |
|                                          | 2015        | 29.00%        | 54.50%        | 16.50%        | 0.00%        | 4084        |
| <b>Thirrje dalëse</b>                    | 3M I/2017   | 33.40%        | 50.38%        | 10.99%        | 5.23%        | 3802        |
|                                          | 2016        | 33.70%        | 51.70%        | 10.80%        | 3.80%        | 3940        |
|                                          | 2015        | 31.70%        | 49.30%        | 13.10%        | 5.90%        | 3642        |
| <b>SMS dalëse</b>                        | 3M I/2017   | 22.54%        | 62.87%        | 10.54%        | 4.05%        | 4589        |
|                                          | 2016        | 21.20%        | 66.70%        | 8.90%         | 3.20%        | 4988        |
|                                          | 2015        | 18.10%        | 65.80%        | 8.10%         | 8.00%        | 4787        |
| <b>Trafik Data</b>                       | 3M I/2017   | 21.17%        | 55.53%        | 20.31%        | 2.98%        | 3954        |
|                                          | 2016        | 21.00%        | 54.80%        | 22.10%        | 2.10%        | 3937        |
|                                          | 2015        | 17.60%        | 50.80%        | 28.80%        | 2.70%        | 3727        |
| <b>Të ardhura totale nga komunikimet</b> | 2016        | 30.68%        | 48.64%        | 11.60%        | 9.07%        | 3524        |
|                                          | 2015        | 34.30%        | 47.10%        | 12.00%        | 6.60%        | 3582        |
| <b>Te ardhurat me pakicë</b>             | 2016        | 28.07%        | 56.18%        | 11.15%        | 4.60%        | 4089        |
|                                          | 2015        | 28.20%        | 54.00%        | 12.40%        | 5.40%        | 3894        |

Pjesët e tregut të operatorëve celular për treguesin përdorues aktiv telefoni për tremujorin e parë të viti 2017 janë: Vodafone 48.22%, Telekom Albania 33.95%, Albtelekom 12.6% dhe Plus 5.23%. Për vitin 2016 pjesët e tregut janë: Vodafone 50.8%, Telekom Albania 30.7%, Albtelekom 13.1% dhe Plus 5.4%, nga ku vihet re ulje e pjesës së tregut të Vodafone, Albtelekom dhe Plus. Duke pasur parasysh treguesit e mësipërm mund të themi se Vodafone është konkurrenti me pjesë më të madhe në treg, më pas vjen Telekom Albania, Albtelecom dhe në fund konkurrenti me pjesë tregu më të vogël, Plus.

### Vlerësimi i tregut pas përqendrimit

Referuar marrëveshjes në lidhje me transferimin e ½ frekuencave nga Plus tek Vodafone si dhe vlerësimin e strukturës së tregut të frekuencave, pritet që rreth 208 mijë pajtimtarët aktive të Plus-it nga të cilët rreth 5.8 mijë pajtimtar me kontratë<sup>10</sup>, të jenë përpara zgjedhjes së njërit prej 3 operatorëve të mbetur në treg, por vlerësimi i saktë i treguesve të pjesës së tregut është e pamundur në këtë fazë për faktin se:

- Pas transaksionit, çdo klient i Plus do të pyetet paraprakisht për përzgjedhjen e operatorit që do të zgjedhe për marrjen e shërbimit në vijim.
- E drejta e portabilitetit të numrit, sipas kuadrit ligjor në fushën e telekomunikacionit, i jep liri zgjedhjeje çdo klienti në përzgjedhjen e operatorit që dëshiron.
- Ulja e tarifave të terminimit on-net/off-net do të ulë kostot e klientëve pavarësisht operatorit nga i cili përfiton shërbimin.

<sup>10</sup> Statistika, 3 muji II AKEP


Sipas AKEP, pas realizimit të përqendrimit, pajtimtarët ekzistues, por edhe ata të rinj (përfshirë ata që në të ardhmen do zgjedhin të kalojnë nga Plus në Vodafone), do të kenë mundësinë të përfitojnë shërbim celular me cilësor si rrjedhojë e shtimit të kapacitetit të spektrit në dispozicion të tyre. Nëpërmjet transferimit të spektrit të Vodafone, ky i fundit ka mundësi të shpërndaje me mire nivelin e shfrytëzimit të spektrit në përdorim dhe t'i hapë rrugën investimeve të reja të cilat deri me tani mund të kenë qenë të kufizuara për shkak të kufizimit sasior të spektrit në dispozicion me frekuencat objekt kontrolli i 900, 1800 dhe 2100 MHz.

Sikurse edhe në vendet e tjera, duke qenë se tregu i telefonisë celulare është një treg me barriera në hyrje për shkak të numrit të kufizuar të licencave, ai karakterizohet nga struktura oligopoli e tregut dhe vlerësimet që bëhen në rastet e përqendrimeve bazohen në simulimin e një ekuilibri të ri Nash-Bertrand<sup>11</sup> në rritjet e çmimeve që mund të sjellë si pasojë përqendrimi (UPP)<sup>12</sup>. Në rastet kur ka barriera të larta në treg këto modele popullohen me të dhëna që mblidhen nga anketa drejtuar konsumatorëve fundor sidomos me rezultatet të diversion ratios<sup>13</sup> dhe të dhëna nga portabiliteti i numrave.

Sipas një studimi<sup>14</sup> të kryer mbi përdorimin e teknikave analitike për vlerësimin e përqendrimeve ex-ante dhe ex-post, përdorimi i teknikave analitike do të fokusohet në një vlerësim ex-post të tregut pas portabilitetit të numrave, kur efektet e ndryshimit të strukturës së tregut do të jenë të dukshme dhe të matshme. Analiza në këtë rast do të bazohet në gjetjet evropiane dhe globale për efektet e pas përqendrimit në tregun e telefonisë celulare në Evropë e me gjerë.

Tregu i telefonisë celulare është një treg me përqendrim shumë të lartë. Ky treg kërkon investime shumë të larta fillestare të cilat mund të sjellin barrira në hyrje/dalje nga tregu, me informacion të plotë mbi shërbimet dhe çmimet, ka karakteristikat e një tregu oligopol.

**Grafiku 1 HHI ndër vite**



Sipas AKEP<sup>15</sup>, edhe në Shqipëri njësoj si në trendet globale, ndërmarrjet që operojnë në tregun e telefonisë celulare ofrojnë një sërë shërbimesh dhe paketash tarifore dhe shpesh është e vështirë krahasimi i tarifave për shërbime të veçanta dhe/ose për njësi për shkak të rritjes së përdorimit të shportave (bundles) me një shërbim ose me shumë shërbime (paketa të integruara).

Sipas AKEP, ecuria e tarifave me pakicë të tregut celular analizohet në dy drejtime kryesore: - Të ardhura mesatare për minutë/përdorues (ARPM/ARPU); - Tarifatat nominale me pakicë të operatorëve. (Average Revenue Per User) dhe ARPM (Average revenue Per Minute) ku këto dy tregues deri në vitin 2015 kanë ardhur duke u ulur duke treguar përmirësim të efikasitetit të tregut.

<sup>11</sup>Sipas modelit Bertrand të oligopolit, ndërmarrjet në mënyrë të pavarur zgjedhin çmimet (jo sasinë) në mënyrë që të maksimizojnë fitimet. Kjo arrihet duke supozuar që çmimet e ndërmarrjeve konkurrense merren si të mirëqena. Si rezultat, ekuilibri i arritur është ekuilibri Nash i çmimeve, referuar si ekuilibri Bertrand (Nash).

<sup>12</sup>Indeksi i presionit të çmimit të sipërm (UPP) fokusohet në shtytjen e ndërmarrjes së përqendruar për të rritur çmimet post-transaksion, dhe llogaritet duke përdorur shkallën e devijimit dhe përfitimet që vijnë nga ky përqendrim para përqendrimit.

<sup>13</sup>Shkalla e devijimit (Diversion Rate) llogaritet zgjedhjen e alternativës së radhës (zëvendësuesi më i afërt) që do të llogaritet sipas zgjedhjes që do të bëjnë pajtimtarët e Plus pas mbylljes së Operatorit.

<sup>14</sup> [http://www.unipi.gr/unipi/images/various/akad\\_tmim/oikon\\_epist/J.10\\_European\\_Competition\\_Journal.pdf](http://www.unipi.gr/unipi/images/various/akad_tmim/oikon_epist/J.10_European_Competition_Journal.pdf)

<sup>15</sup> <https://www.akep.al/images/stories/AKEP/raporte/RAPORTI-VJETOR-2016-110517.pdf>

**Tabela të dhënat nga AKEP për ARPM dhe ARPU**

|      | ARPM<br>(Lek/minute) | ARPU<br>(Lek/vit) | ARPM<br>Ndryshimi<br>vjetor (%) | ARPU Ndry-<br>shimi Vjetor<br>(%) |
|------|----------------------|-------------------|---------------------------------|-----------------------------------|
| 2010 | 6.49                 | 8,594             |                                 |                                   |
| 2011 | 5.35                 | 8,319             | -18%                            | -3%                               |
| 2012 | 3.92                 | 7,132             | -27%                            | -14%                              |
| 2013 | 3.13                 | 5,863             | -20%                            | -18%                              |
| 2014 | 2.63                 | 5,447             | -16%                            | -7%                               |
| 2015 | 2.36                 | 5,125             | -10%                            | -6%                               |

Sipas të dhënave nga ITU<sup>16</sup>, e cila vlerëson çdo vit tregun e telekomunikimeve në bazë të indikatorëve të ndryshëm dhe rolit të rregullatorëve në treg, në profilin e tregut të telefonisë celulare për Shqipërinë deri në 2015, ndërsa segmente të caktuara të tregut të telekomunikimeve si shërbimet e telefonisë fikse, DSL, Modem Cable, TV etj, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme, vlerësohen si tregje me nivel të lartë konkurrence, pjesa e tregut të pakicës së telefonisë mobile dhe pjesa e tregut të shërbimit të internetit (3G dhe 4G) ndodhet në kushtet e një konkurrence të pjesshme dhe ka nevojë për ndërhyrje të rregullatorit.

**Tabela ITU Profili i Shqipërisë 2015**

| Level of Competition (Latest data available: 2015) |    |                                                                        |
|----------------------------------------------------|----|------------------------------------------------------------------------|
| Local Fixed Line Services                          | C* |                                                                        |
| Domestic fixed long distance                       | C  |                                                                        |
| International Fixed Long Distance                  | C* |                                                                        |
| Mobile                                             | P* | P: 4 licenses/authorisations for GSM mobile frequencies from 1996-2010 |
| IMT (3G, 4G, etc.)                                 | P* | P: 3 UMTS authorisations for 3G frequencies 1900/2100 MHz              |
| Wireless Local Loop                                | N  |                                                                        |
| DSL                                                | C  |                                                                        |
| Cable modem                                        | C  |                                                                        |
| Fixed Wireless Broadband                           | N  |                                                                        |
| Leased Lines                                       | C  |                                                                        |
| International Gateways                             | C* |                                                                        |
| Internet Services                                  | C  |                                                                        |
| Cable Television                                   | C  |                                                                        |
| Fixed Satellite Services (FSS)                     | C  |                                                                        |
| Mobile Satellite Services (MSS)                    | N  |                                                                        |
| VSAT                                               | C* |                                                                        |

M: Monopoly  
P: Partial competition (year when competition was introduced)  
C: Full competition (year when competition was introduced)  
N: N/A

**Efektet në tregun e pakicës:** Gjatë periudhës që AK ka realizuar hetim për sjelljen e operatoreve të telefonisë celulare nga ku u konstatua se operatorët konkurrojnë më tepër me shporta me shërbime të kombinuara që quhen paketat “Bundeling”. Shërbimet përbërëse të paketave dhe çmimet e tyre mund ti konsiderojmë si produkte homogjene dhe të zëvendësueshme nga ana e zgjedhjes konsumatorë. Gjatë periudhës hetimore vihet re që paketat kanë kombinime shërbimesh të krahasueshme nga ana konsumatore.

Portabiliteti i numrit, unifikimi i tarifave in-net dhe off- net si dhe fakti që më shumë se 90% e përdoruesve të telefonisë celulare kanë shërbim me parapagesë, rrisim mundësinë e lëvizshmërisë së klientëve dhe ulin mundësinë që klientët e Plus të kalojnë të gjithë në operatorin Vodafone.

Në rastet kur transferimi i klientëve do të ndahet në tre operatorët në treg, Vodafone do të vazhdojë të ketë pjesën më të madhe të tregut dhe Telekom e Albtelecom me pjesë të qëndrueshme tregu.

Në përfundim të analizës ekonomike vlerësojmë se për shkak të strukturës oligopolistike të tregut të telefonisë celulare, barrierave në hyrje për shkak të licensave të dhëna, pjesës së ulët të tregut që zotëron ndërmarrja PLUS, jemi të mendimit së dalja nga tregu i operatorit Plus mund të sjellë ndryshime të strukturave të tregut.

<sup>16</sup> <http://www.itu.int/net4/itu-d/icteye/CountryProfile.aspx>

Për gjitha sa më sipër, jemi të mendimit që transaksioni i synuar për transferimin e bllokut të frekuencave nga Plus Communication tek Vodafone Albania mund të sjellë ndryshime në strukturën e tregut të shërbimeve të telefonisë celulare.

### **Konkluzione**

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitimin e të drejtave të përdorimit të ½ të spektrit të Plus nga Vodafone dhe në zbatim të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 10, pika b dhe neni 12 i tij si dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e Përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3, transaksioni është klasifikuar përqendrim pasi ai prek në mënyrë të drejtpërdrejtë një pjesë të asetëve që gjenerojnë të ardhura të ndërmarrjes në transaksion për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së Autorizimit Individual.

Ky transaksion në zbatim të Ligjit “ Për komunikimet elektronike në RSH” është njoftuar në AKEP dhe ka marrë miratimin paraprak nëpërmjet Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP, më të cilin theksohet se transferimi i frekuencave nuk krijon deformime të konkurrencës; nuk dëmton përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient i spektrit të frekuencave; rritet efica e përdorimit të spektrit të frekuencave; mbrohet interesi publik dhe realizohet transparenca e nevojshme e parashikuar ligjërisht.

Struktura e tregut të spektrit të frekuencave para përqendrimit tregon se asnjë nga operatorët në treg nuk zotëron pozite dominuese. Pas transferimit, pjesa e tregut e ndërmarrjes Vodafone Albania SHA rritet duke arritur nga XX % deri në XX % sipas llojit të frekuencës.

Sipas dokumentacionit të depozituar ndërmarrja Plus paraqitet në kushte të vështira financiar në vitet e fundit të cilat nuk i mundësojnë vijimin më tej me investime për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe konkurruese ndaj konsumatorëve të këtyre shërbimeve. Në nenin 13, pika 3 të Ligjit Nr.9121, parashikohet se një përqendrim mund të mos ndalohe në rastet kur ndërmarrja palë në përqendrim rrezikon seriozisht të falimentojë dhe nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së saj ose ndërmarrja duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt, pavarësisht forcimit të pjesë së tregut të ndërmarrjeve palë në marrëveshje.

Duke qenë se frekuencat janë input ose baza teknike për sigurimin e shërbimit të telefonisë celulare, dhe për më tepër kur në tregun e shërbimeve celularë pas transferimit të Frekuencave do të kemi një operator më pak, është i rëndësishëm vlerësimi i konkurrencës në kuptim të Ligjit 9121/2003 të tregut të shërbimeve celulare.

Tregu i telefonisë celularë është një treg me indeks të lartë përqendrimi Hershman Herfindal, i cili vjen për shkak të numrit të kufizuar të operatoreve në treg si dhe pjesës së madhe të tregut që zotërojnë dy kompanitë më të mëdha në treg (Vodafone dhe Telekom Albania).

Nga transaksioni në lidhje me transferimin e ½ frekuencave nga Plus tek Vodafone si dhe vlerësimin e strukturës së tregut të frekuencave, konstatojmë se Vodafone Albania mund të rrisë pjesën e tregut në shërbimet që ofron, por duhet të theksojmë se rritja e pjesës së tregut pas përqendrimit do të këtë ndikim të vogël në treg për shkak të pjesës së vogël të tregut që zotëron Plus Communication.

Vlerësimi i saktë i treguesve të pjesës së tregut është e pamundur të vlerësohet në këtë fazë për faktin se<sup>17</sup>:

- Pas transaksionit, çdo klient i Plus Communication do të pyetet paraprakisht për përzgjedhjen e operatorit që do të zgjedhe për marrjen e shërbimit në vijim.
- E drejta e portabilitetit të numrit, sipas kuadrit ligjor në fushën e telekomunikacionit, i jep liri zgjedhjeje çdo klienti në përzgjedhjen e operatorit që dëshiron.
- Ulja e tarifave të terminimit on-net/off-net do të ulë kostot e klientëve pavarësisht operatorit nga i cili përfiton shërbimin.

---

<sup>17</sup>Analiza Vjetore e AKEP/2016

Pas transferimit në tregun e telefonisë celulare do të ofrojnë shërbimin e tyre tre operator nga të cilët Vodafon Albania SHA ka pozitë dominuese në treg<sup>18</sup> e ndjekur nga Telekom Albania dhe Albtelecom. Pas transferimit AKEP do të vendosë kushte në Autorizimet Individuale që do të lëshohen në kohën e fillimit të shfrytëzimit të spektrit dhe mbulimit për të bërë të mundur rritjen e efektivitetit të përdorimit dhe shmangien e mbajtjes së bllokuar të tij.

Referuar rasteve të ngjashme të trajtuara nga Autoritetet e Konkurrencës në BE, industria e telefonisë celulare që nga viti 2010 është prekur nga reduktimi i numrit të operatoreve në treg të cilat kanë qenë objekt vlerësimi dhe monitorimi i vazhdueshëm prej tyre.

**Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun e spektrit të frekuencave ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t'i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimi në përputhje me nenin 56, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.**

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës:

### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek VODAFONE ALBANIA SHA
- II. Detyrimin e AKEP për të siguruar frekuenca të lira për çdo hyrës të ri në treg.
- III. Pas përfundimit të transferimit të spektrit, AKEP-i të kryejë analizën e tregut të telefonisë celulare, duke përcaktuar operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), sipas kërkesave të Kreut VI të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar. AKEP-i për nxitjen e konkurrencës në treg të vendosë kushte dhe detyrime të veçanta sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 ndaj OFNT-ve dhe në rast moszbatimi ta parashtrojë rastin përpara Autoritetit të Konkurrencës.
- IV. Autoriteti i Konkurrencës të realizojë vlerësimin e tregut pas përqendrimit mbështetur në analizën e AKEP.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

<sup>18</sup>Referuar procedurave hetimore të kryera nga Autoriteti i Konkurrencës



## VENDIM

Nr. 485, datë 23.11.2017

### Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek TELEKOM ALBANIA SHA.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 23.11.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek TELEKOM ALBANIA SHA.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet, 2, 10 - 12, neni 13, pika 3 dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit mbi transferimin e ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek TELEKOM ALBANIA SHA si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

## VËREN SE:

### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Pranë Autoritetit të Konkurrencës (AK) në datën 24 tetor 2017, me shkresë Nr. 428 Prot. “Konfirmim i depozitimit të dokumenteve”, janë depozituar dokumente dhe informacione në lidhje me Marrëveshjen për Transferimin e Spektrit nga PLUS COMMUNICATION SHA (Plus) tek TELEKOM ALBANIA SHA (Telekom).

Në datë 26 korrik 2017 me shkresën Nr. 326 Prot të AK “Kërkohet konsultim paraprak nga AK”, Plus i ka kërkuar institucionit tonë konsultim paraprak lidhur me transaksionet që synohen të ndodhnin në treg, konkretisht lidhur me transferimin e frekuencave që aktualisht përdoreshin nga Plus, dhe që do t'i kalonin Telekom Albania dhe Vodafone Albania në masën 1/2 secili.

Me shkresën Nr. 326/1 Prot., datë 26.07.2017 “Në përgjigje Tuajës Nr 764 Prot., datë 26.07.2017”, institucioni jonë i ka kthyer përgjigje Transferuesit Plus/ndërmarrjes target, duke e informuar ndërmarrjen target lidhur me detyrimin që kanë palët për të njoftuar dhe për të depozituar gjithë informacionin e nevojshëm me qëllim fillimin e procedurave nga Autoriteti i Konkurrencës.

Bashkëlidhur shkresës së Plus, gjendej edhe një korrespondencë (shkresa me Nr 744 Prot, datë 18.07.2017) ku operatori Plus i ishte drejtuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me miratimin



paraprak për transferimin e frekuencave dhënë në përdorim sipërmarrësit Plus tek dy operatorët e tjerë celularë dhe konkretisht Telekom dhe Vodafone.

AKEP pas kësaj kërkesë zyrtare të Plus, ka marrë në shqyrtim sa më lart dhe me shkresën Nr. 1620/1, datë 21.07.2017 është shprehur se në parim është dakord lidhur me këto transferime dhe se Plus duhet të vijojë me plotësime dokumentacioni për të arritur në miratimin final për këtë transferim: AKEP shprehet se sipas pikës 2 të nenit 74 të Ligjit Nr. 9918, pas marrjes së kërkesës për transferim, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të verifikojë nëse sipërmarrësi, të cilit i kërkohet që t'i kalojë e drejta e përdorimit të radio-frekuencës, i përmbush të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe rregullat përkatëse të zbatueshme nga AKEP-i, si dhe që, transferimi i kërkuar, nuk kërkohen deformime në konkurrencë dhe nuk dëmtohet përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient i spektrit të frekuencave.

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr 326/3, datë 05.10.2017 “Kërkesë për informacion” i është drejtuar AKEP ku kërkon informacion nëse është marrë vendim lidhur me miratimin e procedurës së transferimit. AKEP me shkresën Nr 326/4, Prot, datë 11.10.2017 informon Autoritetin e Konkurrencës se kishte filluar procedurat e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga Plus për miratimin e transferimit të frekuencave. Gjithashtu na informon se kishte kërkuar dokumentacion shtesë dhe plotësim të dokumentacionit, deri në dhënien e autorizimeve individuale për lejin e përdorimit të frekuencave të transferuara nga Plus tek dy operatorët Telekom dhe Vodafone, duke vendosur kushtet e përdorimit të tyre, kushtet e veçanta në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në kuadrin e tyre ligjor në fuqi.

Nëpërmjet shkresës Nr. 408/5, datë 13.11.2017, Prot i AK është depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, Vendimi Nr. 20, datë 13.11.2017 i AKEP “Për dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtës së përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication SHA tek sipërmarrësit Telekom Albania SHA dhe Vodafon Albania SHA”.

Me synim realizimin e një vlerësimi të plotë të transaksionit dhe pasojave në treg, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 326/6 datë 06.11.2017 “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar Plus Communication, ku kërkon informacion shtesë mbi arsyet ekonomike që çuan në vendimmarrjen e transferimit të spektrit të frekuencave. Në përgjigje të shkresës sonë, Plus, nëpërmjet shkresës Nr. 326/7 Prot, datë 07.11.2017 “Dërgohet informacion pranë Autoritetit të Konkurrencës”, Plus na informon se arsyeja për këtë transaksion ka qenë që tregu i komunikimeve elektronike të gjenerojë zhvillime të mëtejshme. Për shkak të vështirësive financiare ndërmarrja nuk mund të vijojë më tej me investime për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe konkurrese ndaj konsumatorëve dhe duke pasur parasysh kërkesat e AKEP ndaj operatorëve të tjerë për të siguruar vijimin e ofrimit të shërbimeve të kontraktuara, kërkon të transferojë frekuencat në përdorim të saj tek operatorët e tjerë celular sipas Marrëveshjeve me këta operatorë.

### **Palët në transaksion**

**Ndërmarrja Telekom Albania SHA (Telekom)**, një shoqëri aksionare, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 22.11.1995, me Numër Unik Identifikimi J61814094W dhe me seli në adresën: Rr. "Gjergj Legisi", Ndërtesa 4-katëshe, Laprakë, Tiranë. Kapitali i ndërmarrjes Telekom është XXXXXX lekë me numër aksionesh XXXXX me vlerë XXXX lekë secila.

**Ndërmarrja Plus Communication SHA (Plus)**, një shoqëri aksionare e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 11.06.2009, me NIPT K91811014B, me seli qendrore në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova", Godina e Re, pranë Gardës së Republikës, Kati i 2, Tiranë, Shqipëri. Kapitali i ndërmarrjes është XXXXXX lekë me numër aksionesh XXXXXXXX me vlerë nominale XXXX lekë secila.

## Përqendrimi

Transaksioni konsiston në përfitim të drejtave të përdorimit të ½ të spektrit të Plus nga Telekom. Telekom dhe Plus kanë rënë dakord<sup>1</sup> për transferimin e të drejtës së përdorimit të ½ të spektrit të frekuencave 900 MHz; ½ të spektrit të frekuencave 1800 MHz dhe ½ të spektrit të frekuencave 1970-1980 MHz çiftuar me 2160-2170 MHz, për kohëzgjatjen e mbetur respektivisht, dhënë në përdorim Plus nga AKEP.

Plus ushtron veprimtarinë e vet në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 745, datë 26.06.2009, i ndryshuar, dhe është pajisur nga AKEP me Autorizimin Individual (në vijim referuar si ("Autorizimi Individual")) për përdorimin e frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 me qëllim ndërtimin e rrjetit të lëvizshëm të komunikimeve publike GSM, për ofrimin e shërbimit publik telefonik të lëvizshëm tokësor në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Me Vendimin e AKEP Nr. 2677, datë 21.04.2016 "Dhënie e Autorizimit Individual sipërmarrësit Plus Communication". Plus pas përfundimit të procedurave të tenderimit është pajisur edhe me "Autorizimin Individual" për të drejtat e përdorimit të brezit të frekuencave 1970-1980 MHz çiftuar me 2160-2170MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915-1920 MHz, për një periudhë 15 vjeçare.

Në datë, 18 tetor 2017 është lidhur midis Plus dhe Telekom Marrëveshja për Transferimin e Spektrit. Plus zotëron spektrin e frekuencave 900, 1800 dhe 2100 MHz dhe këto frekuenca janë të transferueshme në përputhje me parashikimet e Ligjit Për Komunikimet Elektronike (Ligji Nr. 9918/2008).

**Çmimi i transferimit<sup>2</sup>:** XXXXXX Euro pa TVSH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës janë depozituar marrëveshjet e nënshkruara midis Albtelecom dhe Plus si dhe Marrëveshja e nënshkruar nga Plus dhe Vodafone. Në të dyja **Marrëveshjet për Zgjidhje me Pajtim** palët Albtelecom dhe Plus si dhe Vodafone dhe Plus kanë rënë dakord të tërhiqen dhe të heqin dorë përfundimisht nga gjykimi i të gjitha mosmarrëveshjeve gjyqësore pavarësisht ekzekutueshmërisë së vendimeve gjyqësore.

Sipas kësaj marrëveshjeje, Albtelecom është shprehur se nuk ka më interes të përdorë, të gjithë apo një pjesë të frekuencave që ju janë akorduar Plus nga AKEP, dhe se për këtë arsye nuk ka asnjë pretendim në të tashmen apo në të ardhmen, kërkesa apo kërtime në rast se këto frekuenca do t'i transferohen të tretëve (përfshirë operatorët e tjerë shqiptarë).

Sipas vlerësimit të AKEP, marrëveshjet për transferim frekuencat midis tre operatorëve (nga Plus Communication tek Vodafone Albania dhe Telekom Albania) si dhe midis katër operatorëve të rrjetit celular (për tarifat e terminimit të aplikueshme në Plus dhe proceset gjyqësore) nuk janë de-juro marrëveshje për bashkim apo për blerje kompanish (Merger apo Take-over), këto marrëveshje për transferim të plotë të radio frekuencave të Plus (asete të paprekshme të subjektit Plus) tek dy operatorët e tjerë celular de-fakto çojnë në ndryshim të strukturës së tregut dhe duhen trajtuar në bazë të Ligjit 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"

## Xhiro për vitin 2016

Xhiro e palëve në këtë transaksion, në zbatim të nenit 12, pika 1/b, dhe neni 17, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, llogaritet sipas të dhënave të Pasqyrave Financiare të depozituar në dosjen e palëve njoftuese nga ku konstatohet se xhiroja vjetore për vitin 2016 është si më poshtë:

Xhiro totale e palëve në **tregun e brendshëm**: është XXXXX **Lekë**:

— Telekom Albania SHA : XXXXXXXXXXXX Lekë

<sup>1</sup>Marrëveshja për Transferimin e Spektrit.

<sup>2</sup>Burimi: Pika 3.1 e Marrëveshjes për Transferimin e Frekuencave

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **Përcaktimi i tregut përkatës**

Vlerësimi i konkurrencës në rastet e përqendrimeve realizohet duke patur parasysh strukturën e tregut dhe konkurrencën aktuale dhe potenciale në treg. Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), si edhe Udhëzimit Nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit, dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.

**Tregu përkatës i produktit:** Sa më sipër, treg përkatës i produktit do konsiderohet tregu i frekuencave dhënë në përdorim të operatorit Plus Communication SHA nga AKEP (frekuencat GSM 900MHz, 1800MHz dhe 2100MHz). Në këtë rast mund të themi se kemi edhe tregje të prekura dhe të lidhura me tregun përkatës i cili është tregu me pakicë i telefonisë celulare. Të gjithë operatorët që ushtrojnë veprimtari në tregun e telefonisë celulare në Shqipëri, janë të integruar vertikalisht në tregun e telefonisë celulare me pakicë. Tarifa e terminimit<sup>3</sup> në celularë (shërbimi me shumicë) ndikon drejtpërdrejtë në tarifat e thirrjeve telefonike të paguara nga përdoruesit fundor të rrjeteve të tjera (shërbimi me pakicë) e cila është përcaktuar nga AKEP në masën e 1.48 lekë/minutë.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

### **VLERËSIMI I KONKURRENCËS**

Transaksioni ndodh në tregun e spektrit të frekuencave të cilët mbikëqyren dhe rregullohet nga AKEP në zbatim të nenit 74 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH” dhe Rregullores Nr. 30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”.

Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga palët, në shkresën Nr. 326 Prot (prot AK), datë 26.07.2017 “Kërkohej konsultim paraprak nga AK”, struktura e tregut të frekuencave është si më poshtë:

#### **Të dhëna konfidenciale**

Nga analiza e treguesve, vihet re se asnjë nga operatorët në treg nuk ka pozitë dominuese në tregun e frekuencave të dhëna nga AKEP.

Sipas analizës, AKEP<sup>4</sup> ka vijuar ruajtjen e barazisë në sasinë e spektrit të frekuencave midis sipërmarrësve që ofrojnë rrjete të lëvizshme dhe shërbime publike komunikimi, me qëllim sigurimin e mos diskriminimit, nxitjen e investimeve, rritjen e efikasitetit të shfrytëzimit, sigurimin e integritetit dhe sigurisë së rrjeteve konkurrencën e lirë dhe mbrojtjen e interesit dhe sigurisë publike. Politika e ndjekur në autorizimin e operatoreve të telefonisë së lëvizshme për përdorimin e spektrit GSM 900/1800 ka qenë ajo e alokimit të sasive të barabarta të spektrit pavarësisht kohës së dhënies dhe çmimit.

Sikurse është përshkruar më sipër, marrëveshja e transferimit të frekuencave ka parashikuar transferimin e ½ të frekuencave nga ndërmarrja Plus Communication drejt ndërmarrjes Telekom Albania pas së cilës struktura e tregut dhe pjesa e kombinuar paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

<sup>3</sup>Burimi: Vendimi Nr. 2699, datë 1.12.2016 Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik” - Tarifa e terminimit e Vodafone, AMC dhe EM të reduktohet me 1.12.2014, në nivelin 1.48 lek/minutë, që përbën tarifën mesatare benchmark për vendet anëtare dhe kandidatë në BE që kanë aplikuar LRIC të pastër në 2013 (të përcaktuar në dokumentin e miratuar më 13.03.2014);

<sup>4</sup>Referuar relacionit shoqërues të Vendimit 20, datë 13.11.2017 AKEP

Marrëveshja e transferimit të spektrit do të sjellë rritje të pjesës së tregut të brezit të frekuencave për ndërmarrjen Telekom Albania, e cila pas përqendrimit arrin nivelin 36% për bllokun e frekuencës 900MHz, 34% për bllokun e frekuencës 1800MHz dhe 33% për bllokun e frekuencës 2100MHz.

Referuar informacionit të paraqitur nga Plus nëpërmjet shkresës Nr. 326, datë 26.07.2017, ndërmarrja Plus shprehet se ka renë dakort për transferimin e spektrit me qëllimin e vetëm që tregu i komunikimeve elektronike të gjenerojë zhvillime të mëtejshme. Plus shprehet së “Gjatë gjithë viteve të operimit në treg, që nga viti 2010, shoqëria ka rezultuar me humbje të konsiderueshme.... Humbja e akumuluar në vite kapin shifra të konsiderueshme rreth 6.1 milion lekë dhe për këtë arsye aksionaret e shoqërisë kanë ndërmarre dy herë masa ristrukturimi të kapitalin për të mbuluar humbjet.”

Referuar të dhënave mbi numrin e pajtimtarëve të katër ndërmarrjeve në treg, vihet re se ndërsa në tregun e frekuencës PLUS zotëron gjysmën e tregut të spektrit që ka Telekom apo Albtelekom, në tregun e shërbimeve, konkretisht në kartat SIM përfshire broadband dhe datacard, PLUS zotëron vetëm 4.2% të tregut ndërkohë që Telekom zotëron 32.1% të tregut dhe Albtelekom 14.2%, gjë e cila tregon për nivel të ulët të shfrytëzimit të spektrit të frekuencave. Në kushtet kur ndërmarrja Plus paraqet tregues të ulët të performancës financiare dhe teknike dhe deklaron vështirësi në kryerjen e investimeve.

Në nenin 13, pika 3 të Ligjit Nr.9121, parashikohet se një përqendrim mund të mos ndalohet në rastet kur ndërmarrja palë në përqendrim rrezikon seriozisht të falimentojë dhe nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së saj ose ndërmarrja duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt, pavarësisht forcimit të pjesës së tregut të ndërmarrjeve palë në marrëveshje.

Konkurrenca ndikohet nga numri i konkurrentëve efektivë në treg. Sipas AKEP vlerësohet se tre konkurrentët mund të zhvillojnë një gamë të gjerë shërbimesh duke ofruar shërbime me cilësi të lartë, çmime konkurruese, zgjedhje dhe inovacione për konkurrencën e përgjithshme të tregut.

Lidhur me vlerësimin paraprak të transferimit të spektrit, Këshilli Drejtues i AKEP, në Vendimin e tij Nr 20, datë 13.11.2017 “Për dhënien paraprakisht të miratimit për transferim frekuencash...” arriti në konkluzionin se:

- Spektri që zotërojnë aktualisht 3 operatorët, mënyra e shfrytëzimit, shërbimet e ofruara, teknologjia e aplikuar, numri i pajtimtarëve etj, bën që transferimi i spektrit nga Plus Communication të mos ndikojë në konkurrencën në treg,
- Ky spektër shtesë mendojmë se do të shfrytëzohet nga dy operatorët për rritjen e kapacitetit të transmetimit për shkak të kërkesës për trafik më të madh të dhënash,

Nga transaksioni i kërkuar:

- Nuk krijohen deformime të konkurrencës,
- Nuk dëmtohet përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient i spektrit të frekuencave,
- Rritet eficaenca e përdorimit të spektrit të frekuencave,
- Mbrohet interesi publik,
- Realizohet transparenca e nevojshme e parashikuar ligjërisht.

Për sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi të jap paraprakisht miratimin për transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus tek Vodafon dhe Telekom Albania SHA

Transferimi i propozuar i frekuencave 900/1800/2100 MHz të Plus Communication tek Telekom Albania dhe Vodafone Albania është një rast i veçantë i transferimit të frekuencave në kuptim të Ligjit 9918/2008 dhe kuadrit rregullator evropian për komunikimet elektronike pasi operatori Plus do të transferojë jo një pjesë të

spektrit të frekuencave por të gjithë spektrin drejt dy operatoreve të tjerë dhe si rrjedhojë nuk do të jetë më operator i rrjetit celular duke çuar në një konsolidim të tregut celular nga katër operatore në tre të tillë.

AKEP vlerëson se përveç vlerësimit apo opinionit të AKEP të impaktit të transaksioneve të propozuara në konkurrencën në tregun celular, këto transaksione duhet të trajtohen nga AK në përputhje me Ligjin 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”.

Referuar detyrimit të përcaktuar në Ligjin 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Sekretariati mori në shqyrtim ndikimin që sjell në tregun e shërbimeve ky transaksion. Duhet të theksojmë se struktura e tregut të frekuencave jo detyrimisht përcakton edhe strukturën e tregut të shërbimeve celulare, për faktin se brezi i frekuencave përfaqëson vetëm kapacitetin teknik për të siguruar ofrimin e shërbimeve. Vlerësimi i konkurrencës si dhe i strukturave të tregut u realizua në tregun e ofrimit të shërbimit, output-et, e cila përfshin tregun e shumicës dhe tregun e pakicës së shërbimeve celulare, e detajuar kjo sipas produkteve.

## VLERËSIMI I TREGUT TË SHËRBIMEVE

Industria e telekomunikimit është një industri që siguron mesatarisht 40 miliard lekë të ardhura, ose rreth 3% të GDP-së të shtetit shqiptar<sup>5</sup>. Telefonja celulare zë 91% të industrisë së telefonisë (fiks dhe celulare). Tregu i komunikimeve celulare, ka qenë në vite objekt vlerësimi dhe analize e Autoritetit të Konkurrencës e cila në bashkëpunim me AKEP ka vlerësuar dhe ka dhënë rekomandime në lidhje me shqetësimet e tregut.

Tregu i telefonisë celulare është një treg i rregulluar, me barriera në hyrje për shkak të numrit të kufizuar të licencave dhe referuar Kapitullit VI “Rregullimi i Konkurrencës” të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i sjelljes së sipërmarrësve në treg është objekt i këtij ligji e përcaktuar në nenet 31 deri 41 të Ligjit.

Referuar përcaktimit të tregut të produktit si dhe Raportit Vjetor 2016 të AKEP-it, rezulton se gjatë vitit 2016 tregu i telefonisë celulare paraqitet sipas treguesve të mëposhtëm:

|                                                                          | 2013          | 2014                 | 2015          | 2016          | Ndryshimi<br>2016/2015 |
|--------------------------------------------------------------------------|---------------|----------------------|---------------|---------------|------------------------|
| <b>Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:</b>                       |               |                      |               |               |                        |
| - sipas kartave SIM                                                      | 5,282,350     | 4,928,784            | 4,777,885     | 5,160,060     | <b>8%</b>              |
| - përdorues aktivë Numri                                                 | 3,685,983     | 3,406,772            | 3,442,665     | 3,360,888     | <b>-2%</b>             |
| <b>përdoruesve me akses broadband 3G/4G:</b>                             |               |                      |               |               |                        |
| - Totali                                                                 | 1,231,259     | 1,576,877            | 2,049,072     | 2,739,550     | <b>34%</b>             |
| - Përdorues aktive Thirrje                                               | 1,231,259     | 907,975 <sup>5</sup> | 1,297,281     | 1,686,354     | <b>30%</b>             |
| <b>telefonike dalëse të përdoruesve celulare (minuta)</b>                | 6,769,300,966 | 7,301,024,035        | 7,381,147,348 | 6,793,769,155 | <b>-8%</b>             |
| <b>Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit</b>                   | 1,689,200,882 | 1,826,346,190        | 1,598,702,865 | 1,610,322,977 | <b>1%</b>              |
| <b>Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)</b> | 2,529,549     | 6,269,940            | 12,740,073    | 26,753,639    | <b>110%</b>            |

### Burimi: AKEP, Raporti vjetor 2016

Nga të dhënat e tabelës vihet re se numri i përdoruesve të shërbimeve tradicionale telefonike celulare dhe sasia e thirrjeve dhe SMS-ve të gjeneruara nga përdoruesit celulare ka pasur luhatje gjatë periudhës 2013-2016 dhe këta tregues janë kryesisht me tendencë rënëse. Ndërkohë përdorimi i shërbimeve të aksesit broadband nga rrjete celulare ka rritje të ndjeshme në vitin 2016 krahasuar me vitin 2013. Rritja e ndjeshme e përdorimit të shërbimit të aksesit broadband celular në terma përdoruesish dhe trafikut të të dhënave në vitin 2016, është

<sup>5</sup> Bazuar në të dhënat e GDP për vitin 2015-2016 të INSTAT dhe Raportit vjetor të AKEP

shoqëruar me rënie të përdorimit të shërbimeve tradicionale celulare, thirrje dhe SMS, duke evidentuar përsëri efektin e zëvendësimit të mesazheve SMS dhe thirrjeve telefonike me mesazhe/thirrje nga aplikacionet OTT (Over The Top) nga Interneti i aparateve celulare.

Sipas raportit të AKEP, tregu i telefonisë celulare ofron shërbimin e Thirrjeve Celulare, SMS, aksesin broadband, transferimit të të dhënave, thirrjeve dalëse brenda dhe jashtë vendit të cilat të vlerësuara sipas strukturës së tregut mes 4 operatorëve celularë, paraqiten si më poshtë:

| Shërbimet                                                             | Telekom Albania | Vodafone | Albtelecom | Plus | HHI   |
|-----------------------------------------------------------------------|-----------------|----------|------------|------|-------|
| Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card) | 32.1%           | 49.4%    | 14.2%      | 4.3% | 3,689 |
| Përdorues Aktivë Telefoni                                             | 30.7%           | 50.8%    | 13.1%      | 5.4% | 3,725 |
| Përdorues aktivë broadband                                            | 27.3%           | 54.7%    | 13.7%      | 4.3% | 3,940 |
| Thirrje dalëse                                                        | 33.7%           | 51.7%    | 10.8%      | 3.8% | 3,946 |
| SMS dalëse                                                            | 21.2%           | 66.7%    | 8.9%       | 3.2% | 4,986 |
| Trafik Data                                                           | 21.0%           | 54.8%    | 22.1%      | 2.1% | 3,939 |

Referuar të dhënave të mësipërme vihet re se, tregu i telefonisë celularë është një treg me indeks të lartë përqendrimi të Hershman Herfindal-it i cili vjen për shkak të numrit të kufizuar të operatoreve në treg si dhe pjesës së madhe të tregut që zotërojnë dy kompanitë më të mëdha në treg (Telekom Albania dhe Vodafone).

Dispozitat që parashikon Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, pavarësisht strukturës së përqendruar të tregut, kanë bërë të mundur mbajtjen nën monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të sjelljes së ndërmarrjeve në treg nëpërmjet mekanizmave të:

- Mos diskriminim të tarifave on-net/off-net, procedurë e cila u krye në dy faza dhe treguesit e përdorimit dhe përfitimit të këtyre tarifave tregojnë për një shtim të konsiderueshëm të volumit të thirrjeve apo sms mes operatoreve telefonik dhe thirrjeve ndërkombëtare<sup>6</sup>.
- Uljes së tarifave të përdoruesve celularë. Sipas vlerësimit të AKEP, treguesit e ARPU (Average Revenue Per User) dhe ARPM (Average Revenue Per Minute), të ardhurat që sigurojnë operatorët celular nga përdoruesit, kanë ardhur në rënie dhe janë në nivele më të ulta krahasuar me Rajonin dhe Bashkimin Evropian<sup>7</sup>.
- Transparencës së informacionit dhe detyrimit të operatoreve për publikimin e shërbimeve, tarifave, ofertave dhe lehtësimin e krahasimit të tarifave.

Pas analizave të tjera të AKEP në lidhje me tarifat për shërbimet e aksesit broadband celular, tarifat e shërbimeve të roaming ndërkombëtar, afatit të ofertave mujore, tarifave standarde për njësi komunikimi (pay as you go), tregojnë se tregu i telefonisë celulare po performon mirë pavarësisht strukturës së përqendruar të tij.

<sup>6</sup>Burimi: Raporti Vjetor 2016 i AKEP, fq 45-46

<sup>7</sup>Burimi: Raporti vjetor 2016 i AKEP, fq 50-51



## Pjesët e tregut të operatorëve celularë 2015-3M/I 2017

| Treguesit                                                             | Viti      | Telekom Albania | Vodafone | Albtelecom | Plus  | HHI  |
|-----------------------------------------------------------------------|-----------|-----------------|----------|------------|-------|------|
| Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card) | 3M I/2017 | 32.00%          | 48.92%   | 14.40%     | 4.68% | 3646 |
|                                                                       | 2016      | 32.10%          | 49.40%   | 14.20%     | 4.30% | 3691 |
|                                                                       | 2015      | 34.30%          | 41.50%   | 16.00%     | 8.20% | 3222 |
| Përdorues Aktivë Telefoni                                             | 3M I/2017 | 33.95%          | 48.22%   | 12.60%     | 5.23% | 3664 |
|                                                                       | 2016      | 30.70%          | 50.80%   | 13.10%     | 5.40% | 3724 |
|                                                                       | 2015      | 32.70%          | 46.80%   | 14.10%     | 6.40% | 3499 |
| Përdorues aktivë broadband                                            | 3M I/2017 | 28.12%          | 52.72%   | 14.12%     | 5.05% | 3794 |
|                                                                       | 2016      | 27.30%          | 54.70%   | 13.70%     | 4.30% | 3944 |
|                                                                       | 2015      | 29.00%          | 54.50%   | 16.50%     | 0.00% | 4084 |
| Thirrje dalëse                                                        | 3M I/2017 | 33.40%          | 50.38%   | 10.99%     | 5.23% | 3802 |
|                                                                       | 2016      | 33.70%          | 51.70%   | 10.80%     | 3.80% | 3940 |
|                                                                       | 2015      | 31.70%          | 49.30%   | 13.10%     | 5.90% | 3642 |
| SMS dalëse                                                            | 3M I/2017 | 22.54%          | 62.87%   | 10.54%     | 4.05% | 4589 |
|                                                                       | 2016      | 21.20%          | 66.70%   | 8.90%      | 3.20% | 4988 |
|                                                                       | 2015      | 18.10%          | 65.80%   | 8.10%      | 8.00% | 4787 |
| Trafik Data                                                           | 3M I/2017 | 21.17%          | 55.53%   | 20.31%     | 2.98% | 3954 |
|                                                                       | 2016      | 21.00%          | 54.80%   | 22.10%     | 2.10% | 3937 |
|                                                                       | 2015      | 17.60%          | 50.80%   | 28.80%     | 2.70% | 3727 |
| Të ardhura totale nga komunikimet                                     | 2016      | 30.68%          | 48.64%   | 11.60%     | 9.07% | 3524 |
|                                                                       | 2015      | 34.30%          | 47.10%   | 12.00%     | 6.60% | 3582 |
| Te ardhurat me pakicë                                                 | 2016      | 28.07%          | 56.18%   | 11.15%     | 4.60% | 4089 |
|                                                                       | 2015      | 28.20%          | 54.00%   | 12.40%     | 5.40% | 3894 |
|                                                                       |           |                 |          |            |       |      |

Pjesët e tregut të operatorëve celular për treguesin përdorues aktiv telefoni për tremujorin e parë të viti 2017 janë: Telekom Albania 33.95%, Vodafone 48.22%, Albtelecom 12.6% dhe Plus 5.23%. Për vitin 2016 pjesët e tregut janë: Telekom Albania 30.7%, Vodafone 50.8%, Albtelecom 13.1% dhe Plus 5.4%, nga ku vihet re ulje e pjesës së tregut të Vodafone, Albtelecom dhe Plus. Duke pasur parasysh treguesit e mësipërm mund të themi se Vodafone është konkurrenti me pjesë më të madhe treg, më pas vjen Telekom Albania, Albtelecom dhe në fund konkurrenti me pjesë tregu më të vogël, Plus.

### Vlerësimi i tregut pas përqendrimit

Referuar marrëveshjes në lidhje me transferimin e ½ frekuencave nga Plus tek Telekom si dhe vlerësimin e strukturës së tregut të frekuencave, pritet që pajtimtarët aktive të Plus-it të jenë përpara zgjedhjes së njërit prej 3 operatorëve të mbetur në treg, por vlerësimi i saktë i treguesve të pjesës së tregut është e pamundur në këtë fazë për faktin se:

- Pas transaksionit, çdo klient i Plus Communication do të pyetet paraprakisht për përzgjedhjen e operatorit që do të zgjedhe për marrjen e shërbimit në vijim.
- E drejta e portabilitetit të numrit, sipas kuadrit ligjor në fushën e telekomunikacionit, i jep liri zgjedhjeje çdo klienti në përzgjedhjen e operatorit që dëshiron.



— Ulja e tarifave të terminimit on-net/off-net do të ulë kostot e klientëve pavarësisht operatorit nga i cili përfiton shërbimin.


Sipas AKEP, pas realizimit të përqendrimit, pajtimtarët ekzistues, por edhe ata të rinj (përfshirë ata që në të ardhmen do zgjedhin të kalojnë nga Plus në Telekom), do të kenë mundësinë të përfitojnë shërbim celular me cilësor si rrjedhojë e shtimit të kapacitetit të spektrit në dispozicion të tyre. Nëpërmjet transferimit të spektrit të Telekom, ky i fundit ka mundësi të shpërndaje me mire nivelin e shfrytëzimit të spektrit në përdorim dhe t'i hapë rrugën investimeve të reja të cilat deri me tani mund të kenë qenë të kufizuara për shkak të kufizimit sasior të spektrit në dispozicion me frekuencat objekt kontrolli i 900, 1800 dhe 2100 MHz.

Sikurse edhe në vendet e tjera, duke qenë se tregu i telefonisë celulare është një treg me barriera në hyrje për shkak të numrit të kufizuar të licencave, ai karakterizohet nga struktura oligopoli e tregut dhe vlerësimet që bëhen në rastet e përqendrimeve bazohen në simulimin e një ekuilibri të ri Nash-Bertrand<sup>8</sup> në rritjet e çmimeve që mund të sjellë si pasojë përqendrimi (UPP)<sup>9</sup>. Në rastet kur ka barriera të larta në treg këto modele popullohen me të dhëna që mbledhen nga anketa drejtuar konsumatorëve fundor sidomos me rezultatet të diversion ratios<sup>10</sup> dhe të dhëna nga portabiliteti i numrave.

Sipas një studimi<sup>11</sup> të kryer mbi përdorimin e teknikave analitike për vlerësimin e përqendrimeve ex-ante dhe ex-post, përdorimi i teknikave analitike do të fokusohet në një vlerësim ex-post të tregut pas portabilitetit të numrave, kur efektet e ndryshimit të strukturës së tregut do të jenë të dukshme dhe të matshme. Analiza në këtë rast do të bazohet në gjetjet evropiane dhe globale për efektet e pas përqendrimit në tregun e telefonisë celulare në Evropë e me gjerë.

Tregu i telefonisë celulare është një treg me përqendrim shumë të lartë. Ky treg kërkon investime shumë të larta fillestare të cilat mund të sjellin barrira në hyrje/dalje nga tregu, me informacion të plotë mbi shërbimet dhe çmimet, ka karakteristikat e një tregu oligopol.

#### Grafiku i HHI ndër vite



Sipas AKEP<sup>12</sup>, edhe në Shqipëri njësoj si në trendet globale, ndërmarrjet që operojnë në tregun e telefonisë celulare ofrojnë një sërë shërbimesh dhe paketash tarifore dhe shpesh është e vështirë krahasimi i tarifave për shërbime të veçanta dhe/ose për njësi për shkak të rritjes së përdorimit të shportave (bundles) me një shërbim ose me shumë shërbime (paketa të integruara).

<sup>8</sup>Sipas modelit Bertrand të oligopolit, ndërmarrjet në mënyrë të pavarur zgjedhin çmimet (jo sasinë) në mënyrë që të maksimizojnë fitimet. Kjo arrihet duke supozuar që çmimet e konkurrentëve merren si të mirëqena. Si rezultat, ekuilibri i arritur është ekuilibri Nash i çmimeve, referuar si ekuilibri Bertrand (Nash).

<sup>9</sup>Indeksi i presionit të çmimit të sipërm (UPP) fokusohet në shtyesën e ndërmarrjes së përqendruar për të rritur çmimet post-transaksion, dhe llogaritet duke përdorur shkallën e devijimit dhe përfitimet që vijnë nga ky përqendrim para përqendrimit.

<sup>10</sup>Shkalla e devijimit (Diversion Rate) llogaritet zgjedhjen e alternativës së radhës (zëvendësuesi më i afërt) që do të llogaritet sipas zgjedhjes që do të bëjnë pajtimtarët e Plus pas mbylljes së Operatorit.

<sup>11</sup> [www.unipi.gr/unipi/images/various/akad\\_tmim/oikon\\_epist/J.10\\_European\\_Competition\\_Journal.pdf](http://www.unipi.gr/unipi/images/various/akad_tmim/oikon_epist/J.10_European_Competition_Journal.pdf)

<sup>12</sup><https://www.akep.al/images/stories/AKEP/raporte/RAPORTI-VJETOR-2016-110517.pdf>

Sipas AKEP, ecuria e tarifave me pakicë të tregut celular analizohet në dy drejtime kryesore: - Të ardhura mesatare për minutë/përdorues (ARPM/ARPU); - Tarifatat nominale me pakicë të operatorëve. (Average Revenue Per User) dhe ARPM (Average revenue Per Minute) ku këto dy tregues deri në vitin 2015 kanë ardhur duke u ulur duke treguar përmirësim të efikasitetit të tregut.

**Tabela: Të dhënat nga AKEP për ARPM dhe ARPU**

|      | ARPM<br>(Lek/minute) | ARPU<br>(Lek/vit) | ARPM<br>Ndryshimi<br>vjetor (%) | ARPU Ndry-<br>shimi Vjetor<br>(%) |
|------|----------------------|-------------------|---------------------------------|-----------------------------------|
| 2010 | 6.49                 | 8,594             |                                 |                                   |
| 2011 | 5.35                 | 8,319             | -18%                            | -3%                               |
| 2012 | 3.92                 | 7,132             | -27%                            | -14%                              |
| 2013 | 3.13                 | 5,863             | -20%                            | -18%                              |
| 2014 | 2.63                 | 5,447             | -16%                            | -7%                               |
| 2015 | 2.36                 | 5,125             | -10%                            | -6%                               |

Sipas të dhënave nga ITU<sup>13</sup>, e cila vlerëson çdo vit tregun e telekomunikimeve në bazë të indikatorëve të ndryshëm dhe rolit të rregullatorëve në treg, në profilin e tregut të telefonisë celulare për Shqipërinë deri në 2015, ndërsa segmente të caktuara të tregut të telekomunikimeve si shërbimet e telefonisë fikse, DSL, Modem Cable, TV etj, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme, vlerësohen si tregje me nivel të lartë konkurrence, pjesa e tregut të pakicës së telefonisë mobile dhe pjesa e tregut të shërbimit të internetit (3G dhe 4G) ndodhet në kushtet e një konkurrence të pjesshme dhe ka nevojë për ndërhyrje të rregullatorit.

**Tabela : ITU Profili i Shqipërisë 2015**

| Level of Competition (Latest data available: 2015) |    |                                                                        |
|----------------------------------------------------|----|------------------------------------------------------------------------|
| Local Fixed Line Services                          | C* |                                                                        |
| Domestic fixed long distance                       | C  |                                                                        |
| International Fixed Long Distance                  | C* |                                                                        |
| Mobile                                             | P* | P: 4 licenses/authorisations for GSM mobile frequencies from 1996-2010 |
| IMT (3G, 4G, etc.)                                 | P* | P: 3 UMTS authorisations for 3G frequencies 1900/2100 MHz              |
| Wireless Local Loop                                | N  |                                                                        |
| DSL                                                | C  |                                                                        |
| Cable modem                                        | C  |                                                                        |
| Fixed Wireless Broadband                           | N  |                                                                        |
| Leased Lines                                       | C  |                                                                        |
| International Gateways                             | C* |                                                                        |
| Internet Services                                  | C  |                                                                        |
| Cable Television                                   | C  |                                                                        |
| Fixed Satellite Services (FSS)                     | C  |                                                                        |
| Mobile Satellite Services (MSS)                    | N  |                                                                        |
| VSAT                                               | C* |                                                                        |

M: Monopoly  
P: Partial competition (year when competition was introduced)  
C: Full competition (year when competition was introduced)  
N: N/A

**Efektet në tregun e pakicës:** Gjatë periudhës që AK ka realizuar hetim për sjelljen e operatorëve të telefonisë celulare nga ku u konstatua se operatorët konkurrojnë më tepër me shporta me shërbime të kombinuara që quhen paketat “Bundeling”. Shërbimet përbërëse të paketave dhe çmimet e tyre mund t’i konsiderojmë si produkte homogjene dhe të zëvendësueshme nga ana e zgjedhjes konsumatorë. Gjatë periudhës hetimore vihet re që paketat kanë kombinime shërbimesh të krahasueshme nga ana konsumatore.

Portabiliteti i numrit, unifikimi i tarifave in-net dhe off- net si dhe fakti që më shumë se 90% e përdoruesve të telefonisë celulare kanë shërbim me parapagesë, rrisin mundësinë e lëvizshmërisë së klientëve dhe ulin mundësinë që klientët e Plus të kalojnë të gjithë në operatorin Telekom.

<sup>13</sup> <http://www.itu.int/net4/itu-d/icteye/CountryProfile.aspx>

Në rastet kur transferimi i klientëve do të ndahet në tre operatoret në treg, Vodafone do të vazhdojë të ketë pjesën më të madhe të tregut dhe Telekom e Albtelecom me pjesë të qëndrueshme tregu.

Në përfundim të analizës ekonomike vlerësojmë se për shkak të strukturës oligopolistike të tregut të telefonisë celulare, barrierave në hyrje për shkak të licensave të dhëna, pjesës së ulët të tregut që zotëron ndërmarrja PLUS, jemi të mendimit së dalja nga tregu i operatorit Plus mund të sjellë ndryshime të strukturave të tregut.

Për gjitha sa më sipër, jemi të mendimit që transaksioni i synuar për transferimin e bllokut të frekuencave nga Plus Communication tek Telekom Albania mund të sjellë ndryshime në strukturën e tregut të shërbimeve të telefonisë celulare.

### **Konkluzione**

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitimin e të drejtave të përdorimit të  $\frac{1}{2}$  të spektrit të Plus nga Telekom dhe në zbatim të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 10, pika b dhe neni 12 i tij si dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e Përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3, transaksioni është klasifikuar përqendrim pasi ai prek në mënyrë të drejtpërdrejtë një pjesë të aseteve që gjenerojnë të ardhura të ndërmarrjes në transaksion për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së Autorizimit Individual.

Ky transaksion në zbatim të Ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH” është njoftuar në AKEP dhe ka marrë miratimin paraprak nëpërmjet Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP, më të cilin theksohet se transferimi i frekuencave nuk krijohen deformime të konkurrencës; nuk dëmtohet përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient i spektrit të frekuencave; rritet efica e përdorimit të spektrit të frekuencave; mbrohet interesi publik dhe realizohet transparenca e nevojshme e parashikuar ligjërisht.

Struktura e tregut të spektrit të frekuencave para përqendrimit tregon së asnjë nga operatorët në treg nuk zotëron pozite dominuese. Pas transferimit, pjesa e tregut e ndërmarrjes Telekom Albania SHA rritet duke arritur nga XX % deri në XX % sipas frekuencës.

Sipas dokumentacionit të depozituar ndërmarrja Plus paraqitet në kushte të vështira financiar në vitet e fundit të cilat nuk i mundësojnë vijimin më tej me investime për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe konkurruese ndaj konsumatorëve të këtyre shërbimeve. Në nenin 13, pika 3 të Ligjit Nr.9121, parashikohet se një përqendrim mund të mos ndalohe në rastet kur ndërmarrja palë në përqendrim rrezikon seriozisht të falimentojë dhe nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së saj ose ndërmarrja duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt, pavarësisht forcimit të pjesës së tregut të ndërmarrjeve palë në marrëveshje.

Duke qenë se frekuencat janë input ose baza teknike për sigurimin e shërbimit të telefonisë celulare, dhe për më tepër kur në tregun e shërbimeve celularë pas transferimit të Frekuencave do të kemi një operator më pak, është i rëndësishëm vlerësimi i konkurrencës në kuptim të Ligjit 9121/2003 të tregut të shërbimeve celulare.

Tregu i telefonisë celularë është një treg me indeks të lartë përqendrimi Hershman Herfindal, i cili vjen për shkak të numrit të kufizuar të operatoreve në treg si dhe pjesës së madhe të tregut që zotërojnë dy kompanitë më të mëdha në treg (Telekom dhe Vodafone).

Nga transaksioni në lidhje me transferimin e  $\frac{1}{2}$  frekuencave nga Plus tek Telekom si dhe vlerësimin e strukturës së tregut të frekuencave, konstatojmë se Telekom Albania mund të rrisë pjesën e tregut në shërbimet që ofron, por duhet të theksojmë se rritja e pjesës së tregut pas përqendrimit do të ketë ndikim të vogël në treg për shkak të pjesës së vogël të tregut që zotëron Plus Communication.

Vlerësimi i saktë i treguesve të pjesës së tregut është e pamundur të vlerësohet në këtë fazë për faktin se:

- Pas transaksionit, çdo klient i Plus Communication do të pyetet paraprakisht për përzgjedhjen e operatorit që do të zgjedhe për marrjen e shërbimit në vijim.

- E drejta e portabilitetit të numrit, sipas kuadrit ligjor në fushën e telekomunikacionit, i jep liri zgjedhjeje çdo klienti në përzgjedhjen e operatorit që dëshiron.
- Ulja e tarifave të terminimit on-net/off-net do të ulë kostot e klientëve pavarësisht operatorit nga i cili përfiton shërbimin.

Pas transferimit në tregun e telefonisë celulare do të ofrojnë shërbimin e tyre tre operator nga të cilët Vodafon Albania SHA ka pozitë dominuesë në treg<sup>14</sup> e ndjekur nga Telekom Albania dhe Albtelecom. Pas transferimit AKEP do të vendosë kushte në Autorizimet Individuale që do të lëshohen në kohën e fillimit të shfrytëzimit të spektrit dhe mbulimit për të bërë të mundur rritjen e efektivitetit të përdorimit dhe shmangien e mbajtjes së bllokuar të tij.

Referuar rasteve të ngjashme të trajtuara nga Autoritetet e Konkurrencës në BE, industria e telefonisë celulare që nga viti 2010 është prekur nga reduktimi i numrit të operatoreve në treg të cilat kanë qenë objekt vlerësimi dhe monitorimi i vazhdueshëm prej tyre.

Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun e spektrit të frekuencave ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t'i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimi në përputhje me nenin 56, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës:

### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek TELEKOM ALBANIA SHA.
- II. Detyrimin e AKEP për të siguruar frekuenca të lira për çdo hyrës të ri në treg.
- III. Pas përfundimit të transferimit të spektrit, AKEP-i të kryejë analizën e tregut të telefonisë celulare, duke përcaktuar operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), sipas kërkesave të Kreut VI të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar. AKEP-i për nxitjen e konkurrencës në treg të vendosë kushte dhe detyrime të veçanta sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 ndaj OFNT-ve dhe në rast moszbatimi ta parashtrojë rastin përpara Autoritetit të Konkurrencës.
- IV. Autoriteti i Konkurrencës të realizojë vlerësimin e tregut e shërbimeve pas përqendrimit mbështetur në analizën e AKEP.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<sup>14</sup> Referuar procedurave hetimore

## VENDIM

Nr. 486, datë 05.12.2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të ndërmarrjes Fitzroy Merger CO, tërësisht e kontrolluar nga CTH Invest S.A. me Ferrara Candy Company Holdings Inc.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të ndërmarrjes Fitzroy Merger CO, tërësisht e kontrolluar nga CTH Invest S.A. me Ferrara Candy Company Holdings Inc.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet bashkimit të ndërmarrjes Fitzroy Merger CO, tërësisht e kontrolluar nga CTH Invest S.A. me Ferrara Candy Company Holdings Inc;

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Pranë Autoritetit të Konkurrencës (AK) në datën 16.10.2017, me shkresën Nr. 422 Prot, janë depozituar dokumente dhe informacione në lidhje me njoftimin e përqendrimit nëpërmjet bashkimit të ndërmarrjes Fitzroy Merger CO, tërësisht e kontrolluar nga CTH Invest S.A. me Ferrara Candy Company Holdings Inc;

Në datë 28.09.2017, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen dhe Planin e Bashkimit. Njoftimi është kryer pranë Autoritetit të Konkurrencës në datë 16.10.2017, duke respektuar afatin ligjor prej 30 ditësh siç përcakton neni 12, pika 2 e Ligjit Nr 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar.

#### Palët në transaksion

**Blerësi:** CTH Invest SA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Belgjikës, me adresë në Place de la Sainte-Alliance 16, B-1180 Uccle-Belgjikë, me Nr 0660.681.450 RPM Bruksel. Objekti<sup>1</sup> i kësaj ndërmarrjeje, është përmbushja sipas formës së tyre e të gjitha aktiviteteve industriale, tregtare, financiare, drejtpërdrejtë ose tërthorazi në lidhje me krijimin, menaxhimin dhe financimin e çdo shoqërie, objekt i të cilave është kryerja e cilësdo nga operacionet, pavarësisht nga forma e tyre, si dhe nga menaxhimi i përhershëm ose i përkohshëm, i portofolave të krijuara për këtë qëllim. Ndërmarrja mund të bashkëpunojë ose të marrë pjesë ose të

<sup>1</sup> Sipas Statutit të Ndërmarrjes CTH depozituar më 13 Prill 2017,



interesohet për shoqëritë e tjera, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në çfarëdo mënyre. Gjithashtu ajo mund të veprojë si administrator apo likuidues në shoqëri të tjera. Ndërmarrja mund të kryejë në përgjithësi çdo aktivitet tregtar, industrial, financiar, të luajtshëm ose të paluajtshëm që ka lidhje direkte ose në mënyrë të tërthortë me qëllimin e shoqërisë ose që mund të lehtësojë realizimin e saj.

**Shitësi: Ndërmarrja Target: Ferrara Candy Company Holdings, Inc.** është një shoqëri e themeluar dhe që ekziston sipas ligjeve të shtetit të Delaware, me seli në adresën One Tower Lane, Suite 2700 Oakbrook Terrace, State of Delaware, IL 60181, ShBA, regjistruar në regjistrin tregtar të Delaware me Nr 5139840. Targeti ushtron aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave.

Përqendrimi ka të bëjë me një transaksion financiar që realizon bashkimin e Ferrara Candy Company Holdings Inc (Target-Ferrara) me Fitzroy Merger Co (Fitzroy), shoqëri e bashkimit e kontrolluar prej CTH Invest S.A (Blerësi-CTH).

Në mbledhjen e Këshillit Administrativ të CTH, siç evidentohet nga procesverbali i mbledhjes i datës 26 Shtator 2017, konstatohet se kjo ndërmarrje ka hyrë në diskutime me Ferrara Candy Holdings INC, për të blerë këtë të fundit. Me qëllim zbatimin e këtij transaksioni, është krijuar rishtazi (vetëm për këtë transaksion) një ndërmarrje tërësisht e kontrolluar nga CTH që është ndërmarrja Fitzroy Merger CO, e cila do të bashkohet me Ferrara dhe kjo e fundit do t'i mbijetojë këtij bashkimi dhe do të vazhdojë si një ndërmarrje tërësisht e kontrolluar nga CTH.

Ndërmarrja target përfshin kryesisht prodhimin dhe shitjen e konfeksioneve prej çokollate kryesisht në SHBA. Targeti është themeluar në Delaware, SHBA dhe nuk kryen shitje në Shqipëri.

Sipas Statutit të ndërmarrjes CTH<sup>2</sup> depozituar më 13 Prill 2017, kjo ndërmarrje me Nr 0660.681.450 RPM Bruksel, është krijuar më 03.08.2016. Kapitali aksionar i kësaj shoqërie është XXXXXXXX Euro<sup>3</sup>.

Blerësi<sup>4</sup> është një shoqëri e lidhur me Grupin Ferrero, një prodhues produktesh ushqimore, i cili ushtron aktivitet në prodhimin dhe tregtimin e ëmbëlsirave dhe produkteve të tjera të ëmbla (p.sh. ëmbëlsirave prej çokollate, karamеле, snacks dhe ëmbëlsirave në formë kremi) në të gjithë botën.

Ferrero International S.A.<sup>5</sup>, rregjistruar më 30.09.1997, është një shoqëri aksionare me seli në Rrugën “Findel Business Centre”, Rue de Treves në Luksemburg. Kjo ndërmarrje ka për objekt veprimtarinë e përgjithshme industriale, tregtare, financiare të pasurive të luajtshme ose të paluajtshme që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, me krijimin, administrimin dhe financimin, në çfarëdo formë, të të gjitha sipërmarrjeve dhe shoqërive që kanë për objekt çdo aktivitet, në çfarëdo formë si dhe administrimin dhe vlerësimin e portofolit të krijuar për këtë arsye. Shoqëria mund të interesohet në të gjitha drejtimet për veprimtaritë tregtare, sipërmarrjet ose shoqëritë që kanë një objekt të njëjtë, të ngjashëm ose të lidhur ose që janë të një natyre që favorizon zhvillimin e saj ose shtrirjen e veprimtarisë së saj. Kapitali i kësaj shoqërie është XXXXXXXX Euro<sup>6</sup>.

Ferrero është një prodhues produktesh ushqimore, i cili ushtron veprimtari në prodhimin dhe tregtimin e ëmbëlsirave dhe produkteve të tjera të ëmbla. Ferrero nuk është i pranishëm në Shqipëri dhe vepron në tregun shqiptar nëpërmjet Ferrero d.o.o, një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Kroacisë, në bazë të kontratave të distribucionit/shpërndarjes. Dy distributorët e Ferrero d.o.o në Shqipëri janë Inter Trade & Distribution SHPK dhe Kosmonte Foods Tirana SHPK.

<sup>2</sup> Sipas Ekstraktit të plotë të detajeve të shoqërisë

<sup>3</sup> Statutit të Ndërmarrjes CTH, neni 5 “Kapitali”

<sup>4</sup> Seksioni 3 i Formularit të Njoftimit të përqendrimit

<sup>5</sup> Ekstrakti i Ferrero International S.A

<sup>6</sup> Neni 3 i Statutit të Ferrero International S.A.

Inter Trade & Distribution SHPK është themeluar më 10.03.2009, me numër unik identifikimi K91524002L, me objekt të aktivitetit ndër të tjera importim, eksportim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve dhe artikujve të ndryshëm ushqimorë, cigareve, pijeve, të higjienës personale, kozmetike e të tualetit, detergjentëve, etj.

Kosmonte Foods Tirana SHPK është themeluar më 23.12.2009 me numër unik identifikimi K92423004V me objekt të aktivitetit tregtia me shumicë dhe pakicë e pemëve dhe perimeve, dhe kryerjen e çdo aktiviteti pa kufizim, për sa kohë që është i lejueshëm nga legjislacioni në fuqi.

### **Xhiro për vitin 2016**

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXXXXXXXXX Lekë:

- CTH Invest S.A.<sup>7</sup> = XXXXXXXXXX;
- Ferrero International S.A.<sup>8</sup> : XXXXXXXXXX €<sup>9</sup> = XXXXXXXXXX Lekë;
- Ferrara Candy Company Holding, Inc.<sup>10</sup> : XXXXXXXXXX<sup>11</sup> = XXXXXXXXXX Lekë.

Xhiro totale në **tregun e brendshëm** është XXXXXXXXXX<sup>12</sup> Lekë:

- Inter Trade & Distribution SHPK: XXXXXXXXXX Euro = XXXXXXXXXX Lekë;
- Kosmonte Foods Tirana SHPK: XXXXXXXXXX Euro = XXXXXXXXXX Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa a) dhe b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **Përcaktimi i tregut përkatës**

**CTH Invest S.A.** është një shoqëri aksionare belge dhe ka si qëllim kryerjen në Belgjikë dhe jashtë saj të gjithë veprimeve industriale, tregtare, financiare, të luajtshme ose të paluajtshme të lidhura drejtpërdrejtë me krijimin, menaxhimin dhe financimin e ndërmarrjeve etj.

Kjo shoqëri nuk ka aktivitet dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

CTH Invest S.A. është një shoqëri e lidhur me grupin Ferrero.

Grupi Ferrero nuk është i pranishëm në Shqipëri, ai vepron në tregun shqiptar nëpërmjet Ferrero d.o.o, ndërmarrje kroate, në bazë të kontratave të distribucionit/shpërndarjes me dy subjekte shqiptare: Inter Trade & Distribution SHPK dhe Kosmonte Foods Tirana SHPK.

Grupi Ferrero është aktiv në tregun shqiptar në shitjen e ëmbëlsirave të çokollatës, produkteve të ëmbla në formë kremi si dhe ëmbëlsirave të freskëta prej qumështi me anë të dy distributorëve vendas.

**Ferrara Candy Company Holding, Inc** është një shoqëri amerikane që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave.

Kjo shoqëri nuk ka aktivitet dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit, dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.

<sup>7</sup>Burimi: Shkresa Nr 422/3 Prot, datë 14.11.2017, CTH Invest S.A. është themeluar më datë 29.07.2016 dhe nuk ka realizuar xhiro.

<sup>8</sup>Burimi: Paqyrat financiare të audituara të shoqërisë Ferrero International S.A për vitin financiar që mbaron me 31 gusht 2016 (periudha 01.09.2015 – 31.08.2016).

<sup>9</sup>Burimi: Kursi zyrtar i BSH viti 2016, 1Euro = 137 lekë

<sup>10</sup>Burimi: Pasqyrat financiare të audituara të Ferrara Candy Company Holding, Inc. për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2016

<sup>11</sup>Burimi: Kursi zyrtar i BSH viti 2016, 1USD = 124 lekë

<sup>12</sup>Burimi: Shkresa Nr 422/3 Prot, datë 14.11.2017



**Tregu përkatës i produktit:** Duke marrë parasysh aktivitetet e palëve pjesëmarrëse në transaksion si dhe referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregjet përkatëse në analizën e këtij përqendrimi janë si më poshtë:

- Tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej çokollate;
- Tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave në formë kremi;
- Tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave me përmbajtje qumështi si snack të freskët dhe ëmbëlsira të ftohta dhe;
- Tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej sheqeri.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

## **VLERËSIMI I KONKURRENCËS**

Ferrero ka një gamë të gjerë produktesh si: ëmbëlsira prej çokollate (Ferrero Rocher, Raffaello, Ferrero Golden Gallery); ëmbëlsira në formë kremi (Nutella); ëmbëlsirat me përmbajtje qumështi, snack të ëmbël të freskët (Kinder); ëmbëlsira prej sheqeri të cilat përgatiten duke shpërndarë sheqer në ujë apo qumësht dhe duke e përpunuar atë në lloje të ndryshme të ëmbëlsirave, si dhe pastilje me karakteristika freskuese (Tic Tac).

Vetë grupi Ferrero nuk ka prezencë të drejtpërdrejtë në vendin tonë, por i realizon shitjet e tij nëpërmjet dy distributorëve vendas Inter Trade & Distribution SHPK dhe Kosmonte Foods Tirana SHPK.

Referuar të dhënave të paraqitura nga pala njoftuese, rezulton se në total produktet e Ferrero në Shqipëri zënë XX% të të gjithë tregut .

Transaksioni i propozuar nuk do të ketë efekte në strukturën e tregut të brendshëm shqiptar, sepse ndërmarrja target nuk është e pranishme në Shqipëri. Si pasojë, nuk kemi një mbivendosje horizontale të veprimtarive ekonomike të shoqërive target dhe blerësit apo ndërmarrjeve të zotëruara nga grupi Ferrero.

Ky transaksion nuk pritet të sjellë asnjë ndryshim të pozitës ekonomike të grupit Ferrero në vendin tonë, duke qenë se ndërmarrja target nuk ka shitje dhe as prezencë në Shqipëri. Presioni konkurrencial për produktet e grupit Ferrero do të ngelet sërish i njëjtë, duke qenë se tregu vendas nuk paraqet barrierë në hyrje për konkurrentët ekzistues apo ato të rinj.

**Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstaton se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti si rezultat i krijimit, ose forcimit të pozitës dominuese.**

## **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës:

### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit të ndërmarrjes Fitzroy Merger CO, tërësisht e kontrolluar nga CTH Invest S.A. me Ferrara Candy Company Holdings Inc.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 487, datë 05.12.2017

**Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi Portofolin e Kredisë së Procredit Bank AD Beograd nga Banca Intesa AD Beograd.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Ledia MATIA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të Sekretariatit mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi Portofolin e Kredisë së Procredit Bank AD Beograd nga Banca Intesa AD Beograd.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d, nenet 2, 10 - 12, dhe neni 16 dhe Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53 - 64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi Portofolin e Kredisë së Procredit Bank AD Beograd nga Banca Intesa AD Beograd,

### VËREN SE:

#### TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Pranë Autoritetit të Konkurrencës (AK) në datën 20.11.2017, me shkresë Nr. 475 Prot, është marrë njoftimin në lidhje me një transaksion financiar që realizon Shitblerjen e Portofolit të Kredisë nga ana e Banca Intesa AD Beograd të Procredit Bank AD Beograd.

Nëpërmjet shkresës 475/2 datë 23.11.2017 “Përcillet dokumentacioni”, është depozituar pranë AK Marrëveshja Kuadër për Shitblerjen e Portofolit të Kredive mes palëve Banca Intesa AD Beograd dhe Procredit Bank AD Beograd.

#### Palët në transaksion

**Blerësi: Banca Intesa A D Beograd**, një bankë e themeluar dhe që vepron sipas Ligjit të Serbisë, si shoqëri aksionare me seli të regjistruar në Milenta Popovica 7b, 11000 Belgrade, Serbi, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve Serbe.

**Shitësi/ Targeti: Procredit Bank AD Beograd**, një bankë e themeluar dhe që vepron sipas Ligjit të Serbisë si shoqëri aksionare me seli të regjistruar në Milutina Milankovica 17, 11000 Belgrade, Serbi, e regjistruar në regjistrin e Shoqërive e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve Serbe.

Njoftimi ka të bëjë me kryerjen e një transaksion financiar që realizon blerjen nga Banca Intesa A D Beograd:

- Të portofolit të përzgjedhur të kredisë së Procredit Bank AD Beograd dhe
- Të bazës së përzgjedhur të klientëve të Procredit Bank AD Beograd.(Asetet Target)

Përqendrimi realizohet në tregun e shërbimeve bankare në Serbi dhe nuk ka efekt të drejtpërdrejtë në Shqipëri, pasi asetet target nuk janë të pranishme dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri. Duke qenë se mëmat e tyre përkatëse operojnë në Shqipëri nëpërmjet degëve përkatëse Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA dhe Procredit Bank SHA, për Marrëveshjen Kuadër të shitblerjes së Portofolit të Kredive duhet të merret aprovimi i Autoritetit të Konkurrencës, duke përfshirë edhe Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës<sup>1</sup>.

### **Xhiro për vitin 2016**

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **XXXXXXXX Lekë**

- Intesa Sanpaolo S.p.A: XXXXXXXXXXXX €<sup>2</sup> = XXXXXXXXXXXX Lekë
- Banca Intesa AD Beograd: XXXXXXXXXXXX RSD = XXXXXXXXXXXX Lekë
- Procredit Bank AD Beograd: XXXXXXXXXXXX € = XXXXXXXXXXXX Lekë

Xhiro totale në **tregun e brendshëm** është XXXXXXXXXXXX Lekë:

- Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA : XXXXXXXXXXXX Lekë
- ProCredit Bank SHA: XXXXXXXXXXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **ANALIZA E KONKURRENCËS**

**Banca Intesa AD Beograd** ofron shërbime bankare tek personat fizik, ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha dhe klientë të korporatave në Serbi. Kjo ndërmarrje është pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo. Banca Intesa AD Beograd nuk realizon të ardhura dhe nuk është prezente në Shqipëri.

**Procredit Bank AD Beograd** është aktiv në tregun e shërbimeve bankare. Kjo ndërmarrje i përket Grupit Procredit. Procredit Bank AD Beograd nuk realizon të ardhura dhe nuk është prezente në Shqipëri.

**Intesa Sanpaolo S.p.A** është mëma e Intesa Sanpaolo Group, një nga grupet më të mëdhenj bankar në Itali. Intesa Sanpaolo gëzon një prezencë të përzgjedhur në Evropën Qendrore dhe Lindore, në vende të Lindje së Mesme dhe Afrikës së Veriut. Intesa Sanpaolo S.p.A është prezente dhe operon në Shqipëri me filialin e zotëruar tërësisht prej saj, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA** është një bankë kryesore në vend që u ofron kompanive, klientëve institucionalë e privatë me të ardhura të larta si dhe klientëve individë e biznese të vogla e të mesme zgjidhje të arsyeshme përmes shërbimeve e produkteve të saj. Banka i ofron shërbimet e saj përmes një rrjeti prej 32 degësh në qytete të ndryshme të vendit dhe vazhdon të zgjerohet në mënyrë strategjike duke ndjekur nga afër zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

**Procredit Bank SHA** është aktive në tregun e shërbimeve bankare në Shqipëri. Banka i ofron shërbimet e saj nëpërmjet 13 degë/agjensi në të gjithë vendin. Kjo ndërmarrje i përket Grupit Procredit.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- tregu përkatës i produktit, dhe
- tregu përkatës gjeografik.

<sup>1</sup> Marrëveshja kuadër e shitblerjes së Portofolit të Kredive, faqja 5.

<sup>2</sup> Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2016, 1euro=137 lekë.

**Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet **tregu i brendshëm** pra territori i Republikës së Shqipërisë.

## **VLERËSIMI I KONKURRENCËS**

Sektori bankar vazhdon të luajë rolin kryesor në ndërmjetësimin financiar në Shqipëri, me një strukturë që ka mbetur e pandryshuar në vitet e fundit, e përbërë nga 16 banka me kapital privat. Pjesa më e madhe e sektorit bankar kontrollohet nga filialet e grupeve të huaja bankare me origjinë të kapitalit nga Bashkimi Evropian, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në legjislacionin shqiptar dhe mbikqyret nga Banka e Shqipërisë.

Treguesit kryesorë të sistemit bankar që janë aktivet, depozitat dhe kreditë.

### **Tregu i Aktiveve**

Në tregun e aktiveve për vitin 2016 vërejmë se Banka Kombëtare Tregtare ka përqindjen më të lartë të aktiveve me xxx %, e ndjekur nga Raiffeisen Bank me xxx % dhe Credins Bank me xxx %. Në terma të aktiveve, tregu paraqitet me një strukturë mesatarisht të përqendruar ku Indeksi i Përqendrimit ( Hershman Herfindal) është në vlerën 1463

### **Tregu i Depozitave**

Në tregun e depozitave rezulton se Banka Kombëtare Tregtare ka përqindjen më të lartë me xxx %, e ndjekur nga Raiffeisen Bank me xxx % dhe Credins Bank me xxx %. Tregu i depozitave klasifikohet si mesatarisht i përqendruar me Indeks e Përqendrimit në HHI= 1447.

### **Tregu i Kredive**

Në tregun e kredisë Banka Kombëtare Tregtare ka përqindjen më të lartë me xxx %, e ndjekur nga Credins Bank me xxx % dhe Raiffeisen Bank me xxx %. Tregu bankar shqiptar klasifikohet si mesatarisht i përqendruar në terma të kredive me Indeks Përqendrimi në vlerën 1304.

## **Konkluzione**

Transaksioni i njoftuar ka për qëllim përfitimin e kontrollit mbi Portofolin e Kredisë të Procredit Bank AD Beograd nga Banca Intesa AD Beograd. Të dyja këto shoqëri nuk operojnë dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

Banca Intesa AD Beograd është pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo dhe Procredit Bank AD Beograd është pjesë e Grupit Procredit.

Ky transaksion ndodh ndërmjet Banca Intesa AD Beograd dhe Procredit Bank AD Beograd të cilat janë prezente vetëm brenda territorit të Serbisë dhe nuk kanë apo do të sjellin asnjë ndikim në tregun shqiptar, pavarësisht se mëmat e tyre përkatëse operojnë në Shqipëri nëpërmjet degëve përkatëse Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA dhe Procredit Bank SHA .

Si përfundim,

**Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t’i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimi në përputhje me nenin 56, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.**

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës:

### **VENDOSI:**

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi Portofolin e Kredisë së Procredit Bank AD Beograd nga Banca Intesa AD Beograd.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIME ME OBJEKT – ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE

### VENDIM

Nr. 447, datë 16.01.2017

**Për Dhënien e disa Rekomandimeve Bashkisë Berat për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit funeral**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 16.01.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i një ankese kundrejt Bashkisë Berat;

**Baza Ligjore:** Neni 24, gërma d) e f), neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”;

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të raportit “Mbi vlerësimin e Ankesës së “E.K.” kundrejt Bashkisë Berat”,

### VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar Kërkesa-Ankimore, datë 12.12.2016 me ankues E.K. Person Fizik, e cila i drejtohet Bashkisë së Qytetit Berat dhe për dijeni: Autoritetit të Konkurrencës; Këshillit Bashkiak Berat; dhe Shoqërisë Soliar SHPK

Objekti i kësaj kërkesë ankimore është mosfunksionimi i zhvillimit të aktivitetit funeral si pasojë e një marrëveshjeje të ndaluar që ka si objekt pengimin e konkurrencës.

Pas vlerësimit paraprak të ankesës, me qëllim grumbullimin e një informacioni sa më të plotë lidhur me problematikat e ngritura në ankesë, u zhvilluan takime me përfaqësues të Bashkisë Berat dhe me Ankuesin E.K..

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës rezulton se si rezultat i një procedure elektronike prokurimi, Autoriteti Kontraktor “Bashkia Berat” ka lidhur Kontratën e Shërbimit Nr. 6150 prot, dt. 10.11.2016, me objekt “Mirëmbajtje e varrezave publike dhe të varrezave Dëshmorët e Kombit Berat”, me Operatorin Ekonomik fitues “AB.Zoga” sh.p.k & “Pienvis” SHPK

Në vijim, Bashkia Berat, me anë të shkresës nr. 6426/1 prot, dt. 06.12.2016 (në përgjigje të së cilës është hartuar edhe Ankesa objekt vlerësimi) ka kërkuar nga Ankuesi “E.K.” zbatimin e detyrimit ligjor për lidhjen e Akt-Marrëveshjes së propozuar nga subjekti AB.ZOGA sh.p.k, të hartuar në zbatim të nenit 8, pika 8.4 të Kontratës së Shërbimit Nr. 6150 prot, dt. 10.11.2016 në bazë të të cilit: operatori ekonomik fitues duhet të lidhi kontrata për shërbimin funeral me subjektet e licensuara.

Sipas Ankuesit, referuar përmbajtjes së Kontratës së Shërbimit Nr. 6150 prot, dt., Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 70, dt. 29.06.2016, Ligjit nr. 9220, dt. 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, nuk rezulton që të jetë miratuar kontraktimi i administrimit të shërbimit funeral, për rrjedhojë pretendimet e “AB.Zoga” sh.p.k, të shpalosura në Projekt/Akt- marrëveshje, se është i autorizuar të realizojë edhe mbledhjen e tarifave të shërbimit funeral edhe kryerjen e punimeve dhe shërbimeve funerale nuk gjejnë mbështetje në Kontratën e Shërbimit dhe në legjislacionin përkatës.

Bazuar në Kontratën e Shërbimit Nr. 6150 prot, dt. 10.11.2016 me objekt “Mirëmbajtja e varrezave publike dhe të varrezave Dëshmorët e Kombit Berat”, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të Dëshmorëve të Kombit të Bashkisë Berat (pika 9.3 e Kontratës), konsiston në: ruajtjen e varrezave; pastrim prerje bari; ujitje bimësh dekorative; mirëmbajtje parcele ekzistuese; pastrim rruge e sheshe; rifreskim i germave të varrezave të dëshmorëve; pastrim varri prej mermeri në varrezat e dëshmorëve.

Në këtë objekt nuk rezulton të jetë i përfshirë administrimi i shërbimit funeral dhe mbledhja e tarifave për këtë shërbim.

Për sa me sipër Bashkia Berat i jep Operatorit ekonomik "AB.Zoga" sh.p.k & “Pienvi” sh.p.k, të drejtën dhe detyrimin e lidhjes së kontratave për shërbimin funeral me subjektet e licësuara që e ofrojnë këtë shërbim, si dhe të zbatojë tarifat e vendosura me Vendim të Këshillit Bashkiak për këtë shërbim, shërbime këto jashtë objektit të kontratës.

Projekt/Akt-Marrëveshja objekt ankimimi i detyron palët e përfshira në këtë marrëveshje (SOLIAR Sh.p.k dhe E.K. (Ankimuesi)) që të lidhin një marrëveshje me subjektin AB ZOGA Sh.p.k, subjekt i cili gjithashtu operon në të njëjtin treg përkatës si edhe dy subjektet e tjera.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

#### **VENDOSI:**

- I. T’i rekomandojë Bashkisë Berat hapjen e tregut për konkurrencë të lirë në shërbimin e punimeve funerale duke vendosur kritere të njëjta për të gjithë operatorët që ofrojnë këtë shërbim.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për dërgimin e tyre pranë institucioneve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**



## VENDIM

Nr. 450, datë 28.02.2017

**Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|      |                |         |
|------|----------------|---------|
| Znj. | Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z.   | Koço BROKA     | Anëtar  |
| Znj. | Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z.   | Eduard YPI     | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 28.02.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Raporti mbi vlerësimin e ankesës së Shoqërisë "Albanian Stevedoring Company (ASC)" sh.p.k, hartuar nga Grupi i Punës;

**Baza Ligjore:** Nenet: 29/1, 24, (shkronjat ç dhe d); 26, 28 (germa a) dhe 42 (pika 1); të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), Rregulloren "Për Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës" (e ndryshuar), neni 12; si dhe Rregulloren "Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës", neni 4.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Raportit mbi vlerësimin ankesës së Shoqërisë "Albanian Stevedoring Company (ASC)" sh.p.k, dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

### VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja "Albanian Stevedoring Company (ASC)" sh.p.k, ka depozituar Formularin e Ankesës nr. 22 prot, datë 23.01.2017, nëpërmjet së cilës kjo shoqëri ankohet kundrejt ndërmarrjeve: "EMS-Albanian Port Operator (EMS APO)" sh.p.k; "German Albanian Logistic Agency" sh.p.k (referuar si "GALA"); si dhe shoqërisë "EMS Shipping & Trading" Gmbh (referuar si "EMS").

Nga provat e administruara rezulton se ndërmarrja që ka objekt menaxhim-operimin (koncesionari EMS APO) e terminalit lindor të Portit të Durrës, është licencuar për kryerjen e shërbimit stivador dhe ka të njëjtën licence dhe të njëjtin objekt të aktivitetit me shoqëritë e tjera të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho, "ASC" Sh.p.k, "Liburnët 1" dhe "Egnatia-1", të cilave i'u është refuzuar aksesit për të operuar në terminalin lindor nga ana e Koncesionarit.

Ndërmarrja "EMS APO", duke patur koncesionin në terminalin lindor me objekt: menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Terminalin Lindor ne Partin e Durrësit, është e detyruar të zbatojë dispozitat e Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar), duke i'u ofruar palëve aksesin e nevojshëm në shërbimet që Koncesionari ka ekskluzivitet, duke lidhur kontratat e nevojshme të cilat garantojnë kushte të barabarta dhe konkurrenciale.

Analiza e provave të administruara nga ana e shoqërisë Ankuese ASC sh.p.k; rezultateve të nxjerra në raportin e auditimit në Portin e Durrësit nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit; provave të siguruar nga ana e korrespondencës me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës; si edhe monitorimit të realizuar nga Grupi i Punës, rezulton se: mund të jemi para shkeljes së nenit 9 të Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar), ku përcaktohet se përbën abuzim nga ana e një ndërmarrje me pozitë dominuese: refuzimi për të ofruar shërbime/produkte, refuzimi për të lidhur kontrata si edhe zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime të njëjta me palët, duke i vendosur ato në kushte të pabarabarta konkurrence.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 42, pika 1, nenit 9 dhe nenit 24, (shkronja d), të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar),

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit;
- II. Hetimi Paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga dita e nesërme e nënshkrimit të Kontratës Koncesionare, datë 6 Maj 2013, me objekt "Menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Terminalit Lindor në Portin e Durrësit", me palë "EMS Shipping & Trading GmbH" dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, deri më datë 28.02.2017;
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo me vonë se dy muaj nga marrja e këtij vendimi;
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve vepruese në tregun objekt-hetimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 451, datë 28.02.2017

**Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|      |                |         |
|------|----------------|---------|
| Znj. | Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z.   | Koço BROKA     | Anëtar  |
| Znj. | Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z.   | Eduard YPI     | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 28.02.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Marrja e masave të perkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.

**Baza Ligjore:** Nenet, 9, 24 dhe neni 44 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Pergjithshëm dhe Raportit të Grupit të Punës mbi vlerësimin ankesës së Shoqërisë "Albanian Stevedoring Company (ASC)" SHPK, lidhur me kufizimet e konkurrencës në tregun e shërbimit stivadore (ngarkim-shkarkim dhe aktivitetet e lidhura me to) për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit";

### VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja "Albanian Stevedoring Company" sh.p.k, (ketu e vijim-ASC), ka depozituar Formularin e Ankesës nr.22 prot, datë 23.01.2017, nëpërmjet së cilës kjo shoqëri ankohet kundërt ndërmarrjeve: "EMS-Albanian Port Operator (EMS APO)" sh.p.k; "German Albanian Logistic Agency" sh.p.k (referuara si "GALA"); si dhe shoqërisë "EMS Shipping&Trading" GmbH (referuara në vijim si- "EMS").

Sipas ankimesit "EMS APO" ka krijuar një pozitive monopol të paligjshme në Terminalin Lindor, duke u sjellë në mënyrë abuzive kundërt të gjithë operatorëve stivadore që operojnë në Portin e Durrësit:

- duke mos iletuar këta operatorë që të veprojnë dhe të japin shërbimet e tyre lirish në këtë pjesë të portit;
- duke i penguar klientet (kompanitë ekspedicionare dhe pronarët e anijeve) që të lidhin kontrata shërbimi me operatorët e tjerë stivadore; dhe madje,
- duke i detyruar klientet që në kundërshtim të plotë me nenin 9 të ligjit 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të zgjidhin kontratat me operatorin stivadore që e kishin përzgjedhur vetë fillimisht dhe duke i detyruar ata që të marrin shërbimet tek vet "EMS APO".

Ankuesi pretendon se veprimet abuzive të "EMS APO" kanë nisur që në vitin e parë të zbatimit të Kontrates

se Sherbimit (2013) dhe vazhdojne, duke dhene edhe disa raste te ketyre veprimeve te emertuara sipas klienteve si rastet: "Kurum"; "Klosi"; "Nereida"; "Arican Dadayli"; anijet "Alessia" dhe "Ganda"; "Spiros Cement"; "Dedja Shipping". Lidhur me pengesat e krijuara ne keto raste nga Koncesionari, ankuesi ka kerkuar zgjidhje nga institucionet perkatese si APD dhe Ministria e linjes (MTI), te cilat kryesisht ne pergjigjet e dhena kane theksuar se:

"Koncesionari ne zbatim te detyrave kontraktuale, nuk duhet tu imponohet ne asnje rast klienteve, per te perzgjedhur operatoret e tyre te perpunimit, pasi ky veprim perben shkelje te detyrimeve te parashikuara ne Kontraten Konfesionare".

Koncesionari eshte pajisur me autorizim/licencen per perpunimin e mallrave rifuxho vetem ne Terminalin Lindor (Autorizim nr. 370/2, dt.23.09.2015), operatoret e tjere nuk kane kryer asnje sherbim ne kete terminal. Ne keto kushte "EMS APO" ka ekskluzivitet te plote mbi do sherbim te Terminalit Lindor, duke filluar nga: sherbimi i menaxhimit, sherbimi stivador; si dhe sherbimin spedicioner (i cili mundeson lidhjen me klientin) qe ofrohet nga shoqeria GALA, e cila gjithashtu eshte pjese e EMS-se dhe zoterohet 100% prej saj ne kuota kapitali. Keto shoqeri kane vepruar ne menyre te njejte, te koordinuar duke pasur si qellim demtimin e shoqerise konkurrenente ASC.

Lidhur me kete situatë te krijuar nga EMS eshte shprehur edhe KLSH pas auditimit te kryer (per periudhen e veprimtarise 01.11.2013- 30.04.2016) konkretisht me vendimin nr. 12336 date 30.09.2016 "Per evidentimin e materialeve te auditimit te ushtruar ne APD "Mbi zbatimin e ligjshmerise, rregullshmerise se veprimtarise ekonomiko-financiare ", ne piken b.3)/1 KLSH evidenton se Kompania Konfesionare edhe pse e pajisur me licencen e stivadorit ka vendosur monopol ne kete sherbim pasi porti i Durrësit nuk ka zhvilluar nje procedure per te perzgjedhur kompanine stivadore ,pra nuk ka patur nje konkurrence ne kete sherbim, ne kundërshtim me Ligjin Nr. 9251, date 08.07.2004 "Kodi Detar i RSH-se".

Situata e krijuar ne Terminalin Lindor ndërmjet shoqerise Koncesionare EMS APO dhe operatoreve te licencuar te ngarkim-shkarkimit per keto sherbime ka qene nje shqetesim real edhe per APO e cila ne cilesine e Land Lord Port, ka kerkuar me insistim zgjidhjen e menjehershme te ketyre mosmarreshjeve dhe respektimin e detyrimeve kontraktuale te cilat palet kane me APO.

APO nepermjet shkreses Nr. 3525, date 03.12.2015 "Mbi situaten ne Terminalin Linder" drejtuar EMS APO, ne piken 3, shprehet se: "Pretendimet tuaja mbi veprime te paautorizuara nga ASC ne terminalin lindor me argumentimin se i vetmi operator i autorizuar ne Terminalin lindor eshte "EMS APO" nuk qendrojne, pasi ASC ashtu edhe si edhe kompanite e tjera stivadore te licencuara, kane te drejten te operojne ne te gjithë territorin e Portit te Durrësit, sipas parimit te perzgjedhjes, i cili garanton mos diskriminimin dhe konkurrencen ne sherbimin ndaj perdoruesve te Portit te Durrësit".

Ne keto kushte:

- Operatoret e licencuar stivadore jane bllokuar te punojne;
- Ata nuk lejohen te hyjne ne Terminalin Linder per te kryer sherbimet ndaj klientit;
- EMS APO nuk ve ne perdorim vinc;at, te cilat i disponon vetem ai, duke bllokuar anijet ne port per dite te tera dhe duke mos i lejuar ata te hyjne ne terminal per te kryer sherbime . Pasoje e kesaj sjellje te EMS APO eshte zgjidhja e kontratave me shoqerite stivadore.

Fakti qe Terminali Lindor ka ekskluzivitetin mbi disa sherbime te caktuara, i mundeson Koncesionarit "EMS APO" qe te kontrolloje lehtesisht dhe ne menyre teresisht te pavarur keto sherbime nga operatoret stivadore, duke qene madje ne gjendje qe te kontrolloj krejtesisht edhe klientet qe duhet te marrin sherbime ne Terminalin Linder.

EMS APO nepermjet shoqerise spedicionere GALA (e cila gjithashtu eshte pjese e grupit EMS dhe zoterohet 100% nga EMS), operon edhe ne sherbimin spedicioner , i cili ndërmjeteson lidhjen per llogari te Koncesionarit te sherbimeve stivadore me klientet e portit duke forcuar poziten e saj dominuese kundrejt

ofruesve te tjere te ketyre sherbimeve (stivadore/spedicionere). Ne tregun e ofrimit te sherbimit stivador per mallrat rifuxho,duke monopolizuar kete sherbim, EMS lehtesisht mund te krijoj te njejten situatë edhe ne ofrimin e sherbimit spedicioner nepermjet shoqerise GALA. Ne kete menyre, perdoruesi i portit nuk ka mundesi tjeter zgjedhjeje pervec;se EMS APO.

Sjellja e "EMS APO" ka vendosur shoqerine ASC dhe c;do operator tjeter qe vepron ne port ne kushte te pabarabarta dhe te pafavorshme konkurrence, duke ndermarre veprime konkrete per te perjashtuar konkurrentet. Kjo sjellje mund te perbeje nje abuzim me poziten dominuese (monopol) qe zoteron ky Koncesionar, ne ofrimin e sherbimeve ne Terminalin Lindor te Portit te Ourresit, sipas nenit 9, pika 2, te ligjit nr.9121/2003 .

Nga vleresimi ligjor dhe administrimi i provave te sjella nga ankimuesi ASC sh.p.k; nga monitorimi ne APO; nga rezultatet e nxjerra ne raportin e auditimit ne Portin e Durrësit nga ana e Kontrollit te Larte te Shtetit; si dhe korrespondences me MTI, vleresojme se: Shoqeria "EMS Shipping & Trading GmbH" nepemjet "EMS APO" (te ciles i zoteron 100% te kapitalit) dhe nepermjet kontrates konfesionare "Per dhenien ne koncesion menaxhimin, operimin, mirembajtjen dhe permiresimin teknik te Terminalit Lindor te Portit te Durrësit ", nenshkruar ne date 6 Maj 2013 me MTI, ka krijuar pozite monopol ne tregun perkates duke krijuar dyshimin e arsyeshem se jemi para shkeljes se nenit 9 te Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences".

**Si konkluzion,** ne zbatim te detyrimeve qe rrjedhin nga kontratat/licence te lidhura ndermjet operatoreve stivadore dhe APO, parimit te portit te hapur "common user port" sipas te cilit duhet ti garantohet e drejta i;:do perdoruesi te portit te perzgjedh operatorin e tij; detyrimeve te Koncesionarit ne zbatim te ligjit 9121/2003, Komisioni i Konkurrences shprehet se mund te ndodhemi perballe nje situatë urgjence, per shkak te rrezikut te kryerjes se nje demi te rende dhe te pariparueshem per konkurrencen, pasi ka te ngjare te kete shkelje te nenit 9 (abuzimi me poziten dominuese) te Ligjit "Per mbrojtjen e konkurrences".

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrences, bazuar ne nenin 24, germa d), nenin 44 te Ligjit Nr. 9121, date 28.07.2003, "Per mbrojtjen e konkurrences" (i ndryshuar),

#### **VENDOSI:**

##### **I. Marrjen e mases se perkohshme si vijon:**

Koncesionari "EMS APO":

- Te zbatoje ne menyre te menjehershme detyrimin ligjor per ofrimin e sherbimit te ngarkim-shkarkimit dhe sherbimet e lidhura me to per te gjithë operatorët e licencuar stivadore qe ushtrojne veprimtarine e tyre sipas licences;
- Te lejoje aksesin e operatoreve stivadore te licencuar ne Terminalin Lindor per te kryer sherbimet ndaj klienteve;
- "EMS APO" te vendos ne perdorim vinçat per te gjitha shoqerite stivadore .

##### **II. Masat e perkohshme merren per nje periudhe kohore deri ne perfundim te hetimeve;**

III. Ne rast te moszbatimit te vendimit per masa te perkohshme te cituara ne piken 1 te ketij vendimi, Koncesionari "EMS APO" ndeshkohet me gjobe deri ne 10 % te xhiros vjetore per shkelje te rende te konkurrences ne zbatim te nenit 74, pika 1,germa b) te ligjit nr. 9121 "Per mbrojtjen e konkurrences" (te ndryshuar);

IV. Ne rast te moszbatimit te masave te perkohshme brenda afateve te percaktuara ne kete vendim, Komisioni i Konkurrences vendose gjoba periodike deri ne 5 % te xhiros mesatare ditore, deri sa Shoqeria Koncesionare "EMS APO" SHPK te veproje ne perputhje me vendimin per masat e perkohshme ,ne zbatim te nenit 76, pika 1,germa b) te ligjit nr. 9121 "Per mbrojtjen e konkurrences"

(te ndryshuar);

V. Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem i Autoritetit te Konkurrences per njoftimin e ve ndimit Shoqerise Koncesionare "EMS APO" SHPK, MTI, APD dhe operatoreve te interesuar stivadore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 455, datë 28.03.2017

### Për hapjen e procedures se hetimit paraprak ne tregun e transportit nderkombetar detar te udhetareve dhe automjeteve ne Portin e Vlores.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 28.03.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i Relacionit te Sekretares te Pergjitheshme mbi "Ankesen e ndermarrjes 'ARKLEAND BUS'" SHPK

**Baza Ligjore:** Neni 9, pika 2, germa a), c) dhe ç); Neni 42, pika 1, te Ligjit Nr. 9121, date 28.7.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences" (i ndryshuar); Neni 4 i Rregullores "Per Procedurat Hetimore te Autoritetit te Konkurrences" .

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit te Sekretarit te Pergjithshem mbi ankesen e ndermarrjes "ARKLEAND BUS" SHPK;

### VËREN SE:

Prane Autoritetit te Konkurrences , me date 27 .02.2017, shoqeria "Arkleand Bus" Shpk, e cila kryen veprimtari ne fushen e transportit nderkombetar te udhetareve me autobus, ka depozituar Formularin-Tip te Ankeses, protokolluar me Nr. 91 Prot,date 27.02.2017.

Shoqeria "Arkleand Bus" Shpk ankohet lidhur me disa veprime te agjensive "Gerveni Travel" Sh.p.k dhe "Euroferries" Sh.p.k, te cilat operojne si agjensi detare dhe speditionere prane portit te Vlores. Keto agjensi jane perfaqesuese te shoqerise te tragetit "Northbay Transportes Marittimos Lda", qe operon ne linjen Vlore - Brindisi dhe anasjelltas.

Ankuesi , "Arkleand Bus" shpk , eshte operator transporti dhe njekohesisht klient i agjensive detare "Gerveni Travel" Sh.p.k dhe "Euroferries" SHPK, pasi perdor transportin detar te tyre per udhetare dhe automjete nga Vlorë ne Brindisi dhe anasjelltas.

Ankuesi e perdor kete port detar, pasi eshte i pajisur me licjence nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures , per kryerjen e transportit nderkombetar te udhetareve me autobus ne linjen (Elbasan - Raguza, me itenerar ne stacionet : ELBASAN - Lushnje - Fier - Porti Vlore - Porti Brindisi - Taranto - Polikoro - Nova Siri - Specano - Lamecia Terme - Rosarno - Messina - Giardini Naksos - Katania - RAGUZA) dhe perdorimi i Portit te Vlores eshte nje domosdoshmeri per te ndjekur itenerarin e percaktuar sipas licjences me siper . Pra objekti i ankeses eshte Tregu i transportit nderkombetar detar te udhetareve dhe automjeteve ne iteneraret : Porti i Vlores- Porti Brindizit-anasjelltas.

Ne Portin e Vlores aktualisht vepron vetem nje traget ne pronesi te shoqerise "Northbay Transportes



Marittimos Lda". Kjo shoqe ri realizon transportin detar nderkombetar te udheta reve dhe automjeteve ne linjen Vlore - Brindisi dhe anasjelltas , duke realizuar shitjen e biletave nepermjet dy agjensive detare "Gerveni Travel" Sh.p.k dhe "Euroferries" Sh.p.k perfaqesuese te shoqerise pronare te tragetit.

Ankuesi eshte orientuar nga shoqeria "Northbay Transportes Marittimos Lda", pronare e tragetit qe operon ne linjen Vlore -Brindisi dhe anasjelltas , qe te realizoje prerjen e biletave nepermjet agjensise "Euroferries" SHPK

Ankuesi pretendon se qe nga momenti qe trageti i shoqerise "Northbay Transportes Marittimos Lda" vepron i vetem ne Portin e Vlores , c;mimet e biletave te pasagjereve per shoqerine "Arkleand Bus" shpk jane rritur nga 22 Euro ne 30 Euro dhe tashme se fundi, nga mesi i muajit Shkurt ne 60 Euro, po ashtu nderkohe edhe cmimet per biletën e transportit te autobuseve nga 180 Euro ne 308 Euro.

Sipas ankuesit, agjensia "Euroferries" Sh.p.k, me seli prane Portit Vlore, ne menyre verbale , perpara prerjes se biletave, kerkon nje garanci prej 1000 Euro per cdo autobus, me qellim qe te realizohet dhe kthimi me te njejten linje.

Shoqeria "Gerveni Travel" Sh.p.k, si perfaqesuese e shoqerise "Northbay Transportes Marittimos Lda", pronare e tragetit , ka kerkuar nga shoqeria "Arkleand Bus" Sh.p.k te lidh nje kontrate ekskluzive , te cilen nuk ja ka kerkuar asnje kompanie tjeter qe operon ne kete treg, duke vendosur disa kushte te pabarabarta dhe te paperballueshme per kete ndermarrje, si:

- Garanci 50 000 Euro, ku ne rast te prishjes se kesaj kontrate, kjo vlere i mbetet shoqerise pronare te tragetit.
- Garanci 50 000 Euro, ku ne rast te prishjes se kesaj kontrate, kjo vlere i mbetet shoqerise pronare te tragetit.
- Çmime te biletave nga 35 - 40 Euro per person, tarifa te cilat jane shume te larta krahasuar me cmimet qe aplikon me ndermarrjet e tjera .

**Per sa me siper**, nga pretendimet e ankimuesit si dhe faktet dhe provat e paraqitura prej tij, rezulton se sjellja e shoqerise italiane "Northbay Transportes Marittimos Lda" pronare e tragetit qe operon ne linjen Vlore -Brindisi dhe anasjelltas , si dhe e agjensive detare perfaqesuese te tij, "Gerveni Travel" Shpk dhe "Euroferries" Shpk, ne tregun e transportit nderkombetar detar te udhetareve dhe automjeteve nga porti i Vlores, bazuar ne nenin 9, pika 2, germa a, c dhe <.;;, te Ligjit 9121/2003 mund te pengojë, kufizojë ose shtremberojë konkurrencen ne kete treg, duke vendosur ne kushte te pafavorshme konkurrence shoqerine "Arkleand Bus" Shpk.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrences, ne mbështetje te neneve: 9, pika 2, germa a, c dhe ç, 24, germa d) dhe 42, pika 1, te Ligjit Nr. 9121, date 28.7.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences" (i ndryshuar),

#### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedures se hetimit paraprak ne tregun e transportit nderkombetar detar te udhetareve dhe automjeteve ne portin e Vlores;
- II. Hetimi Paraprak do te perfshije periudhen kohore 01 Mars 2016 deri me 28 Mars 2017;
- III. Raporti i Hetimit Paraprak duhet te paraqitet ne Komisionin e Konkurrences, jo me vone se 3 muaj nga marrja e ketij vendimi;
- IV. Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem i Autoritetit te Konkurrences per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 462, datë 23/ 05 /2017

**Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 23.05.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i Relacionit të Sekretares të Përgjithëshme mbi “Ankesën e paraqitur nga Z. Hysen CAKA, Z.Ardian CAKA dhe Znj. Lima CAKA.

**Bazë ligjore:** Neni 9, pika 2, germa a), c) dhe ç); Neni 42, pika 1; të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar); Neni 4 i Rregullores “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretares të Përgjithëshme mbi vlerësimin ankesës së paraqitur nga Z. Hysen CAKA, Z.Ardian CAKA dhe Znj. Lima CAKA, lidhur me kufizimet e konkurrencës në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” Sh.p.k

### VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës me datë 12.04.2017, janë paraqitur Z. Hysen CAKA dhe Znj. Lima CAKA të cilët ushtrojnë aktivitet me objekt: “Prodhim dhe përpunim brumi, furrë buke”. Këta persona kanë paraqitur një ankesë, në lidhje me sjelljen e ndërmarrjes “Nelly” Sh.p.k e cila ushtron aktivitet në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj.

Sipas ankimuesve ndërmarrja “Nelly” Sh.p.k është distributor ekskluziv i produkteve “Maja” dhe “Miel” të markës “Zrnopan” të tipit “S”, “Plus” dhe “T” të prodhuar nga kompania “Lesaffre” kompani Franceze, me qendër rajonale në Kroaci.

Ankimuesit pretendojnë se janë ndodhur përpara faktit të mos furnizimit me këto produkte nga ndërmarrja “Nelly” Sh.p.k dhe për këtë arsye kanë kontaktuar në telefon me Z. Haki HOXHA administrator i ndërmarrjes “Nelly” Sh.p.k, i cili i ka deklaruar se nuk do ti furnizojë më, pasi ankimuesit kanë hapur një Furrë Buke (Pikë Shitje) në zonën e “Don Boskos” përballë Furrës së Bukës së kompanisë “SOMEK” dhe konkurojnë këtë të fundit, i cili rezulton të jetë miku i Z. Haki HOXHA administrator i ndërmarrjes “Nelly” SHPK

Sipas ankimuesve, ndërmarrja “Nelly” Sh.p.k është i vetmi distributor i këtij produkti në Republikën e Shqipërisë, produkt të cilin e importon nga Kroacia dhe sipas tyre ky produkt nuk ka zëvendësues të tjerë në vend, duke i dhënë ndërmarrjes “Nelly” Sh.p.k pozita “monopol” në tregtimin e këtij produkti, pozita të cilat ajo i përdor për të goditur ankimuesit duke shkelur nenin 9 të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ( i ndryshuar).

Ndërprerja e furnizimit me këtë produkt i shkakton një dëm të rëndë dhe të pa riparueshëm ankimuesve pasi këta të fundit kanë kontrata me të tretë për furnizimin me bukë speciale të cilat prodhohen me këto produkte, dhe mos përmbushja e kontratës i ngarkon me penalitete, gjithashtu ankimuesit pretendojnë se 40 % të produkteve të bukës që tregëtojnë i prodhojnë me “Maja” dhe “Miell” të markës “Zrnopan” të tipit “S”, “Plus” dhe “T” të prodhuar nga kompania “Lesaffre” me dsitributor në Shqipëri ndërmarrjen “Nelly” SHPK

Për sa më sipër, nga pretendimet e ankimuesit si dhe faktet dhe provat e paraqitura prej tij rezulton se sjellja e ndërmarrjes “Nelly” shpk në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj, duke refuzuar të furnizojë ankimuesit Z. Hysen CAKA, Z.Ardian CAKA dhe Znj. Lima CAKA me produkte “Maja” dhe “Miell” të markës “Zrnopan” të tipit “S”, “Plus” dhe “T”, bazuar në nenin 9, pika 2 të Ligjit 9121/2003 mund të pengojë, kufizojë ose shtrëmbërojë konkurrencën në këtë treg, duke vendosur në kushte të pafavorshme konkurrence ankimuesit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 9, pika 2; 24, germa d) dhe 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar),

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” Sh.p.k, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
  - II. Hetimi Paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2017 deri me 15.05.2017.
  - III. Raporti i Hetimit Paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës, jo më vonë se 3 muaj nga marrja e këtij vendimi.
  - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 466, datë 20.06.2017

**Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e distribucionit dhe shfaqjes së filmave në rrjetet e kinemave në Tiranë.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 20.06.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Relacionit mbi projekt-vendimin "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e distribucionit dhe shfaqjes së filmave në rrjetet e kinemave në Tiranë".

**Bazë ligjore:** Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", {i ndryshuar}, neni 24, {shkronja d) dhe neni 26. Ligji Nr. 44/2015 datë 30. 04. 2015 "Kodi i procedurave administrative të RSH".

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të raportit të monitorimit mbi tregun e distribucionit dhe shfaqjes së filmave në rrjetet e kinemave, nga ish-Spektori i Analizës dhe Studimit, si dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

### VËREN SE:

Industria e prodhimit, e shpërndarjes {distribucionit} dhe shfaqjes së filmave rregullohet në bazë të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", {i ndryshuar}, si dhe akteve nenligjore në zbatim të tij; Ligji Nr.35 Dt 31/3/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" dhe Rregullores "Për Qendren Kombëtare të Kinematografisë". Ligji "Për kinematografinë" mbështet në fushë-zbatimin e tij, prodhimin, shpërndarjen e filmit shqiptar dhe përcakton rregullat për kontrollin dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, për filmat shqiptar, të para dhe pas, viteve 1990. Agjencitë e përfaqësimit të të drejtave kolektive, konkretisht Forumi i Mbrojtjes për Autorë të Audiovizualit (FMAA) për veprat filmike, kanë mundësinë të evidentojnë dhe të kontrollojnë hyrjen në treg të filmave të rinj, si dhe të mbledhin të ardhura nga e drejta e transmetimit në përkrahje të prodhuesve dhe përfituesve të të drejtës së autorit. Këto akte dhe institucione rregullojnë dhe kontrollojnë respektimin e të drejtave që lindin nga prodhimi i një vepre filmike, si dhe marrëdhëniet midis prodhuesve dhe shpërndarësve. Në vlerësimin e pengesave në hyrje, u vu re se tregu nuk paraqet pengesa ligjore të përcaktuara nga aktet ligjore, parka të tilla të larta ekonomike, të cilat kanë të bëjnë me investimin fillestar për infrastrukturën e sallave dhe me teknologjinë e transmetimit..

Në vlerësim të analizës së konkurrencës dhe në zbatim të Udhezimit "Për Tregun Përkates", përcaktohet se tregu përkates, i marrë në analizë, është Tregu i Shpërndarjes dhe Shfaqjes së filmave në rrjetin e Kinemave në zonën gjeografike të qytetit të Tiranës.

Nga vlerësimi i strukturës së tregut, u konstatua se tregu i shfaqjes së filmave në kinema është një treg i përqendruar, me karakteristikat e një strukture oligopolistike, me konkurrente në treg dhe me pjesë tregu

thujse te njejta.

Nga analiza e politikave lidhur me percaktimin e çmimit per filmat premiere dhe ata jo- premiere, ofertat, si dhe menyren e marketingut, rezultoi per te tre kinemate, se: "Dita e Premieres" eshte dita e Enjte dhe "Dita e Kinemase" eshte dita e Hene; oraret e shfaqjes se filmit jane te zhvendosura ne kohe, me 30 minuta nga njera-tjetra, çmimi i biletave eshte thujse i njejte, si ne rastin e filmave premiere, ashtu edhe ne ditet e tjera. Nderkohe qe organizohen veprimtari te njejta per femijet, pothuajse mete njejtat çmime.

Ne nje treg oligopolistik, ku ne te cilin verehet se ndermarrjet zoterojne pothuaj pjese te njejta tregu, si dhe kane sjellje te njejta (oferta} lidhur me çmimin e biletave, ashtu edhe menyrave te marketingut, atehere keta jane tregues dhe shenja se mund te kete sjelljeje te bashkerenduara mes konkurrenteve, ne menyren e shperndarjes dhe shfaqjes se filmave, kryesisht per filmat e huaj, gje qe ne se dote provohej, nepermjet hetimeve, dote perbente shkelje te nenit 4 te ligjit 9121 date 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences".

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrences, ne zbatim te neneve 4; 9; dhe 42; te Ligjit Nr. 9121, date 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences", (i ndryshuar}, te nenit 4 te Rregullores "Per Procedurat Hetimore te Autoritetit te Konkurrences", si dhe nenit 12 te Rregullores "Per Funksimin e Autoritetit te Konkurrences",

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedures se Hetimit Paraprak ne tregun e shperndarjes dhe shfaqjes se filmave ne rrjetet e kinemave te qytetit te Tiranes;
  - II. Periudha e Hetimit Paraprak do te jete 1 Janar 2015 deri ne 30 qershor 2017;
  - III. Raporti i hetimit paraprak duhet te paraqitet ne Komision jo me vane se 3 muaj nga marrja e ketij vendimi;
  - IV. Ngarkohet Sekretaria e Pergjithshme per njoftimin e ketij vendimi tek palet objekt-hetimi dhe ndjekjen e procedurave hetimore te parashikuara ne ligjshmerine perkatese.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 467, datë 04.07.2017

**Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e “Raportit të hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës”.

**Bazë ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d dhe neni 26; Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative i RSH”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm,

### VËREN SE:

#### PROCEDURA E NDJEKUR

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, shoqëria "Arkleand Bus" Shpk, e cila kryen aktivitet në fushën e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus, ka depozituar Formularin Tip të Ankesës, protokolluar me Nr. 91 Prot, datë 27.02.2017, kundrejt agjencive "Gerverni Travel" SH.P.K dhe "Euroferries" SH.P.K, përfaqësuese të shoqërisë së tragetit "Northbay Transportes Marittimos Lda", që operon në linjën Vlorë - Brindisi dhe anasjelltas.

Bazuar në ankesën e paraqitur, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 455, datë 28.03.2017 të Komisionit të Konkurrencës, "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës", vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve.

Për mbledhjen e fakteve dhe të të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Porti Detar Vlorë, Qendra Kombëtare e Licencimit dhe ndërmarrja “Northbay Transportes Marittimos LDA” e cila ushtron veprimtari në treg.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt.28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 128 prot, datë 28.03.2017 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektime pranë ndërmarrjeve që operojnë në treg, ku u mbajtën dhe

procesverbalet përkatëse “Mbi inspektimin në ndërmarrje” dhe “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit”. Gjithashtu u zhvillua dhe një takim me përfaqësues të Portit Detar Vlorë në ambientet e këtij Porti.

## **TREGU PËRKATËS**

Tregu përkatës i produktit është shërbimi i transportit ndërkombëtar detar i udhëtarëve dhe automjeteve që realizohet nga Porti i Vlorës drejt Portit të Brindisit në Itali dhe anasjelltas.

Tregu përkatës gjeografik është territori i Portit të Vlorës, për shkak të karakteristikave (distanca, zona e veçuar gjeografike) në të cilin realizohet transporti detar ndërkombëtar i udhëtarëve dhe automjeteve nga Porti i Vlorës drejt Portit të Brindisit në Itali dhe anasjelltas.

## **ANALIZA E KONKURRENCËS**

Shërbimi i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës për periudhën nën hetim është ofruar nga kompania "Northbay Transportes Marittimos" LDA e përfaqësuar nga agjencia detare "Gerverni Travel" SH.P.K, si dhe nga kompania "EUROPEAN SEAWAYS" INC e përfaqësuar nga agjencia detare "RUCI LINE" SH.P.K për vitin 2016 dhe "EUROPEAN SEAWAYS" SH.P.K për vitin 2017. Shërbimi i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës, realizohet nëpërmjet mjeteve lundruese/trageteve në pronësi ose përdorim të kompanive të mësipërme që operojnë në portin detar Vlorë në linjën Vlorë - Brindisi dhe anasjelltas.

Ndërmarrja "EUROPEAN SEAWAYS INC", ka filluar të operojë në port nga muaji Gusht 2016 dhe ka vazhduar operimin deri më datë 21.02.2017. Që nga data 22.02.2017 kjo ndërmarrje ka ndërprerë operimin e saj me pretendimin se është bllokuar operimi në portin Italian të Brindisit.

Ndërmarrja “Northbay Transportes Marittimos Lda”, me përfaqësues “Gerverni Travel” SH.P.K, për gjithë periudhën nën hetim zotëron rreth 86 % të tregut përkatës, imarkim/disimbarkim pasagjerësh dhe automjetesh, duke pasur një pozicion dominues në këtë treg.

Duke filluar nga data 22.02.2017 dhe në vazhdim, në Portin Detar Vlorë ka operuar vetëm kompania: “Northbay Transportes Marittimos Lda” me tragetin "St. Damian", përfaqësuar nga agjencia Detare "GERVENI TRAVEL" SH.P.K, e cila realizon transportin ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve e vetme, duke mos pasur konkurrentë në këtë zonë gjeografike, dhe duke zotëruar në këtë mënyrë 100 % të tregut përkatës.

Shoqëria Ankimuese “Arkleand Bus” SH.P.K ka kërkuar të udhëtojë me tragetin e kompanisë “Northbay Transportes Marittimos Lda”, por ka hasur në refuzimin e shërbimit dhe vendosjen e kushteve të padrejta tregtare lidhur me rritjen e çmimit të biletës së tragetit për pasagjer dhe automjete (autobus), si dhe detyrimin e saj për të udhëtuar vajtje-ardhje vetëm me tragetin e kësaj Kompanie, e cila për dhënien e shërbimit ka kërkuar nënshkrimin e një kontrate me kushte e detyrime të padrejta tregtimi.

Detyrimi i Klientit /Shoqërisë së Autobuzave për të udhëtuar vetëm me anije që i përkasin kompanive “Northbay Transportes Marittimos”/“Tnitsea Shipping” me qendër në Madeira, i heq atij të drejtën e për zgjedhjes në rast hyrjeje në treg të një Agjencie tjetër detare, përfaqësuese të një Kompanie të re pronare mjeti lundrues, e cila do ti ofronte shoqërisë çmime grupi më konkurruese.

Duke qene se për periudhën nga 22.02.2017 e në vijim Kompania pronare tragei “Northbay Transportes Marittimos Lda” operon e vetme në linjën Vlorë-Brindisi dhe anasjelltas, duke pasur një pozicion monopol në këtë treg, ajo ka dhe detyrimin për të ofruar shërbimet e saj ndaj të gjitha palëve të interesuara, siç janë dhe shoqëritë e transportit rrugor të udhëtarëve me autobuza.



Nga të dhënat e administruara për periudhën objekt hetimi dyshohet se kompania me pozitë dominuese në treg, ka aplikuar tarifa të ndryshme për veprime të njëjta tregtare. Gjithashtu për periudhën pas datës 22 Shkurt 2017 që përkon me daljen nga tregu të kompanisë konkurrense “EUROPEAN SEAWAYS INC”, konstatohet se ka pasur një rritje të çmimeve të biletave të udhëtimit për pasagjerë dhe automjete.

Pavarësisht rritjes, çmimet e aplikuara nga ndërmarrja “Northbay Transportes Marittimos Lda”, janë brenda kufirit të çmimeve tavan të përcaktuara duke respektuar tarifat e deklaruara në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës. Konkretisht çmimet e aplikuara + tarifat portuale të kompanisë “Northbay” për pasagjerë për kategoritë “Seat/Poltrone” dhe “Ponte/Deck”, kanë variuar nga 20 në 50 Euro, ndërkohë që çmimi tavan i miratuar për kategorinë “Ponte/Deck”, për sezonin e ulët është vajtje/ardhje 40/45 euro dhe në sezonin e lart është vajtje/ardhje 50/55 euro, ndërsa për kategorinë “Seat/Poltrone” çmimi tavan i miratuar për sezonin e ulët është vajtje/ardhje 60/50 euro dhe në sezonin e lart është vajtje/ardhje 70/60 euro. Gjithashtu ky fakt vërtetohet edhe nga deklaratimet e Portit Detar Vlorë (shkresa nr. 143/2, dt. 26.04.2017) sipas të cilit çmimi maksimal i deklaruar në MTI nuk është tejkaluar.

Draft kontrata e propozuar nga pala nën hetim nuk është konkluduar dhe ka mbetur në nivelin e negociatave verbale mes palëve e pakonkluduar në një marrëdhënie kontraktuale me kushte dhe detyrime.

Ankimuesi përpara përfundimit të hetimit paraprak, më datë 15.05.2017, ka kërkuar tërheqjen e ankesës së datës 27.02.2017, për shkak se situata ka ndryshuar dhe është tarifuar njëloj si kompanitë e tjera. Marrëdhëniet kontraktuale janë rivendosur në vullnet të lirë dhe draft/kontrata e propozuar nuk është konkluduar me firmosjen e saj dhe se sjellja e ndërmarrjes nën hetim është korrigjuar duke ofruar shërbimin e transportit të mjeteve dhe pasagjerëve nga/drejt Brindizit-Itali me kushte të njëjta tregtimi për të gjitha shoqërit e interesuara.

Pas tërheqjes së ankesës nga ana e ankimuesit, për të vlerësuar kushtet e tregut për konkurrencë, me datë 15.06.2017 është realizuar një inspektim në portin e Vlorës nga ku rezultoi se situata është normalizuar dhe operatori i vetëm i tragetit i ofron shërbim të gjitha shoqërive të interesuara me kushte të njëjta tregtimi, duke e vendosur tregun në kushtet e konkurrencës të lirë dhe efektive dhe pa diskriminime në ofrimin e shërbimeve me operatorëve që përdorin linjën e transportit detar Vlorë-Brindisi.

Tregu i shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve ka qenë objekt monitorimi, hetimi dhe vendimmarrjeje nga ana e Autoritetit të Konkurrencës. Përkatësisht edhe me VKK nr.248, datë 11/10/2012 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”; VKK nr.349, datë 19/02/2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”, si dhe VKK Nr. 369, datë 2.07. 2015 “Për disa masa detyruese në tregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në Portin e Vlorës”.

Rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës dhënë me Vendimin nr. 349, datë 19/02/2015 "Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve", janë reflektuar në Udhëzimin e MTI Nr. 4, datë 21.5.2015 "Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre", të ndryshuar me Udhëzimin Nr. 6251, datë 23.12.2016.

Por, nga analiza e kryer gjatë procedurës së hetimit paraprak është vënë re se këto rekomandime nuk janë zbatuar në praktikë, pasi në kontratën e operatorëve me Portin mungojnë dispozitat përkatëse lidhur me detyrimin e operatorëve për depozitim të kostove reale për shërbimin që ofrojnë, mbajtjen e të dhënave ditore

për tarifat e aplikuara për çdo biletë të shitur, dhe mbajtjen e rekordeve të shitjeve të biletave nga ndërmarrjet që operojnë në treg, pra këto të dhëna nuk mbikëqyren nga MTI

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit: 24, germa d); 26; 43, pika 5; 45 dhe 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

- I. Detyrimin e ndërmarrjes “Northbay Transportes Marittimos Lda”, përfaqësuar nga “Gerverni Travel” SH.P.K, të zbatojë kushte të barabarta për veprime tregtare të njëjta me palët (shoqëritë e transportit rrugorë që përdorin transportin detar nga Porti i Vlorës), për ti vendosur në gjëndje të favorshme konkurrence;
- II. Në rast të mos zbatimit të pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi, ndërmarrjet ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa c) të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);
- III. Monitorimin e tregut të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës për periudhën nga data 04.07.2017 deri më 04.01.2018, me qëllim verifikimin e sjelljes së Ndërmarrjes “Northbay Transportes Marittimos Lda” për zbatimin e detyrimit të vendosur sipas pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi;
- IV. T’i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës, Nr. 349, datë 19/02/2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”, të realizojë:
  - Monitorimin e zbatimit të tarifave sipas njoftimeve dhe miratimit të MTI-së për secilin traget/linjë kryesisht gjatë sezonit të lartë;
  - Sigurimin e të dhënave të detajuara mbi të gjitha kostot reale për shërbimin që ofrojnë operatorët;
  - Monitorimin e mbajtjes së të dhënave ditore për tarifat e aplikuara për çdo biletë të shitur, si dhe mbajtjes së rekordeve të shitjeve të biletave nga ndërmarrjet që operojnë në treg.
- V. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës;
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për realizimin e monitorimit sipas pikës 3 të dispozitivit të këtij vendimi, si dhe njoftimin e këtij vendimi, Portit Vlorë, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 469, datë 11.07.2017

**Për rekomandime në lidhje me çertifikimin paraprak të shoqërisë “Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror, Albgaz SHA.**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 11.07.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Për disa rekomandime në lidhje me çertifikimin paraprak të shoqërisë “Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror, Albgaz SH.A”.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), neni 24 pika d) dhe f) neni 69 dhe 70. Ligji nr. 44/2015 datë 30.04. 2015 “Kodi i procedurave administrative i RSH”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të informacionit në lidhje me çertifikimin paraprak të shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz SH.A” të bordit të ERE-s:

### VËREN SE:

Me shkresën Nr. 437 Prot., datë 07.06.2017, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka dërguar pranë Autoriteti të Konkurrencës, vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 82 datë 26.05.2017, “Mbi çertifikimin paraprak të Shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz SH.A”.

Çertifikimi paraprak i Shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz SH.A është bazuar në nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit Nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i cili përcakton se Operatori i Kombinuar duhet të çertifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këto nene për veprimtaritë që do të kryej.

Dokumenti për çertifikimin paraprak të Shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz” SH.A., përshkruan detyrat dhe përgjegjësitë referuar neneve 36, 40, 42 dhe 46 të ligjit Nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, por që përcaktojnë kryesisht detyrimet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror.

Gjithashtu, neni 80 i ligjit Nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” përcakton detyrat, objektin, përgjegjësitë dhe veprimtarinë që duhet të ushtrojë operatori i Kombinuar i Gazit Natyror.

Ndërsa, në vendimin për çertifikimin e paraprak të operatorit të kombinuar të Gazit Natyror, ERE i referohet kryesisht detyrave dhe funksioneve të OST – së Gazit Natyror, ndërkohe që OST – ja (e gazit apo e energjisë elektrike) është operatori i vetëm i tregut dhe si i tillë roli dhe funksioni i tij është shumë specifik dhe i mirëpërcaktuar. Por, meqenëse jemi në kushtet e mungesës së modelit të miratuar të tregut të gazit natyror, të parashikuar në pikën 1, neni 88 i ligjit Nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” si edhe të një tregu gazi natyror që pothuajse nuk ekziston, rrjedhimisht edhe roli, funksionet apo përgjegjësitë e secilit operator pjesëmarrës në tregun e Gazit Natyror janë të paqarta apo jo të mirëpërcaktuara.

Gjithashtu referuar parashikimeve të pikës 6, të nenit 80, të ligjit Nr. 102/2015 ku “Një operator i kombinuar i sistemit mban llogari të ndara për secilën nga veprimtaritë e tij, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji”, vërejmë se në certifikimin paraprak nuk është parashikuar apo respektuar edhe parimi i ndarjes së llogarive financiare për veprimtaritë e ndryshme të Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror.

Për sa më sipër:

- për të vlerësuar dhe qartësuar situatën se si do të zhvillohet tregu i gazit Natyror në Shqipëri;
- për të mos patur ndërveprime apo ndërfinancime midis veprimtarive brenda të njejtit subjekt të licencuar për disa veprimtari; si edhe
- për vazhdimin e certifikimit të operatorëve të tjerë të tregut si parashikimeve të ligjit Nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” del e nevojshme që ERE t’i propozojë qeverisë projektin e Modelit dhe Rregullave të Tregut të Gazit Natyror në Shqipëri.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d); 26; 43, pika 5; 45 dhe 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

#### **I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë:**

- Të dizenojë dhe të çojë për miratim pranë Këshillit të Ministrave Modelin dhe Rregullat e Tregut të Gazit Natyror në Shqipëri ku të parashikohen mënyra e organizimit, funksionimit dhe ndërveprimit mes Operatorit të Kombinuar të gazit natyror Albgaz SH.A me OST, OSSH, Prodhim, Impiantet e Përpunimit, Furnizimit, Depozitimit dhe operatorëve të tjerë.
- Në miratimin paraprak të Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror Albgaz SH.A të parashikohet ndarja e llogarive për secilën nga veprimtaritë e tij.

#### **II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 470, datë 11.07.2017

**Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Aeroport".**

Komisioni i Konkurrencës i përbërë nga:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 11.07.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Raportit të hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Aeroport".

**Bazë ligjore:** Neni 24, germa d), neni 43, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003). Ligji Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të republikës së Shqipërisë".

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të Raportit të Hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Aeroport" dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës dhe Pretendimeve të ndërmarrjes AIR BP Albania të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, përkatësisht me shkresën Nr.152 Prot, datë 11.04.2016.

### VËREN SE:

#### PROCEDURA E NDJEKUR

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003), me Vendimin Nr. 417, datë 18.05.2016 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Aeroport" (TIA).

Pas realizimit të procedurës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 432, datë 14.09.2016 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Aeroport".

Në zbatim të vendimit të mësipërm, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin 9121/2003 dhe Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet administrimit të informacioneve nga pala nën hetim dhe palë të tjera. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati paraqiti pranë Komisionit të Konkurrencës Raportin e Hetimit të Thelluar.

Raporti i hetimit të thelluar iu komunikua ndërmarrjes AIR BP Albania (ABP Albania), me anë të shkresës Nr. 321/4 Prot., datë 05.12.2016 të Komisionit të Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe nenit 18 të Rregullores “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, pala nën hetim paraqiti pretendimet e saj mbi raportin e hetimit të thelluar me shkrim, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

## **ANALIZA E KONKURRENCËS**

### **Tregu përkatës i produkteve**

Tregu përkatës i produktit i referohet tregut të importimit dhe shitjes së produktit JET A-1 karosene, (i klasifikuar me kodin 27101921 "Karburant Avionash JET A-1").

### **Tregu Gjeografik**

Ndërmarrja ABP ALBANIA e zhvillon veprimtarinë e saj kryesisht në Aeroportin Ndërkombëtar të Shqipërisë, por kjo ndërmarrje merr pjesë edhe në ofrimin e karburantit JET A-1 karosene edhe për mjetet ajrore helikopterë të qeverisë shqiptare, etj..

Për shkak të kushteve specifike që kërkohen për të operuar në "Tirana International Aeroport", dhe pjesës së tregut të kësaj ndërmarrjeje (mbi XX%) në këtë zonë gjeografike, vlerësohet si treg përkatës gjeografik tregu brenda territorit të "Tirana International Aeroport".

### **Struktura e Tregut**

Nga analiza e tregut të furnizimit me karburant të avionëve JET A -1 karosene në "Tirana International Aeroport", konstatohet se është vetëm një ndërmarrje ABP ALBANIA, e cila është importues dhe shitës me shumicë për këtë produkt.

Në tregun gjeografik objekt i këtij hetimi ndërmarrja ABP ALBANIA operon në zonë të lirë doganore, pra produkti që ajo tregton JET A-1 karosene është i përjashtuar nga akciza dhe taksa e karbonit, që aplikohet në rastet kur ky produkt tregtohet jashtë zonës së lirë doganore, brenda territorit shqiptar.

Nga analiza e të dhënave të importit të produktit JET A-1 karosene rezulton se në tregun e furnizimit me karburant të mjeteve ajrore në pronësi të qeverisë shqiptare (helikopterë) operon edhe ndërmarrja AFT SHA, një ndërmarrje e cila kryen aktivitetet edhe në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të dieselit dhe benzinës për automjete.

### **Pozita Dominuese e Ndërmarrjes Air Bp Albania**

Sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit nr. 9121/2003 pozita dominuese e një ndërmarrje përcaktohet kryesisht nga pjesa e tregut, pengesat në hyrje, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve, varësia ekonomike e furnizuesve dhe blerësve, fuqia kundërvepruese e blerësve , zhvillimi rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve, lidhjet ekonomike me ndërmarrjet e tjera, homogjeniteti i produkteve, transparenca e tregut, uniformiteti i kostos dhe i madhësisë së ndërmarrjeve, qëndrueshmëria e kërkesës ose kapaciteteve të lira prodhuese.

Në rastin konkret ndërmarrja ABP ALBANIA në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar të tregut zotëron monopolin e furnizimit me karburant në aeroportin TIA prej vitesh. Kjo ndërmarrje në kuptim të nenit 8, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", ka një pozitë dominuese ku zotëron XX% të tregut përkatës.

### **Kriteret Ndërkombëtare të Sigurisë**

Shërbimi i ofrimit të karburantit JET A-1 karosene për avionë kërkon cilësi, siguri dhe garanci të veçantë për shkak të sensitivitetit që ka fluturimi me avionë, pasi dëmet apo aksidentet që ndodhin në tregun e fluturimeve civile kanë një impakt mjaft të madh tek përdoruesit, gjithashtu edhe tek kompanitë që ushtrojnë aktivitetin në këtë treg, të cilat përveç dëmeve materiale/fizike rezultojnë edhe në dëmtim të imazhit të ndërmarrjeve të lidhura me tregun e fluturimeve. Për këto arsye, veç të tjerash, është mjaft e rëndësishme që edhe ndërmarrjet



që kryejnë furnizimin e avionëve me karburant duhet të kenë licencat dhe certifikimet e nevojshme përkatëse për ushtrimin e këtij aktiviteti, në mënyrë që të ofrojnë, cilësi, siguri dhe garanci në produktin e tyre.

### **Marrëveshja midis Air BP Albania dhe Tirana International Airport**

Ndërmjet ndërmarrjes “Air BP Albania” SHA (ABP Albania) dhe ndërmarrjes “Tirana International Airport” SHPK (TIA) më datë 24.02.2009 është lidhur marrëveshja “Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”” (Marrëveshja).

Në bazë të nenit 18 të marrëveshjes së mësipërme, në tërësi përbëhet edhe nga dy marrëveshjet e tjera të lidhura midis ABP Albania dhe TIA, përkatësisht:

- “Marrëveshja për Dizenjimin (projektimin) dhe Ndërtimin e një Impianti naftë si dhe Pajisjes së Transportimit të saj në Avion në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës” (Marrëveshja e Ndërtimit); dhe
- “Marrëveshja për marrjen me Qira të një Hapësire Toke në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës” (Marrëveshja e Qirasë).

Ndërmarrja TIA zotëron koncesionin dhe ushtron veprimtarinë e saj në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” Tiranë, në bazë të Ligjit Nr. 9312, datë 11.11.2004 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Koncesionit lidhur midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe “Tirana Airport Partners” SHPK për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare” (Ligji 9312/2004).

Në bazë të Ligjit 9312/2004, TIA është e autorizuar të nën-kontraktojë përsa i përket planifikimit, ndërtimit, drejtimit dhe mirëmbajtjes së Impiantit të ri. Në Shtojcën 48 të këtij Ligji janë përcaktuar kushtet e ndërtimit të impianteve të karburantit në zonën e koncesionit.

Vlefshmëria dhe afati i Marrëveshjes në tërësi është përcaktuar në Pikën 2 të saj, sipas të cilës kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën kur Impianti i Ri do të bëhet funksional dhe do të vazhdojë deri në datën 22.04.2025.

Në bazë të Pikës 3.1.1 të Marrëveshjes, TIA i ka dhënë të drejtën ndërmarrjes ABP Albania që gjatë Afatit të Marrëveshjes do ti sigurojë Aeroportit shërbimet e mëposhtme gjatë Orëve të Funksionimit të Aeroportit:

- Shitja e Karburantit për Avionë tek Klientët sipas çmimeve të cilët përputhen me legjislacionin shqiptar (duke përfshirë por pa u kufizuar në legjislacionin përkatës lidhur me konkurrencën e ndershme) drejt të gjithë Klientëve me të cilët ABP mund të bjerë dakord;
- Depozitimi i Karburantit për Avionë në Impiantin e Ri;

Sipas Pikës 3.7 të Marrëveshjes, TIA nuk do të lejojë asnjë person tjetër, firmë apo shoqëri, për të furnizuar karburant për avion ose produkte të këmbyeshme në avion brenda Aeroportit deri më 31 Dhjetor 2014, ose deri atëherë kur numri i pasagjerëve që përdorin Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës të tejkalojë dy milion pasagjerë në një vit kalendarik, duke i dhënë ABP Albania të drejtën ekskluzive të shërbimit të furnizimit në avion (into plane service).

ABP Albania, sipas Marrëveshjes do të jetë zotëruesi dhe operatori i impiantit të depozitimit të karburantit në Aeroport dhe gjithashtu furnizuesi i vetëm i shërbimit (into-plane service) të karburantit në avionë.

Në bazë të Pikës 4.2 të Marrëveshjes, ABP Albania do të lejojë Palët e Treta të cilave ju është dhënë leje për të hyrë në aeroport nga TIA për të shitur ose bërë të mundur karburant për avionë në hyrjen e Aeroportit dhe të përdorë pajisjet e depozitimit, me kusht që Pala e Tretë të përmbushë (në mënyrë të arsyeshme) kushtet e përcaktuara nga Pika 4.2.1 deri në pikën 4.2.13 të Marrëveshjes.



Në bazë të kërkesës së palëve, Autoriteti i Konkurrencës mori në shqyrtim njoftimin e Marrëveshjes për përjashtim nga ndalimi ndërmjet ndërmarrjes ABP Albania dhe ndërmarrjes TIA të datës 24.02.2009.

Sipas analizës së Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të marrëveshjes kemi tre tregje përkatës:

- Tregu për sigurimin e depozitimit të karburantit për avionë;
- Tregu i tregtimit të karburantit për avionë;
- Tregu i shërbimit të furnizimit në avionë.

Sipas vlerësimi të Autoritetit të Konkurrencës, kjo Marrëveshje, pavarësisht kufizimeve që sjell në tregun e shërbimit të furnizimit me karburant për avionë në avionë të justifikuara nga vetë specifika e këtij shërbimi: kontribuon në përmirësimin e shpërndarjes së produktit dhe shërbimit, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, uljen e kostos së shërbimit dhe produktit, realizon një pjesëmarrje më të drejtë në përfitim nga ana e konsumatorëve, nxit kërkimin dhe zhvillimin dhe përhapjen e njohurive profesionale, rrit sigurinë për sasinë e mallrave që ofron dhe realizon mbulimin e plotë financiar të çdo përgjegjësie të mundshme.

Si përfundim, Autoriteti i Konkurrencës, pas vlerësimit të Marrëveshjes, me Vendimin Nr. 116, datë 29.05.2009 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes midis “Tirana International Airport” SHPK dhe “AIR BP Albania” SHA “Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë, si dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës ”Nënë Tereza””, ka vendosur:

- Të përjashtojë nga ndalimi, (i parashikuar në nenin 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”), Marrëveshjen e datës 24.02.2009 midis “Tirana International Airport” SHPK dhe “Air BP Albania” SHA, “Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”.

Aktualisht ekskluziviteti i dhënë ndërmarrjes ABP Albania nga ndërmarrja TIA, sipas Pikës 3.7 të Marrëveshjes, ka përfunduar më datë 31 Dhjetor 2014, sipas përcaktimit në këtë dispozitë të Marrëveshjes.

Marrëveshja midis ndërmarrjes ABP Albania dhe ndërmarrjes TIA e datës 24.02.2009, vazhdon të jetë në fuqi midis palëve dhe referuar Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 116, datë 29.05.2009 ajo është e përjashtuar nga ndalimi për të gjithë kohëzgjatjen e saj deri në datën 22.04.2025.

### **Sjellja e Ndërmarrjes ABP Albania**

Duke qenë se ndërmarrja ABP Albania zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës, analiza e sjelljes së saj u krye në lidhje me ndonjë abuzim të mundshëm në tregun përkatës, sipas nenit 9, pika 2 të Ligjit Nr. 9121/2003.

Palëve të Treta, të cilave ju është dhënë leje për të hyrë në aeroport nga TIA, për të shitur ose bërë të mundur furnizimin me karburant për avionë në hyrjen e Aeroportit dhe të përdorë pajisjet e depozitimit, në bazë të Pikës 4.2 të Marrëveshjes, do të lejohen nga ABP për të ushtruar aktivitet, me kusht që Pala e Tretë të përmbushë kushtet dhe të lidhë marrëveshjet përkatëse me ABP të përcaktuara nga Pika 4.2.1 deri në pikën 4.2.13 të Marrëveshjes.

Referuar shkresës së ndërmarrjes ABP datë 08.07.2016, të dërguar gjatë procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Airport”, informohemi se ndërmarrjet ABP dhe TIA, për të përgatitur mbarimin e periudhës së ekskluzivitetit, kanë përgatitur një Draft Marrëveshje Akses/Përdorimi, e cila lehtëson aksesin për çdo palë të kualifikuar, e cila dëshiron të furnizojë karburant nga pajisjet dhe infrastruktura e ABP. Një kopje e Draft Marrëveshjes së Akses/Përdorimit na është vënë në dispozicion nga ndërmarrja ABP.

Në shkresën e mësipërme, ndërmarrja ABP informon se gjatë periudhës së ekskluzivitetit dhe pas kësaj periudhe nuk ka marrë asnjë kërkesë formale ose joformale nga asnjë palë për të pasur akses për bërjen e

furnizimit me karburant, apo furnizimit në aeroplan në TIA. Nëse/kur ABP do të marrë ndonjë kërkesë joformale ose aplikim formal për këtë qëllim, të gjitha aplikimet do të vlerësohen duke përdorur kriteret dhe kushtet e përmbajtura në Marrëveshjen e Aksesit/Përdorimit, duke mundësuar dhe lehtësuar aksesin e cilitdo subjekti të kualifikuar që dëshiron të furnizojë me karburant, duke përdorur pajisjet dhe infrastrukturën përkatëse. Gjithashtu, gjatë procedurës së hetimit paraparak dhe të hetimit të thelluar nuk është administruar asnjë kërkesë nga palë të interesuara për të kryer furnizimin me karburant në TIA.

Si konkluzion, referuar sa më sipër, lidhur me vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese në tregun përkatës ABP Albania, mbi dhënien e aksesit për palët e tjera të interesuar për të ushtruar aktivitet pranë TIA, në kuptim të nenit 9, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 9121/2003, rezulton se kjo ndërmarrje, për periudhën nën hetim, nuk ka kufizuar asnjë ndërmarrje për të ushtruar aktivitet në tregun përkatës.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) dhe 43, pika 5, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", të ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Aeroport".
- II. Monitorimin e tregut për 1 (një) vit nga dalja e këtij vendimi për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes "Air BP Albania" SHA në lidhje me kërkesat potenciale nga palët e interesuara për të hyrë dhe për të ushtruar aktivitet në tregun përkatës.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 472, datë 14.09.2017

**Për mbylljen e Hetimit Paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 14.09.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i “Raportin e Hetimit Paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK”.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42 dhe neni 43 pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003). Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit të Hetimit Paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK; Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm raportin e hetimit paraprak,

### VËREN SE:

#### PROCEDURA E NDJEKUR

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 29/1, nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 ka shqyrtuar ankesën që personat fizik Hysen Caka dhe Lima Caka kanë depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK për mos furnizimin me produktet “Zrnopan T”, “Zrnopan S” dhe “Zrnopan Plus”.

Komisioni i Konkurrencës, pas vlerësimit të Ankesës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121/2003 me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 462, datë 23.05.2017, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nënproduktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK, vendosi hapjen e hetimit për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës. Një kopje e Vendimit i është bërë e njohur dhe ndërmarrjes “Nelly” SHPK. Periudha e hetimit e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin e mësipërm është nga 01.01.2017 deri në 15.05.2017.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës (Autorizim Inspektorësh), grupi i inspektimit, gjatë periudhës së hetimit ka kryer inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjes “Nelly” SHPK dhe ankimuesve.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121/2003, është kërkuar informacion nga: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Ndërmarrja nën

hetim “Nelly” SHPK; Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).

## **TREGU PËRKATËS**

Tregu përkatës i produktit përfshin:

Tregun e produkteve përzierës me fara për prodhimin e bukëve dhe simiteve i ndarë në tre nën tregje:

- Nën tregu i produkteve përzierës me fara për prodhimin e bukëve dhe simiteve të zeza (ZRNOPAN T);
- Nën tregu i produkteve përzierës me fara për prodhimin e bukëve dhe simiteve të bardha (ZRNOPAN S) dhe;
- Nën tregu i produkteve përzierës me fara për prodhimin e bukëve dhe simiteve me përmbajtje të lartë farash dhe antioksidantësh (ZRNOPAN PLUS).

Tregu i produkteve të përdorura për ardhjen e brumit, majasë, i ndarë në dy nën tregje:

- Maja e njomë;
- Maja e thatë.

Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Tregu përkatës gjeografik në rastin tonë përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë.

## **PJESËT E TREGUT**

Për të vlerësuar pozicionin që zë ndërmarrja nën hetim në tregjet përkatëse, si dhe zëvendësueshmërinë e produkteve u analizuan të gjitha importet e siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nga ku janë nxjerrë pjesët e tregut për ndërmarrjet importuese të majasë së njomë dhe majasë së thatë në sasi dhe në vlerë, si dhe për produktet ZRNOPAN T, S dhe PLUS.

Tregu i majasë me dy nën tregjet përkatëse të majasë së njomë dhe të thatë është një treg shumë i përqendruar, por kjo shkallë përqendrimi nuk vjen nga pjesa e tregut e ndërmarrjes nën hetim, “Nelly” SHPK, e cila përfaqësohet me 1.6 % në tregun e majasë së thatë dhe 26.8% në tregun e majasë së njomë.

Tregu i produkteve përzierës me fara për prodhimin e bukëve dhe simiteve Zrnopan T, S dhe Plus është një treg shumë i përqendruar, por kjo shkallë përqendrimi nuk vjen nga pjesa e tregut e ndërmarrjes nën hetim, “Nelly” SHPK, e cila përfaqësohet me një pjesë tregu prej 27.7 %.

Sipas bilancit të ndërmarrjes, vlerës së shitjeve në tregun përkatës dhe normës së ulët të fitimit, ndërmarrja “Nelly” SHPK nuk ka fuqi ekonomike e financiare për të shkaktuar kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.

Pra, bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 9121/2003 nuk plotësohet kriteri kryesor i pozitës dominuese mbi pjesën e tregut. Bazuar në këtë kriter si dhe në kriteret e tjera, si fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes, konkurrenca potenciale, rezulton se ndërmarrja “Nelly” SHPK nuk zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës. Si rezultat nuk jemi para rastit të një abuzimi të mundshëm me pozitën dominuese në tregun e majasë dhe tregun e produkteve përzierës me fara për prodhimin e bukëve dhe simiteve Zrnopan T, S dhe Plus.

## **ANALIZA E SJELLJES SË NDËRMARRJES “NELLY” SHPK**

Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes është kryer bazuar në faturat e blerjes dhe të shitjes të administruara gjatë inspektimit dhe në përgjigje të kërkesës për informacion drejtuar ndërmarrjes “Nelly” SHPK.

Në tregun e produktit Maja ndërmarrja “Nelly” SHPK nuk ka pozitë dominuese; tregu ka shumë klientë të rëndësishëm (furra buke); ndërmarrja Nelly nuk është e integruar vertikalisht; sasia e importuar është rritur me 12% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm; ankimesi nuk rezulton të ketë blerë gjatë vitit 2017, prandaj dhe nuk provohet refuzimi për të ofruar për këtë produkt dhe sjellja abuzuese e ndërmarrjes “Nelly” SHPK.

Në bazë të faturave të blerjes dhe të shitjes së ndërmarrjes “Nelly” SHPK rezultoi se kjo ndërmarrje nuk është e integruar vertikalisht për produktin Zrnopan, pra nuk zotëron ndonjë furrë buke dhe klientët e saj janë mjaft të rëndësishëm për nga fuqia që kanë.

Kufizimet e konkurrencës shfaqen kur ndërmarrjet kanë pozitë dominuese dhe konkurrojnë në tregun e rrjedhës së poshtme me ankimuesin (në rastin tonë Caka), të cilit i refuzohet produkti.

Në tregun e produkteve përzierës me fara për prodhimin e bukëve dhe simiteve i ndarë në tre nën tregje, atë të ZRNOPAN T, S dhe PLUS ndërmarrja “Nelly” SHPK është e vetmja që tregon këto produkte të firmës franceze Lesaffre. Por referuar deklaratave të ankimuesit dhe furrës së bukës Someg, produktet kanë zëvendësues, megjithatë është bërë analiza e sjelljes për mundësinë e refuzimit për të ofruar.

Oferta e produkteve Maja dhe ZRNOPAN në treg është rritur për periudhën nën hetim krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe çmimi i vendosur në tregun e rrjedhës së sipërme nga ofruesi nuk është i lartë për të shkaktuar efekte negative në konkurrencë në tregun e rrjedhës së poshtme dhe si rezultat tek konsumatori përfundimtar.

Pas vlerësimit të të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurës hetimore si: dokumentacionit të administruar gjatë inspektimeve; dokumentacionit të dorëzuar nga ndërmarrja nën hetim; dokumentacionit të sjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk u konstatuan elementë të abuzimit me pozitën dominuese në tregun e produkteve përzierës me fara për prodhimin e bukëve dhe simiteve i ndarë në tre nën tregje dhe në tregun e produkteve të përdorura për ardhjen e brumit, majasë i ndarë në dy nën tregje, të parashikuara në nenin 9 të Ligjit Nr. 9121/2003.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 42 dhe nenin 43, pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 477, datë 12.10.2017

**Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i “Raportit të hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”.

**Baza Ligjore:** Nenet: 9, 24, germa d); 26, 43 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003); Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Raportit të hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

## VËREN SE:

### PROCEDURA E NDJEKUR

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrja “Albanian Stevedoring Company” sh.p.k, (këtu e vijim-ASC) kundrejt ndërmarrjeve: EMS APO; “German Albanian Logistic Agency” sh.p.k (referuara si “GALA”); si dhe shoqërisë “EMS Shipping&Trading” GmbH (referuara në vijim si - “EMS”), filluan procedurat për vlerësimin e ankesës në respektim të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Pas shqyrtimit të raportit mbi vlerësimin e ankesës së Shoqërisë ASC dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 42, pika 1, nenit 9 dhe nenit 24, (shkronja d), të Ligjit Nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 450, datë 28.02.2017 vendosi: hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se mund të ndodhemi përballë një situatë urgjence të

parashikuar në nenin 44 të Ligjit Nr. 9121/2003, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 (abuzimi me pozitën dominuese) të këtij Ligji. Bazuar në këtë vlerësim Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 451, datë 28.02.2017 vendosi marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, ndaj ndërmarrjes EMS APO.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: MTI, APD, EMS APO, GALA, ASC, Liburnet-1, Egnatia-1.

Në bazë të nenit 36, të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 92 Prot., datë 01.03.2017 “Autorizim Inspektorësh”, u kryen inspektime pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.

Komisioni i Konkurrencës gjithashtu, gjatë procedurës së hetimit paraprak, ka zhvilluar seanca dëgjimore me EMS APO (me kërkesë të kësaj ndërmarrjeje), me ankuesin ndërmarrjen ASC dhe me MTI.

## **TREGU PËRKATËS**

Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

- Tregu përkatës i produktit
- Tregu përkatës gjeografik

## **TREGU PËRKATËS I PRODUKTIT**

“Terminal Lindor Durrës” (TLD) është i përcaktuar si një nga facilitetet e portit të Durrësit që konsiston dhe përbëhet nga kalata nr. 10 dhe kalata nr. 11 dhe zonat dhe sheshet korresponduese të operacioneve, trafikut dhe të depozitimit pas këtyre kalatave dhe që do të zhvillohet në përputhje me masterplanin e Portit të Durrësit.

Referuar masterplanit të miratuar për Portin e Durrësit, Terminali Lindor, për shkak të karakteristikave të tij, është i destinuar për përpunimin e mallrave rifuxho. Shërbimi i përpunimit të mallrave gjenerale/përgjithshme, kryhet në Terminalin Perëndimor të Portit të Durrësit, gjithashtu ky shërbim, në bazë të Kontratës Koncesionare, lejohet të kryhet edhe në Terminalin Lindor.

Në bazë të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 450, Datë 28.02.2017, hetimi paraprak është hapur në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.

Referuara sa më sipër, tregu përkatës i produktit përfshin ofrimin e shërbimeve stivadore për mallrat rifuxho (minerale, qymyr, likuide (lëngje), etj) nga ndërmarrjet e licencuara për ngarkimin, shkarkimin, depozitimin, transportimin, përpunimin dhe aktivitete të tjera të lidhura me to.

## **TREGU PËRKATËS GJEOGRAFIK**

Bazuar në masterplanin e miratuar dhe kontratën koncesionare, përpunimi i ngarkesave rifuxho nga të gjithë operatorët stivadorë të licencuar/autorizuar kryhet pranë Terminalit Lindor të Portit Durrës, nga të cilat, ndërmarrja koncesionare EMS APO, operon vetëm pranë këtij Terminali.

Referuar sa më sipër, tregu përkatës gjeografik vlerësohet zona gjeografike e Terminalit Lindor të Portit të Durrësit.



## ANALIZA E TREGUT

Porti i Durrësit përbëhet nga 4 (katër) terminale, përkatësisht: Terminali i Trageteve; Terminali i Kontenierëve; Terminali Lindor dhe Terminali Perëndimor; si dhe facilitetet portale për çdo terminal. Në Portin e Durrësit përpunohen mallrat e përgjithshme, drithëra, kontenierë, tragete, minerale, etj.

Terminali Lindor, në bazë të kontratës së koncesionit, menaxhohet dhe administrohet nga ndërmarrja EMS APO, e cila është poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjitha infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali. Çdo përdorues porti për të marrë shërbimet nga ky terminal, duhet patjetër të ketë akses në infrastrukturën dhe facilitetet që ofron ky terminal.

Në bazë të licencave të lëshuara, 4 (katër) janë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e përpunimit të ngarkesave rifuxho dhe gjenerale në Portin e Durrësit. Nga të cilat, 3 (tre) stivadorë të licencuar nga APD e ofrojnë shërbimin e përpunimit të këtyre ngarkesave në Terminalin Lindor dhe Perëndimor, kurse koncesionari EMS APO e ofron këtë shërbim vetëm pranë Terminalit Lindor, ku është dhe poseduesi i të gjitha faciliteteve të këtij terminali.

### VLERËSIMI I POZITËS DOMINUESE

Koncesionari EMS APO është posedues dhe administrues i vetëm i infrastrukturës dhe faciliteteve të Terminalit Lindor, duke qenë 100% dominues në tregun e rrjedhës së sipërme (operim, menaxhim dhe administrim i infrastrukturës), gjithashtu ofron shërbime në tregun e rrjedhës së poshtme të përpunimit të ngarkesave (shërbime stivadore), gjë e cila e bën këtë ndërmarrje të integruar vertikalisht në të dy nivelet e tregut.

Koncesionari EMS APO është posedues dhe administrues i vetëm i infrastrukturës dhe faciliteteve të Terminalit Lindor të Portit Durrës, duke zotëruar 100% të pjesëve të këtij tregu, duke filluar nga marrja në dorëzim e terminalit (15 korrik 2013) për gjithë periudhën e koncesionit dhe në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e rrjedhës së sipërme (upstream market).

Nga vlerësimi i pozitës dominuese dhe pjesëve të tregut përkatës të shërbimit të ngarkim shkarkimit të mallrave rifuxho, në tregun gjeografik përkatës, zonën e Terminalit Lindor të Portit Durrës, ndërmarrja EMS APO, e cila zotëron 100 % të tregut të rrjedhës së sipërme, nga nëntori 2015 deri në shkurt 2017 zotëron gjithashtu 100% të tregut të rrjedhës së poshtme të ngarkim shkarkimit të mallrave rifuxho (stivadore) pranë këtij terminali, dhe në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e rrjedhës së poshtme (downstream market) të ofrimit të shërbimeve stivadore për mallrat rifuxho pranë Terminalit Lindor të Portit Durrës.

### Vlerësimi i Sjelljes së Ndërmarrjes EMS APO

Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes EMS APO, e integruar vertikalisht dhe me pozitë dominuese në të dy nivelet e tregut, është bazuar në raport me qëndrimet e saj ndaj konkurrentëve në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të mallrave rifuxho në Terminalin Lindor të Portit Durrës për periudhën hetimore.

Pas dhënies me koncesion të “Menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Terminalin Lindor në Portin e Durrësit” ndërmarrjes EMS APO, kjo ndërmarrje, me kërkesë të APD dhe MTI, ka lidhur marrëveshje për ofrimin e shërbimit stivador me ndërmarrjet ASC dhe Liburnet-1, kurse me ndërmarrjen Egnatia-1 nuk është arritur të nënshkruhet marrëveshje.

Nga krahasimi i dy kontratave të lidhura nga ndërmarrja EMS APO me ndërmarrjet stivadore ASC dhe Liburneti-1, rezulton se midis tyre ka ndryshime në kushtet kryesore siç janë: pjesa e fitimit në përqindje (%) dhe volumet e shërbimit në ton. Ndërmarrja EMS për ndërmarrjen stivadore ASC ka caktuar pjesën e pagesës prej 33% të tarifave përkatëse të përpunimit të çdo lloji ngarkese, ndërsa për ndërmarrjen Liburnet – 1 pjesa e pagesës në përqindje ndryshon sipas llojit të ngarkesave, konkretisht: 33% për ngarkesat Rifuxho dhe 39% për ngarkesa të lehta rifuxho dhe ngarkesat Gjenerale. Lidhur me volumet e shërbimit sipas kontratës me ndërmarrjen ASC palët marrin përsipër të sigurojnë shërbimet për një volum 650,000 ton në vit, ndërsa me ndërmarrjen Liburnet-1 volumi vjetor i shërbimeve lihet i papërcaktuar.

Ndërmarrja EMS APO nuk ka respektuar detyrimin e saj për lidhjen e kontratave me kushte të njëjta bashkëpunimi dhe jo-diskriminuese me kompanitë stivadore ASC dhe Liburnet-1 në Terminalin Lindor. Këto kontrata përmbajnë kushte të ndryshme për stivadorët nga ato të vendosura në kontratat/licencë me APD. Sipas kontratave të nën-kontraktimit stivadorët nuk mund të hyjnë drejtpërdrejt në marrëdhënie me përdoruesit e portit (klientin) por janë të detyruar të kryejë shërbimet vetëm me kërkesën e EMS-së. Sipas këtyre kontratave EMS rezulton të jetë operatori i vetëm me të cilin përdoruesit e portit duhet të komunikojnë për realizimin e shërbimeve dhe kryerjen e pagesës së tarifave të përpunimit, duke i kufizuar në këtë mënyrë klientit (përdoruesit të portit) të drejtën e përzgjedhjes së operatorit të tij të përpunimit.

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nëpërmjet shkresës Nr. 1164/3, Prot., datë 23.03.2015 sqaron se: "Çdo rast i përcaktimit, mbledhjes apo përdorimit të tarifave dhe përqindjeve të ndryshme nga ato që janë parashikuar në kontratën stivadore me APD, përbën moszbatim dhe shkelje të detyrimeve kontraktuale, konkretisht nenit 8.4, pika 1, dhe nenit 8.5."

Ndërmarrja Egnatia-1 rezulton se nuk ka hyrë në marrëdhënie kontraktore me ndërmarrjen EMS APO dhe për pasojë nuk ka ushtruar aktivitet në Terminalin Lindor që nga viti 2013, kohë në të cilën është lidhur edhe kontrata e Koncesionit. Kjo shoqëri nuk ka pranuar të bashkëpunojë me EMS APO, pasi, sipas saj, kushtet e kontratës së propozuar nga kjo e fundit përmbanin kushte të ndryshme nga kontrata/licencë e lidhur me APD.

Ndërmarrja EMS APO i ka ofruar ndërmarrjes Egnatia-1 kushte të ndryshme nga ato të kontratës/licencë duke e vendosur atë në gjendje të pafavorshme konkurrence me pasojë nxjerrjen nga tregu i ngarkim-shkarkimit të mallrave rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit. Një sjellje e tillë, e kryer nga një ndërmarrje me pozitë dominuese dhe e integruar vertikalisht në tregun përkatës, e cila ka detyrimin ligjor të kontraktojë me cilindo që kërkon një shërbim, i cili bën pjesë në objektin e veprimtarisë së saj, në zbatim të nenit 9, pika 2, gërma (a) dhe (c) të Ligjit Nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, me pasojë të rënda për konkurrencën në treg.

Nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes EMS APO në lidhje me rastet: Kurum, Antea Cement, Klosi, Dedja Shipping, "Nazlikiz", "AKIN", "HALIDE", "GRANDA" dhe "PORHOV", rezulton se kjo ndërmarrje, me pozitë dominuese dhe e integruar vertikalisht në të dy nivelet e tregut, ka penguar konkurrentët e saj në tregun e rrjedhës së poshtme (stivadore), ndërmarrjet ASC dhe Liburnet-1, që të ofrojnë shërbimin e përpunimit të mallrave/anijeve për përdoruesit e portit, duke ju refuzuar aksesin në facilitetet e infrastrukturës që disponon, gjë e cila, në bazë të nenit 9, pika 2, gërma (c) të Ligjit Nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes EMS APO, pasi i vendos ato në kushte të pafavorshme konkurrence.

Referuar analizës së tregut të shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, rezulton se sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese EMS APO, duke vendosur kushte të padrejta tregtimi dhe refuzuar aksesin në facilitetet e infrastrukturës që disponon ndaj ndërmarrjeve stivadore, në zbatim të nenit 9, pika 2, gërma (a) dhe (c) të Ligjit Nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, me pasojë të rënda për konkurrencën në treg.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 9, 24, (germa d); 26, 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EMS-Albanian Port Operator" SHPK, me NUIS L31804506A, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.
- II. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga dita e nesërme e nënshkrimit të Kontratës Koncesionare, datë 6 maj 2013, me objekt "Menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Terminalit Lindor në Portin e Durrësit", me palë "EMS Shipping & Trading GmbH" dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, deri më datë 28.02.2017, ditën e hapjes së hetimit paraprak;
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një)

muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 479, datë 26.10.2017

**Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i “Raportit të hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës”.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42 dhe neni 43 pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003). Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të Raportit të hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi raportin e hetimit paraprak,

## VËREN SE:

### PROCEDURA E NDJEKUR

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të monitorimit mbi tregun e distribucionit dhe shfaqjes së filmave në rrjetet e kinemave, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me Vendimin Nr. 466, datë 20.06.2017, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e distribucionit dhe shfaqjes së filmave në rrjetet e kinemave në Tiranë. Periudha e hetimit e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin e mësipërm është nga 01.01.2015 deri në 30.06.2017.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës, grupi i inspektimit, gjatë periudhës së hetimit ka kryer inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve “Empire” SHPK (Empire), “Millenium” SHPK (Millenium) dhe “Cineplexx” SHPK (Cineplexx) .

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121/2003, është kërkuar informacion nga ndërmarrjet: Empire, Millenium, Cineplexx dhe “D & L Administim” SHPK.

### TREGU PËRKATËS

Përkufizimi i tregut nënkupton dallimin midis filmave të rinj të shfaqur ekskluzivisht në kinema, të njohur si "filma first run" (premierë) dhe filma të tjerë që rishfaqen për të disatën herë, si dhe shqyrtimin e sektorëve të ndryshëm të shfaqjes së filmit: televizion, video dhe kinema. Filmata premierë shfaqen ekskluzivisht në kinema dhe filmat që nuk janë më premierë mund të shfaqen nga secili nga të tre sektorët, ose madje edhe nga të tre

në të njëjtën kohë.

Tregu përkatës i produktit përfshin tregun e shfaqjes së filmave në kinema.

Nga analiza e konkurrencës rezulton se për filmat premierë, televizioni dhe video nuk janë zëvendësues të afërt, ndërsa për filmat jo premierë ata mund të konsiderohen si zëvendësues të afërt, përderisa konsumatori ka mundësi zgjedhjeje.

Edhe për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës mund të themi se produktet e tregut përkatës të produktit janë të zëvendësueshëm pasi shfaqësit e filmave mund të përshtatin llojin e filmave të shfaqur (aksion, komedi, dramë, romancë, animacion) në varësi të kërkesës për këto produkte, pa qenë nevoja për përpjekje të shtuara (p.sh. pa patur nevojë për rregullime teknike) dhe pa kosto shtesë. Ky faktor përbën një indikator tjetër për të konkluduar se të gjithë filmat i përkasin të njëjtit treg, pavarësisht kategorisë së veçantë të tyre (aksion, komedi, etj.).

Produktet e tregut përkatës janë homogjene dhe ekziston transparencë informacioni për sa i përket çmimeve, ofertave, orareve, etj., duke i siguruar konsumatorit mundësinë e informimit pa kosto.

Duke u bazuar në zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës për tregun gjeografik, sallat e Shkodrës dhe Korçës konsiderohen si të pazëvendësueshme me sallat e Tiranës për shkak të largësisë gjeografike, pasi nuk është e mundshme të arrihen në të njëjtën kohë nga konsumatorët. Prandaj tregu përkatës gjeografik në rastin tonë përfshin qytetin e Tiranës.

## STRUKTURA E TREGUT

Sipas treguesve relativë të pjesëve të tregut në bazë të të ardhurave totale të realizuara nga shitja e biletave, vërejmë se ndërmarrja Cineplexx zotëron pjesën më të madhe të tregut të shfaqjes së filmave me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut me tendencë rritje, përkatësisht 71.8 % për vitin 2015, 72.26 % për vitin 2016 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2017 vërehet një tendencë rritje në 74.52 %. Ndërmarrja Cineplexx është një kinema multipleks dhe zotëron teknologji të re, Real 3D.

Ndërmarrja e dytë për nga pjesa e tregut është Empire, e cila zotëron 22.7 % të tregut për vitin 2015, 17.59 % për vitin 2016 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2017, 16.03 % të tregut, pra ka një tendencë rënie të pjesëve të tregut. Ndërsa ndërmarrja Millenium zotëron 5.5 % të tregut për vitin 2015, 10.14 % për vitin 2016 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2017, 9.03 % të tregut<sup>1</sup>, duke dyfishuar pjesën e tregut në vitin 2016 dhe duke rënë lehtësisht në vitin 2017.

Sipas treguesve relativë të pjesëve të tregut në bazë të numrit të biletave të shitura, vërejmë se ndërmarrja Cineplexx Albania zotëron pjesën më të madhe të tregut, përkatësisht 63.17 % për vitin 2015, 62.44 % për vitin 2016 dhe 62.8 % për 6-mujorin e parë të vitit 2017. Ndërmarrja e dytë për nga pjesa e tregut është Empire, e cila zotëron 29.38 % të tregut për vitin 2015, 23.76 % për vitin 2016 dhe 25.04 % të tregut për 6-mujorin e parë të vitit 2017. Ndërsa ndërmarrja Millenium zotëron 7.45 % të tregut për vitin 2015, 13.81 % për vitin 2016 dhe 12.16 % të tregut për 6-mujorin e parë të vitit 2017.

Në termat e strukturës së tregut për nga treguesi i të ardhurave nga shitja e biletave dhe numri i biletave të shitura, rezulton se në tregun e shfaqjes së filmave operojnë vetëm tre ndërmarrje. Tregu i shfaqjes së filmave paraqitet me një strukturë oligopolistike me vetëm tre ndërmarrje, ku ndërmarrja më e madhe, me pjesë të konsiderueshme është Cineplexx me rreth 72 % të tregut nga të ardhurat e realizuara nga shitja e biletave dhe rreth 62% nga numri i biletave të shitura. Nisur nga struktura e tregut treguesi i përqendrimit në vitin 2016 rezulton të jetë shumë i lartë, përkatësisht 5,634 për sa i përket të ardhurave të realizuara nga shitja e biletave dhe 4,653 sipas numrit të biletave të shitura.

Duke marrë në konsideratë kriterin e pengesave të hyrjes në tregun përkatës rezulton se ka barriera ekonomike për t'u futur në treg, por referuar legjislacionit që rregullon tregun përkatës, nuk ekzistojnë barriera ligjore për

<sup>1</sup> Për vitin 2016 pjesët e tregut i përkasin ndërmarrjes IDA që sot përfaqësohet nga Millenium. Ndërsa për vitin 2017 janë mbledhur pjesët e tregut të ndërmarrjeve IDA dhe Millenium, meqenëse Millenium e ka filluar aktivitetin në 13.03.2017.

futjen në treg të ndërmarrjeve të reja.

Duke marrë parasysh: pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjes dhe të konkurrentëve të tjerë; pengesat në hyrje në tregun përkatës; fuqinë ekonomike financiare; karakteristikat e tjera të tregut përkatës si homogjenitetin e produkteve; transparencën e tregut; kapacitetet e lira dhe risitë; bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, ndërmarrja Cineplexx ka pozitë dominuese në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës.

## **ANALIZA E SJELLJES SË NDËRMARRJES CINEPLEXX**

### **Abuzimi me Pozitën Dominuese**

Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes me pozitë dominuese Cineplexx, nëse ka abuzuar me pozitën e saj nëpërmjet vendosjes së çmimeve të padrejta të tregtimit, është marrë në analizë: rezultati financiar (fitueshmëria e ndërmarrjes); krahasimi i çmimeve me rajonin dhe rrjetin e Cineplexx në Ballkan (benchmark); si dhe krahasimi kosto - çmim shitje.

Rezultati financiar (humbja) i ndërmarrjes Cineplexx për vitin 2015 është -53,270,785 lekë, ndërsa për vitin 2016 rezultati financiar (humbja) është -27,925,505 lekë.

Nga krahasimi i çmimit mesatar të biletave të shfaqjes së filmit në kinema (benchmark rajonal) rezultoi se krahasuar me vendet e rajonit si Podgorica, Shkupi, Beogradi, Kroacia dhe Zagrebi, Shqipëria e ka çmimin e biletës më të ulët se mesatarja e çmimit të biletës së rajonit dhe pak më të ulët se çmimi i biletave të rrjetit Cineplexx në rajon, çfarë tregon se në Shqipëri ndërmarrja Cineplexx nuk operon nëpërmjet vendosjes së çmimeve të larta, në kushtet kur kemi një ndërmarrje me pozitë dominuese.

Nga krahasimi i çmimeve që aplikojnë 3 (tre) ndërmarrjet, rezulton se ndërmarrja Cineplexx aplikon çmime më të larta se dy ndërmarrjet e tjera për filmat që shfaqen në 3D, kurse dy ndërmarrjet e tjera aplikojnë të njëjtin çmim bilete për shfaqjen në 2D dhe 3D. Kjo vjen si rezultat i teknologjisë më të avancuar që i përgjigjet standardit të gjithë grupit Cineplexx, si dhe investimeve dhe risive të sjella nga kjo ndërmarrje.

Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese, Cineplexx, në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës, bazuar në rezultatin financiar të ndërmarrjes, krahasimi me çmimet e rajonit (benchmark rajonal) dhe çmimet e rrjetit Cineplexx në rajon, si dhe çmimet me konkurrentët e tjerë në vend, rezulton se nuk vërehen shenja të abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes Cineplexx, në kuptim të nenit 9, të Ligjit Nr. 9121/2003.

Praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit.

Megjithëse nuk vërehen shenja të kufizimit të konkurrencës, në tregun përkatës ushtron veprimtari një ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme dhe me fuqi tregu në rritje, Cineplexx, prandaj është e nevojshme mbikëqyrja e sjelljes së saj në vazhdimësi për të analizuar kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg në kuptim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9121/2003.

### **Praktikat e Bashkërenduara**

Gjatë procedurave hetimore u kryen inspektime (Dawn Raids) në ambientet e ndërmarrjeve nën hetim për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një bashkëpunimi të mundshëm midis konkurrentëve, ose të një praktike përjashtuese, por gjatë këtyre inspektimeve nuk u gjet asnjë provë direkte apo gjurmë komunikimi midis tyre.

Bazuar në analizën e strukturës së tregut rezulton se tregu është shumë i përqendruar, me një ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme tregu (Cineplexx), por konkurenti më i afërt, IDA ka dyfishuar pjesën e tregut në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015. Gjithashtu ndërmarrja Cineplexx dhe ndërmarrjet e tjera kanë rritur volumin për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, duke mos patur kufizim të tregut për nga numri i biletave të



shitura. Në një treg me strukturë heterogjene, me kapacitete vendesh të ndryshme, me teknologji më të avancuar është e vështirë që ndërmarrjet të koordinojnë sjelljet e tyre.

Nga çmimi i shitjes së biletave, pas pagesës së TVSH (20%) dhe QKK (1%), 50% i shkon distributorit të filmit dhe 50% i ngelet ndërmarrjes. Në strukturën e këtij çmimi, 30% zënë shpenzimet për paga dhe pjesa tjetër shkon për qira, mirëmbajtje, amortizim, etj. Pra, 61% e çmimit të biletës shkon për pagesën e TVSH-së, QKK-së dhe distributorëve, e cila është një përqindje e konsiderueshme fikse e kostos së biletës dhe është e njëjtë për të gjitha ndërmarrjet.

Nga analiza e çmimeve të biletave të aplikuara nga ndërmarrjet, rezulton se ndërmarrjet aplikojnë çmime të ndryshme në varësi të ditëve dhe orarit të shfaqjes së filmave, si dhe teknologjisë së shfaqjes së tyre (2D/3D). Ndërmarrja Cineplexx aplikon çmime më të larta se dy ndërmarrjet e tjera për filmat që shfaqen në 3D, kjo vjen si rezultat i teknologjisë më të avancuar që i përgjigjet standardit të gjithë grupit Cineplexx, si dhe investimeve dhe risive të sjella nga kjo ndërmarrje. Edhe në rastet kur çmimi i aplikuar është i njëjtë (500 Lekë), kjo vjen si rezultat i transparencës së informacionit dhe strukturës oligopolistike të tregut përkatës dhe jo si rezultat i bashkëveprimit midis ndërmarrjeve.

Është vlerësuar treguesi i performancës (fitimet) si një nga evidencat rrethore që vijnë në ndihmë të metodologjisë për provimin e kartelit me evidenca indirekte ku kanë rezultuar fitime negative.

Duke qenë se filmat prodhohen dhe dalin në tregun ndërkombëtar në një kohë të caktuar, një veçanti e këtij tregu është se dita e premierës së filmit është e njëjtë për kinematë tona me ato ndërkombëtare, si dhe filmat që shfaqen janë të ngjashëm nga një kinema në tjetrën.

Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, si pjesët e tregut, volumet e shitjeve, krahasimi i çmimeve të shitjes së biletave midis konkurrentëve dhe rezultati financiar negativ, rezulton se nuk vërehen shenja të koordinimit të sjelljes (marrëveshjes) midis ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës, në kuptim të nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003. Pra mund të themi që nuk jemi para rastit të një kufizimi të konkurrencës për marrëveshje, apo praktikë të bashkërenduar.

Si përfundim, pas vlerësimit të të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurës hetimore si: dokumentacionit të administruar gjatë inspektimeve; dokumentacionit të dorëzuar nga ndërmarrjet nën hetim; analizave ekonomike të kryera sipas metodologjisë së përcaktuar në raport, nuk u konstatuan shenja të kufizimit të konkurrencës, si përsa i përket marrëveshjes së ndaluar (praktika të bashkërenduara) ashtu edhe abuzimit me pozitën dominuese, sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 9, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, por në treg ushtron veprimtari një ndërmarrje me pozitë dominuese sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 9121/2003.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 28, nenin 42 dhe nenin 43, pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

- I. Për të analizuar kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, ndërmarrja me pozitë dominuese “Cineplexx” SHPK, çdo 6 muaj, përkatësisht brenda datave 10 Prill dhe 10 Tetor të çdo viti, duhet të dërgojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacion mbi çmimet e shitjes së biletave, kostot përkatëse dhe brenda datës 10 Prill të dërgojë një kopje të pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm së bashku me shënimet shpjeguese të pasqyrave analitike financiare.
- II. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 4 dhe nenit 9, të Ligjit Nr. 9121/2003.



III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 481, datë 16.11.2017

**Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror.**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 16.11.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Vlerësimi i Vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 161, datë 12.10.2017 “Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror” dhe draft-licencës përkatëse;

**Baza ligjore:** Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të informacionit në lidhje me miratimin e licencës së aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror dhe draft-licencës përkatëse:

### VËREN SE:

Enti Rregullator i Energjisë, me anë të shkresës Nr. 684 prot, datë 20.10.2017, ka dërguar për marrje mendimi Vendimin e Bordit të ERE Nr. 161, datë 12.10.2017, “Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”.

Vendimi i ERE-s është hartuar në mbështetje të nenit 16 të ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; seksionit II, neni 22, 23 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror” si dhe neni 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016.

Në draft – licencën e publikuar është përcaktuar se Enti Rregullator i Energjisë e jep Licencën e Shpërndarjes së Gazit Natyror, për kryerjen e aktivitetit të Shpërndarjes së Gazit Natyror në një zonë gjeografike të caktuar dhe një personi apo subjekti të caktuar. Licenca së bashku me kushtet e saj, do të ketë efekt për një periudhë 30 vjeçare.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i draft-licencës së publikuar u konstatua se:

— Në parashikimet e pikës 4.6 të draft-licencës, ku përcaktohen investimet që do të kryejë i licencuari, nuk janë të qarta përgjegjësitë e të licencuarit në rast të mos përmbushjes së detyrimeve për kryerjen e investimeve të planifikuara për rrjetin e shpërndarjes. Realizimi i investimeve të planifikuara është një element shumë i rëndësishëm, që ndikon në cilësinë e shërbimit të shpërndarjes apo edhe në aksesin e përdoruesve të rrjetit, për tregun e gazit natyror. Nëse kapacitetet e rrjetit të shpërndarjes, impiantet e përpunimit, apo pikat lidhëse nuk do të përballojnë kërkesat e tregut sipas planifikimeve, atëherë mund të

krijohen probleme dhe shqetësime për funksionimin e tregut, aktorëve të tregut, konkurrencën në treg, përfshirjen e kostove të investimeve të planifikuara në tarifën e shpërndarjes, etj.

Investimet në sistemin e shpërndarjes së gazit natyror, i cili supozohet të jetë një operator i vetëm në një zonë gjeografike të caktuar, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e sistemit të shpërndarjes dhe të tregut të gazit natyror, megjithëse modeli i tregut të gazit natyror ende nuk është miratuar.

Në draft-licencë nuk është parashikuar raportimi nga i licencuari dhe monitorimi periodik nga ERE, për realizimin e investimeve të planifikuara dhe të miratuara.

- Në parashikimet e pikës 4.10 përcaktohet ndër të tjera se “.....në qoftë se i Licencuari është një kompani vertikalisht e integruar në sektorin e gazit natyror, ai do t'i ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktiviteteve të prodhimit, Transmetimit, Shpërndarjes, operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, Tregtimit, Furnizimit dhe operimit në impiantet e GNL-së; në mënyrë të tillë që të provojë në mënyrë të besueshme pranë ERE-s dhe çdo autoriteti tjetër, të ngarkuar me ligj, se nuk ka ndër-subvencionime, nuk cënohet konkurrenca dhe nuk ka diskriminim”. Por, për kompanitë vertikalisht të integruara, duhet të merren në konsideratë gjithë parashikimet e nenit 51 të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” si edhe parashikimet e nenit 26 “Unbundling of distribution system operators” të direktivës 73/2009/EC të datës 13.07.2009 “Lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”.
  - Në draft-licencën e paraqitur nuk është parashikuar detyrimi i të licencuarit për të publikuar të dhënat e rrjetit të shpërndarjes për përdoruesit e tregut, të cilat japin informacione të vlefshme për operatorët e tregut dhe përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes, në tregun e gazit natyror, të tilla si kapacitetet e rrjetit të shpërndarjes në zonën përkatëse, hapësirat e depozitimit, të përpunimit, pikat lidhëse me rrjetin e transmetimit, pikat hyrëse dhe dalje në rrjet dhe çdo informacion tjetër për tregun.
- Përveç sa më sipër, edhe modeli i tregut të gazit natyror ende nuk është miratuar dhe tregu i gazit natyror është në fazat fillestare të zhvillimit të tij.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

#### **I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë:**

- Në draft-licencën e operatorit të shpërndarjes së Gazit Natyror të parashikohet raportimi i vazhdueshëm nga ana e të licencuarit dhe monitorimi i vazhdueshëm mbi realizimin e investimeve të planifikuara duke parashikuar sanksione në rast mosrealizimi.
- Në parashikimet e pikës 4.10 të draft-licencës, lidhur me kompanitë vertikalisht të integruara, të përfshihen në draft – licencë të gjithë parashikimet ligjore të nenit 51 të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si edhe parashikimet e nenit 26 “Unbundling of distribution system operators” të direktivës 73/2009/EC, datë 13.07.2009 “Lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”.
- Të përcaktohet në draft licencë, detyrimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së gazit natyror, që të publikojë të gjithë të dhënat lidhur me tregun e shpërndarjes, të cilat ndihmojnë operatorët e tregut dhe përdoruesit e rrjetit, për të patur gjithë informacionin e nevojshëm për rrjetin e shpërndarjes në tregun e gazit natyror.

#### **II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 482, datë 16.11.2017

**Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të furnizimit të gazit natyror.**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 16.11.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Vlerësim i vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 162, datë 12.10.2017 “Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës për aktivitetin e furnizimit të gazit natyror” dhe draft-licencën përkatëse;

**Baza ligjore:** Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të informacionit në lidhje me miratimin e licencës për aktivitetin e furnizimit të gazit natyror dhe draft-licencën përkatëse:

### VËREN SE:

Enti Rregullator i Energjisë, me anë të shkresës Nr. 684 prot., datë 20.10.2017, ka dërguar për marrje mendimi vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 162, datë 12.10.2017 “Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës së aktivitetit të furnizimit të gazit natyror”.

Vendimi i ERE-s është hartuar në mbështetje të nenit 16 të ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, seksionit II, neni 22, 23 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016.

Në draft-licencën e publikuar janë përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat dhe detyrimet e të licencuarve për aktivitetin e furnizimit me gaz natyror. Në draft-licencë përcaktohet se Enti Rregullator i Energjisë e jep këtë Licencë, për të kryer veprimtarinë e furnizimit të Gazit Natyror dhe/ose të Furnizuesit të mundësisë së fundit ose/dhe për të përmbushur detyrimin e shërbimit publik/universal.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i draft-licencës konstaton se:

- Licencimi i aktivitetit të furnizimit duhet të jetë konform me rolin, funksionin dhe parashikimet e operatorit të furnizimit, sipas Modelit të Tregut të Gazit Natyror, i cili është ende i pa miratuar;
- Licencimi i aktivitetit të furnizimit duhet të jetë konform dhe në përputhje me strategjinë, politikat dhe programet për mbikëqyrjen e sigurisë së furnizimit me gaz natyror, parashikuar në nenet 5, 6 dhe 10 të Ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;

- Në draft-licencë nuk është përcaktuar afati brenda të cilit mund të ndryshohet furnizuesi, kështu në pikën 3 (2) (a) të draft-licencës është përcaktuar mundësia e ndryshimit të furnizuesit, por pa vendosur afat se sa mund të zgjasë perioda nga kërkesa për ndryshim furnizuesi deri në aprovim të kërkesës, pasi mos përcaktimi i afatit mund të krijojë vonesa dhe probleme për konsumatorin apo marrësin e shërbimit;
- Në draft-licencë nuk është parashikuar se si do të veprohet me faturimin e sasisë së gazit natyror të konsumuar, pra duhet parashikuar fatura e detajuar apo transparenca në faturim. Gjithashtu nuk është parashikuar publikimi i të dhënave mbi tregun, operatorëve të tregut dhe historikun e furnizimit nga operatori i shpërndarjes së Gazit Natyror, sipas parashikimeve ligjore të nenit 3(12) të Direktivës 73/2009/EC të datës 13.07.2009 “Lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”;
- Në draft-licencë nuk është parashikuar regjistrimi i dyfishtë i faturave të shpenzimeve për aktivitetet e të licencuarit, pra nëse operatori i furnizimit është i licencuar edhe në aktivitete të tjera, faturat që pasqyrojnë shpenzimet e kryera duhet të jenë qartësisht të ndara dhe të evidentueshme për çdo aktivitetet që kryen operatori i licencuar, si edhe duhet parashikuar ndarja e pronësisë për çdo aktivitet të licencuar.

Përveç sa më sipër, edhe modeli i tregut të gazit natyror ende nuk është miratuar, dhe tregu i gazit natyror është në fazat fillestare të zhvillimit të tij.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

#### **I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë:**

- Licencimi për veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror, të kryhet pasi/ose paralelisht me miratimin e Modelit të Tregut të gazit Natyror, të parashikuar edhe në nenin 88 të Ligjit “Për Sektorin e Gazit Natyror”, në mënyrë që të dalin qartë kushtet e operimit, roli dhe funksioni i operatorit apo operatorëve të furnizimit;
- Në pikën 3 (2) (a) të draft-licencës të përcaktohet afati i ndryshimit të furnizuesit “të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, jo më shumë se 3 javë nga fillimi i procedurës për ndryshim të furnizuesit” dhe sipas parashikimeve ligjore të nenit 3(6)(a) të Direktivës 73/2009/EC të datës 13.07.2009 “Lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”;
- Në pikën 3.4 të draft-licencës të shtohet një paragraf ku të përcaktohet: “I licencuari i ngarkuar sipas ligjit me detyrimin për sigurimin e shërbimit të furnizimit me gaz natyror u siguron klientëve dhe ndërmarrjeve të gazit të dhëna mbi tregun e gazit natyror, konsumin e gazit natyror, duke i publikuar njëkohësisht këto të dhëna, të cilat janë të vlefshme për operatorët e tregut” sipas parashikimeve ligjore të nenit 3(12) të Direktivës 73/2009/EC të datës 13.07.2009 “Lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”;
- Në pikën 4 të draft-licencës të parashikohet ndarja e pronësisë në rast se operatori është ndërmarrje vertikalisht e integruar;
- Në pikën 4.1 të shtohet paragrafi: “faturat e shpenzimeve për çdo aktivitet të të licencuarit të jenë lehtësisht të dallueshme se cilit aktivitet i përket, pra faturat të kenë shenja dalluese të qarta sipas përkatësisë së aktivitetit të licencuara që janë përdorur, me qëllim që të shmangen mbivendosjet e shpenzimeve apo regjistrimet e dyfishta, për aktivitetet e të licencuarit”.

#### **II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 483, datë 16.11.2017

**Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të tregtimit të gazit natyror.**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 16.11.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Vlerësimi i vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 163, datë 12.10.2017 “Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror” dhe draft-licencës përkatëse.

**Baza ligjore:** Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të informacionit në lidhje me miratimin e licencës së aktivitetit të tregtimit të gazit natyror dhe draft-licencës përkatëse:

### VËREN SE:

Enti Rregullator i Energjisë, me anë të shkresës Nr. 684 prot, datë 20.10.2017, ka dërguar për marrje mendimi vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 163, datë 12.10.2017 “Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror”.

Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 163, datë 12.10.2017 është hartuar dhe ka filluar procedurën për miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, seksionit II, neni 22, 23, të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016.

Në draft-licencën e publikuar janë parashikuar kushtet për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, detyrimet e të licencuarit, kontrollin mbi performancën e veprimtarisë së licencuar, heqjen e licencës, situatat e emergjencës, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të drejtën për apelim, bazuar në seksionin II, neni 22, 23 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentit të draft-licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, konstatohet se:

- Kushtet dhe veprimtaria e të licencuarit për tregtim të gazit natyror duhet të përputhen me parashikimet e Modelit të Tregut të Gazit Natyror, i cili ende nuk është miratuar;
- Në draft – licencën e paraqitur nuk është i qartë parashikimi për tregun primar dhe tregun sekondar, të cilët janë parashikuar në nenin 4 (109) (110) dhe nenin 84(1)(2)(3)(4), të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e

Gazit Natyror”, si dhe roli dhe funksioni i operatorit për aktivitetin e tregtimit në Modelin e Tregut të Gazit Natyror;

- Në draft-licencë nuk është parashikuar afati i vlefshmërisë së licencës, sipas parashikimeve të nenit 23(1)(a) të Ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;
- Në pikën 3.6.1 të draft-licencës nuk është parashikuar mbajtja e llogarive të ndara për gjithë aktivitetet e licencuara të operatorit, pra të përcaktohet që: “i licencuari duhet të ketë llogari të veçanta për çdo aktivitet.

Duke marrë në konsideratë që tregu i gazit natyror është një treg që sapo ka filluar të zhvillohet, përcaktimi i rolit, funksionit dhe kushteve të operatorit/operatorëve për zhvillimin e aktivitetit të tregtimit, sipas niveleve të tregut është shumë i rëndësishëm për konkurrencën dhe eficientësinë në treg.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f) dhe 69 e 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

#### **I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë:**

- Licencimi i aktivitetit të tregtimit të kryhet pasi/ose paralelisht me miratimin e Modelit të Tregut të Gazit Natyror, të parashikuar në nenin 88 të ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, mbi bazën e të cilit do të përcaktohen nivelet e tregtimit të Gazit Natyror;
- Në draft – licencë duhet të përcaktohet qartë roli dhe funksioni i tregut primar dhe tregut sekondar, tregut me shumicë dhe tregut me pakicë, sipas parashikimeve të nenit 4 (109) (110) dhe nenit 84(1)(2)(3)(4), të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe roli dhe funksioni i operatorit që do të kryejë aktivitetin e tregtimit në Modelin e Tregut të Gazit Natyror.
- Në draft-licencë duhet të përcaktohet afati i vlefshmërisë së licencës, të parashikuar në nenin 23 pika 1(a) e Ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;

Në pikën 3.6 të draft-licencës të parashikohet mbajtja e llogarive të ndara për gjithë aktivitetet e licencuara të operatorit”.

#### **II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**



## VENDIM

Nr. 488 datë 05.12.2017

### **Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2017 shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i Relacionit mbi tregun e grumbullimit të duhanit në zonën e Dumresë/Belshit;

**Baza Ligjore:** Neni 24 (shkronja d), 26 dhe 42 (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”. Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Relacionit mbi tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit, hartuar nga Sekretariati,

### **VËREN SE:**

Nisur nga disa artikuj të publikuar në median e shkruar dhe vizive në datat 22-24 Nëntor 2017, është konstatuar përsëri se ndërmarrja Mika Korça Sha, si grumbulluesi kryesor në vend, nuk ka shlyer kultivuesit e duhanit në zonën e Belshit/Dumresë. Kultivuesit e Belshit ankohen se kanë shuma të mëdha parash pa marrë, edhe pse kanë kontratë me këtë ndërmarrje. E njëjta situatë është dhe për kultivuesit e zonës së Shkodrës dhe Korçës.

Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar procese monitorimi dhe hetimi në këtë treg, dhe së fundmi me Vendimin Nr. 438, datë 05.10.2016, ka vendosur t'i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë:

- Marrjen e masave për hapjen e tregut të grumbullimit të duhanit të prodhuar në vend për të nxitur zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg;
- Asistencën e specialistëve të Ministrisë së Bujqësisë gjatë procesit të kategorizimit të duhanit sipas cilësisë dhe vendosjes së çmimeve përkatëse të përcaktuara në kontratat midis palëve gjatë grumbullimit në stacionet e caktuara në vend;
- Monitorimin e realizimit të pagesave nga ana e ndërmarrjes Mika Korça Sha, brenda afateve të parashikuara në kontratën e lidhur nga kjo ndërmarrje me fermerët.

Megjithatë, referuar njoftimeve në media, situata në treg mbetet e njëjtë, pra shoqëria ka rreth 6 muaj që nuk

shlyen kultivuesit për prodhimin e dy viteve të fundit 2015-2017, në zonën e Belshit/Dumresë, e cila është zona më e madhe e prodhimit të duhanit në vend.

Shoqëria “Mika Korça” Sha është themeluar si person juridik me vendimin Nr.4781, Datë 07.06.1994 të Regjistrimit Tregtar e krijuar me dy ortakë, pala shqiptare dhe pala greke që zotërojnë aksionet e tyre me një kapital fillestar, përkatësisht 37.98% nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës dhe 62.02% Leaff Tabacco A.Michailides S.A.

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është grumbullimi, përpunimi dhe eksporti i duhanit. Ky produkt grumbullohet kryesisht në zonat Elbasan, Fier, Lushnje, Berat, Pogradec, Korçë etj. si zona më të përshtatshme për prodhim duhani të llojit Katerin, Samsun, Llovine, ku grumbullimin më të madh e kap zona Elbasan me 76%, zona Berat me 18% dhe zona Korçë-Pogradec me 6%.

Ndërmarrja “MIKA KORÇA” operon me anë të kontratave paraprake me fermerët në kultivimin e duhanit. Këto kontrata të prodhimit dhe blerjes së duhanit të papërpunuar përcaktojnë qartë sasinë që duhet të prodhojë fermeri sipas cilësisë së përcaktuar, si dhe çmimet përkatëse.

Në territorin e RSH-së nuk ekziston asnjë fabrikë e cila mund të përpunojë dhe të realizojë procesin e plotë të ambalazhimit të cigareve me destinacion klientin fundor. Në këto kushte e vetmja mundësi për produktin duhan është eksporti, proces që realizohet nga ndërmarrjet grumbulluese të duhanit, kryesisht ndërmarrjes “MIKA KORÇA” Sh.a, si ndërmarrja kryesore në vend me një pozicion dominant në tregun e blerjes së duhanit në vend.

Pozicioni që ndërmarrja Mika Korça sh.a ka në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit të prodhuar në vend, si ndërmarrja kryesore e cila grumbullon duhan me destinacion eksportin e këtij produkti, fuqia që kjo ndërmarrje ka për vendosjen e çmimeve të blerjes, si dhe sjellja e saj e vazhdueshme kundrejt fermerëve, përbëjnë indicio se mund të jemi para një abuzimi të mundshëm me pozitën dominuese të kësaj ndërmarrjeje në treg, në kuptim të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 8 dhe 9, nenit 24, shkronja d, dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.
  - II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 01/06/2016 deri në 30/11/2017;
  - III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
  - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 490 datë 20.12.2017

### Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 20.12.2017 shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi vlerësimin e ankesës ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines.

**Baza Ligjore:** Nenet: 8, 9, 24, germa d); 26, 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003); Neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”; Neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”; Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

### VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet formularit të ankesës Nr. 423 Prot., datë 20.10.2017, kanë paraqitur ankesën e tyre disa pasagjerë, lidhur me sjelljen e shoqërisë ajrore Austrian Airlines.

Sipas ankuesve kjo kompani ka ndryshuar itinerarin e udhëtimit dhe orarin e tij në momentin e fundit kur pasagjerët janë paraqitur në aeroport, pa ndonjë paralajmërim paraprak. Gjithashtu, pavarësisht se rezervimi dhe prerja e biletës është bërë për të fluturuar me avion të shoqërisë Austrian Airlines, kjo shoqëri i detyron udhëtarët të fluturojnë në itinerare të tjera me avionë të linjave të tjera, duke mos marrë shërbimin e paguar.

Lidhur me ankesat e mësipërme, më datë 17.11.2017 në ambientet e Autoritetit të Konkurrencës është mbajtur takim me një prej ankuesve, i cili deklaroi se në ditën e nisjes në aeroportin ndërkombëtar “Tirana International Airport” (TIA) u njoftuam që 40 udhëtarë, të cilët ishin prezentë në aeroport, nuk mund të udhëtonin, pasi nuk kishte vende avioni.

Ndërmarrja Austrian Airlines operon e vetme në tregun e transportit ajror të udhëtarëve në linjën Tiranë – Vjenë dhe anasjelltas.

Referuar sa më sipër, duke pasur parasysh ankesën e depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, pozicionin e ndërmarrjes Austrian Airlines, e cila operon e vetme në linjën direkte Tiranë – Vjenë dhe anasjelltas, si dhe fuqinë që kjo ndërmarrje ka për vendosjen e kushteve të tregtimit, mund të jemi para një kufizimi të mundshëm të konkurrencës nga kjo ndërmarrje në treg, në kuptim të nenit 9, të Ligjit Nr. 9121/2003.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 9, 24, (germa d); 26, 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines.
  - II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2017 deri në 31 Dhjetor 2017;
  - III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
  - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 491, datë 28.12.2017

### Për hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi ankesën e ndërmarrjes “Skenderi G” SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet: 8, 9, 24, germa d); 26, 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003); Neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”; Neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”; Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

#### VËREN SE :

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja Skenderi G SHPK ka depozituar ankesën Nr. 169 Prot., datë 21.11.2017, lidhur me shërbimin e mirëmbajtjes së kasave fiskale për karburantet, për të cilin ka një kontratë me ndërmarrjen “AE Distribution” SHPK (AED).

Sipas ankuesit, nga ndërmarrja AED në mënyrë të njëanshme është njoftuar që për shkak të një detyrimi të prapambetur referuar Kontratë Shitje për Pajisje Fiskale që në vitin 2010 nuk do të ofrohet asnjë shërbim i kërkuar për asistencë dhe mirëmbajtje, gjë e cila ka dëmtuar procesin e shitjes së karburantit, duke qenë se Kasat Fiskale dhe distributorët janë në regjim automatik në bazë të parimit “Pa kupon nuk ka karburant”.

Bashkëngjitur ankesës, është depozituar dhe një ankesë datë 15.11.2017, të disa ndërmarrjeve të tregtimit të karburantit, lidhur me problematikën me shoqëritë e autorizuar të pajisjeve fiskale AED dhe “DAISY ETM”, të cilat kanë marrë përsipër për të ofruar të gjitha shërbimet e shoqërisë “CKV NOKI ALBANIA” SHPK, për shkak se kësaj shoqërie, nuk ju rinovua Autorizimi nga ana e Ministrisë së Financave. Sipas kësaj shkrese, ndërmarrjet shprehen se gjenden në kushtet e mos ofrimit të shërbimit të furnizimit me karburant të klientit fundor, sepse është mbushur memoria fiskale në pajisjen fiskale dhe duhet zëvendësuar menjëherë nga shoqëria që ofron këtë shërbim.

Mosofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale që përdoren për tregtimin e karburanteve sjell mos ofrimin e shërbimit të furnizimit me karburant për klientin fundor nga ankuesi dhe nga ndërmarrjet e tjera të tregtimit me pakicë të karburanteve, pasi, sipas VKM 781/2007 dhe UMF Nr. 16/2010, përcaktohet se

furnizimi me karburant duhet të jetë i lidhur saktësisht me regjistrimin e shitjeve dhe duhet të punojë nën rregullin e detyrueshëm “Pa kupon tatimor, s’ka karburant”.

Referuar sa më sipër, duke pasur parasysh ankesën e depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe pozicionin e ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve, të cilat janë të vetme për ofrimin e këtij shërbimi, mund të jemi para një kufizimi të mundshëm të konkurrencës nga këto ndërmarrje në treg, në kuptim të nenit 9, të Ligjit Nr. 9121/2003.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 9, 24, (germa d); 26, 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Prill 2017 deri në 31 Dhjetor 2017;
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3(tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 492, datë 28.12.2017

**Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i Relacionit mbi ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura nga UKT;

**Baza Ligjore:** Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të Relacionit mbi ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura nga UKT,

## VËREN SE:

### PROCEDURA E NDJEKUR

Nisur nga vendimmarrja e Entit Rregullator të Ujit mbi miratimin e tarifave të reja për Bashkinë Tiranë, sipas të cilave çmimi i ujit për konsumatorët është rritur me 44 %, Autoriteti i Konkurrencës ka filluar procedurën e vlerësimit të ndryshimit të tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, nga ku rezultoi se:

- Me vendimin Nr. 79, datë 26.07.2017 “Për dhënie mendimi mbi ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm”, Këshilli Bashkiak i Tiranës ka miratuar propozimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha, për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm.
- Për miratimin e këtij vendimi Këshilli Bashkiak i Tiranës është bazuar mbi relacionin shpjegues tekniko-ekonomik dhe dokumentacionit ligjor të ndërmarrjes së Ujësjetllës Kanalizimeve Tiranë.
- Në faqen zyrtare të UKT, Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe ERRU në të cilat është publikuar Vendimi Nr. 47/2017 i ERRU mbi miratimin e tarifave për periudhën 01/01/2018 e në vazhdim, nuk



gjenden bashkëlidhur relacioni me argumentet ekonomike dhe ligjore mbi të cilat është bazuar kjo vendimmarrje.

- KKRR lidhur me këtë vendimmarrje nuk ka marrë vlerësimin paraprak të Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të neneve 69 dhe 70 të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, me qëllim vlerësimin e shkallës së kufizimit ose pengimi të konkurrencës.
- Për një vlerësim sa më të plotë dhe të saktë të vendimmarrjes së ERRU, në zbatim të nenit 28, 69 dhe 70 të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me anë të shkresës nr. 474 prot, datë 20/11/2017 është kërkuar informacioni i plotë nga ERRU mbi këtë vendimmarrje, informacioni i cili na është vënë në dispozicion nga ana e ERRU-së nëpërmjet shkresës së saj nr. 319/1 prot, dt.12.12.20017 (Protokolluar pranë AK me nr. 474/1 prot, datë 15.12.2017).

### **Vlerësimi mbi ndryshimin e tarifës së ujit**

Nga analiza e bërë mbi ndryshimin e tarifës së ujit rezulton se: tregu i ujit është një treg i rregulluar, ku analizimi dhe miratimi i ndryshimit të tarifave të ujit duhet të aprovohet nga Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (ERRU). Për këtë qëllim ERRU me Vendimin Nr. 42, Datë 09.12.2015 ka miratuar "Metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", e cila bazohet në katër objektivat e politikës së tarifave, si vijon:

- Mbulimi i kostove: fillimisht mbulimi i kostove për operim dhe mirëmbajtje e më tej hap pas hapi deri në mbulimin e të gjitha kostove të operatorit që lidhen me realizimin e aktivitetit të tij për ofrimin e shërbimeve përkatëse;
- Efikasitetin menaxhues;
- Përballueshmërinë e saj nga konsumatorët në nevojë, dhe;
- Efikasitetin mjedisor.

Bazuar në legjislacionin sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator me Vendimin Nr. 47, datë 07/11/2017 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime tiranë sha”, ka miratuar ndryshimin e tarifave për periudhën 01 Janar 2018 dhe në vijim, vetëm për furnizimin me ujë, ndërkohë që tarifat për largimin e ujërave të ndotura nuk do të ndryshojnë.

Tarifat e furnizimit me ujë do ndryshojnë vetëm për tre kategori: a) Klientët familjarë, për të cilët tarifa nga 45 Lekë/m<sup>3</sup> bëhet 65 Lekë/m<sup>3</sup>, pra tarifa rritet me rreth 44%; b) Klientët publikë, për këtë kategori tarifa ndryshon nga 120 Lekë/m<sup>3</sup>, në 140 Lekë/m<sup>3</sup>, pra me një rritje rreth 17%; dhe kategoria e tretë c) Klientët privat, për të cilët tarifa ndryshon nga 135 Lekë/m<sup>3</sup>, në 155 Lekë/m<sup>3</sup>, pra me një rritje rreth 15%. Duhet theksuar se për të tre këto kategori rritja parashikohet në masën 20 Lekë.

Përveç ndryshimeve në kategoritë e mësipërme, ERRU ka miratuar edhe ndryshimin e tarifës fikse mujore të shërbimit “Tarifë Fikse” për të gjitha kategoritë duke e çuar në 200 lekë/muaj/klient, nga 100 lekë/muaj/klient që është aktualisht deri me datë 31 dhjetor 2017.

Gjithashtu, në këtë Vendim ERRU ka paraqitur edhe treguesit kryesorë të performancës për vitet 2018, 2019 dhe pritshmërinë për vitin 2022, të cilët sipas metodologjisë së përcaktimit të tarifave të ERRU janë pjesë e objektivave për vlerësimin e ndryshimit të tarifave.

Sipas relacionit shpjegues teknik të ndërmarrjes vihet re një nivel i lartë i ujit pa të ardhura prej 67.6% për vitin 2017.

Me hartimin e Plan Biznesit realizimi i objektivave strategjike synohet të arrihen brenda periudhës 2017-2021

duke vënë fokusin 5 - vjeçar si më poshtë:

- Rritja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë të popullsisë në Tiranë nga 85% në 95.3% (qyteti i Tiranës 100% dhe komunat 72%) dhe mbulimi me shërbim kanalizimesh nga 78.1% në 83.5%;
- Arritja e shërbimit të pandërprerë, të vazhdueshëm dhe me presion të furnizimit me ujë (24/7) në pjesën më të madhe të zonës së shërbimit të UKT-së;
- Reduktimi i ujit pa të ardhura nga 67.6% në 40% në vitin 2021;
- Rritja e normës së arkëtimit të faturave nga 79.9% në 92%;
- Vazhdimi i përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë në mënyrë që kontributi i saj të arrijë nivelin 7.3 miliardë lekë gjatë 2017-2021.

Në analizën e miratimit të tarifave, për vitet 2018 dhe 2019 nuk janë të evidentuara treguesit e performancës lidhur me “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”, këto dy tregues paraqiten vetëm në kolonën e pritshmërive për vitin 2022 dhe parashikohen përkatësisht 24 orë/ditë dhe 2.45 punonjës/000/lidhje.

Ndryshim ka pësuar edhe “Pagesa rregullatore” për sh.a. UK Tiranë, e cila nga 1% e të ardhurave vjetore të llogaritura, është ndryshuar në 0.6 % të të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

Miratimi i tarifave për ofrimin e shërbimeve të UKT-së bëhet nga ERRU, me kërkesë të ndërmarrjes së UKT dhe me aprovim të Asamblesë së Aksionerëve. Kërkesa për rritjen e tarifave duhet të jetë e justifikuar dhe mirë argumentuar, për të bërë të mundur vlerësimin e katër objektivave të politikës së tarifave të miratuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, miratuar me Vendimin Nr. 42, Datë 09.12.2015 të ERRU.

Në relacionin shpjegues teknik, i cili është pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 79, datë 26.07.2017 mbi miratimin e ndryshimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, UKT kërkon ndryshimin e tarifave nisur nga nevoja për investime në bazë të së cilës ka analizuar kostot e O&M duke përcaktuar kostot që do të merren në konsideratë dhe që do të përballohen nga tarifa. Mbi këtë relacion teknik është bazuar edhe vendimarrja e ERRU-se.

Kërkesa për ndryshimin e tarifave, është bërë për të mundësuar realizimin e investimeve gjithëpërfshirëse si në rrjetin e transmetimit ashtu edhe atë të shpërndarjes, investime të cilat sipas UKT nuk mund të realizohen me tarifat aktuale, ndërkohë që nuk janë vlerësuar mënyrat alternative të financimit nëpërmjet kredive dhe/ose obligacioneve të qeverisjes vendore. Pra, UKT për mbulimin e investimeve është bazuar në rritjen e tarifave dhe jo në gjithë elementët përbërës të kostos së shërbimit, ose sipas parashikimeve të “Metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura”.

Burimet për të përballuar kostot e investimeve janë të ardhurat e krijuara nga shitja e shërbimeve të UKT, të cilat do të mbulojnë të gjitha kostot e parashikuara. UKT parashikon një rritje të të ardhurave në vitin 2018, prej 1,250,000 lekë, e cila do të vijë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.

Kalkulimi dhe llogaritja e tarifave, të analizuara nga ERRU do të sjellë të ardhura të cilat do të përballojnë kostot dhe do të sigurojnë një tepriçë pozitive, e cila do të jetë garanci që do të akumulohet për shlyerjen e kredive të reja, që do të fillojnë të shlyhen pas tre vitesh.

Bazuar në relacionin shpjegues të ERRU për miratimin e tarifave të reja për vitin 2018, nuk gjejmë të detajuar strukturën e kostos mbi bazën e së cilës është miratuar tarifa brenda së cilës përfshihen tre elementë:

- Tarifa e ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve ;
- Tarifa për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura;

— Tarifa e shërbimit.

Pra, nuk gjejmë të detajuar strukturën e kostos mbi bazën e së cilës është përcaktuar tarifa përfundimtare e miratuar, e parashikuar në Metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, e cila përcakton faktorët e strukturës së tarifës, referuar peshës relative të tarifës së dhënë për njësinë e volumit të konsumit të ujit ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve dhe niveleve të ndryshme të konsumit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

#### **I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:**

- Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
- Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e:
  - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve;
  - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura;
  - Tarifës së shërbimit.
- Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
- Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
- Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.

#### **II. T’i rekomandojë UKT-së që:**

- Aksionarët e UKT për ta bërë tregun sa më eficient duhet të vlerësojnë mënyrat alternative të financimit të nevojave financiare të UKT nëpërmjet kredive të buta/të lehtësuara ose nëpërmjet obligacioneve të qeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 10 158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”.

#### **III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIME ME OBJEKT - MARRËVESHJE TË NDALUARA

### VENDIM

Nr. 446, datë 16.01.2017

**Për hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 16.01.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Relacionit të Sekretares së Përgjithshme dhe Informacionit të Sektorit të Analizës dhe Studimeve mbi monitorimin e tregut të Gazit të Lëngshëm për konsum familjar dhe biznesin.

**Baza Ligjore:** Nenet 24, (shkronja d) dhe 42, (pika 1) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të informacionit të Sektorit të Analizës dhe Studimeve mbi monitorimin e tregut të Gazit të Lëngshëm për konsum familjar dhe biznesin dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, Nr.7/1Prot., datë 13.01.2017.

### VËREN SE :

Në bazë të nenit 28 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Sektori i Analizës dhe Studimeve i Autoritetit të Konkurrencës ka realizuar një monitorim në tregun e shitjes së gazit të lëngshëm me bombola për familjare dhe biznese.

Realizimi i këtij monitorimi u krye pas shqetësimeve të ngritura nga media elektronike dhe e shkruar për një rritje të çmimeve të shitjes me pakicë të GLN për kategorinë familjare dhe biznese, që përdorin këtë produkt për përdorim rezidencial.

Tregu i GLN-së funksionon në zbatim të ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore, në të cilin përcaktohen qartë rregullat teknike për tregtimin me shumicë dhe pakicë të GLN- së, rregullat e transportit dhe kushtet në të cilat duhet të instalohet dhe përdoret bombola e GLN- së. Pas hyrjes në fuqi të paketës së re fiskale 2017 ku parashikohet vendosja e akcizës për kategorinë GLN vetëm për automjetet në vlerën 8 lekë/litrë prej datës 1 Janar 2017.

Nga monitorimi konstatohet se në treg ka subjekte që tregtojnë me të njëjtin gomim, sjellje e cila mund të përbëjë shenja të një kufizimi të konkurrencës në shkelje të nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Konkurrencën”, i ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 42, pika 1, neneve 4 dhe 9, nenit 24, (shkronja d), të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar),

## **VENDOSI:**

- I. Hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
  - II. Hetimi Paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 01.07.2016 deri në përfundim të periudhës së hetimit.
  - III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 muaj nga marrja e këtij vendimi.
  - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

**Nr. 453, datë 07.03.2017**

**Për dhënien e disa Rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe bankat e nivelit të dytë.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 07.03.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimin e raportit të hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar;

**Baza Ligjore:** Neni 24, germa d) e f), neni 26, neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Raportit të Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin Bankar, Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, pas marrjes së opinionit dhe komenteve të Bankës së Shqipërisë dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave mbi Raportin e Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin Bankar si dhe pas tryezës së rrumbullakët të datës 09.02.2017,

## VËREN SE:

### PROCEDURA E NDJEKUR

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", (i ndryshuar), ka realizuar një monitorim në tregun bankar, nga rezultoi se gjatë viteve të fundit tregu bankar paraqet karakteristikat e një tregu me norma relativisht të larta fitimi në kushtet e stanjacionit të kreditimit; interesa shumë të ulta të depozitave (deri në 0.55 % mbi bazë vjetore nën nivelin e inflacionit); diferenca (spread) relativisht të larta mes interesave të kredive dhe depozitave; tendencës në rritje të interesave të letrave me vlerë të qeverisë, kryesisht afatgjata (obligacione) në kushtet e një politike lehtësuese monetare dhe kur norma bazë e interesit të depozitave kanë tendencë në rënie; ka rritje të komisioneve për pagesat kryesisht brenda vendit etj.

Këto rrethana të bëjnë të mendosh që konkurrenca në sektorin bankar mund të jetë kufizuar ose shtrembëruar si rezultat dhe/ose pasojë e shkeljes së nenit 4 (marrëveshje të ndaluara) dhe/ose nenit 9 (abuzim me pozitën dominuese) të Ligjit nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të monitorimit në tregut bankar si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), 26 dhe 41 (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; nenit 12 të Rregullores "Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës", si dhe nenit 3 të Rregullores "Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës", me anë të Vendimit Nr. 373, dt. 16.09.2015 "Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në Sektorin Bankar" (i ndryshuar) vendosi hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar për të vlerësuar nëse konkurrenca në këtë sektor është e kufizuar ose e shtrembëruar si pasojë

e sjelljes së një ose disa bankave.

Në zbatim të nenit 41 (pikat 2 & 4) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", të ndryshuar, me qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm për kryerjen e hetimit dhe vlerësimin e konkurrencës në treg, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga subjektet që operojnë në këtë treg, Banka e Shqipërisë(BSH) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave(AAB), në përgjigje të të cilave është administruar dhe informacioni përkatës.

Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar komente dhe sugjerime nga BSH dhe AAB mbi Raportin "Hetim i Përgjithshëm në Sektorin Bankar" (shkresa nr. 349, datë 20.10.2016). Në përgjigje të kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës Banka e Shqipërisë me anë të shkresës së saj Nr. 4971/1 Prot., datë 14.11.2016, (Protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 349/1 Prot., datë 16.11.2016) si dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave me anë të shkresës Nr 179 prot, datë 13.12.2016, (Protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 407 Prot., datë 14.12.2016), kanë paraqitur opinionet dhe komentet e tyre lidhur me Raportin e Autoritetit të Konkurrencës "Hetim i Përgjithshëm në Sektorin Bankar".

Në zbatim të nenit 41 dhe 70 të Ligjit me datë 09.02.2017 u zhvillua një tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

## **ANALIZA E KONKURRENCËS**

Në zbatim të Ligjit nr.9121, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 76, datë 07.04.2008 ka miratuar udhëzimin "Për tregun përkatës", sipas të cilit tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik. Përcaktimi i tregut si në dimensionin e produktit dhe atë gjeografik, bëhet me qëllim që të identifikohen konkurrentët aktualë dhe potencialë të ndërmarrjeve që janë të përfshirë në atë treg, sjelljen e këtyre ndërmarrjeve, llogaritjen e pjesëve të tregut, përcaktimin e fuqisë së ndërmarrjes, strukturën e tregut me qëllim vlerësimin e konkurrencës në treg.

### **Tregu përkatës i produktit**

Për të vlerësuar tregun përkatës të produktit është analizuar zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, barrierat në hyrje/zgjerimit, konkurrenca potenciale.

Tregjet përkatëse përfshijnë Llogari rrjedhëse; Depozita me/pa afat; Kredi konsumatore; Kredi kufi (OVD); Kredi hipotekore; Karta krediti; Karta debiti; Transferta bankare; Letra me vlerë në tregun primar, Shërbimi e-Banking, të ofruara nga bankat e nivelit të dytë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës**

Nga ana e ofertës produktet/shërbimet që ofrojnë bankat e nivelit të dytë mund të kenë zëvendësues dhe shërbimet e ofruara nga subjektet financiare jo bankë (SFJB). Nga analiza u konstatua se edhe pse pjesërisht bankat dhe SFJB e shohin si zëvendësues njëri-tjetrin, procedura e dhënies së kredi/mikrokredive nga SFJB dhe kostot për marrjen e tyre ndryshojnë ndjeshëm nga ajo e sistemit bankar. Gjithashtu portofoli i vogël i kredisë/mikrokredisë të SFJB krahasuar me portofolin e kredisë së bankave bën që përfshirja ose jo e SFJB në analizën e pjesëve të tregut për produktet e sipërpërmendura nuk do ndikonte në sistemin bankar.

Shërbimi i transfertave ndërbankare që ofrohet nga bankat e nivelit të dytë, mund të konsiderohet si shërbim i zëvendësueshëm nga SFJB. Bankat nuk i shohin SFJB si zëvendësues të shërbimit të tyre për faktin se bankat e nivelit të dytë janë të detyruara të përdorin sistemin e AIPS, AECFI dhe SWIFT (i cili ka besueshmëri dhe siguri të lartë të klienti), ndërsa për SFJB-të nuk aplikohet i njëjti rregull. Kjo bën që afatet e realizimit të transfertave nga SFJB janë më të shpejta se bankat. Ndërsa M-Pesa e klasifikon shërbimin e saj si unik duke qenë se transfertat bëhen nëpërmjet telefonit. Një element tjetër që përbën diferencën mes SFJB dhe bankave



është vlera maksimale e transfertës dhe ky fakt përbën dhe diferencën në profilin e klientit i cili kërkon këtë shërbim nga SFJB, apo bankat.

### **Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës**

Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës në sektorin bankar është vlerësuar nga sjellja e përfituesve të produkteve/shërbimeve të bankës të cilët janë individët, bizneset e vogla dhe të mesme (SME), korporatat dhe sektori publik.

Disa nga indikatorët e marrë në analizë për matjen e zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës janë:

- Transparenca e Informacionit. Banka e Shqipërisë, si autoriteti mbikëqyrës i bankave të nivelit të dytë ushtron detyrimin për rritjen e nivelit të transparencës së aktivitetit të bankave. Bankat janë të detyruara në përputhje me Rregulloren "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja" dhe "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", të publikojnë informacion të hollësishëm në lidhje me interesat, komisionet për produktet dhe shërbimet e tyre. Ky informacion është i aksesueshëm pranë faqes zyrtare të internetit të secilës bankë, pranë faqes zyrtare të BSH, ndërkohë që informacioni i ofruar për SFJB- të nuk ka të njëjtën shkallë transparence sikurse bankat e nivelit të dytë.
- Inelasticiteti i kërkesës është më i dukshëm sidomos për produktet e lidhura me llogaritë rrjedhëse.
- Ofrimi i shërbimeve/produkteve. Kërkesat e klientëve përcaktojnë rëndësinë e parametrave të ndryshëm të konkurrencës në këtë sektor. Një klient do të përfitonte nga një bankë numër më të gjerë dhe shumëllojshmëri shërbimesh/produktesh dhe me një shtrirje gjeografike në të gjithë qytetet e Shqipërisë, ndërkohë që SFJB-të ofrojnë një numër të limituar produktesh/ shërbimesh me një numër më të vogël degësh/ zyrash të tyre. Nisur nga produktet që ofrojnë SFJB-të (mikrokredi kryesisht në sektorin e bujqësisë), tipologjia e klientit të SFJB-ve është kryesisht biznes/ fermer në sektorin e bujqësisë apo blegtorisë, duke u orientuar drejt klientëve me nevoja minimale financiare.
- Lehtësia në përfitimin e shërbimeve dhe produkteve. Për përfitimin e produkteve/ shërbimeve klienti duhet të paraqesë pranë bankave dhe SFJB dokumentacionin administrativ të kërkuar sipas rastit. Nga informacioni i disponuar është vënë re se në rastin e shërbimit të ofruar nga SFJB-të, dokumentacioni apo procedurat administrative janë më të thjeshta dhe perioda e përfitimit të produktit është më e shkurtër, duke i dhënë avantazh SFJB-ve në krahasim me bankat e nivelit të dytë.
- Avantazhin konkurrues nga ana e kërkesës mes SFJB dhe bankave e gjejmë edhe në shërbimin e transfertave monetare, ku për marrjen e këtij shërbimi nga SFJB nuk është i nevojshëm posedimi i një llogarie rrjedhëse nga klienti por transfertat realizohen vetëm me dokumentacionin identifikues, ndërkohë që ky shërbim i marrë nga bankat kërkon në mënyrë të detyrueshme ekzistencën e të paktën një llogarie rrjedhëse (në nisje/në mbërritje). Gjithsesi kufizimi i vlerave maksimale të transfertave, bën diferencën mes bankave dhe SFJB dhe për rrjedhojë dhe diferencën në profilin e klientit që përfiton shërbimin nga këta ofrues.

Në përfundim të analizës së zëvendësueshmërisë në tregun e produktit, u konstatua se Subjektet Financiare Jobankë nuk ofrojnë produkte zëvendësuese me Bankat e nivelit të dytë dhe sjellja e SFJB nuk do të jetë pjesë e analizës.

### **Barrierat e hyrjes dhe zgjerimit.**

#### **Licencimi si bankë/degë e një banke të huaj**

Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për licencimin e bankave dhe të degëve të bankave të huaja për të ushtruar veprimtari bankare dhe veprimtari të tjera financiare, në përputhje me ligjin "Për bankat

në Republikën e Shqipërisë".

Licenca që i jepet një banke apo dege të një banke të huaj, është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme. Pjesë përbërëse e licencës është edhe aneksi i veprimtarive bankare dhe veprimtarive financiare, për të cilat banka dhe dega e bankës së huaj licencohet.

Kushtet, kërkesat, afatet, dokumentacioni dhe procedurat për licencimin e bankës dhe degës së bankës së huaj për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, përcaktohen në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (nenet 17, 18) dhe Rregulloren "Për Licencimin dhe Ushtrimin e Veprimtarisë së Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja në Republikën e Shqipërisë", (nenet 6 dhe 7) miratuar me Vendimin Nr. 14, datë 11.03.2009 të BSH.

Referuar rezultateve të pyetësorit, Bankat kryesisht i gjykojnë kriteret e vendosura nga Banka e Shqipërisë për liçensimin e një banke të nivelit të dytë apo pajisjen me licenca të reja për veprimtaritë financiare tepër realiste dhe koherente, të përshtatshme, të arsyeshme dhe përgjithësisht në frymën e një kuadri rregullativ të kujdesshëm dhe në përfaqësim të vazhdueshëm me direktivat e BE.

### **Tregu përkatës gjeografik**

Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse bankat e nivelit të dytë janë prezente në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si treg gjeografik përcaktohet tregu i Republikës së Shqipërisë.

### **Vlerësimi i strukturave të tregjeve të produkteve dhe sjellja e ndërmarrjeve**

Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm për analizën e konkurrencës, në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, AK interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve.

Autoriteti në përgjithësi i konsideron pjesët e vogla të tregut si një tregues i mirë për mungesën e fuqisë së tregut. Eksperienca e vendeve të Bashkimit Evropian tregon se pozita dominuese nuk është e mundur nëse pjesa e tregut përkatës e ndërmarrjes është më e vogël se 40%.

Sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha në të cilën ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozitë dominuese dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit. Por si rregull i përgjithshëm, Autoriteti nuk del me një konkluzion përfundimtar pa analizuar të gjithë faktorët e rëndësishëm, të cilët mund të kufizojnë sjelljen e një ndërmarrjeje.

Në treguesit e përqendrimit të shprehur nëpërmjet Indeksit Herfindahl Hirschmann (HHI)<sup>1</sup> të përlogaritur për totalin e aktiveve, gjatë vitit 2014-J-Sh 2015, ka një rritje të lehtë nga 1,379 në 1,479, por ngelet në nivelin e një treguesi me një shkallë përqendrimi të moderuar. Edhe treguesit CR3<sup>2</sup> dhe CR5 janë në nivelet 58% dhe 75%. Të njëjtën linjë ndjek edhe treguesi HHI, CR3 dhe CR5 për kreditë dhe depozitat me një shkallë përqendrimi të moderuar.

Nga vlerësimi i modelit Panzar-Rosse që mat konkurrencën në sektorin bankar statistika H rezulton 0.742, konkurrenca në sektorin bankar për periudhën e marrë në analizë (2010- 2015) është në kushtet e konkurrencës

<sup>1</sup> indeksi Herfindahl-Hirschmann ("HHI") mat përqendrimin e tregut duke mbledhur përqindjet e pjesëve të tregut në katror të të gjitha ndërmarrjeve të industrisë. Me një HHI poshtë 1000, përqendrimi i tregut mund të karakterizohet si i ulët, një HHI midis 1000 dhe 1800, tregu ka përqendrim mesatar dhe një HHI mbi 1800, tregu ka përqendrim të lartë.

<sup>2</sup> Raporti i përqendrimit të ndërmarrjeve kryesore, që gjendet duke mbledhur pjesët individuale të tregut të konkurrentëve kryesore. CR3 llogaritet si totali i pjesëve të tregut të 3 ndërmarrjeve me të mëdha në industri dhe CR5 të 5 ndërmarrjeve me të mëdha.

monopolistike<sup>3</sup>.

Depozitat janë produkte nëpërmjet të cilave bankat sigurojnë likuiditetet monetare kurse klienti depoziton mjetet e tij të lira kundrejt përfitimit të interesave. Për bankat, depozitat gjenerojnë shpenzime nëpërmjet pagesës së interesave aty ku është e parashikuar dhe të ardhura nga komisionet (në vlera shumë të vogla krahasuar me produktet e tjera). Nga të dhënat e marra mbi portofolin e depozitave (e konvertuar në lekë për të gjitha monedhat) u vlerësua struktura e tregut të depozitave e cila tregon se tregu i depozitave (në total) është një treg mesatarisht i përqëndruar me treguesin HHI në vlerën 1383 në vitin 2014 (HHI për 9-M 2015 është 1485) dhe me CR3 dhe CR5 të qëndrueshme në vlerën 55.8% dhe 73.5% për vitin 2014.




tatim taksa, sigurime, qarkullimi monetar nëpërmjet bankave për transaksione me vlera të larta, etj.). Ndryshe nga llogaria rrjedhëse, Depozitat me afat paraqiten me tregues në rënie krahasuar me vitin 2014, e cila mund të këtë ardhur nga ulja e normës së interesit të depozitave me afat, e shoqëruar kjo me zhvendosjet e kursimeve të individëve në investime në instrumente të tjerë financiarë.

Portofoli i depozitave në vlera absolute, në shtator 2015 ka reflektuar një rritje me rreth 20 miliardë lekë të vlerës së tij krahasuar me vitin 2014, rritje kjo e ndikuar nga rritja e vlerës së llogarive rrjedhëse në rreth 14%. Rritja e vlerës së llogarive rrjedhëse, është një fakt i cili tregon për rritje të vlerës së likuiditeteve monetare në qarkullim e cila mund të jetë pasojë e politikave për uljen e informalitetit dhe regjistrimin e bizneseve informale, gjë e cila çon edhe në formalizimin e qarkullimit të parave nëpërmjet sistemit bankar (derdhje detyrime fiskale,

Nga vlerësimi i strukturës së tregut të depozitave për vitin 2014/9M-2015 rezultoi se depozitat me afat zënë pjesën më të madhe të tregut të depozitave me rreth 71% të tyre, e shoqëruar nga llogaritë rrjedhëse me 22 % dhe më pas me depozitat pa afat me vetëm 7% të tregut. Nëse do t'i referohemi treguesve 9 muor të vitit 2015 do të vëmë re një ulje të lehtë të depozitave me afat kundrejt një rritje të llogarive rrjedhëse.

Kreditimi është procesi i dhënies hua të fondeve {burime financiare në formën e kapitalit të derdhur prej aksionerëve apo fondeve të grumbulluara nga depozitat} që banka disponon sipas kushteve të rëna dakord midis bankës dhe huamarrësit, i cili mund të jetë një individ, biznes apo korporatë. Nga të dhënat e BSH, pjesën më të madhe të kredisë e zë kredia e biznesit me rreth 50% të portofolit, overdrafti zë afërsisht 25% të portofolit, kredia hipotekore 20% dhe ajo konsumatore 4-6%.



Portofoli i kredisë së sektorit bankar sipas llojit, viti 2014, 9MI-2015

Tregu i kredisë ka karakteristikat e një tregu mesatarisht të përqëndruar më tregues përqendrimi HHI 1163 për vitin 2014 dhe 1182 për vitin 2015. Tre bankat me të mëdha zënë 50% të tregut për vitin 2014 dhe 52% për vitin 2015, dhe pesë bankat më të mëdha zënë 66% të tregut si për vitin 2014 ashtu edhe për 2015. Në analizën

<sup>3</sup> Në Ekonomiks strukturat e tregjeve janë: konkurrenca e plotë, konkurrenca monopolistike, oligopoli dhe monopoli. Statistika H është një tregues që matet nga një ekuacion logaritmik i cili tregon elasticitetet e çmimit në termat e të ardhurave nga interesi kundrejt kapitalit, punës dhe kapitalit fizik. H merr vlera negative kur struktura e tregut është monopol ose një oligopol ku ndërmarrjet bashkërendojnë sjelljet, kur H merr vlera nga 0-1 jemi në kushtet e një strukture tregu konkurrencë monopolistike dhe kur H del 1 jemi në kushtet e një konkurrencë perfektë.

sipas llojit të kredisë, produktet e kredisë konsumatore dhe overdraft-it për biznesin paraqiten në nivele të larta përqendrimi, ndërkohë që produkti i kredisë hipotekore tregu është më pak i përqëndruar.

Nga administrimi i të dhënave, u konstatua se lëvizshmëria e klientëve nga një bankë në tjetrën (transferimi i kredive) për produktin e kredive është i ulët, klientët përballen më kosto administrative dhe financiare, element pengues në lëvizshmërinë e klientit nga njëra bankë në tjetrin. Në një treg të maturuar, për të rritur nivelin e konkurrencës në treg dhe rritjes së mundësisë së zgjedhjes konsumatore, duhet të krijojnë lehtësira për lëvizshmërinë e klientëve duke ulur kostot "bllokuese" (kostot të cilat e detyrojnë klientin të qëndrojë pranë një banke si komisione për mbyllje llogarie, kosto shtesë në rast të transferimit të pagës nga një bankë në një bankë tjetër përsa i përket produkteve të lidhura me llogarinë rrjedhëse (karta elektronike dhe overdraft), komisione/ penalitete për mbylljen para kohe të kredisë, humbjen e interesit në rast të mbylljes para afatit të një depozite me afat, kosto administrative për klientin si kohë, rimbushje formularësh, përgatitje dokumentacioni, etj.) si dhe të rrisin transparencën duke i bërë më të kuptueshme këto kosto për klientin.

Transferte bankare është operacioni përmes të cilit klienti i një banke urdhëron bankën që të dërgojë një shumë të caktuar parash nga llogaria e tij bankare, në llogarinë bankare të një personi/biznesi tjetër përfitues. Transferta mund të kryhet brenda të njëjtës bankë (transferte e brendshme) por edhe nga një bankë në një tjetër. Ky treg mundëson transferimin e fondeve, të cilat mbahen në llogari të hapura pranë bankave ose institucioneve të parasë elektronike, midis një debitori dhe përfituesi të fondeve, bazuar në instruksionet e marra për pagesën.

Tregu i transfertave bankare ka Indeks përqendrimi HHI, të moderuar për vitin 2014, (1345), me një rritje të lehtë në nëntë mujorin e vitit 2015 (1494), me treguesit e CR3 (55% dhe 59%) dhe CR5 (75% dhe 80%) në rritje.

E - Banking është një shërbim në distancë, që ofrohet nëpërmjet kanaleve elektronike të shpërndarjes dhe të komunikimit, të produkteve dhe shërbimeve tradicionale dhe të reja bankare. Disa nga shërbimet më të përdorura që mund të ofrohen në rrugë elektronike, të grupuara sipas katër kategorish kryesore janë: 1) Informacion, 2) Kontrolli i bilancit, 3) Transferte të fondeve, 4) Kredi si edhe shërbimet bazë si këshillimi financiar etj.

Referuar të dhënave të mundësuar nga Banka e Shqipërisë për transfertat e kryera nëpërmjet E – Banking rezulton se për vitin 2014 ky lloj shërbimi ka zënë rreth 4% të totalit të transfertave të iniciuara nga klientët.

Duke patur parasysh dinamikën e tregut dhe zhvillimet e teknologjisë së informacionit në sistemin bankar, lind nevoja e stimulimit të produktit E - banking nga bankat dhe përfitimi i shërbimit nga klientët. E- banking mund të vlerësohet nga bankat e vogla, me shtrirje të kufizuar gjeografike dhe nga hyrësit e rinj, si element që do të nxiste aftësinë e tyre konkurruese në sistemin bankar. Në një situatë të tillë janë të nevojshme iniciativat për promovimin e shërbimit të E - banking nga BSH duke modernizuar sistemin e pagesave.

Kartat e debitit dhe kreditit, paraqesin një treg të vogël për nga vlera në krahasim me produktet e tjera bankare. Nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë rezulton se për vitin 2014, numri kartave të debitit prezente në tregun bankar është 788,215. Ky produkt ofrohet nga 14 banka. Në total, pagesat e kryera nëpërmjet kartës së kreditit për vitin 2014 kanë qenë rreth 7.8 miliardë ALL.

Pozicionet respektive të konkurrentëve në treg reflektohen në treguesit e nivelit të përqendrimit të këtij segmenti si indeksi HHI, i cili për të dy periudhat e marra nën shqyrtim rezulton të jetë në nivele të larta (për vitin 2014, HHI = 1720; janar-shtator 2015, HHI = 1618), duke treguar nivele të moderuara përqendrimi në këtë segment produkti, me tendencë në ulje kur krahasojmë të dy periudhat e marra në shqyrtim.

Numri i kartave të kreditit ka ardhur në rritje nëse do të krahasonim vitin 2014 (73,804), me 9 mujorin e parë të vitit 2015 (80,426). Ky produkt gjen përdorim më të gjerë nga klientët "Individ" krahasuar me klientët

"Biznes". Vlera e pagesave të kryera nga individët zë 92.9% të totalit të pagesave me kartë krediti për vitin 2014 dhe 95.1% të pagesave me kartë krediti periudhën janar - shtator 2015.

Për periudhën janar- shtator 2015 tregu shfaq nivele më të larta përqendrimi krahasuar me vitin 2014 (HHI për vitin 2014 =1931; HHI për periudhën janar-shtator 2015=2056). Nga përlogaritja rezulton se CR3=65.3 dhe CR5=80.4%.

Stimulimi i kartave lokale, të cilat nuk kanë kosto të larta si kartat që imponohen nga skemat ndërkombëtare (MasterCard, Visa etj.), vjen si një sugjerim nga bankat, pasi do të mundësonte më shumë përdorim dhe pranim të pagesave, si dhe do të shoqërohej me kosto më të ulta për bankat dhe rrjedhimisht edhe për klientët e tyre. Nga këndvështrimi i konkurrencës, nxitja e skemave lokale do të rriste presionin konkurrencial të bankave më të vogla ndaj bankave të tjera të pranishme në këtë treg, të cilat kanë një fuqi ekonomike më të madhe dhe mundësinë për ti "subvencionuar" këto produkte.

Në lidhje me nxitjen e skemës së pagesave nëpërmjet kartave, bankat gjithashtu sugjerojnë se është e nevojshme ekzistenca e një kuadri rregullativ nga institucionet dhe organet qeveritare/ shtetërore që të synojnë uljen apo limitimin e përdorimit të transaksioneve cash, rregullimin e tregut nga organet vendimmarrëse dhe ligjvënëse lidhur me pagesat me karta (vendosja e një rregulli për bizneset për kalimin e një pjese të xhiros me anë të kartave) ose ndryshe formalizimi në mënyrë që të rritet numri i dyqaneve dhe pikave të shitjes që pranojnë pagesa me kartë. Nga ana e kërkesës, do të ishte e nevojshme: edukimi i konsumatorëve, tregtarëve, bizneseve mbi lehtësinë, shpejtësinë dhe sigurinë e përdorimit të kartave bankare.

Pjesëmarrësit në tregun primar të letrave me vlerë për vitin 2014 janë: Banka e Shqipërisë e cila merr pjesë në ankande me kërkesa jokonkurruese me 11.26%, Bankat e nivelit të dytë të cilat marrin pjesë me kërkesa konkurruese me 61,54%, institucionet financiare dhe jo financiare me 15,11% dhe individët, të cilët marrin pjesë në ankand me kërkesa jokonkurruese me 11,92%.

Peshën më të madhe në të gjithë letrat me vlerë, janë bonot e thesarit 12 mujore që përfaqësojnë 36.32% të gjithë letrave me vlerë. Vitet e fundit kanë hyrë obligacionet 10 vjeçare dhe është rritur pesha e obligacioneve 2 dhe 3 vjeçare. Në tregun e bonove të thesarit, Indeksi HHI i bazuar në pjesët e tregut për volumnin e portofolit është i moderuar me 1451 për vitin 2014. Vlerat e treguesit CR3 dhe CR5 janë në nivelet 56.4% dhe 69.3%.

Diferenca midis bonove të thesarit dhe interesit të depozitave është 1.41 në vitin 2014 dhe për 9 mujorin 2015 bie në 1.05 ose me 25.5%. Nga vlerësimi i ecurisë së yield-eve të bonove të thesarit për tre maturitetet kryesore (3, 6, 9 mujore) rezulton se normat e interesit për bonot 3 mujore në fund të 9 mujorit 2015 kanë rënë me 17%, për bonot 6 mujore në fund të 9 mujorit 2015 kanë rënë me 9% dhe për bonot 12 mujore në fund të 9 mujorit 2015 kanë rënë me 4%.

## **TRANSPARENCA E INFORMACIONIT BANKAR**

Bazuar në Rregulloren e BSH "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja", bankat publikojnë raportet periodike, që përfshijnë informacionin sipas kategorive kryesore të përcaktuara në rregullore dhe nuk publikojnë informacione të klasifikuara si konfidenciale ose sekret mbi klientelën e tyre, apo informacione që ndikojnë në pozicionin konkurrues të tyre në treg.

Sipas Rregullores së BSH "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", bankat kanë detyrimin të publikojnë dukshëm dhe qartësisht në faqet e tyre të internetit dhe në ambientet e tyre të punës informacionin mbi normat e interesit të kredive dhe depozitave, si dhe komisionet për produktet dhe shërbimet që ato ofrojnë për klientët. Përpara se klienti të zgjedhë një produkt ose shërbim, bankat i japin klientit paraprakisht informacion të plotë për kushtet, afatet dhe normat në përqindje të interesit, për rreziqet që shoqërojnë marrjen e produktit apo shërbimit, si dhe komisionet dhe gjokat (penalitetet), në rastet kur këto të fundit bëhen të aplikueshme etj.



Në rastet kur bankat ndryshojnë kushtet e kontratave dhe/ose të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve bankare apo financiare, ato duhet të njoftojnë me shkrim dhe në mënyrë individual, secilin klient që është subjekt i këtyre ndryshimeve. Ky njoftim, duhet të kryhet përpara se ndryshimet të bëhen të aplikueshme. Ai duhet të përmbajë informacion të saktë, të plotë dhe të shprehur në një gjuhë të kuptueshme për klientin.

Në këtë mënyrë bankat informojnë paraprakisht klientin por nuk presin një miratim paraprak prej tij, në rastin e kontratës së llogarisë dhe të depozitës duke i marrë vendimet në mënyrë të njëanshme. Fuqia kundërvepruese e klientit në këtë rast pothuajse nuk ekziston, pasi banka nuk i jep asnjë të drejtë klientit të shprehë mendimin e tij para aplikimit të ndryshimeve të njoftuara. Me qëllim shmangien e një sjellje të mundshme abuzuese të bankës ndaj klientit është e nevojshme marrja e masave për forcimin e pozitës së klientit kundrejt bankës, duke i dhënë të drejtë klientit që të heqë dorë nga kontrata brenda një afati të caktuar nga njoftimi dhe pa asnjë kosto shtesë, në qoftë se ai nuk është dakord me ndryshimet e bëra<sup>4</sup>.

Kjo do të mundësohej nëpërmjet një ndryshimi në Rregulloren e BSH "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", konkretisht në riformulimin e pikës 4 të nenit 9 të saj, ose ku BSH e gjykon të përshtatshme, ku të përcaktohet detyrimi i Bankës që të parashikojë në kontratën e llogarisë dhe të depozitës përveç mënyrës së njoftimit edhe atë të marrjes së pëlqimit të klientit për ndryshimin e kushteve apo afateve të kontratës së nënshkruar, para se të aplikojë ndryshimin; të drejtën e klientit që në çdo rast të heqë dorë nga kontrata, brenda një afati të caktuar nga njoftimi dhe pa asnjë kosto shtesë, në qoftë se ai nuk është dakord me ndryshimet e bëra.

Me qëllim që të rritet mundësia e klientit për të zgjedhur produktin më të mirë për të, duhet lehtësuar aksesin në informacione (komisione, interesa etj.), të cilat do të mundësojnë qytetarëve të krahasojnë produktet individuale të ofruara nga banka të veçanta, si dhe njëkohësisht të krahasojnë çmimet e ofruara nga bankat për këto produkte. Rritja e mundësive për të krahasuar produktet individuale do të rezultojë më pas në një rritje në lëvizshmërinë e klientit dhe konkurrencë më të madhe midis ndërmarrjeve në treg për ofrimin e shërbimeve bankare.

Me qëllim shmangien e shqetësimeve të tregut, nisur edhe nga praktika e vendeve të tjera<sup>5</sup>, do të ishte me vend ndërmarrja e nismës për krijimin e një kodi të sjelljes së bankave/subjekteve financiare ndaj klientëve të tyre, me qëllim rritjen e transparencës së bankave në shërbimet dhe produktet që ato u ofrojnë klientëve, gjë e cila mund të realizohet nëpërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave.

## **VLERËSIMI I BARRIERAVE TË KONKURENCËS**

Sipas pikës 7 të nenit 127 të Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në RSH": "Bankat dhe degët e bankave të huaja mund të shkëmbejnë informacion në lidhje me kreditë që u japin klientëve, mbi bazën e një marrëveshjeje midis tyre dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit tjetër në fuqi". Një marrëveshje e tillë është edhe Marrëveshja "Mbi mbylljen e kredive të klientëve ndërmjet bankave", e nënshkruar ndërmjet të gjitha bankave anëtare të AAB-së, me ndërmjetësimin e AAB-së. Kjo marrëveshje ka synim rregullimin në mënyrë institucionale të procesit/ procedurave të transferimit të kredive të klientëve ndërmjet bankave me qëllim minimizimin e riskut të kredive dhe përdorimin e fondeve të kredive vetëm për qëllimin e rifinancimit të kredive në bankat e tjera. Marrëveshja përcakton rrjedhjen e procesit të punës nga pikëpamja operationale që duhet të ndjekin bankat në rastin e kërkesës së klientit për transferimin e kredisë nga një bankë në një bankë tjetër dhe nuk përcakton kushtet dhe termat e kreditimit të klientit në asnjërën bankë.

Publikimi i informacionit rreth të gjithë tregut dhe konkurrentëve mund të përbëjë një mekanizëm monitorues

<sup>4</sup> Referuar ndryshimeve të bëra në legjislacionin bankar Italian në vitin 2006/materiali i OECD Policy Roundtables on "Competition and Regulation in Retail Banking 2006", Italy.

<sup>5</sup> Botim i OECD "Konkurrenca dhe shërbimi bankar 2006", rasti i Republikës Çeke pika 2: Marrëdhëniet mes Rregullatorëve Bankarë dhe Autoriteteve të Konkurrencës, faqe 108.

dhe lehtëson mundësinë e bashkërendimit të sjelljeve. Këtë rol e përforcon me tepër ndërmjetësimi i shoqatës në lidhjen e marrëveshjes si më sipër.

Sipas OECD-së, bankat komunikojnë me njëra-tjetrën, bazuar në marrëveshjet e ndryshme të nënshkuara ndërmjet tyre, me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara prej tyre ndaj klientëve. Ky bashkëpunim rrit risqet për një sjellje të mundshme antikonkurruese ndërmjet bankave. Me qëllim parandalues, sektori bankar ka nevojë për një mbikëqyrje më të fortë ndaj sjelljeve të mundshme antikonkurruese.

Banka në bazë të procedurave të brendshme të prokurimit, përzgjedh një numër ekspertësh të jashtëm të kualifikuar për vlerësimin e kolateralit. Në disa banka është klienti ai që zgjedh vlerësuesin nga lista e aprovuar paraprakisht nga banka dhe në disa banka të tjera është vetë banka e cila përcakton se cili vlerësues nga lista do të kryejë vlerësimin. Të gjitha bankat duhet t'i mundësojnë klientit që të zgjedhë një vlerësues nga lista e vlerësuesve të bankës, me qëllim zgjedhjen e shërbimit më të mirë për të (bazuar në koston e vlerësimit dhe afatin kohor të përfundimit të tij) dhe jo të zgjedh banka siç ndodh me shumicën e tyre. Kjo do të mundësohej me ndërhyrjen e BSH, si rregullator, nëpërmjet implementimit të kësaj sjelljeje në Udhëzuesin përkatës "Për përgatitjen e vlerësimeve të pasurive të paluajtshme për qëllime të marrjes së një kredie nga një institucion financiar".

Bankat, në rolin e ndërmjetësit në sigurime, negociojnë paraprakisht për lidhjen e kontratave të sigurimit. Banka orienton dhe informon klientin për kompanitë e sigurimit me të cilat ka marrëveshje duke i mundësuar atij të drejtën të zgjedhë një nga shoqëritë e sigurimit të paracaktuara nga vetë Banka. Bankat kryesisht kanë marrëveshje të shumta në numër, të lidhura me shoqëri të ndryshme sigurimi. Pavarësisht këtyre marrëveshjeve bankat shprehen se ato pranojnë kontrata të lëshuara edhe nga kompani të tjera përveç atyre me të cilat kanë marrëveshje të shkruar.

Pjesa më e madhe bankave, pavarësisht nënshkrimit të kontratave ose jo, nëpërmjet procedurave të tyre të brendshme përzgjedhin paraprakisht një numër noterësh me të cilët bashkëpunojnë (bazuar në kritere si: afërsia me degën e Bankës, reputacioni noterit, eksperiencia profesionale, parimit të mirëbesimit etj.) në rastet e noterizimit të kontratave që lidh me klientët për shërbimet/produktet e ofruara nga Banka, duke i dhënë mundësi klientit të përzgjedhë njërin nga noterët me të cilët banka bashkëpunon/ka përzgjedhur.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

#### **I. T'i rekomandojë Bankës së Shqipërisë:**

- Rishikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit midis BSH dhe Autoritetit të Konkurrencës, ku të përfshihet: Një kapitull i veçantë për rregullimin e konkurrencës në tregjet bankare, në të cilin të përcaktohet mënyra e bashkëpunimit midis dy institucioneve në lidhje me çështje të konkurrencës në tregun bankar.
- Riformulimin e pikës 4 të nenit 9 të Rregullores së Bankës së Shqipërisë "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare" si vijon: "Banka duhet të parashikojë në kontratën e llogarisë dhe të depozitës mënyrën e njoftimit të klientit për ndryshimin e kushteve të punës. Para se të aplikojë ndryshimin, në kushtet e rinovimit të kontratës, banka të marrë pëlqimin e klientit".
- Identifikimin dhe adoptimin e masave të mundshme për uljen e kostove të transfertave në nisje dhe në mbërritje në monedhë të huaj, kryesisht euro dhe dollar amerikan, nga një bankë te një bankë tjetër brenda vendit. Kjo do të çojë në nxitjen e qarkullimit të monedhës së huaj në kanalet bankare, dhe do të ndihmojë në uljen e përdorimit të parasë cash në ekonomi.



- Stimulimin dhe promovimin e shërbimit E - banking nga BSH dhe bankat me qëllim nxitjen e aftësisë konkurruese të konkurrentëve më të vegjël si dhe të hyrësve të rinj në sistemin bankar dhe rritjen e përfitimeve të këtij shërbimi nga klientët.
- Identifikimin dhe marrjen e nismave për rregullimin e mëtejshme të kuadrit ligjor/rregullator, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera përgjegjëse, me qëllim uljen në të ardhmen të përdorimit të transaksioneve cash në ekonomi.

## II. T'i rekomandojë Shoqatës Shqiptare të Bankave:

- Ndërmarrjen e nismës për krijimin e “Kodit të Sjelljes” nga bankat e nivelit të dytë që nuk e kanë ende një Kod të Sjelljes/Kod Etike dhe publikimin dukshëm të tij në faqen zyrtare dhe ambientet e bankës, me qëllim rritjen e transparencës së bankave në shërbimet dhe produktet që ato u ofrojnë klientëve.

## III. T'i rekomandojë Bankave të nivelit të dytë:

- T'i mundësojnë klientit përzgjedhjen e vlerësuesit dhe të noterit në një listë të përzgjedhur të bankës, me qëllim rritjen e konkurrencës mes ofruesve të këtyre shërbimeve.
- Nxitja e kartave lokale, që nuk kanë kosto të larta si kartat që emetohen nga skemat ndërkombëtare (MasterCard, apo Visa etj.) që do të mundësonin më shumë përdorim dhe pranim të pagesave pasi kostot do të ishin më të ulta edhe për bankat rrjedhimisht edhe për klientët.
- Të krijojnë lehtësira për lëvizshmërinë e klientëve duke ulur kostot "bllokuese" (kostot të cilat e detyrojnë klientin të qëndrojë pranë një banke si komisione për mbyllje llogarie, kosto administrative për klientin si kohë, rimbushje formularësh, përgatitje dokumentacioni, përdorimi i teknologjive të reja për tu afuar më shumë lehtësi tek klientët) si dhe të rrisin transparencën duke i bërë më të kuptueshme këto kosto për klientin, përfshirë edhe skedën e amortizimit të kredisë, e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe në të gjitha bankat dhe për të gjitha rastet.
- Bankat të bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit dhe Shoqëritë e Ruajtjes së Sigurisë Fizike për të rritur sigurimin e transportit të vlerave monetare brenda dhe për jashtë vendit.

## IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi Bankës së Shqipërisë, Shoqatës Shqiptare të Bankave, bankave të nivelit të dytë, si dhe palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I KONKURRENCËS

## VENDIM

Nr. 454, datë 21.03.2017

**Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i Raportit të Hetimit Paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes;

**Baza Ligjore:** Nenet: 4, 9, 24, germa d); 26, 43 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" si dhe Rregullorja "Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës", neni 5.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të Grupit të Punës "Mbi Hetimin Paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes",

### VËREN SE :

#### PROCEDURA E NDJEKUR

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga Sektori i Analizës dhe Studimeve "Mbi monitorimin e tregut të Gazit të Lëngshëm për konsum familjar dhe biznesin", si dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 42, pika 1, neneve 4 dhe 9, dhe nenit 24 (shkronja d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", me anë të Vendimit Nr. 446, datë 16.01.2017 vendosi "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes".

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 8, datë 16.01.2017 "Autorizim inspektorësh", Grupi i Punës gjatë periudhës së hetimit paraprak, procedoi me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes.

#### Tregu përkatës

Tregu përkatës i Gazit të Lëngshëm të Naftës (GLN)

Për shkak të karakteristikave që GLN-ja mbart në përfitimin e nxehtësisë për përdorim rezidencial, në industri, si karburant për automjetet, etj., si edhe të çmimeve të ulëta krahasuar me karburantet e tjera për shkak të trajtimit të ndryshëm për sa i përket taksimit në vend, GLN-ja paraqet një zëvendësueshmëri të ulët nga ana e

kërkesës konsumatore. Në këto kushte, vlerësojmë se treg përkatës i produktit në këtë rast është:

- Tregu i importit;
- Tregu i depozitimit;
- Tregtimit me shumicë dhe pakicë të produktit GLN.

Për efekt të analizës në raport është pasqyruar edhe tregu i ngarkim - shkarkimit të GLN nga dy Portet që ofrojnë këtë shërbim.

Tregu përkatës i Gazit të Lëngshëm të Naftës (GLN)

Ndërmarrjet nën hetim e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm.

## **STRUKTURA E TREGUT**

Importi dhe tregtimi i GLN-së në territorin e Republikës së Shqipërisë funksionon si një treg i liberalizuar për sa i përket aktivitetit të importit, por kjo veprimtari realizohet vetëm nëpërmjet dy porteve të naftës në zonën gjeografike të ish Uzinës së Sodës PVC në Gjirin e Vlorës dhe në zonën gjeografike të Porto Romanos, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit, duke pasur të "drejtën ekskluzive" për këtë lloj shërbimi në territorin gjeografik përkatës.

Porti "Porto Romano" i është dhënë me koncesion nga shteti Shqiptar, ndërmarrjes "Romano Port" SHA, me anë të Ligjit nr.9298, datë 28.10.2004, Për ratifikimin e "Marrëveshjes së Koncesionit, të formës "BOT" (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës". Me anë të kësaj marrëveshjeve, kjo ndërmarrje ka marrë përsipër të ndërtojë dhe të shfrytëzojë pontilin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe të infrastrukturës së nevojshme portuale, në funksion të depozitave bregdetare që do të ndërtohen në zonën bregdetare të Porto Romanos.

Referuar ekstrakteve të regjistrit tregtar, aksionari kryesor Pirro Bare, ndërmarrja e të cilit është përfituese e koncesionit të "ROMANO PORT" SHA, zotëron:

- 99.84% të aksioneve të ndërmarrjes "ROMANO PORT" SHA, që realizon shërbimin e ngarkim-shkarkimit;
- 50% të aksione në ndërmarrjen "INTER GAZ" SHA që ka ndërtuar depozita gazi pranë këtij Porti;
- 100% të aksioneve në ndërmarrjen A&V GAZ SHA;
- Nëpërmjet ndërmarrjes A&V GAZ SHA zotëron edhe 100% të aksioneve në ndërmarrjen "AV Distribution" SHA, e cila ushtron veprimtarinë në tregun e shitjes me shumicë të GLN-së.

Në të gjithë strukturën e funksionimit të tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të GLN-së nga zona e Porto Romanos kemi ndërmarrje të integruara vertikalisht, e cila rrit fuqinë e këtyre ndërmarrjeve, dhe mund të çojë në kufizime të konkurrencës në zbatim të ligjit 9121/2003.

Porti "Vlora-1" i është dhënë me koncesion nga shteti Shqiptar, ndërmarrjes "La Petrolifera Italo Rumena" SPA, me anë të Ligjit nr.9231, datë 13.05.2004, Për ratifikimin e "Marrëveshjes së Koncesionit të formës "BOO" për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në gjirin e Vlorës", si dhe për ratifikimin e "Marrëveshjes së koncesionit të formës "BOT", për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës". Me anë të 2 (dy) marrëveshjeve të mësipërme, kjo ndërmarrje kishte marrë përsipër që brenda afateve të parashikuara në marrëveshje të ndërtonte dhe të shfrytëzonte terminalin bregdetar në portin "Vlora-1" dhe të infrastrukturës

portale të nevojshme në shërbim të terminalit bregdetar.

### **Nivelet e tregtimit të GLN-së**

Referuar informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) për vitin 2016, si dhe nga informacioni i grumbulluar gjatë inspektimeve rezulton se tregu është strukturuar sipas niveleve të mëposhtme:

- Në nivelin e parë (importit dhe shitjes me shumicë) bëjnë pjesë ndërmarrjet "A&V Gaz" SHA; "Kevin gaz" SHA; "AL- GAZ 2015" SHA; "Kastrati" SHA; "KASTRIOT & PETROL" SHA dhe "Bena Gas" SHA.;
- Në nivelin e dytë bëjnë pjesë ndërmarrjet e tregtimit me shumicë të GLN të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar. Këto ndërmarrje themelohen në formën e shoqërive anonime dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të GLN-së vetëm pas pajisjes me licencë tregtimi. Këto shoqëri kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëri të tregtimit me pakicë të GLN-së, si stacione të shitjes së karburanteve apo njësi të lëndëve djegëse;
- Në nivelin e tretë bëjnë pjesë ndërmarrjet e tregtimit me pakicë të GLN-së të cilat janë të detyruara të furnizohen vetëm nga shoqëritë e tregtimit me shumicë, me qëllim shitje tek personat që janë konsumatorë fundorë.

### **Integrimi vertikal**

Referuar ekstrakteve të regjistrit tregtar, një prej aksionerëve zotëron 99.84% të aksioneve të ndërmarrjes "ROMANO PORT" SHA, zotëron gjithashtu dhe 50% të aksioneve në ndërmarrjen "INTERGAZ" SHA që ka ndërtuar depozita gazi pranë këtij Porti. Gjithashtu ky aksionar zotëron 100% të aksioneve në ndërmarrjen A&V GAS SHA, e cila kryen veprimtari importit të GLN-së. Gjithashtu, ndërmarrja A&V GAS SHA zotëron 100% të aksioneve në ndërmarrjen "AV Distribution" SHA, e cila ushtron veprimtarinë në tregun e shitjes me shumicë të GLN-së.

Në zonën e Portit "Vlora 1", në bazë të marrëveshjes së Koncesionit, ndërmarrja "PIA" zotëron me koncesion Portin dhe infrastrukturën e ngarkim shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së. I gjithë kapaciteti depozitues i GLN-së i janë dhënë me qera ndërmarrjes "FAM GAS" L.L.C.. Ndërmarrja Kevin Gaz SHA 100% të sasisë së importuar e realizon nga ndërmarrja "FAM Gas" L.L.C.. Aksioneri i ndërmarrjes "Kevin Gaz" SHA zotëron 100 % të aksioneve në ndërmarrjen "Manual Gas" SHPK.

### **VLERËSIMI I POZITËS DOMINUESE**

Një nga kriteret kryesore, që përcaktojnë pozitën dominuese në treg është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Përvoja e vendeve të Bashkimit Europian udhëzon, që pozita dominuese nuk është e mundur nëse pjesa e tregut përkatës të ndërmarrjes është më e vogël se 40%. Eksperienca sugjeron se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit.

Ndërmarrja "A&V GAS" SHA për vitin 2016 zotëron një pjesë tregu prej 36.9%, kurse ndërmarrja Kevin Gaz SHA për vitin 2016 zotëron një pjesë tregu prej 36.4%.

Treguesi i përqendrimit në import mbetet i lartë për shkak të numrit të ulët të operatorëve (2) të cilët zotërojnë pjesët kryesore të tregut.

Në përfundim të analizës së pjesëve të tregut për një periudhë gati 5 vjeçare, rezulton se dy ndërmarrjet "A&V

GAS" SHA dhe "KEVIN GAZ" SHA, kanë zotëruar mbi 70% të tregut, dhe në fund të vitit 2016 kanë përkatësisht: 36.9% A&V GAS SHA dhe 36.4% Kelvin Gaz SHA. Kështu të dy ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të madhe tregu të cilën edhe e mbajnë për një kohë të gjatë, duke u bërë partnerë të paevitueshëm për importuesit e GLN-së, dhe për pasojë duke iu siguruar "dominimin" në tregun përkatës.

### **Vlerësimi i kufizimeve të mundshme në treg**

Ndërmarrjet importuese dhe shitëse me shumicë "A&V GAS" SHA dhe "KEVIN GAZ" SHA, kanë një sjellje të bashkërenduar përsa i përket çmimit të shitjes me shumicë të GLN-së dhe ndarjes gjeografike të burimeve të furnizimit, çka mund të përbëjë një praktikë të bashkërenduar/marrëveshje të ndaluar në shkelje të nenit 4, pika 1, të Ligjit 9121/2003.

Mesatarja e diferencës çmim blerje - çmim shitje për periudhën objekt hetimi është shumë e ngushtë dhe thuajse simetrike, duke paraqitur sjelljen e njëjtë që kanë ndërmarrjet "A&V GAS" SHA dhe "KEVIN GAZ" SHA, gjë e cila në kuptim të nenit 4 të Ligjit 9121/2003, mund të përbëjë një praktikë të bashkërenduar/marrëveshje të ndaluar midis këtyre 2 (dy) ndërmarrjeve.

Në të gjithë strukturën e funksionimit të tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të GLN-së nga zona e Porto Romanos kemi ndërmarrje të integruara vertikalisht, e cila rrit fuqinë e këtyre ndërmarrjeve, dhe mund të çojë në kufizime të konkurrencës në zbatim të ligjit 9121/2003.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 4, 9, 24, (germa d); 26, 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar),

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes, për ndërmarrjet si vijon:
    - "ROMANO PORT" SHA, "IB GAS AG", "INTER-GAZ" SHA, "A&V GAS" SHA, "AV DISTRIBUTION" SHA;
    - "LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE" SHA, "FAM GAS", "KEVIN GAZ" SHA dhe "EMANUEL GAS" SHPK.
  - II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore Maj 2015 deri Shkurt 2017;
  - III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se gjashtë {6} muaj nga marrja e këtij vendimi.
  - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit ndërmarrjeve nën hetim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 461, datë 23.05.2017

### Për hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare.

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 23.05.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Relacionit “Mbi monitorimin e tregut të telefonisë celulare me parapagese”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), neni 24, shkronja d, dhe neni 26. Ligji nr. 44/2015 datë 30. 04. 2015 “Kodi i procedurave administrative të RSH”

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Monitorimit të Tregut të Telefonisë celulare me parapagese nga Sektori i Analizës dhe Studimit dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

#### KONSTATOI:

Nisur nga ankesat e depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës nga Qendra “Konsumatori Shqiptar”, si dhe 3 ankimes me objekt "Hetimi i tregut të telefonisë celulare në lidhje me shfaqjen e praktikave të koordinuara dhe abuzimit me pozitën dominuese" për planet tarifore që ofrojnë për publikun e telefonisë celulare, Sekretariati në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar“( këtu e vijim-Ligji) ka monitoruar tregun e shërbimit të telefonisë celulare. Nga monitorimi ka rezultuar se disa nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimet në këtë treg kanë ndryshuar paketat për klientët me parapagim.

Tregu përkatës i produktit është tregu me pakicë i shërbimeve celulare dhe analiza e konkurrencës është fokusuar në sjelljen ndaj çmimit të ofertave, sipas ndërmarrjeve në tregun përkatës. Tregu celular me pakicë përfshin si shërbimet tradicionale të telefonisë dhe mesazheve SMS dhe ato të aksesit broadband në Internet nga rrjete celulare. Gjithsesi analiza fokusohet edhe në segmente të veçanta të përdoruesve/shërbimeve si ato me kontratë dhe parapagim. Sipas statistikave të rregullatorit AKEP, klientët me parapagim përbëjnë rreth 90% të numrit të klientëve të ndërmarrjeve celulare.

Referuar informacionit të mbledhur gjatë monitorimit, rezulton se tre shoqëri kanë ndryshuar paketat standarte në periudhën 27 mars 2017 - 4 prill 2017 në një sjellje të mundshme të koordinuar sipas parashikimeve të nenit 3, pika 4 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), dhe që në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

Gjithashtu bazuar në të dhënat e rregullatorit AKEP, rezulton se tregu i telefonisë celulare ka strukturën e një tregu oligopolistik me një operator me pozitë dominuese në tregun përkatës të shërbimeve celulare me pakicë, si dhe dy ndërmarrje të tjera me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut. Të tre ndërmarrjet zotërojnë bashkërisht

rreth 95 % në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit nr.9121/2003, ekziston mundësia edhe për të abuzuar me pozitën dominuese në treg.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 4; 9; dhe 42; të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), të nenit 4 të Rregullores “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe nenit 12 të Rregullores “Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare për të hetuar nëse ka, apo jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Periudha e Hetimit Paraprak do të jetë 1 Janari 2016 deri në 23 Maj 2017.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi tek palët objekt-hetimi dhe ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në legjislacionin përkatës.
- IV. Raportit të hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komision jo më vonë se 3 muaj nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**



## VENDIM

Nr. 476, datë 05.10.2017

**Për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 390, datë 22.12.2015 dhe mbylljen e hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Koço BROKA       | Anëtar  |
| Znj. Iva ZAJMI      | Anëtar  |
| Z. Eduard YPI       | Anëtar  |
| Znj. Leida MATJA    | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 05.10.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i “Raportin e hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43 pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003). Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Raportit të hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

### VËREN SE :

#### PROCEDURA E NDJEKUR

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga Sektori i Analizës dhe Studimeve “Mbi monitorimin e tregut të Gazit të Lëngshëm për konsum familjar dhe biznesin”, si dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 42, pika 1, neneve 4 dhe 9, dhe nenit 24 (shkronja d) të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr. 446, datë 16.01.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”, vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 8, datë 16.01.2017 “Autorizim inspektorësh”, grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit procedoi me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes.

Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se: mund të ndodhemi para një shkeljeje të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr. 454, datë 21.03.2017 "Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-

shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes", vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes, për ndërmarrjet si vijon: "ROMANO PORT" SHA, "IB GAS" AG, "INTER-GAZ" SHA, "A&V-GAS" SHA, "AV DISTRIBUTION" SHA; "LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE" SHA (PIA), "FAM GAS" L.L.C, "KEVIN GAZ" SHA dhe "EMANUEL GAS" SHPK.

Në zbatim të Vendimit Nr. 454 , datë 21.03.2017 të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin Nr. 9121/2003 dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar.

### **Tregu Përkatës**

Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

- Tregun e produkteve
- Tregun gjeografik

Për sa i përket ngarkim/shkarkim – depozitim dhe importit në rrugë detare kjo veprimtari realizohet vetëm nëpërmjet dy porteve në zonën e ish Uzinës së Sodës PVC në Gjirin e Vlorës dhe në zonën e Porto Romanos, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit. GLN është produkt i cili përftohet nga përpunimi i naftës bruto nëpërmjet procesit të distilimit në rafineritë e përpunimit të naftës. GLN përdoret për përfitim të nxehtësisë në kaldaja dhe për gjenerimin e fuqisë në makina/makineri, për përdorim rezidencial, etj. Llojet kryesore të hidrokarbureve janë: benzina, dieseli, vajguri, kerosene, vajra lubrifikante, solvent dhe gazi i lëngshëm i naftës.

Për shkak të karakteristikave që GLN-ja mbart në përfitim të nxehtësisë për përdorim rezidencial, në industri, si karburant për automjetet, etj, si edhe të çmimeve të ulëta krahasuar me karburantet e tjera për shkak të trajtimit të ndryshëm për sa i përket taksimit në vend, GLN paraqet një zëvendësueshmëri të ulët nga ana e kërkesës konsumatore.

Në këto kushte, vlerësojmë se tregu përkatës i produktit në këtë rast është:

- Tregu i ngarkim – shkarkimit të GLN-së;
- Tregu i depozitimit të GLN-së;
- Tregu i importit GLN-së;
- Tregtimin me shumicë të GLN-së.

Shërbimet e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit nëpërmjet rrugës detare ofrohen nga Porti Vlora -1 në Vlorë (këtu e në vijim Vlora-1) dhe Porto Romano në Durrës, (këtu e në vijim Porto Romano), lidhur me mënyrën e funksionit të secilit port si dhe bazuar në marrëveshjet koncesionare secili nga portet vlerësohet si treg përkatës gjeografik i veçantë.

Përsa i përket importit dhe tregimit me shumicë të GLN-së ndërmarrjet nën hetim zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm.

Struktura e Tregut të Gazit të Lëngshëm të Naftës (GLN)

Importi dhe tregtimi i GLN-së në territorin e Republikës së Shqipërisë funksionon si një treg i liberalizuar për sa i përket aktivitetit të importit, por kjo veprimtari realizohet vetëm nëpërmjet dy porteve të naftës në zonën gjeografike të ish Uzinës së Sodës PVC në Gjirin e Vlorës dhe në zonën gjeografike të Porto Romanos, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit.

Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.454, datë 21.03.2017 dhe analizës së informacionit të grumbulluar gjatë hetimit rezulton se ndërmarrjet nën hetim ushtrojnë veprimtarinë sipas niveleve të mëposhtme:

- **Në nivelin e parë (ngarkim-shkarkim dhe depozitim)** bëjnë pjesë ndërmarrjet Romano Port, Intergaz; IB GAS, PIA, Fam Gas.
- **Në nivelin e dytë (importi)** bëjnë pjesë ndërmarrjet e importit A&V GAS dhe KEVIN GAS.
- **Në nivelin e tretë (tregu i shitjes me shumicë)** bëjnë pjesë ndërmarrjet e tregimit me shumicë të GLN të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 8450/1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre”. Këto ndërmarrje themelohen në formën e shoqërive aksionare dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tregimit me shumicë të GLN vetëm pas pajisjes me licencë tregtimi. Këto shoqëri kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëri të tregimit me pakice të GLN, si stacione të shitjes se karburanteve apo njësi të lendeve djegëse.

#### Tregu i Ngarkim-Shkarkimit dhe Depozitimit të GLN-së

Nga të dhënat e administruara gjatë procedurës së hetimit rezulton se në zonën e Romano Port ekzistojnë 3 (tre) impiante depozitimi të produktit GLN. Ndërmarrja Intergaz disponon në pronësi 5 (pese) depozita me kapacitet 10.000 m<sup>3</sup> të cilat ia ka dhënë me qira për një afat 3 (tre) vjeçar ndërmarrjes IB Gas shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit të Zvicrës.

Në Portin Vlora - 1, aktualisht ekzistojnë dy depozita me kapacitet rreth 2.400 m<sup>3</sup> secila pra në total rreth 4.800 m<sup>3</sup>, të cilat janë në pronësi të koncesionarit PIA. Që prej vitit 2014 këto depozita i janë dhënë me qira ndërmarrjes Fam Gas, ndërmarrje e regjistruar në Kosovë dhe e cila operon në zonën e lirë doganore në portin Vlora-1 duke qenë një kompani e paregjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri.

#### Sjellja e Ndërmarrjeve Romano Port dhe PIA

Ndërmarrja Romano Port në zonën gjeografike të portit Porto Romano ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit të produktit të GLN-së. Në bazë të kontratës koncesionare tarifat e aplikuara nga kjo ndërmarrje miratohen paraprakisht nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA).

Ndërmarrja PIA, e cila ka marrë me koncesion portin Vlora-1, në bazë të marrëveshjes koncesionare ofron shërbimin e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN. Pra, importuesit e GLN-së, në bazë të marrëveshjes koncesionare gjejnë shërbim të plotë për ngarkim-shkarkim dhe depozitim, shërbim që në bazë të marrëveshjes koncesionare në Portin Vlora-1 ofrohet nga PIA, e cila është e detyruar t'ua ofrojë këtë shërbim në bazë të tarifave përkatëse, duke i trajtuar operatorët në kushte të barabarta.

Për sa më sipër, të gjithë ndërmarrjet importuese të licencuara për ushtrimin e tregimit të GLN-së, të cilat nuk kanë ndërtuar depozita pranë portit të Porto Romanos, kanë një mundësi tjetër për importin e GLN-së në rrugë detare nëpërmjet portit Vlora-1.

Në zonën gjeografike të portit Porto Romano gjatë periudhës nën hetim kanë ushtruar aktivitetin e ngarkim-shkarkimit dy ndërmarrje A&V GAS dhe Alb-Durazzo, si dhe një ndërmarrje e re në këtë treg (Al Gaz). Ndërsa në portin Vlora-1 ka ushtruar aktivitetin e ngarkim-shkarkimit vetëm ndërmarrja Fam Gas.

Nga analiza e të dhënave të administruara rezulton se sasia e GLN-së së përpunuar nëpërmjet porti Porto Romano është më e madhe se sasia e përpunuar në portin “Vlora 1”, përkatësisht rreth 45% e sasisë totale të importuar të GLN-së përpunohet në portin Vlora 1 dhe rreth 55% e sasisë në portin Porto Romano.

Nga të dhënat e administruara, konstatohet se ndërmarrja Romano Port nuk i ka ndryshuar tarifat e shërbimeve të ofruara përgjatë periudhës 2015 – 2016 – 2017, si tarifat e aplikuara për ngarkim-shkarkimin e GLN-së ashtu edhe tarifat e administrimit dhe informimit të saj. Tarifat e ndërmarrjes Romano Port miratohen paraprakisht nga OSHA dhe nuk mund të ndryshohen në mënyrë të njëanshme nga vetë ndërmarrja.

Ndërmarrja PIA ka aplikuar tarifa të shkallëzuara gjatë vitit 2015 sipas sasisë së përpunuar të produktit të GLN-së, ndërsa që prej vitit 2016 ndërmarrja PIA ka aplikuar tarifë të unifikuar dhe më të ulët krahasuar me periudhën e mëparshme lidhur me shërbimin e ngarkim-shkarkimit.

Referuar sa më sipër vërehet se ndërmarrjet Romano Port dhe PIA aplikojnë tarifa të ndryshme lidhur me përpunimin dhe administrimin e produktit të GLN-së.

### Tregu i Importit të GLN-SË

Një nga kriteret kryesore, që përcaktojnë pozitën dominuese në treg është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Përvoja e vendeve të Bashkimit Evropian udhëzon, që pozita dominuese nuk është e mundur nëse pjesa e tregut përkatës të ndërmarrjes është më e vogël se 40%. Eksperienca sugjeron se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit

Struktura e tregut të importit të gazit tregon se ndërmarrja A&V GAS, e cila ka patur pjesë tregu mbi rreth 50% gjatë viteve 2012-2014, ka pësuar rënie gjatë dy viteve të fundit, duke mbërritur në 36.9% të tregut të importit të GLN-së për vitin 2016. Ndërsa për periudhën janar-shkurt 2017, pjesa e kësaj ndërmarrje është rreth 19%.

Ndërmarrja KEVIN GAS ka rritur ndjeshëm pjesën e saj të tregut duke mbërritur në 36.4% të tregut të importit të GLN-së gjatë vitit 2016 nga 27.8% që ishte sasia e importuar për produktin GLN të kësaj ndërmarrje në vitin 2015. Volumet sasiore të importuara nga ndërmarrja Kevin Gaz krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 janë rritur me 66% dhe vazhdojnë të jenë të larta duke arritur në rreth 45% për muajt janar-shkurt 2017.

Në përfundim të analizës së pjesëve të tregut, bazuar në udhëzimin mbi pozitën dominuese të ndërmarrjeve në treg dhe praktikave më të mira të Komisionit Evropian, rezulton se ndërmarrja A&V GAS e ka humbur pjesën e tregut që zotëronte në periudhën 2011-2015 dhe nuk e plotëson kriterin e pjesës së tregut për t’u vlerësuar si ndërmarrje me pozitë dominuese.

Në bazë të të dhënave të administruara dhe analizuara rezulton se ndërmarrja A&V GAS ka humbur 10 % të pjesës së tregut të importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së për vitin 2016, kurse ndërmarrja KEVIN GAZ ka fituar 10% të totalit të tregut të importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së në vend për vitin 2016, si edhe ka pasur një rritje me 66 % për sa i përket aktivitetit të saj krahasuar me vitin 2015. Paqëndrueshmëria e pjesëve të tregut për tre vitet e fundit, (A&V GAS - 58% në 2014, 47% në 2015, 37% në 2016) (KEVIN GAZ - 18% në 2014, 28% në 2015 dhe 36% në 2016), jep një panoramë të qartë se nuk jemi para dominancës kolektive.

Gjithashtu, një ndërmarrje e re është futur në treg në Dhjetor të vitit 2015 AL Gaz, me një pjesë tregu prej 15.5% për vitin 2016.

Ndërmarrja KEVIN GAZ është bërë furnizues i disa prej ndërmarrjeve më të mëdha të nivelit të dytë të

tregtimit, si grupi Kastrati, Petrol Gas, Andkri, Mega Gas etj., të cilët gjatë periudhës 2014 - 2015 kanë qenë furnizuar nga ndërmarrja A&V GAS.

Bazuar në praktikat më të mira të OECD-së dhe rasteve të Komisionit Evropian, mbi abuzimin me pozitën dominuese kolektive, ndryshimi i madh i pjesëve të tregut, paqëndrueshmëria e tyre në vite, ndryshimi i burimeve të furnizimit të ndërmarrjeve, ndjekja e politikave të ndryshme të çmimit, janë prova që nuk jemi para një dominancë kolektive të 2 (dy) ose më shumë ndërmarrjeve.

Nga krahasimi i çmimeve mesatare mujore të shitjes së ndërmarrjeve importuese dhe shitëse me shumicë A&V GAS dhe KEVIN GAS me bursën PLATZ për periudhën hetimore maj 2015 deri në shkurt 2017 rezultoi se këto ndërmarrje kanë reflektuar trendin e Bursës PLATZ.

Ndërmarrjet importuese dhe shitëse me shumicë "A&V GAS" SHA dhe "KEVIN GAS" SHA për periudhën nën hetim maj 2015-shkurt 2017 kanë çmime të ndryshme blerje dhe aplikojnë çmime të ndryshme shitje nga njëra-tjetra me diferenca domethënëse për produktin e GLN-së në këtë nivel, krahasuar këto me të ardhurat bruto të realizuara nga shitja e produktit GLN për secilën nga këto ndërmarrje.

Gjatë procedurës së inspektimit në ndërmarrjet nën hetim nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2013. Gjithashtu, sjellja e ndërmarrjeve ndaj çmimit të shitjes, duke aplikuar çmime të ndryshme me diferenca domethënëse për këtë treg, nuk përbën shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003, si dhe Metodologjisë së OECD "Për zbulimin e kartelevë me evidenca indirekte" në formën e një marrëveshje të ndaluar/praktike të bashkërenduar midis këtyre ndërmarrjeve.

Referuar pasqyrave financiare, treguesit EBITDA për periudhën 2013 - 2015 dhe marzhet bruto e të ardhurave për periudhën objekt hetimi tregojnë se nuk jemi përpara normave të fitimeve jo normale ose ekseseve të cilat janë tregues të një tregu që vuan nga mungesa e konkurrencës.

### **Tregu i Shitjes me Shumicë**

Në këtë nivel tregtimi janë përfshirë ndërmarrjet e blerjes dhe shitjes me shumicë të produktit të GLN-së në vend që e blejnë produktin kryesisht pranë ndërmarrjeve importuese ose në disa raste importojnë vetë duke e blerë produktin në magazinë të lirë doganore.

Tregu i blerjes me shumicë të GLN-së nga importi përballet me kushte dhe çmime konkurrionale, ku konstatohet se kemi një lëvizje të vazhdueshme të blerësve nga njëri importues tek tjetri në varësi të diferencave në çmime që këta importues mund të aplikojnë. Ndryshimi i furnitorëve (importuesve) nga ana e ndërmarrjeve që blejnë me shumicë GLN, është pranuar edhe nga ana e përfaqësuesve të ndërmarrjeve gjatë inspektimeve, por edhe konstatohet nga faturat e blerjes së periudhës hetimore.

Nga analiza konkludohet se nuk jemi para çmimeve të fiksuara në shitje në nivelin e tregtimit me shumicë. Çmimet e shitjes variojnë nga njëra ndërmarrje tek tjetra, por duke ndjekur trajektoren e çmimeve të rritura të shitjes, transferuar nga çmimet e bursës PLATZ tek importuesit edhe më pas tek kjo kategori tregtimi.

Nga të dhënat vërehet se ka pasur rritje të pjesëve të volumit të sasive dhe të pjesëve të tregut të ndërmarrjes AV Distribution gjatë vitit 2016, në krahasim me atë 2015, dhe rritje e konsiderueshme e pjesës së tregut për periudhën janar-shkurt 2017, ku pjesa e kësaj ndërmarrje ka arritur në rreth 23%.

Ndërmarrja Emanuel Gas ushtron aktivitetin në nivelin e tregtimit me pakicë, me të drejtë për të shitur direkt tek konsumatorët fundorë. Kjo ndërmarrje e ka filluar aktivitetin e tregtimit të GLN-së në muajin shtator 2015. Bazuar në të dhënat e shitjeve të ndërmarrjes KEVIN GAZ, rezultoi se ndërmarrja Emanuel Gas ka realizuar blerje në sasi që janë në nivele dukshëm më të vogla se ato të realizuara nga ndërmarrjet e nivelit të tregtimit

me shumicë.

Nga analiza konkludohet se nuk jemi para çmimeve të fiksuara në shitje në këtë nivel tregtimi. Çmimet e shitjes variojnë nga njëra ndërmarrje tek tjera, por duke ndjekur trajektoren e çmimeve të rritura të shitjes, transferuar nga çmimet e bursës PLATZ tek importuesit edhe më pas tek kjo kategori tregtimi.

## **PROBLEMATIKAT E FUNKSIONIMIT TË TREGUT**

Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin Nr. 390, datë 21.12.2015 ka vendosur mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Financave.

Gjatë procedurës hetimore ka rezultuar se në treg vazhdon shitja në mënyrë direkte nga shitësit me shumicë tek konsumatori fundor (biznes ose familjar) duke shmangur hallkën e shitjes me pakicë të GLN-së.

### **BAZUAR SA MË SIPËR REZULTON SE:**

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të hetimit në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit produktin gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes, rezulton se nga ndërmarrjet nën hetim nuk ka shkelje të Ligjit Nr. 9121/2013.

Nga hetimi rezultoi se rekomandimet e dhëna me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 390, datë 22.12.2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë” nuk janë vënë në veprim nga Ministria.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

I. T’i rekomandojë Operatorit Shtetëror të Autorizuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave:

- Miratimin e një metodologji për rregullimin e tregut e cila të përcaktojë në mënyrë të qartë rolin, funksionet dhe mënyrën e funksionimit të çdo operatori që vepron në fushën e importit, ngarkim-shkarkimit, depozitimit, shitjes me shumicë, shitjes me pakicë dhe shpërndarjes së gazit të lëngshëm natyror;
- Zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 390, datë 22.12.2015 dhe rekomandimeve të dhëna si vijon:
  - Të ndërmarrë veprimet e nevojshme për mirëfunksionimin e segmenteve të tregut të importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së në përputhje me nenin 14, 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.
  - Të ndalojë ndërmarrjet e shitjes me shumicë të GLN-së të shesin me pakicë tek klientët fundor të cilët nuk janë të përfshirë në nenin 14 të Ligjit Nr. 8450, date 24.02.1999.
  - Të ndalohen ndërmarrjet e tregtimit me pakicë të GLN-së që të tregtojnë produkt për njësi të tjera që kanë si objekt rishitjen e këtij produkti siç parashikohet në nenin 16 të Ligjit Nr. 8450, date 24.02.1999. Njësitë e shitjes me pakicë të GLN-së duhet të tregtojnë produkt vetëm për konsumatorët fundor.



- II. Ndërmarrjet nën hetim, Operatori Shtetëror i Autorizuar dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të njoftojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi zbatimin e rekomandimeve të mësipërme brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- III. Monitorimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës të të gjitha segmenteve të tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, për një periudhë 1 (një) vjeçare, e cila fillon nga data 16 tetor 2017.
- IV. Mbyllet e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara dhe monitorimin e tregut.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**